



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË SARANDË

RAPORT PËRFUNDIMTAR
“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE”

TIRANË, maj 2025

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
Përshkrim i shkurtër i institucionit	3
Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore.....	4
Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	7
II. HYRJE	10
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.....	10
2. Identifikimi i çështjes:.....	10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:	11
4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:.....	11
5. Kriteret e vlerësimit:.....	11
6. Standardet e auditimit	12
7. Metodologjia e auditimit	13
8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:.....	13
III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.....	14
1. Informacion i përgjithshëm	14
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.....	14
1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.....	14
2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	21
3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.....	45
4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve	65
5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	122
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore.....	152
7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	179
III. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	194
A. MASA ORGANIZATIVE.....	195
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.....	231
C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.	234
D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E FONDEVE PUBLIKE.....	
E. MASA DISIPLINORE.....	239

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit në të nxehtë nr. 188/8, datë 12.09.2024, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Bashkinë Sarandë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Përshkrim i shkurtër i institucionit

Bashkia Sarandë kufizohet në veri me Bashkitë Himarë dhe Delvinë, në jug me Bashkinë Konispol, në lindje me Bashkinë Finiq dhe në perëndim me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Sarandës. Bashkia e Sarandës është njësi vendore e pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale përbëhet nga ish bashkia Sarandë dhe ish komuna Ksamil, e cila aktualisht funksionon si Njësi Administrative. Sipas të dhënave në faqen zyrtare, Bashkia Sarandë ka një popullsi prej 50.680 banorësh dhe një sipërfaqe prej 58.96 km². Për vitin 2023 Bashkia Sarandë ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Urdhrin nr. 36, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë dhe sipas numrit të përgjithshëm të punonjësve miratuar me VKB nr. 179 datë 27.12.2022. Buxheti vjetor për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 179, datë 27.12.2022 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 32/1 prot., datë 18.01.2023. Për këtë vit, buxheti është parashikuar në vlerën 1,620,459 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,401,745 mijë.

Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Sarandë administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit, për të siguruar qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, duke vlerësuar nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar nëpërmjet dhënies së opinionit të përputhshmërisë.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë marrë në shqyrtim:

- planifikimi, zbatimi e monitorimi i planit të buxhetit
- funksionimi i kontrollit të brendshëm financiar
- planifikimi dhe realizimi i të ardhurave
- shqyrtimi dhe dhënia e opinionit në përgatitjen e pasqyrave financiare
- administrimi i pronës publike
- organizimi dhe funksionimi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

- *organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit*
- *realizimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimi i kontratave të punimeve.*

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike të kampionuara ose në tërësi sipas rastit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Sarandë për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 56 gjetje dhe janë lënë 67 rekomandime dhe 15 masa disiplinore. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

Gjetjet kryesore:

- Nuk janë ngritur komisione për kryerjen e verifikimeve të aktiveve për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” e cila paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 83,323,719 lekë.
- Nuk është hartuar raport lidhur me inventarizimit fizik të aktiveve, vlerësim paraprak për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtje lidhur me karakterin nëse ka diferenca apo jo për gjendjen e aktiveve.
- Nuk janë marrë masat e duhura për të reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse në total nuk ka të regjistruara 5133.81. ha, nga të cilat, 430.9 Hektarë të sipërfaqeve të pyjeve dhe 783.3 hektarë të sipërfaqeve të kullotave të kaluara në favor të saj sipas VKM-ve përkatëse. Gjatë vitit 2023 janë marrë 8 certifikata pronësie të llojit të pasurisë kullotë dhe pyll, të cilat nuk rezultojnë të evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2023 në llogarinë (211).
- Nga mos marrja e masave të nevojshme nga njësia e taksave dhe tarifave vendore janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 62,061,075 lekë.
- Në 26 raste janë zhvilluar projekte artistike, aktivitete kulturore me vlerë 17,315,695 lekë, për të cilat nuk janë kryer nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit.
- U konstatuan mangësi në të gjitha rastet sa i takon hartimit të kriterëve të kualifikimit dhe konkretisht aplikimi në mënyrë të gabuar i masës së vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme në të gjitha rastet, mos argumentimi apo analizimi i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuar në të gjitha rastet, aplikimi i kriterëve të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës, të cilët kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve në 8 raste, mos përfshirja në çdo rast e të gjithë setit të dokumenteve që lidhen me garantimin e punimeve të ngjashme, apo mos përfshirja e zanateve specifike në çdo rast, pavarësisht se sipas zërave të punimeve nevojiten të tillë dhe konkretisht, sa i takon

objekteve të prokurimit “rikonstruksione apo rehabilitime rrugësh”. Në 8 raste KVO ka shpallur fitues operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve të kualifikimit, si gjatë vlerësimit të vetëdeklarimeve, ashtu edhe gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga fituesit. Në tërësi nga veprimet dhe mos veprimet lidhur me procedurat e prokurimit publik apo shmangien e tyre është shkaktuar një efekt financiar negativ në vlerën 22,142,400 lekë, si dhe nga zbatimi i kontratave të punimeve dhe shërbimeve një dëm ekonomik në vlerën 9,928,993.36 lekë, për punime të pa kryera.

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se në të gjitha rastet, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Në lidhje me miratimin e çertifikatave të përdorimit janë konstatuar problematika si mungesa e licencës së kolaudatorit, kontrata me mbikëqyrësin e punimeve, si dhe licenca e tij, akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, situacioni përfundimtar i kryerjes së punimeve, projekti ‘as built’, projektit për mirëmbajtjen e objektit, çertifikata përfundimtare e auditimit të efikasitetit të energjisë, etj.
- Lidhur me veprimtarinë e Inspektoratit të mbrojtjes së territorit vihet re se jo në të gjitha rastet inspektorët kanë respektuar procedurat e parashikuara në mbajtjen e procesverbaleve të konstatimeve, si dhe dokumentimin e plotë dhe të saktë të kundërvajtjes. Edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit sipas dosjeve të subjekteve. Në 4 raste nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve. Në 71 raste vlera e masës administrative dënim me gjobë është vendosur e pabazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Në së paku 6 raste, konstatimet e kryera nga inspektorët e IMTV, janë klasifikuar (nga ana e kryeinspektorit), si punime për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi, në një kohë që rezultojnë të kundërta. Në katër raste (leje ndërtimi të miratuara dhe objektet janë në zhvillim) është konstatuar se zhvilluesi nuk ka respektuar projektin e miratuar, si dhe IMTV nuk ka marrë masa për këto subjekte, etj.

Rekomandimet më kryesore për përmirësimin e situatës lidhen me sistemimet përkatëse në llogaritë kontabël për mangësitë e konstatuara, masat për arkëtimin e debitorëve nga taksat dhe tarifave vendore, masa për shmangien e mangësive të konstatuara në procedurat e prokurimeve dhe lejeve të ndërtimit, etj. si vijon:

- Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave vendore në Bashkinë Sarandë, të merren masat e nevojshme që në administrimin e dosjeve të bizneseve të përfshihen deklaratat tatimore mbi xhiron vjetore të parashikuar duke kryqëzuar informacionin e disponueshëm që gjendet tek Drejtoritë Rajonale Tatimore, me qëllim identifikimin e saktë të xhirove.
- Nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë, Pyje, Kullota dhe Kullimit në Bashkinë Sarandë, të merren masa konkrete që për subjektet e evidentuara që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Sarandë, të hiqen nga fondi pyjor dhe kullor zona e lejuar e shfrytëzimit dhe të kalojnë si pasuri minerare në varësi të Ministrisë së Linjës.
- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrin masa dhe të miratojnë në Këshillin Bashkiak rradhën e faturave të palikuiduara në fund të periudhave

ushtrimore, duke likuiduar fillimisht ato me të hershmet, si dhe të rakordojë mbi gjendjen e faturave të palikuiduara në bilanc me të dhënat e Ministrisë së Financave.

- Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe Drejtoria Ekonomike, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve që disponon. Drejtoria Ekonomike, Bashkia Sarandë të marrë masa për hartimin e një regjistri të saktë të aktiveve, duke evidentuar vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia, për të gjitha aktivet. Për aktivet dhe asetet e saj Bashkia të marrë masa nisjen e procesit të aplikimeve për regjistrim dhe pajisje me certifikatë pronësie
- Nga Komisionet e vlerësimit të ofertave të merren masa për vlerësimin me korrektësi të cdo dokumentacioni të paraqitur nga ofertuesit duke shqyrtuar me kujdes secilin prej tyre, si dhe të mos vijohet me shpalljen e tyre fitues në rastet kur evidentohen mangësi të cilat nuk përbëjnë devijime të vogla.
- Njësia e prokurimit të marrë masa për mos vijimin e asnjë procedure prokurimi për të cilën nuk ka marrë në dorëzim informacionin e nevojshëm, të qartë dhe të mjaftueshëm nga specialistët e fushës të cilët janë përgjegjës për hartimin e preventivave, zërave të punimeve dhe projekteve, si dhe të garantojë transparencë në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit, duke argumentuar teknikisht me cilat specifikime apo zëra punimesh lidhen ato.
- Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për shmangien e mangësive të konstatuara nga veprimtaris e kësaj Drejtorie, duke punuar çdo herë me praktika të plota.
- Nga ana e kryeinspektorit dhe inspektorëve të IMTV të merren të gjitha masat, për të përfshirë në detyrat e tyre funksionale:
 - dokumentimin e kundërvajtjeve me evidenca fotografike / videografike;
 - dokumentimin e procesit të prishjes së objektit të kundërligjshëm me evidenca fotografike / videografike;
 - përshkrimin e saktë të kundërvajtjes së konstatuar, duke cituar ndër të tjera, materialet e ndërtimit të përdorura, përmasat, volumetrinë, si dhe çdo informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm për përcaktimin e saktë të vendimeve vijuese të kryeinspektorit;
 - përcaktimin e qëllimit të objektit të ndërtuar pa leje, nëse ky objekt është ndërtuar për qëllime strehimi, fitimi, ose ndonjë funksion tjetër, për të gjitha rastet që konstatohen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit ose zonat e mbrojtura.
- Nga Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Sarandë të merren masa në bashkëpunim me Njësitë Bashkiake si dhe me Komisariatit të Policisë për identifikimi i ndërtuesve të pa ligjshëm të pa identifikuar në 42 praktikatat e Vendimeve të Gjobës në vitin 2023, si dhe për ndjekjen e procedurave ligjore të përcaktuara në rastet e shkeljeve të konstatuara
- Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Sarandë të marrë masa, për të vijuar ndërhyrjen për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objekteve të kundërligjshëm, sipas dosjeve të subjekteve: F. Q. Ç.; S. Xh.; E. D.; K. M.; A. F. B.; V. V.; B. H. B.; V. M., Th. B.; B. Gj.; G. S.; J. B.; G. M.;
- Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 9,928,993.36 lekë, të shkaktuar nga zëra punimesh të pa kryera, si dhe arkëtimin e vlerave të konsideruar e ardhur e munguar në total nga taksat dhe tarifat vendore, dhënia me qira, si dhe dhënia e lejeve të ndërtimit.

Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin i auditimit

I. Opinioni mbi Pasqyrat Financiare:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Sarandë për periudhën e mbyllur 01.01.2023-31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për **Opinionin me rezervë**”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Institucionit më 31 dhjetor 2023, referuar kuadrit rregullator në fuqi: Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj..

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 27,944 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “Opinionin të modifikuar me rezervë¹” të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë mangësitë e mëposhtme:

Nuk janë ngritur komisione për kryerjen e verifikimeve të aktiveve për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, si dhe nuk është hartuar raport lidhur me inventarizimit fizik të aktiveve, vlerësim paraprak për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtje lidhur me karakterin nëse ka diferenca apo jo për gjendjen e aktiveve, duke ndikuar në mos pasqyrim të saktë dhe të drejtë të llogarisë së aktiveve në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023.

Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, rezultoi se nuk ka informacion për secilin aktiv, duke mos paraqitur një informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël dhe siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për këto llogari dhe dhënien e opinionit për to.

Nuk janë pasqyruar në kontabilitet sipërfaqe të konsiderueshme të tokave të përfituara nga Bashkia Sarandë nëpërmjet VKM-ve, përfshirë 430.9 ha pyje dhe 783.3 ha kullota (në total 5,133.81 ha), Gjatë vitit 2023 janë marrë 8 certifikata pronësie të llojit të pasurisë kullotë dhe pyll nga të cilat 4 certifikata me sipërfaqe totale 712.4 Ha të llojit Kullotë dhe 149.2 Ha të llojit Pyll. Këto certifikata

pronësie nuk rezultojnë të evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2023 në llogarinë (211), të Bashkisë Sarandë. Veprime dhe mosveprime të cilat kanë ndikuar në mos pasqyrim të saktë dhe të drejtë të llogarisë 211, në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023.

Nga auditimi ka rezultuar se në Llogarinë 212 “Ndërtesa Konstruksiione” vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Opinionin mbi përputhshmërinë.

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Bashkia Sarandë me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Sarandë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të kualifikuar të përputhshmërisë”.

Baza për opinionin:

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Bashkia Sarandë në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të kualifikuar.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

1. Nga auditimi në lidhje me procedurat e prokurimit, u konstatuan mangësi:

- Në hartimin e kriterëve të kualifikimit e konkretisht aplikimit në mënyrë të gabuar të masës së vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme;
- Në mos argumentimin apo analizimin e nevojës për numrin e punonjësve;
- Në mos argumentimin apo analizimin e numrit të makinerive të kërkuar;
- Në aplikimin e kriterëve të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës, të cilët kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve;
- Në mos përfshirjen në çdo rast e të gjithë setit të dokumenteve që lidhen me garantimin e punimeve të ngjashme, apo mos përfshirja e zanateve specifike në çdo rast, pavarësisht se sipas zërave të punimeve nevojiten të tillë dhe konkretisht, sa i takon objekteve të prokurimit “rikonstruksiione apo rehabilitime rrugësh”;
- Në 8 raste KVO ka shpallur fitues operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve të

kualifikimit, si gjatë vlerësimit të vetë deklarimeve, ashtu edhe gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga fituesit:

- Gjithashtu në tërësi nga veprimeve dhe mos veprimeve lidhur me procedurat e prokurimit publik apo shmangien e tyre është shkaktuar një efekt financiar negativ **në vlerën 22,142,400 lekë**, si dhe nga zbatimi i kontratave të punime dhe shërbimeve një dëm ekonomik në vlerën **9,928,993.36 lekë**, për punime të pa kryera.

2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se:

- Në trembëdhjetë raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, nuk është i plotë sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore, si në drejtim të mungesës së vërtetimeve të regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore, mungesës së licencave profesionale të tyre, mungesës së policave të sigurimit dhe deklaratave të përgjegjësisë profesionale;

- Në projektet ndërtimore ka mangësi në dokumentacionin që vërteton të drejtat pronësore, në projektin në formatin DWG, në studimin sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, në preventivin e punimeve, në oponencën teknike, në marrëveshjet e lidhura midis palëve për zhvillimin e objekteve fqinje me faqe kallkan, etj.;

- Ka vonesa në shqyrtimin e aplikimeve të subjekteve;

- Ka mangësi në licencat e kolaudatorit, në kontratat me mbikëqyrësit e punimeve dhe licencat e tij;

- Ka mungesa të situacionit përfundimtar të kryerjes së punimeve, të aktit të menaxhimit të mbetjeve urbane, të projektit për mirëmbajtjen e objektit, të çertifikatave përfundimtare të auditimit të eficiencës së energjisë, etj.

3. Nga auditimi i veprimtarisë së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Sarandë u konstatua se:

- Në disa raste nuk janë respektuar procedurat e parashikuara në mbajtjen e procesverbaleve të konstatimeve, si dhe dokumentimin e plotë dhe të saktë të kundërvajtjes;

- Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka vijuar procedurat për arkëtim e shumave të detyrimit sipas dosjeve të subjekteve, edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga inspektorët e terrenit;

- Në 4 raste nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve;

- Në 71 raste vlera e masës administrative dënim me gjobë është vendosur e pabazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore;

- Në 6 raste, konstatimet e kryera nga inspektorët e IMTV, janë klasifikuar (nga ana e kryeinspektorit) si punime për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi, në një kohë që rezultojnë e kundërta;

- Në 4 raste (leje ndërtimi të miratuara dhe objektet janë në zhvillim) është konstatuar se zhvilluesi nuk ka respektuar projektin e miratuar, si dhe IMTV nuk ka marrë masa për këto subjekte;

4. Nga mos marrja e masave të nevojshme nga njësia e taksave dhe tarifave vendore janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 62,061,075 lekë.

5. Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi ligjshmërinë dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë, rezultojnë se në 26 raste janë zhvilluar projekte artistike, aktivitete kulturore me vlerë 17,315,695 lekë, për të cilat nuk janë kryer nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e këtyre shpenzimeve është kryer sipas Vendimit Nr.51, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak.

II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 188/8 prot., datë 12.09.2024, i ndryshuar, nga data 12.09.2024 deri më datë 20.12.2024, në subjektin Bashkia Sarandë, u krye auditimi në të nxehtë, financiar dhe i përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R. K., Përgjegjës grupi
2. A. M., Anëtar
3. P. Xh., Anëtar
4. R. Xh., Anëtar
5. A. H., Anëtar
6. G. K., Anëtar

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet Bashkisë Sarandë dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Sarandë.

2. Identifikimi i çështjes:

Raporti Përfundimtar synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH-së në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe logaritidhënies.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Sarandë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Titullari i Bashkisë, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj. Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe gjithë veprimtarisë.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë e të kryejnë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH-së marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.

5. Kriteret e vlerësimit:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Ligji nr. 84/2023 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar; etj.;

Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;

Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në fushën e prokurimeve publike:

Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore për prokurimin publik;

Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;

UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;

VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”;

VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësive vendore”;

Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e

Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

7. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël. 4. Kontrolli i vlerësimit Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre. 5. Konfirmim nga të tretët Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

3. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Sarandë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

4. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion i kërkuar dhe i vënë në dispozicion lidhur me çështjet nën auditim.

8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Audituesit e KLSH-së, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë mbledhur dhe shqyrtuar dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet

letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Zona Gjeografike: Bashkia e re Sarandë kufizohet në veri me bashkitë Himarë dhe Delvinë, në jug me bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Finiq dhe në perëndim me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Sarandës. Bashkia e re ka dy njësi administrative, qytetin e Sarandës dhe komunën e Ksamilit. Sipas të dhënave në faqen zyrtare, Bashkia Sarandë ka një popullsi prej 50.680 banorësh dhe një sipërfaqe prej 58.96 km². Bashkia Sarandë përbëhet tërësisht nga vija bregdetare nga Koka e Qefalit në veri deri te Kanali i Vivarit në jug, ku shërbimet e turizmit detar dhe kulturor përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Fshati i Çukës, i cili u shkëput nga Saranda në vitin 1996 për të kaluar në varësi të komunës Aliko, është rikthyer në varësi të Sarandës. Asetet kryesore ekonomike të qytetit janë deti, peshkimi, liqeni i Butrintit dhe pasuritë e stërmëdha arkeologjike, parku arkeologjik i Butrintit dhe objekte të tjera të rëndësishme si Manastiri i 40 Shenjtorëve, Kalaja e Lëkurësit, Manastiri i Shën Gjergjit, rrënojat e kalasë së qytetit etj.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat:

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Sarandë	Qyteti Sarandë, Fshatrat: Gjashtë, Metoq, Çukë, Shelegar
Ksamil	Fshatrat: Ksamil

Forma dhe mënyra e organizimit:

Numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 179 datë 27.12.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 32/1 datë 18.01.2022. Struktura Organizative është miratuar me Urdhërin nr. 36, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë.

Për vitin 2023 në këtë institucion struktura organizative e miratuar, përbëhet nga 437 punonjës (pozicione 178), 65% të pozicioneve të strukturës, që përfaqësojnë 117 pozicione pune (287 punonjës).

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm

Në zbatim të Programit të Auditimit në të "Nxehtë", "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë mbi Veprimtarinë e Bashkisë Sarandë" me nr.188/8 prot., datë 12.09.2024, i ndryshuar, për drejtimin nr.1 të Programit të Auditimit, objekti i këtij akt konstatimi është vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Sarandë, për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

1.Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që

kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Sipas Manualit të MFK, në kreun III, “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19 citohet: *Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:*

1. *Mjedisi i kontrollit.*
2. *Menaxhimi i riskut.*
3. *Veprimtaritë e kontrollit.*
4. *Informacioni dhe komunikimi.*
5. *Monitorimi.*

1.Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Aangazhimin për integritet dhe vlerat etike”

Nga auditimi u konstatua se, institucioni megjithëse ka hartuar dhe zbaton një kod etike, i cili është miratuar me Rregulloren e Brendshme me nr.277, datë 20.12.2022, nuk ka procedura të sinjalizimit të rasteve të parregullsisve, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme, nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

Nga auditimi konstatohet se Institucioni nuk ka një procedurë të miratuar në lidhje me vlerësimin e performancës së punonjësve, si dhe nuk ka një plan mbi trajnimin e punonjësve dedikuar sjelljes etike veprime në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 *“Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”*, paragrafët *“Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore”* dhe *“Profesionalizmi i stafit”*.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari i njësisë publike është përgjegjës për ngritjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

Nga auditimi konstatohet se ka mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike pasi nuk ka një plan menaxhimi për veprimet korrigjuese. Nga ana e njësive të varësisë nuk ka raporte në lidhje me veprimtaritë e tyre.

Gjatë vitit 2023, rezulton se janë kryer 7 urdhra për delegim kompetencash, ku konstatohet se në Bashkinë Sarandë nuk ka një rregullore të brendshme ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, neni 15 *“Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”*, si dhe Kapitulli III *“Delegimi i detyrave”*, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

- Nuk është hartuar dhe miratuar një dokument i veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, por këto nuk janë përfshirë as në rregulloren e brendshme.

Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe planveprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Në këtë njësi vendore ekzistojnë linja raportimi vertikal për realizimin dhe horizontal për përmbushjen e përgjegjësedhe rrjedhën e informacionit.

- Në Bashkinë Sarandë delegohen përgjegjësitë nga ana e menaxherëve, në rastin e përmbushjes së detyrave për koordinimin e menaxhimit financiar dhe koordinimin e riskut nga nëpunësi i autorizuar tek nëpunësi zbatues, por në asnjë rast nuk është analizuar risku gjatë delegimit të detyrës.

- Takimet e përfaqësuesve të Bashkisë Sarandë me palët e treta, grupet e interesit si dhe dëgjesat

me publikun nuk janë të dokumentuara me procesverbal.

Në lidhje me parimin 4 *“Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave”*

- Nuk është përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit mënyra e rekrutimit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si dhe eprori direkt i Bashkisë Sarandë, për periudhën e auditimit viti 2023 nuk kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.

-Në rastet e largimeve dhe emërimeve në pozicionet drejtuese për vitin 2023 sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.

Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës.

Në lidhje me parimin 5 *“Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”*

- Në rregulloren e brendshme është përcaktuar detyra e çdo punonjësi për plotësimin e objektivave por në nivel strategjik nuk ka një përfshije për periudha afatgjata për hartimin dhe monitorimin e objektivave.

- Me Urdhrin nr. 44 datë 23.03.2023, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2023, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, neni 8, germa “b”, neni 24, pika 2, pjesë e mbledhjeve të këtij grupi është dhe drejtuesi i njësive se auditit të brendshëm.

- Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësive, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave nuk është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësive, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Në lidhje me parimin 6: *Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.*

-Bashkia Sarandë ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut nëpërmjet Urdhrit nr.34 datë 23.02.2024, i cili rishikohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, por nuk ka marrë masa për implementimin dhe më tej kontrollin e funksionimit të kësaj strategjie.

-Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Sarandë.

-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2, neni 21 “Menaxhimi i Riskut”.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”

- Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë Bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.

- Nuk ka një plan veprimi të mirfilltë për vlerësimin e një risku direkt me relizimin e objektivave specifike.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim”

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

- Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”

Bashkia Sarandë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke mos marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke mos përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III.Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Sektorit të kontrollit Financiar dhe Kontabilitetit/ hartimi dhe rregjistrimi i pagesës kryhet nga specialitet e Sektorit të pagesave , ndërsa Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë(NA).

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit.

- Për cdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i vecantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

- Bashkia Sarandë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të

ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

-Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)apo për ruajtjen e tij.

- Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

- Mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga mungesa e sektorit të auditit.

Në lidhje me parimin 12: *“Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”*

- Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve për të gjitha nivelet në të gjitha aktivet e përfshira.

- Bashkia Sarandë nuk ka procedura të shkuara operative për vlersimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3 ku citohet se: *“2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.*

IV.Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: *“Njësia Publike merr,gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.*

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Në lidhje me parimin 14: *“Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm sistemin elektronik dhe shkresor”*

- Nuk ka një procedurë të shkruar për të siguruar që menaxherët dhe personeli i strukturave të bashkisë të informohen për vendimet dhe projektet që mund të ndikojnë në veprimet dhe përgjegjësitë e tyre, përveç rasteve kur e kërkon ligji për publikim.

-Nuk ka raporte periodike të performacës së bashkisë dhe as publike vjetore në lidhje me shërbimet publike.

-Në disa raste adresimi i shkresave nuk ka shkuar në sektorin përkatës ose shkresat kanë vonesa në kthim pergjigjesh. Nuk janë analizuar shkaqet dhe as masa për parandalimin e ceshtjeve.

Në lidhje me parimin 15: *“Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.”*

- Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit. Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

V.Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Nga auditimi konstatohet se nuk ka një monitorim të zbatimit të sistemit të kontrollit të

brendshëm lidhur me arritjen e objektivave, kryesisht mbi kontrollin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë mbi veprimtarinë duke mbajtur në konsideratë parimet e ekonomicitetin, eficientë dhe efektivitetin.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetsorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar cdo vit pranë Drejtorit të Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

- Në Bashkinë Sarandë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në lidhje me parimin 17: *“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”*

- Në nivel drejtues kryhet monitorimi për statusin e veprimeve përmiruese edhe pse nuk janë mbajtur plane të mirëfillta veprimi.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. I. Zh., Sekretar i Përgjithshëm, znj. F. E., Drejtor i Drejtorisë së Personelit dhe Burimeve Njerëzore, znj. T. S., Drejtor i Drejtorisë së Financës, znj.G. K., specialist jurist në Drejtorinë Juridike, z. M. M., Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

2.Mbi auditimin e organizimit dhe funksionimit të njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

2.1.Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm në Bashkinë Sarandë

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Objektivat kryesore të Strukturës së Auditit të Brendshëm lidhen me kryerjen e misioneve të auditimit (të miratuara nga Kryetari i Bashkisë) në strukturat e varësisë në Bashkinë Sarandë, për të evidentuar zbatimin e dispozitave ligjore referuar Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik dhe Kartës së Auditimit, e miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr.15 datë 13.01.2023 *“Për miratimin e kartës së auditimit të brendshëm”*.

Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.36, datë 06.02.2023 *“Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Sarandë, Institucioneve në varësi për vitin 2023”*.

Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Sarandë është e organizuar me 3 (tre) punonjës, 1 (një) Drejtor dhe 2 (dy) specialist audit, bazuar në nenin 10 në Ligjin nr.114/2015 datë 22.10.2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, si dhe në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *“Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”*.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Struktura e Sektorit të Auditit të Brendshëm, si vijon:

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnim e të vijueshme
1	M. M.	Drejtor	13.08.2010	Ekonomi, Financë	45	13	2012	Po
2	K. H.	Specialiste	09.12.2017	Ekonomik, Statistikë	36	6	2018	Po
3	V. V.	Specialiste	25.05.2023	Punonjëse Sociale	8	1	Pa	Jo

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnim e të vijueshme
							çertifikuar	

Nga auditimi i strukturës së Auditit të Brendshëm, konstatohet se për vitin 2023, 1 (një) punonjës është i pa çertifikuar, në kundërshtim me Ligjin nr. nr114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, pika “2” germat “c” dhe “ç”.

2.2. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Sarandë ka përgatitur Planin Strategjik të cilin e ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE për vitet 2023-2025 me shkresën nr.4069/1, datë 11.10.2022.

Raporti vjetor i veprimtarisë audituese të miratuar nga Titullari i Institucionit për vitin 2023, është dërguar me shkresën nr.759, datë 13.02.2024 në MFE, bashkë me pasqyrat shoqëruese, brenda afatit të përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Me shkresën nr.4069/1, datë 11.10.2022, është përcaktuar edhe Plani Vjetor për vitin 2023, mbi auditimet që do të realizohen nga Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Sarandë për misionet e auditimit si më poshtë:

- Drejtoria e Politikave dhe Mbështetjes Sociale, Bashkia Sarandë;
- Qendra e Kulturës, Bashkia Sarandë;
- Detyrimet e prapambetura (Drejt. E Finances, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Zyra Arsimore);
- Qendra ditore polivalente, Bashkia Sarandë;
- Drejtoria e Personelit, Bashkia Sarandë;
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Sarandë;
- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të Territorit;
- Zbatimi i Rekomandimeve (Subjekte të audituara për vitin 2022).

Gjatë vitit 2023, janë planifikuar si më sipër 8 auditime të cilat janë realizuar, por konstatohet se është bërë ndryshim të planit fillestar ku është zëvendësuar auditimi në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit me auditimi në Shtëpinë e Fëmijës.

Nga auditimi i raporteve të auditimit për vitin 2023, në mënyrë të përmbledhur rekomandimet e lëna nga Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Sarandë paraqiten si më poshtë:

Viti	Të dhëna sipas Raportimit			
	Rekomandime te shprehura ne numër			
	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pa Zbatuar
2023	26	13	12	1
	26	13	12	1

Referuar tabelës më sipër rezulton se Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Sarandë, në auditimet e zhvilluara ka lënë 26 rekomandime në total, të cilat janë pranuar. Nga 26 rekomandime rezulton të jenë zbatuar 13 prej tyre, në proces zbatimi 12 prej tyre si dhe pa zbatuar 1 rekomandim.

Konkluzion:

Nga auditimi i Planit Vjetor të përgatitur për vitin 2023, konstatohet se nuk ka një analizë të thelluar të fushave me risk, mungon analiza mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna ku të përcaktoheshin përgjegjësitë dhe marrja e masave mbi konstatimet në raportet e auditimit. Gjithashtu Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka realizuar misionin e auditimit mbi kryerjen e monitorimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik”, neni 11 pika 2, gërmat “b” dhe “c” dhe neni 6 “Roli i auditimit të brendshëm” gërmat “i” dhe “ç”.

Nga auditimi konstatohet se plani vjetor i auditimit për vitin 2023 ka pësuar ndryshime, të pa argumentuar si dhe nuk ka një analizë të qartë për arsyet e ndryshimit të planit vjetor, duke zëvendësuar një mision auditimi i cili është me risk të lartë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik” dhe me Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Nga auditimi i dosjeve për vitin 2023, konstatohet se nuk ka një analizë të thelluar mbi vlerësimin e riskut, mungon analiza mbi hartimin e testeve të auditimit si dhe planet e veprimit mbi entitete e audituara. Gjithashtu nuk është hartuar programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe nuk është ngritur Komiteti të Auditimit, veprime në kundërshtim me Manualin të Auditimit të Brendshëm.

Nga auditimi i raportimit vjetor të dërguar në MFE, konstatohet se nuk është sipas strukturës së miratuar si dhe nuk ka një analizë mbi veprimet e ndërmarra nga Titullari i Institucionit për zbatimin e rekomandimeve, veprime në kundërshtim me Manualin të Auditimit të Brendshëm.

Për periudhën 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim fushat me risk të lartë si vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, prokurimet publike, etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional veprime në kundërshtim me pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”. Gjithashtu konstatohet se nuk janë përfshirë në planin e auditimit subjekte të teknologjisë së informacionit, mbi auditimin e të dhënave të sistemit të taksave dhe tarifave vendore.

Nga auditimi i Projekt Raporteve të Auditimit dhe Raporteve Përfundimtare të Auditimit për të gjithë misionet e auditimit të zhvilluara në vitin 2023, konstatohen mangësi në strukturën e tyre, duke filluar nga analizimi i riskut, idenfitikimi i risqeve të sistemi të kontrollit të brendshëm, përcaktimi i materialitetit, përgatija e opinioneve të auditimit duke i shoqëruar me gjetjet kryesore si dhe evidencat audituese të mbajtura, veprime në kundërshtim me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm”.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. M. M., Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, znj. K. H. specialiste dhe znj. V. V. specialiste.

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

Në zbatim të pikës 2 “Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit” të Programit të Auditimit Nr.188/8 Prot, datë 12.02.2024, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni i hartimit të programeve buxhetore afatmesme PBA 2023-2025 miratimet e

PBA-ve dhe korrespondenca;

- Dokumenti i programimit buxhetit vjetor për vitin 2023 të miratuara me VKB, fondet e transferues së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë këtyre viteve buxhetore;
- Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Sarandë për shpenzimet dhe të ardhurat;
- Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve si fatura të pa likujduara dhe vendime gjyqësore.
- Dokumentacionet e hartuara periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023;
- Të tjera dokumente mbështetëse (Data bazë të ndryshme ne programet “Excel”, si për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet te ardhurat etj.).

2.1. Programimi i PBA 2023-2025 dhe programimi i buxhetit vjetor 2023.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhër të Titullarit të Institucionit të cilat kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB Nr.179, datë 27.12.2022. Me shkresën Nr.3485 Prot., datë 10.08.2022 dhe Urdhrin Nr.158, datë 10.08.2022 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) si dhe ekipet e menaxhimit të programeve i përbërë nga 17 anëtarë sipas njësive shpenzuese buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor vjetor për vitin 2023.

Projekt buxheti afatmesëm për vitin 2023-2025 është hartuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat e Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr.68-2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore afatmesme dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresë Nr.1873 Prot, datë 06.06.2023 dhe shkresën Nr.3904 Prot, datë 13.09.2023 me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dyte të PBA 2023-2025. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2023-2025, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve. Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 10 programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2023-2025 janë përcaktuar “Përshkrimi” i çdo program, “Politika e programit”, “Qëllimi i Politikës së programit”, “Objektivat e politikës së programit”. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij.

Sipas planifikimit të programit buxhetor afatmesëm për vitin 2023 (trajtuar në aneksin përkatës), Bashkia Sarandë ka parashikuar të ardhura për vitin 2023 në shumën totale 1,620,459 mijë lekë, për vitin 2024 ka parashikuar të ardhura në shumën totale 1,311,411 mijë lekë dhe për vitin 2025 ka parashikuar të ardhurat në shumën 1,344,770 mijë lekë. Për vitin 2023 shuma e të ardhurave të parashikuara rezultojnë të jetë më e lartë pasi referuar të dhënave rezultojnë se në pritshmërinë e vitit 2023 ndikon shuma e transfertave dhe të ardhurat e trashëguara, ndërsa të ardhurat e tjera janë në nivele të përafërta për parashikimet e PBA-së.

Për vitin 2023 buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë VKB Nr.179 datë 27.12.2022 i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, me shkresën Nr.32/1 prot, datë 18.01.2023 sipas aneksit bashkëngjitur.

Mosrakordime ndërmjet PBA dhe buxhetit vjetor 2023 vjen si rezultat i parashikimit jo të saktë të të ardhurave të papërdorura dhe të tjera në PBA 2023-2025. Buxheti është rishikuar me VKB Nr.48, datë 31.03.2022 dhe i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, me shkresën Nr.75/2 Prot, datë 17.04.2022. Burimet e financimit të buxhetit të bashkisë për vitin 2023, (Të ardhurat e veta + Transferta e pakushtëzuar) janë në vlerën 1,179,459 mijë lekë. Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA në anekse.

Nga të dhënat e tabelave në anekse për PBA 2023-2025 rezulton se nuk rakordojnë PBA të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023 pasi në planifikimin e të ardhurave sipas PBA rezulton se shuma burimit të të ardhurave paraqitet në vlerën 1,207,641 mijë lekë ndërsa ndarja e shpenzimeve sipas natyrës për vitin 2023 paraqitet në vlerën 1,385,224 mijë lekë. Referuar të dhënave në tabelën 3 sa më sipër evidentohet analiza e zërave sipas llojit të të ardhurave të parashikuara. Pra rezulton me një mosrakordim në nivelin e parashikimit të PBA në vlerën 177,583 mijë lekë ose në nivelin prej 87% të realizimit.

Duke u nisur nga burimi i financimit për vitin 2023 shpenzimet buxhetore janë planifikuar për t'u përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 855,607 mijë lekë (të ardhurat e vitit në vlerën 497,400 mijë lekë dhe të trashëguara (nga të ardhurat e pa përdorura) në vlerën 358,207 mijë lekë) ose në masën 72.5 %, nga projektet IPA në shumën 6,000 mijë lekë, nga transfertat e pakushtëzuar në shumën 161,021 mijë lekë ose në masën 13.65%, transfertat specifike sektoriale në shumën 156,720 mijë lekë ose në masën 13.3 %. Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2023 shpenzimet për paga e sigurime janë për vlerën 348,900 mijë lekë ose 38 %, shpenzime korrente zënë 40 % ose për vlerën 459,228 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 22 % ose në vlerën 365,320 mijë lekë.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor nuk kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, përveç faktit ku janë transferuar fondet për funksionet e deleguara, sa i përket transferimit të vlerës 13,700,000 mijë lekë në llogari të Qendrës Kulturore dhe Shumësportesh për aktivitetin e Ekipit të Futbollit Butrinti. Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës. Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit". Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të regjistruara dhe të rakorduara me Degën e Thesarit Sarandë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE.

Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e

audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

- Ndryshimet buxhetore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Kështu për vitin 2023 në fund të vitit sipas akt-rakordimit me thesarin, buxheti është ndryshuar për vlerën 13,700,000 mijë lekë. Grand pakësim për vlerën 13,700,000 mijë lekë (pakësim shpenzimesh nga rakordimi me Degën e Thesarit Sarandë, të paparashikuara), miratuar me VKB Nr.48, datë 31.03.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.675/2, datë 27.07.2022, si më poshtë vijon:

Në 000/lekë

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli			
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma
01.01.2023-31.12.2023	179/27.12.2022	13,700,000	48/31.03.2023	13,700,000	602	13,700,000	602	13,700,000
					Progr.8130		Progr.1110	
Totali Viti 2023		13,700,000				13,700,000		13,700,000

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit; Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Sarandë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Sarandë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2023 referuar akt akordimeve me thesarin dhe sipas burimeve të financimit paraqitet si më poshtë:

Për vitin 2023, sipas situacioneve dhe akt rakordimit me thesarin buxheti i planifikuar për vlerën 1,620,459 mijë lekë dhe është realizuar për vlerën 1,401,745 mijë lekë, në aneksin bashkëlidhur.

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për vitin 2023, buxheti është realizuar në masën 87%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,620,459 mijë lekë është realizuar vlera prej 1,401,745 mijë lekë. Ndërsa vetëm për aparatën e bashkisë realizimi është në nivelin 85%, ku nga vlera e parashikuar prej 1,322,126 mijë lekë është realizuar vlera 1,122,645 mijë lekë, nga e cila:

- Zëri investime paraqitet në masën 83%, ku nga vlera e parashikuar prej 567,328 mijë lekë është

realizuar vlera 469,768 mijë lekë. Shpenzimet operative paraqiten në masën 90%, ku nga vlera e parashikuar prej 323,237 mijë lekë është realizuar vlera 290,797 mijë lekë dhe shpenzimet për paga në masën 94%, ku nga vlera e parashikuar prej 126,358 mijë lekë është realizuar vlera 118,472 mijë lekë. Këto mos realizime vijnë nga fakti se struktura organike nuk është plotësuar për numrin e punonjësve të miratuar me VKB dhe se një pjesë e procedurave të parashikuara nuk janë zhvilluar për mungesë stafi, ndërsa pjesa tjetër nuk është financuar pasi nga shoqëritë sipërmarrës nuk janë paraqitur për likuidim dokumentacioni i plotë ligjorë.

Nga të dhënat e pasqyrës në aneks, konstatohet se një pjesë e procedurave janë në proces dhe nuk janë mbyllur ose nga subjektet sipërmarrës nuk janë paraqitur dokumentacioni i plotë përfundimtar për likuidimin dhe marrjen në dorëzim të tyre.

- Mbi detyrimet e prapambetura të raportuara Janar-Dhjetor 2023 sipas raportimit në MFE. Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2022	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023-31.12.2023	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2023	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023
Mallra dhe shërbime	4,586,147	1,163,220	4,586,147	4,542,447	43,700
Vendime gjyqësore	3,177,925		3,177,925	1,997,925	1,180,000
Të tjera			-	-	-
Totali	7,764,072	1,163,220	8,927,292	6,540,372	1,223,700

Konstatimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare, konkretisht llogarive të detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë Sarandë ndaj palëve të treta, konstatohet se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2023 është në vlerën 7,833,710 lekë (nga e cila Llog. 401-408 në vlerën 1,132,200 lekë dhe Llog. 467 në vlerën 6,701,510 lekë), të shpenzimeve të institucionit, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE është në vlerën 1,223,700 lekë, e cila tregon se Drejtoria e Financës raporton në MFE një vlerë të detyrimeve të prapambetura më pak se vlera e tyre e pasqyruar në raportimin e vetëvlerësimit financiar për shumën 6,610,010 lekë më shumë në pasqyrat financiare.

- Situata financiare e Bashkisë Sarandë.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi situatën financiare që paraqet Bashkia Sarandë, rezulton se është në nivelin e 0.1 %. Në këtë situatë nuk janë paraqitur faturat e palikuiduara me fonde të deleguara (specifike), pasqyruar në anekset bashkëlidhur

Konkluzioni: Situata financiare e Bashkisë Sarandë, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 dhe gjendjes së faturave të palikuiduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelin 0.10 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se Bashkia Sarandë nuk është në vështirësi financiare.

- Fondi rezervë/dhe kontigjencës

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për

vitin 2022 në vlerën 5,000 mijë lekë, dhe nuk është përdorur. Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/investime etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Sarandë, për periudhën 01.01.2023–31.12.2023, u konstatua se nuk është likuiduar janë 16 fatura në vlerën 5,897,452 lekë brenda afatit 30 ditorë nga momenti i paraqitjes së tyre, sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr	Periudha	Llog.602		Llog.230+231		Shuma	
		Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera
1	Viti 2023	12	2,341,000	4	3,556,452,	16	5,897,452

Vlera e detyrimeve të faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore dhe planifikimi në buxhetet respektive, të dhëna sipas pasqyrës si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr./datë	Llog.602	Llog.230+231	Vendime gjyqësore
Viti 2021	30,401,541	25,000,000	204/24.12.2020	26,277,310		4,124,231
Viti 2022	7,764,072	10,000,000	168/24/12/2021	7,764,072		2,014,705
Viti 2023	1,223,700	4,000,000	179/27/12/2022	1,000,000		3,000,000
Totali	39,389,313	39,000,000	0	35,041,382	0	9,138,936

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës 31.12.2023.

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2022	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023-31.12.2023	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2023	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023
Mallra dhe shërbime	4,586,147	1,163,220	4,586,147	4,542,447	43,700
Vendime gjyqësore	3,177,925		3,177,925	1,997,925	1,180,000
Të tjera			-	-	-
Totali	7,764,072	1,163,220	8,927,292	6,540,372	1,223,700

-Mbi vendimet gjyqësore.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 1,180 mijë lekë, dhe janë likuiduar në shumën 1,997,925 mijë lekë. Mbetet pa likuiduar në fund të vitit vlera prej 1,180,000 mijë lekë. Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Sarandë, ndiqet praktika sipas pikës 34 të UMF Nr.8, që vendimet gjyqësore regjistrohen në kontabilitet kur marrin formë të prerë sipas vendimit të gjykatës së apelit, ndërkohë që minimalisht për të gjitha vendimet gjyqësore edhe të shkallës së parë duhet të jepen shpjegime dhe informacion në pasqyrën e shënimeve shpjeguese.

Në lidhje me shpenzimet e përmbarimore për vitin 2023, janë likuiduar në total shuma prej 1,509,892 lekë.

Nr	Përshkrimi	Urdhër-pagesa	Data	Shuma
1	Shpenzime Gjyqësore, Zyra Përmbarimore "A."	592	13.12.2023	174,307
2	Shpenzime Gjyqësore, Zyra Përmbarimore "S."	591	15.12.2023	150,960
3	Shpenzime Gjyqësore, Zyra Përmbarimore "E.B."	621	22.12.2023	192,000
4	Shpenzime Gjyqësore, Zyra Përmbarimore "B."	466	25.10.2023	500,000

5	Shpenzime Gjyqësore, Zyra Përmbartimore "B."	177	18.04.2023	204,625
6	Shpenzime Gjyqësore, Zyra Përmbartimore "B."	167	14.04.2023	288,000
	Totali			1,509,892

-Raportet e Monitorimit.

Për vitet 2023, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht: Për vitin 2023 janë dërguar raportet 4-mujore.

- Me shkresën nr. 4197 prot, datë 07.06.2023, është dërguar raporti i parë;
- Me shkresën nr. 2142 prot, datë 04.09.2023, është dërguar raporti i dytë;
- Me shkresën nr. 758 prot, datë 13.02.2023, është dërguar raporti i tretë.

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZSHH dhe Ministrisë së linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financë/ Buxhetit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, në lidhje me investimet publike, u konstatua se:

Tabela mbi financimet e kontratave për investime, burimet e financimit si dhe likuidimet sipas viteve pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Objekti i prokurimeve	Burim finansi	Vlera e kontratës me TVSh	Kontrata		Firma fituese	Likuidimet			Pa likuiduar
			Nr, date	Afati		Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	
"Furnizimi me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar)."	FSHZ H	378,836,979	12.10.2021	1 vit	E. K. & SH. SHPK	77,349,275	64,612,618	185,500,000	51,375,086
Rikonstruksioni i Shkollës Adem Sheme(total)	FSHZ H	56,599,705	22.12.2022	8 muaj	V. K.	-	-	56,425,005	174,700
Totali	-	435,436,684	-	-	-	77,349,275	64,612,618	241,925,005	51,549,786

Për financimet nga Ministrinë e linjës, FZHR dhe donatorë të tjerë, janë lidhur për vitin 2021 gjithsej 5 kontrata në vlerën 429,865 mijë lekë.

Për kontratat e vitit 2022 në vlerën 56,599 mijë lekë.

Financuar në vitin 2021 vlera prej 160,945 mijë lekë dhe për vitin 2022 179,186 mije lek. Për financimet nga buxheti Bashkisë Sarandë dhe Grande janë lidhur për vitin 2022 gjithsej 0 kontrata në vlerën 0 mijë lekë.

Për kontratat e vitit 2022 në vlerën 56,599 mijë lekë. Financuar në vitin 2022 vlera prej 0 lekë, financuar me vonesë në vitin 2023 vlera prej 34,500mijë lekë dhe mbetet akoma për likuidim vlera 22,099 mijë lekë.

I. Vlera e fondeve të parashikuara (planifikuara) dhe fondeve të kontraktuara (realizuara në fakt), për prokurim për vitin 2023 në artikullin (602/231) shprehur gjithsej në vlerë 229,730,368 lekë, nga e cila:

- Prokurimeve me vlera të larta janë parashikuara për vlerën 199,505,122 lekë dhe janë realizuar për vlerën 193,056,246 lekë.

- Prokurime me vlera të vogla janë parashikuara në vlerën 30,225,246 lekë dhe janë realizuar në vlerën 15,097,780 lekë.

I/a. Vlera e fondeve të kontraktuara (realizuara në fakt), në vitin 2023, në artikullin (602/231) shprehur gjithsej në vlerë 208,154,011 lekë, nga e cila:

- Prokurimeve me vlera të larta për vlerën 193,056,246 lekë.

- Prokurime me vlera të vogla në vlerën 15,097,780 lekë.

Nga prokurimet me vlera të larta, sa janë realizuar në fushën e investimeve vlera prej 225,677,000 lekë, dhe sa janë në fushën e shërbimeve/blerjeve në vlerën 155,769,000 lekë.

I/b. Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2023, për artikullin (602/231) shprehur gjithsej në vlerë 0 leke, nga e cila:

- Prokurimeve me vlera të larta për vlerën 0 lekë.

- Prokurime me vlera të vogla në vlerën 0 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi:

Znj. T. S., me detyrë Drejtoresh e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimit Social, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Drejtimi nr.2.6. – Mbi auditimin e burimit të krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

U verifikua dokumentacioni si më poshtë:

1. Evidencat e realizimit të planit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023

2. Regjistrat dhe dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Bashkisë Sarandë.

4. Regjistrat e subjekteve debitorë.

5. Të tjera dokumente mbështetëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

1.Burimi i krijimit të të ardhurave për vitin 2023

Burimi për krijimin e të ardhurave për vitin 2023, në Bashkinë Sarandë, vjen si rezultat i të ardhurave të realizuara nga burimet e veta (taksa dhe tarifa vendore, dhëniet me qira, arkëtimet nga detyrimet e mbartura etj), transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit dhe transfertat e kushtëzuara, si dhe nga fondet e trashëguar nga viti i kaluar.

Për vitin 2023, Bashkia Sarandë ka patur të ardhura në shumën totale 1,749,132 mijë lekë, të paraqitura si më poshtë:

(në mijë lekë)

Përshkrimi	Shuma
Të ardhura nga burimet e veta	788,904
Të ardhura nga Trasnferata e Pakushtëzuar	161,021
Të ardhura nga Transferta e Kushtëzuar	441,000
Të ardhura të mbartura nga viti i kaluar	358,207
Totali	1,749,132

Për vitin 2023, Bashkia Sarandë, për të ardhurat nga burimet e veta i ka planifikuar në fillim të vitit në shumën 503,500 mijë lekë si dhe janë realizuar në shumën 788,904 mijë lekë, duke rezultuar me mbi realizim në shumën 285,404 mijë lekë ose në masën 157 % e analizuar më poshtë. Të ardhurat nga burimet e veta në raport me totalin e të ardhurave janë në masën 45%.

2. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023

2.1. Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Menaxhimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Sarandë, kryhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ku për vitin 2023 është miratuar struktura nga Kryetari i Bashkisë me 14 punonjës, nga të cilët 1 (një) Drejtor, 7 (shtatë) inspektorë verifikimi në terren, 6 (gjashtë) specialistë ku 2 (dy) specialistë për kontabilitetin, 2 (dy) specialistë për vlerësimin dhe planifikimin e të ardhurave, 1 (një) specialist për taksat familjare dhe 1 (një) specialist për mbledhjen e borxhit. (struktura në aneksin bashkëlidhur).

Për vitin 2023, paketa fiskale është miratuar me VKB-në nr.160, datë 25.11.2022 “Për miratimin e paketës fiskale 2023 të Bashkisë Sarandë”.

Nga auditimi i Strukturës së Drejtorisë së të Ardhurave, konstatohet se për mbledhjen e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave, angazhohet vetëm 1 (një) specialist, për rrjedhojë kjo situatë cenon monitorimin dhe mbledhjen e detyrimeve që rrjedhin nga borxhi, duke mos shfaqur përmirësime në këtë fushë me risk. Bashkia Sarandë nuk ka ngritur një strukturë të mirë përcaktuar me përgjegjës sektori dhe specialistë për borxhin nga taksat dhe tarifave, duke sjellë një përkeqësim të situatës së borxhit e cila rezulton edhe për vitin 2023, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 22.

2.2. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023

Nga analiza e të dhënave të tabelës së realizimit të të ardhurave pasqyruar në aneksin bashkëlidhur rezultoi se për vitin **2023**, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga **503,500 mijë lekë** të parashikuara, janë realizuar në shumën **788,904 mijë lekë** ose **157 %** me një diferencë në rritje në vlerën **285,404 mijë lekë** të ardhura të realizuara në tejkallim të planit. Nga të cilat të ardhurat nga taksat janë realizuar në vlerën 490,003 mijë lekë, ose 182% më shumë se planifikimi, të ardhurat nga tarifave janë realizuar në vlerën 254,720 mijë lekë, ose 125% më shumë se planifikimi, të ardhurat nga tatimet janë realizuar në vlerën 8,025 mijë lekë në tejkallim të dukshëm nga planifikimi si dhe të ardhura jo tatimore janë realizuar në vlerën 36,156 mijë lekë, ose 124% më shumë se planifikimi.

Zërat më kryesorë që kanë ndikuar në mbi realizim të të ardhurave janë:

Të ardhura nga taksat e ndikimit në infrastrukturë, janë planifikuar në shumën 90,000 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 291,807 mijë lekë, ose me mbi realizim në masën 324%, fakt i cili tregon se kemi një planifikim jo real dhe të pa argumentuar në fillim të vitit duke mos paraqitur saktë pritshmëritë nga realizimi i të ardhurave nga kjo taksë bazuar edhe në realizimin nga vitet e kaluara.

Të ardhura nga tarifave pastrimit, janë planifikuar në shumën 110,000 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 132,246 mijë lekë, ose me mbi realizim në masën 120%, fakt i cili tregon se kemi një planifikim jo real dhe të pa argumentuar në fillim të vitit duke mos paraqitur saktë pritshmëritë

nga realizimi i të ardhurave nga kjo tarifë bazuar edhe në realizimin nga vitet e kaluara. Të ardhura nga dhënia me qëra e aseteve, janë planifikuar në shumën 5,000 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 9,347 mijë lekë, ose me mbi realizim në masën 187%, për rrjedhojë del në dukje një planifikim jo real, mbi numrin e aseteve që do të jepen me qira gjatë vitit, bazuar edhe në kontratat e qirasë së viteve të kaluara, duke mos argumentuar parashikimin e kësaj takse në fillim të vitit.

Konkluzion:

Kjo situatë tregon se faza e planifikimit të të ardhurave nga ana e Bashkisë Sarandë nuk është real dhe i mirë përcaktuar, duke u paraqitur në mënyrë evidente edhe diferecat e mëdhaja që ekzistojnë midis realizimit të ardhurave dhe planifikimit të tyre në fillim të vitit, ku si rezultat i procesit jo të besueshëm të planifikimit sjell edhe një mangësi të theksuar në parashikimin e buxhetit të vitit 2023, për investimet të cilat do të prokurohen gjatë vitit.

Për sa më sipër mbanjë përgjegjësi, z. L. B., ish-Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2023 deri 28.08.2023, znj.I. Zh., me detyrë të deleguar Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 17.08.2023 dhe në vazhdim, znj.P. T., me detyrë ish-specialiste për vlerësimin dhe planifikimin e të ardhurave, znj.J. L., me detyrë specialiste për vlerësimin dhe planifikimin e të ardhurave.

Përsa më sipër konstatohet se:

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për vitin 2023 planifikimi është për vlerën 500 mijë lekë, i pa argumentuar, pasi realizimet janë në shumën 763 mijë lekë, ose me mbi realizim në masën 153%, duke mos mbajtur në konsideratë realizimet faktike të vitit 2022 në shumën 1,055 mijë lekë. Gjithashtu dhe në fazën e planifikimit nuk është marrë në konsideratë numri i subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.
- Niveli i arkëtimit të të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat vendore paraqitet me diferenca evidente në raport me planifikimin.
- Për vitin 2023 vlerën më të lartë të mbi realizimit të të ardhurave vendore e zenë të ardhura nga Taksat Vendore në shumën 490,003 mijë lekë.
- Nga planifikimi i të ardhurave nga arkëtimi i debitorëve të ndryshme paraqitet me një mos realizim prej 36%.
- Të ardhura nga taksat kombëtare për vitin 2023 nuk janë planifikuar, kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Sarandë, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njësive vendore nga këto taksa.
- Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike, por nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve në përdorim që gjenden në territorin e Bashkisë Sarandë.
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke kërkuar nga familjet që marrin shërbim (vërtetime etj) në Bashkinë Sarandë të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. *Nga auditimi rezulton se nuk është kryer rakordim me zyrat e gjendjes civile nga ana e Sekotrit të tatim taksave vendore për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Sarandë*

2.3. Të dhëna mbi numrin e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet ndaj të cilëve janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Gjendja e bizneseve për vitin 2023

Nr	Lloji i Biznesit	Gjendja ne fillim	Regjistrime te Reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja ne fund
1	Biznesi i Vogël	2,308	860	241	2,927
2	Biznesi i Madh	306	115	24	397
3	Institucione	18	-	-	18
4	Gjithsej	2,632	975	265	3,482

Për vitin 2023, kanë ushtruar aktivitet 3,482 subjekte (2,927 subjekte të biznesit të vogël, 397 subjekte të biznesit të madh) kanë kryer regjistrim si aktivitete të reja 975 biznese, dhe kanë bërë çregjistrim 265 subjekte.

Përsa më sipër konstatohet se:

- Numri i bizneseve ka ardhur duke u rritur nga viti 2022 në vitin 2023, me 619 subjekte të vegjël dhe me një rritje me 91 subjekte të mëdhejn, mbi të cilat nuk ka një analizë nga Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Sarandë, mbi impaktin e shtimit të numrit të bizneseve, sa kanë ndikuar në procesin e planifikimit të të ardhurave dhe nëse është mbajtur në konsideratë gjatë planifikimit të zërave tendenca e shtimit të tyre. Për rrjedhojë kjo situatë tregon një planifikim të pa argumentuar nga ana e Bashkisë Sarandë, me analizë konkrete dhe shteruese.

2.4. Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore, për vitin 2023, realizimi paraqitet në masën 58% ose nga 6,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 3,510 mijë lekë.

Nga të dhënat e nxjerra nga Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë Sarandë në lidhje me sipërfaqen e tokës gjithsej të ndarë sipas ligjit, paraqitet si vijon:

Nr	Bashkia Sarandë dhe NJA	Tokë bujqësore gjithsej ha
1	Sarandë	42
2	Gjashtë	608
3	Metoq	671
4	Shelegar	47
5	Çukë	967
6	Ksamil	0
Totali		2,335

Nga analiza e pasqyrës së mësipërme konstatohet se ka mospërputhje midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme përsa i përket taksës së tokës bujqësore. Kjo tregon se Drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë, dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave, veprim ose mosveprim që bie në kundërshtim me pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr. nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku thuhet se;

“Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka”

Nr	Bashkia Sarandë dhe NJA	Sip e tokes gjithsej ha	Marre toke nga AMTP sip.ha	Marre toke e AMTP familje gjithsej
1	Sarandë	42		92
2	Gjashtë	608	490	454
3	Shelegar	671	47	424
4	Metoq	47	453	48
5	Çukë	967	620	628
6	Sip e mbjellë	0	55	0
Bashkia Sarandë Totali		2,335	1,665	1,646

Nga tabela sa më sipër vihet re se në Bashkinë Sarandë janë posedues të tokës bujqësore sipas ligjit, gjithsej **1,646** familje dhe që duhet ti nënshtrohen taksës për këtë pasuri të paluajtshme sipas kuadrin ligjor.

Në Bashkinë Sarandë rezulton se toka bujqësore i përket kategorisë IV, sipas përkatësisë..

Vlerësimi i tokës sipas sipërfaqes/kategorisë/cmimit

Nr.	Kategoria/tokë	Cmimi/ha/vit	Sipërfaqja/ha	Shuma/lekë	Planifikimi taksës/vit
1	Kategoria II	4,900 lekë			
2	Kategoria III	4,200 lekë			
3	Kategoria IV	3,600 lekë	1,665	6,993,000	
4	Kategoria V	1,900 lekë			
5	Kategoria VI	1,600 lekë			
6	Kategoria VII	1,400 lekë			
Totali		-	1,665 hektar	6,993,000	6,000,000

-Nga sa më sipër vihet re një diferencë në planifikim në vlerën **993,000** lekë më tepër për vitin 2023 (6,993,000 – 6,000,000), gjë e cila duke qenë se nuk mund të realizohet sjell tmungesë të këtyre të ardhurave për vitin 2023 në vlerën **993,000** lekë.

Kjo tregon se Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria e Bujqësisë, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk kanë realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave, veprim ose mosveprim që bie në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Realizimi i taksës bujqësore për vitin 2023, paraqitet në shumën 3,510 mijë lekë nga 6,000 mijë lekë, me mos realizim në masën 42%, situatë e cila tregon një planifikim jo real si dhe punë të mjaftueshme nga strukturat e Bashkisë Sarandë për arkëtimin e taksës.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. L. B., ish-Drejtor i DAV Bashkia Sarandë, z.M. L., Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë, Pyje, Kullota dhe Kullimit Bashkia Sarandë.

3. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi

3.1.Për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Sarandë

Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Sarandë, nuk është aplikuar për pajisjen me autorizime për tregtim karburanti jo në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra me VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM 344, datë 19.04.2017, duke mos u arkëtuar të ardhurat për taksën e pajisjes së Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.

Nga auditimi rezulton se paraqiten 16 subjekte, të cilat operojnë në fushën e tregtimit të karburantit.

Nga ana e Bashkisë Sarandë nuk është zbatuar VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar “Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë”.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën përkatëse në aneks subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas pasqyrës si më poshtë:

Nga auditimi rezulton se për 16 subjekte nuk janë të pajisur me autorizimin e tregtimit të karburantit në kundërshtim me VKM-në nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu I, pika nr.2.

Nga tabela, shihet se tarifa e pajisjes me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve nuk është llogaritur, dhe **vlera prej 24,640,000 lekë, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave të autorizimeve / licencave, për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Sarandë.**

Veprim ky i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35, VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto

dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9. VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi z. R. S., Drejtor i Shërbimeve Publike.

3.2.Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale (banim ose e kombinuar), objekt legalizimit

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Sarandë, mbi realizimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, rezulton se nga ana e DVASHK Sarandë është dërguar informacion për secilin person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale në mënyrë të tillë që të kryhen përlllogaritjet e vlerës së taksës.

Nga auditimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale rezulton se nuk është proceduar në mënyrë efektive për arkëtimin e shumës nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, duke sjelle një situatë me debitorë deri në 31.12.2023 për 2,323 subjekte në shumën 95,756,000 lekë, shumë e pa arkëtuar.

TNI për legalizimin e objekteve informale - Viti 2023

Debitor TNI	Subjekte	Vlera/000/L
Gjendja në 31.12.2022	2,210	85,315
Shtesat përgjatë vitit 2023	113	10,441
Gjendje në 31.12.2023	2,323	95,756

Sa më sipër rezulton se debitorët si pasojë e mos arkëtimit të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë mbi ndërtimet informale në çelje të vitit 2023 paraqiten në shumën 85,315,000 lekë, duke patur edhe shtesat gjatë vitit në shumën 10,441,000 lekë, në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 95,756,000 lekë, situatë kjo e cila ka ardhur në rritje nga viti i mëparshëm si rrjedhojë e mos mbledhjes së detyrimeve dhe arkëtimit të vlerës nga ana e Strukturave të Bashkisë Sarandë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi: z.L. B., ish-Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2023 deri 28.08.2023, z.nj.I. Zh., me detyrë të deleguar Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 17.08.2023 dhe në vazhdim, z.R. P., ish-Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për periudhën 01.01.2023 deri më 29.06.2023; z.Z. B., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për periudhën 29.06.2023 deri më 31.12.2023.

3.3.Mbi realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi për kontratat për investime publike, në territorin e Bashkisë Sarandë

Nga auditimi i subjekteve të cilat kanë kryer punime ndërtimi për kontrata për investime publike rezultojnë se gjatë vitit 2023, janë lidhur 20 kontrata për investime publike, të cilat nuk janë tarifuar për shërbimet dhe pastrimin.

Nisur nga të dhënat në tabelën përkatëse në aneks, konstatohet se për 20 kontratat e investimeve

publike të lidhura më Bashkinë Sarandë dhe Operatorët Ekonomikë, nuk është proceduar me tarifimin mbi shërbimet e pastrimit sipas parashikimeve paketës fiskale. Detyrimi prej 2,090,000 lekë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën “b” të nënpikës 1.3 të pikës 1 në nenin 9, shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 35, shkronjën “f” të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikën 10 të nenit 3 dhe pikën 2 të nenit 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe pika B.1.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë.

3.4.Mbi realizimin e taksës së fjetjes në hotel, në territorin e Bashkisë Sarandë

Taksa e fjetjes në hotel në fillim të vitit është parashikuar në shumën 24,000 mijë lekë dhe është realizuar në fund të vitit 2023 në shumën 37,132 mijë lekë, ose me mbi realizim në masën 155%, i pa argumentuar dhe i pa analizuar nga ana e Bashkisë Sarandë.

Në krahasim me vitin 2022, ku taksa e fjetjes në hotel është realizuar në shumën 18,456 mijë lekë, në vitin 2023 ka ardhur në rritje.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e Bashkisë Sarandë, aplikimi i tarifës bëhet sipas vetë deklarimeve të subjekteve, ku nuk ushtrohet monitorimi nga sektori i terrenit në Drejtorinë e të Ardhurave, në mënyrë të tillë që të ndërtohej një regjistër specifik ku të evidentoheshin dhomat e secilit hotel, shtretërit etj. Mungesa e një regjistri të tillë e bën të pamundur verifikimin real të numrit të personave që akomodohen gjatë sezonit veror kryesisht.

Nga auditimi të dhënave konstatohet një numër i lartë subjektsh debitore mbi taksën e fjetjes në hotel, numër i cili ka ardhur në rritje edhe për vitin 2023, të paraqitura në tabelën më poshtë:

në mijë lekë

Përshkrimi	Debitorë të krijuar në 2023	Debitorë në fund të 2023
Subjektet	523	789
Shuma	54,371	97,098

Sa më sipër konstatohet se në fund të vitit 2023, paraqiten 789 subjekte debitore në fushën e hotelerisë, në shumën 97,098 mijë lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Për sa më sipër mbanjë përgjegjësi, z.L. B., ish-Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2023 deri 28.08.2023, znj.I. Zh., me detyrë të deleguar Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 17.08.2023 dhe në vazhdim, Inspektorët e Sektorit të terrenit, z.A. Ç., z.S. I., z.P. A., z.F. A., z.L. O., z.R. M.

4.Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve

4.1.Për realizimin e të ardhurave nga sipërfaqet e dhëna me qëra nga fondi pyjor dhe kullor në Bashkinë Sarandë, dokumentet e lejeve minerare të dhëna nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik,

Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që ndodhen në territorin e Bashkisë Sarandë:

Nga verifikimi i lejeve minerare të dhëna nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që ndodhen në territorin e Bashkisë Sarandë, rezultojnë 3 subjekte, të cilat operojnë në fushën minerare, si më poshtë vijon:

1. Shoqëria “A” ShPK me NIPT “J.....P”, është lidhur kontrata me Bashkinë Sarandë me nr.2860, datë 27.06.2022, me afat kohor 1 vjeçar, në shumën 1,069,594

2. Shoqëria “P” ShPK me NIPT “K.....G”, shfrytëzon aktivitetin nëpërmjet lejes minerare me nr.661/1, datë 19.12.2022, me sipërfaqe të shfrytëzueshme 10.7 ha.

3. Shoqëria “I-B” ShPK me NIPT “J.....E”, shfrytëzon sipërfaqe minerare prej 3.5 ha në pronësi të vet dhe sipërfaqe prej 15.1 ha në pronësi shtet.

Në lidhje me 3 (tre) shoqëritë e mësipërme, të cilat janë të pajisura me leje minerare për shfrytëzim aktiviteti mineral në territorin e Bashkisë Sarandë, nga informacioni i dhënë nga ana e strukturave përkatëse të Bashkisë Sarandë, rezulton se për vitin 2023 këto sipërfaqe janë pajisur pjesërisht me çertifikatë pronësie të Bashkisë për fondin pyjor/kullor që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Sarandë nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.18, datë 11.03.2020.

Nga ana e Bashkisë Sarandë, rezulton se nuk është vepruar me vendimet e pezullimit të aktivitetit të këtyre subjekteve të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë mbi sipërfaqet e pronësisë të çertifikuara të Bashkisë deri në zbritjen e fondit pyjor, në zbatim të Ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”.

Për sa trajtuar më sipër mban përgjegjësi: z.M. L., Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë, Pyje, Kullota dhe Kullimit Bashkia Sarandë.

4.2.Mbi realizimin e të ardhurave nga hapësirat publike dhe kontratat e plazhit

Gjatë vitit 2023, nëpërmjet VKB nr.160, datë 25.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Sarandë”, janë miratuar tarifrat, për aktivitetin stacione plazhi, konkretisht: 1.Tarifë për zënien e hapësirës publike për zonën e plazhit prej 800 lekë/ m²/sezon dhe 2.Tarifë shërbimi prej 100 lekë/ m²/sezon.

Referuar VKM nr. 1172, datë 24.12.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.171, datë 27.3.2019, për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” sipërfaqet që shfrytëzohen duhet të jenë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe duhet të respektohet raporti 80% sipërfaqe për përdorim privat dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publik.

Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Sarandë deri në 31.12.2023, paraqitet në mënyrë të përmbledhur situata si më poshtë:

Tipologjia e Kontratës	Nr. i Kontratave	Sip. e kontraktuar	Sip. e evidentuar e shfrytëzuar nëpërmjet verifikimeve me pamje nga Bashkia Sarandë	Detyrimi Total (sip m2 * 900 lekë)	Sip. e pa shfrytëzuar
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>d</i>	<i>e</i>	<i>g=(d*900)</i>	<i>h=(e-d)</i>
1-vjecare	93	41,964	61,884	37,767,600	19,920
3-vjecare	6	5,112	7,815	4,600,800	2,703
4-vjecare	1	315	315	283,500	-
5-vjecare	40	22,505	26,830	20,254,500	4,325
Total	140	69,896	96,844	62,906,400	26,948

Nisur nga të dhënat e mësipërme, rezulton se:

Për vitin 2023 janë lidhur 93 kontrata me afat 1 vjeçar, me sipërfaqe të kontraktuar me Bashkinë Sarandë prej 41,964 m², me vlerë detyrimi prej 37,767,600 lekë.

Për 6 kontrata janë lidhur me afat përdorimi 3 vjeçar (*me hyrje në fuqi para vitit 2023*), me sipërfaqe të kontraktuar me Bashkinë Sarandë prej 5,112 m², me vlerë detyrimi prej 4,600,800 lekë.

Për 1 kontratë është lidhur me afat përdorimi 4 vjeçar (*me hyrje në fuqi para vitit 2023*), me sipërfaqe të kontraktuar me Bashkinë Sarandë prej 315 m², me vlerë detyrimi prej 283,500 lekë.

Për 40 kontrata janë lidhur me afat përdorimi 5 vjeçar (*me hyrje në fuqi para vitit 2023*), me sipërfaqe të kontraktuar me Bashkinë Sarandë prej 22,505 m², me vlerë detyrimi prej 20,254,500 lekë.

Gjatë vitit 2023, nga ana e Bashkisë Sarandë nëpërmjet Urdhrit nr.283, datë 22.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Punës për menaxhimin e kontratave të plazhit, të cilët do të kryejnë verifikimet në terren si dhe përgatitjen e planvedosjeve me sipërfaqet faktike.

Nga ana e këtij Grupi për menaxhimin e kontratave nëpërmjet pamjeve me dron janë verifikuar sipërfaqet e kontraktuara ku kanë rezultuar diferenca në sipërfaqe të m² duke shfrytëzuar më tepër.

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura në (Aneks – Tabela 2.6.2.), konstatohet se për sipërfaqet e evidentuara gjatë ushtrimit të kontrollit në terren në raport me sipërfaqet e kontraktuara për subjektet të cilat kanë lidhur kontrata 3, 4 ose 5 vjeçare me Bashkinë Sarandë, paraqiten diferenca për 18 prej tyre me sipërfaqe të kontraktuar prej 27,932 m² dhe sipërfaqe të evidentuara prej 34,960 m², për rrjedhojë konstatohet se janë shfrytëzuar sipërfaqe më tepër nga këto subjekte prej 7,028 m², jo të pëfshira në kontratat e tyre, duke sjellë të ardhura të munguara prej 6,457,500 lekë.

Nga ana e Bashkisë Sarandë nuk është vepruar me pezullimin e tyre gjatë kontrollit të ushtruar në vend si dhe të kryhej penalizimi i këtyre subjekteve me gjoba dhe tarifimin e kësaj sipërfaqe të pa lejuar dhe jashtë kontratave.

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura në (Aneks – Tabela 2.6.3.), konstatohet se për sipërfaqet e evidentuara gjatë ushtrimit të kontrollit në terren në raport me sipërfaqet e kontraktuara për subjektet të cilat kanë lidhur kontrata me afat 1 vjeçar me Bashkinë Sarandë, paraqiten diferenca për 64 prej tyre me sipërfaqe të kontraktuar prej 41,964 m² dhe sipërfaqe të evidentuara prej 61,807 m², për rrjedhojë konstatohet se janë shfrytëzuar sipërfaqe më tepër nga këto subjekte prej 19,843 m², jo të pëfshira në kontratat e tyre, duke sjellë të ardhura të munguara prej 17,901,900 lekë.

Nga ana e Bashkisë Sarandë nuk është vepruar me pezullimin e tyre gjatë kontrollit të ushtruar në vend si dhe të kryhej penalizimi i këtyre subjekteve me gjoba dhe tarifimin e kësaj sipërfaqe të pa lejuar dhe jashtë kontratave.

Në mënyrë të përmbledhur për të gjitha kontratat e plazhit si më poshtë:

Tipologjia e Kontratës	Nr. i Kontratave në Shkelje	Të ardhura të munguara
Kontrata 1 vjeçare	64	17,901,900
Kontrata 3 vjeçare	4	2,429,100

Kontrata vjeçare	5	14	4,028,400
Totali		82	24,359,400

Sa më sipër, konstatohet se për sipërfaqet e evidentuara gjatë ushtrimit të kontrollit në terren nga ana e Bashkisë në raport me sipërfaqet e kontraktuara paraqiten diferenca për 82 subjekte me detyrim të ardhura të munguara prej 24,359,400 lekë.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Shërbimit në Bashkinë Sarandë nuk është vepruar me penalizimin e këtyre subjekteve, duke vendosur gjoha dhe penaltete si dhe duke kërkuar ndërprerjen e kontratës për shkak të shkeljes së sipërfaqeve të lejuara, si dhe të arkëtohej shuma e tarifave sipas kontratave për këto sipërfaqe të shfrytëzuara në tejkalim të atyre të përcaktuara në kontratat respektive.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr.1172, datë 24.12.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.171, datë 27.3.2019, për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

Në lidhje me dokumentacionin mbështetës të kontratave të lidhura gjatë vitit 2023, rezultojnë mangësi duke mos paraqitur pagesën e taksave dhe detyrimeve fiskale nga ana e Bashkisë Sarandë, nuk kanë të shoqëruar planvendosjen për mundësimin e sipërfaqes dhe distancat e lejuara, mangësi edhe në procesverbalin e dorëzimit të sipërfaqes së kontraktuar.

Gjithashtu për vitin 2023 rezulton se në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publik, si dhe mungonin procesverbalet e monitorimit të kontratave për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1172, datë 24.12.2022, ndryshuar me Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1172, datë 24.12.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.171, datë 27.3.2019, për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

Për sa më sipër mbanjë përgjegjësi: z.R. S., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z.L. C., me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, z.L. B., ish-Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2023 deri 28.08.2023, znj.I. Zh., me detyrë të deleguar Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 17.08.2023 dhe në vazhdim.

4.3.Mbi dhënien me qëra të aseteve në pronësi të Bashkisë Sarandë

Nga informacioni i dhënë në lidhje me asetet, për të cilat nga ana e Bashkisë Sarandë janë lidhur kontrata qiraje (mujore ose vjetore), deri në 31.12.2023 rezultojnë aktive 25 kontrata. Gjatë vitit 2023 janë lidhur kontrata të reja qiraje 23 kontrata, si dhe 2 kontrata qiraje rezultojnë nga vitet e kaluara, pasqyruar në tabelën përkatëse në aneks.

Nga lista e kontratave që Bashkia Sarandë ka lidhur gjatë vitit 2023, u audituan me zgjedhje si më poshtë:

1. Dhënia me qira e ambienteve të “Lokal R.”

Nga auditimi në rend kronologjik të veprimeve të ndërmarra nga Bashkia Sarandë për dhënien me

qira të këtij objekti rezultoi se:

Me vendim nr. 46, datë 28.03.2022 të Këshillit Bashkiak është miratuar në parim dhënia me qira e pasurisë lloji ndërtesë “Lokal R.”, me sipërfaqe totale 338 m² në pronësi të Bashkisë Sarandë. Për këtë qëllim Këshilli Bashkiak, me projektvendim nr. 93, datë 29.06.2022 të Komisionit të çështjeve juridike, ka miratuar kriteret për konkurim për këtë objekt si më poshtë:

a. Niveli i investimit të parashikuar deri në	10pikë
b. Niveli i punësimit	10pikë
c. Oferta e detyrimit mujor të qirasë	10pikë
d. Banorë në Bashkinë e Sarandës	30pikë
e. Posedim mbi 10 vjet i objektit	35pikë
f. Të ofrohet shërbim komunitar	5 pikë

Për sa më lart rezulton se, krahas 3 kriterëve të konkurimit të përcaktuara nga VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, anëtarët e Komisionit të çështjet juridike kanë propozuar edhe 3 kriterë të tjera, 2 nga të cilat dhe konkretisht “Banorë në Bashkinë e Sarandës” dhe “Posedim mbi 10 vjet i objektit”, përbëjnë kriterë diskriminuese për subjektet pjesëmarrëse. Së pari, është e paqartë se çfarë pengese sjell për marrjen në përdorim të objektit fakti nëse qiramarrësi nuk banon në Sarandë. Së dyti, ky objekt është dhënë me qira që në vitin 1993 të njëjtit subjekt, vërtetuar nëpërmjet 4 kontratave të qirasë. Pra automatikisht, kriterin për posedim të objektit në përdorim mbi 10 vite nuk mund ta plotësojë asnjë subjekt tjetër veç atij ekzistues që prej vitit 1993. Me VKB nr. 91, datë 29.06.2022 janë miratuar kriteret për dhënien me qira të objektit të mësipërm, si dhe është ngarkuar Kryetari i Bashkisë për vijim e procedurës.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi A.S. me detyrë Kryetar i Këshillit Bashkiak dhe Komisioni për çështjet juridike Gj. I., F. A., V. B., B. M., T. A., S. A. dhe E. L..

Me shkresë nr. 290, datë 20.01.2023, Nën Kryetari i Bashkisë R. Ç. i është drejtuar AShK për marrje informacioni mbi gjendjen juridike për pasuritë 13/383 dhe 13/382 në ZK8641 Sarandë. Me shkresë nr.1065/1, datë 31.01.2023 të AShK Sarandë bëhet me dije se Pasuria me nr. 13/382 është trual Shtet me sipërfaqe 890.16m². Pasuria nr. 13/383 është truall Shtet dhe mbi të ndodhet një ndërtim pa leje. Nga auditimi rezulton se kjo pasuri është pjesë e VKM nr. 411, datë 09.06.2005 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të pa luajtshme shtetërore në Bashkinë Sarandë, Qarku Vlorë”, megjithatë nuk rezulton që të jete miratuar VKM për listën përfundimtare, pra kalimi përfundimisht në pronësi të Bashkisë Sarandë, pasi kjo Bashki është ende në process të inventarizimit të aseteve të saj. Rrjedhimisht, pasuria në fjalë nuk është e pajisur me cetifikatë pronësie në pronësi të Bashkisë Sarandë dhe nuk ka as legalizim të ndërtesës.

Pavarësisht këtyre mangësive, Bashkia Sarandë ka vijuar me procesin e dhënies me qira të objektit. Me urdhër nr. 43, datë 13.02.2023 të titullarit A. G. është ngritur grupi i punës për hartimin e dokumentave me përbërje T. H., A. Sh. dhe B. D. dhe me urdhër nr. 44, datë 13.02.2023 është ngritur komisioni për vlerësimin e ofertave të procedurës së konkurimit, me përbërje L. B., F. B. dhe G. K..

Me shkresë nr. 785, datë 14.02.2023, titullari i Bashkisë i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik për publikimin e njoftimit për dhënien me qira të ambientit me vlerë dysheme 33,800 lekë/muaj. Nga auditimi rezulton se referuar VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë

shtetërore”, i ndryshuar, Kapitulli III, pika a, vlera dysHEME e qirasë mujore për Qarkun e Vlorës brenda qytetit është 200 lekë/m², nga ku rezulton se vlera dysHEME e qirasë mujore për 338 m² duhej të ishte 67,600 lekë/muaj.

Me shkresë nr. 759/1, datë 03.03.2023 është mbajtur procesverbali i hapjes së zarfave, nga ku rezulton se ka marrë pjesë vetëm 1 subjekt, pikërisht subjekti L. Dh., e cila e ka patur në përdorim deri në këtë moment objektin, dhe që është subjekti i vetëm që mund të përmbushë kriteret e vendosura. Në vijim është lidhur edhe kontrata nr. 1705, datë 04.04.2023 me afat 10 vjet, me vlerë qiraje 35,000 lekë/muaj.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi grupi i punës për përgatitjen e dokumenteve të konkurimit T. H., A. Sh. dhe B. D..

2. Dhënia me qera e ambienteve të “Lokal S.”

Nga auditimi në rend kronologjik të veprimeve të ndërmarra nga Bashkia Sarandë për dhënien me qira të këtij objekti rezultoi se:

Me vendim nr. 45, datë 28.03.2022 të Këshillit Bashkiak është miratuar në parim dhënia me qira e pasurisë lloji ndërtesë “Lokal S.”, me sipërfaqe totale 247 m² në pronësi të Bashkisë Sarandë. Për këtë qëllim Këshilli Bashkiak, me projektvendim nr. 93, datë 29.06.2022 të Komisionit të çështjeve juridike, ka miratuar kriteret për konkurim për këtë objekt si më poshtë:

- | | |
|---|--------|
| a. Niveli i investimit të parashikuar deri në | 10pikë |
| b. Niveli i punësimit | 10pikë |
| c. Oferta e detyrimit mujor të qirasë | 10pikë |
| d. Banorë në Bashkinë e Sarandës | 30pikë |
| e. Posedim mbi 10 vjet i objektit | 35pikë |
| f. Të ofrohet shërbim komunitar | 5 pikë |

Për sa më lart rezulton se, krahas 3 kriterëve të konkurimit të përcaktuara nga VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, anëtarët e këtij komisioni kanë propozuar edhe 3 kriterë të tjera, 2 nga të cilat dhe konkretisht “Banorë në Bashkinë e Sarandës” dhe “Posedim mbi 10 vjet i objektit”, përbëjnë kriterë diskriminuese për subjektet pjesëmarrëse. Edhe në këtë rast ky objekt posedohet në përdorim nga i njëjti subjekt që prej vitit 2009, vërtetuar nëpërmjet kontratave të qirasë. Me VKB nr. 91, datë 29.06.2022 janë miratuar kriteret për dhënien me qira të objektit të mësipërm, si dhe është ngarkuar Kryetari i Bashkisë për vijim e procedurës.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi A. S. me detyrë Kryetar i Këshillit Bashkiak dhe Komisioni për çështjet juridike Gj. I., F. A., V. B., B. M., T. A., S. A.dhe E. L..

Edhe për këtë rast, vihet re se Bashkia i është drejtuar ASHK për kërkesë informacioni mbi gjendjen juridike të pronës, për të cilën ka marrë përgjigje me shkresën nr. 2036/1, datë 17.02.2023 se pasuria në fjalë është pronë shtet truall + ndërtesë me sip. 1432.1 m² + 1229.16 m². Nga verifikimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të regjistruara rezulton se në këtë objekt ka dy njësi të privatizuara në pronësi të dy qytetarëve. Pavarësisht këtyre magësive, është vijuar me procedurën e dhënies me qera të objektit. Me urdhër nr. 54, datë 07.03.2023 të titullarit A. G. është ngritur grupi i punës për hartimin e dokumentave me përbërje T. H., A. Sh. dhe B. D. dhe me urdhër nr. 55, datë 07.03.2023 është ngritur komisioni për vlerësimin e ofertave të procedurës së konkurimit,

me përbërje L. B., F. B. dhe G. K..

Me shkresë nr. 1891, datë 13.04.2023, titullari i Bashkisë i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik për publikimin e njoftimit për dhënien me qira të ambientit me vlerë dysheme 24,700 lekë/muaj. Nga auditimi rezulton se referuar VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Kapitulli III, pika a, vlera dysheme e qirasë mujore për Qarkun e Vlorës brenda qytetit është 200 lekë/m², nga ku rezulton se vlera dysheme e qirasë mujore për 247 m² duhej të ishte 49,400 lekë/muaj.

Me shkresë nr. 2124/1, datë 04.05.2023 është mbajtur procesverbali i hapjes së zarfave, nga ku rezulton se ka marrë pjesë vetëm 1 subjekt, pikërisht subjekti A. V., i cili e ka patur në përdorim deri në këtë moment objektin, dhe që është subjekti i vetëm që mund të përmbushë kriteret e vendosura. Në vijim është lidhur edhe kontrata nr. 1705, datë 04.04.2023 me afat 10 vjet, me vlerë qiraje 35,000 lekë/muaj.

Po kështu, konstatohet se procedurat për dhënien me qira të objekteve janë tepër formale, pasi rezulton se për të dy dosjet e audituara Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe të Komisionit të çështjeve ligjore janë të njëjtat, pra janë përdorur në të dyja procedurat dhe nuk ka patur shqyrtim apo vendimarrje më vetë për secalin rast.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi grupi i punës për hartimin e dokumentave të konkurimit T. H., A.Sh. dhe B. D..

5.Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara për vitin 2023

5.1.Gjendja e debitorëve për taksë e tarifa me datë 31.12.2023

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura në format (excel) nga Drejtoria e të ardhurave në Bashkinë Sarandë, rezulton se deri në 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Sarandë në shumën gjithsej **748,910,158 lekë**, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej **3,300** subjekte në vlerën **487,483,824** lekë, dhe **18,915** familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **261,426,334 lekë**.

Niveli i detyrimeve të papaguara në fund të periudhës 2023, paraqitet si vijon:

Emërtimi	Viti 2023	
	Nr.	Vlerë/Lekë
Nga subjektet fizik/juridik	3,300	487,483,824
Nga debitorë familjarë	18,915	261,426,334
TOTALI		748,910,158

Debitorët nga subjektet fizik/juridik

Në lidhje me debitorët të cilët janë subjekte fizik/juridik në fund të vitit 2022 kanë qenë 2,567 debitorë në shumën 321,676 mijë lekë, të cilët kanë ardhur në rritje në fund të vitit 2023 me 3,300 debitorë nga subjektet fizik/juridik në shumën 487,483 mijë lekë. Konkretisht përgjatë vitit 2023 janë shtuar 733 debitorë nga subjektet fizik/juridik në shumën 165,807 mijë lekë, situatë kjo e cila tregon një punë të dobët nga ana e Drejtorisë së të ardhurave në Bashkinë Sarandë, mbi mbledhjen e detyrimeve për debitorët subjekte fizik/juridik, duke mos ndërmarrë plane konkrete dhe monitorime të vazhdueshme për të ulur numrin e debitorëve i cili ka ardhur në përkeqësim nga viti në vit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të

papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

-Për debitorët e mësipërm, Drejtoria e të ardhurave pranë Bashkisë Sarandë nuk kanë përlllogaritur rast pas rasti kamatëvonesë për subjektet.

Në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë do të paraqiten lloji i tatimit mbi të cilin rezultojnë debitorë në fund të vitit 2023, subjektet fizik/juridik:

Lloji i Tatimit	Nr.i Subjekteve Debitorë	Shuma Debitorë në 31.12.2023
Hapësira Publike	84	3,321,705
Taksa e Fjetjes në Hotel	796	100,337,058
Taksë e Ndërtesës	2,535	175,233,002
Taksë Reklame	136	12,319,366
Taksë Tabele	25	1,741,073
Taksë Trualli	89	2,267,800
Tarifë Parkimi	170	2,171,667
Tarifë Shërbimi	3,171	155,800,306
Detyrim	353	34,291,846
Total		487,483,823

- Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave për **312** bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt- konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit.

- Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga **3,300** subjekte debitorë në vlerën **487,483,824 lekë**, janë aktiv të evidentuar të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr.9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, nuk është bërë kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995,“Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”,i ndryshuar, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Debitorët familjarë

Në lidhje me debitorët familjarë në fund të vitit 2022 kanë qenë 11,377 debitorë në shumën 87,396 mijë lekë, të cilët kanë ardhur në rritje në fund të vitit 2023 me 18,915 debitorë familjarë në shumën 261,426 mijë lekë. Konkretisht përgjatë vitit 2023 rezulton një rritje e konsiderueshme prej 7,538 debitorë familjarë në shumën 174,030 mijë lekë, situatë kjo e cila tregon një punë të dobët nga ana e Drejtorisë së të ardhurave në Bashkinë Sarandë, mbi mbledhjen e detyrimeve për debitorët familjarë, duke mos ndërmarrë plane konkrete dhe monitorime të vazhdueshme për të ulur numrin e debitorëve i cili ka ardhur në përkeqësim nga viti në vit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 76, neni 114 dhe neni 117, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, neni 22, neni 26 dhe neni 34, me Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 64, me Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika 1 e nenit 12, pika 2 e nenit 42.

Në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë do të paraqiten lloji i tatimit mbi të cilin rezultojnë debitorë në fund të vitit 2023, familjarë:

Lloji i Tatimit	Prona	Shërbim	Shuma e Detyrimit
Ab.Aktiv - Taksë Ndërtese dhe Taksë Shërbimi (Ksamil)	4,625,209	7,661,688	28,468,652
Ab.Pasiv - Taksë Ndërtese dhe Taksë Shërbimi (Ksamil)	112,066	282,516	781,502
Ab.Aktiv - Taksë Ndërtese dhe Taksë Shërbimi (Sarandë)	27,398,324	49,729,760	217,298,851
Ab.Pasiv - Taksë Ndërtese dhe Taksë Shërbimi (Sarandë)	634,699	1,749,980	14,877,330
Total	32,770,298	59,423,944	261,426,334

Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nga zyrat e taksave në NJA janë përcjellë debitorët në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Sarandë, por konstatohet se nga specialisti i mbledhjes së borxhit nuk është marrë asnjë masë ligjore (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3 dhe 4, me Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42, me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 3 në nenin 6, neni 76, pika 2 në nenin 89, neni 117.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:

1) Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë **3,300** subjekte për vlerën **487,483,824 lekë**, të cilat janë të pa kontabilizuara. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave për subjektet debitorë përveç se janë dërguar bankave urdhër bllokime, në asnjë rast nuk kemi ndjekje të plotë të procedurave të arkëtitimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI - “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2) Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2023, janë gjithsej **debitorë 18,915 familje për vlerën gjithsej 261,426,334 lekë**, konstatohen mangësi pasi nga ana e Drejtorisë së tatim taksave vendore nuk është kryer rakordim me zyrën e gjendjes civile për të nxjerrë të dhënat reale të numrit të familjeve në Bashkinë Sarandë.

3) Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj) në Bashkinë Sarandë të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Për mos nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit tatimor, për popullatën është shkelur neni 70 pika 3 “e drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar.

4) Drejtoria e Taksave Vendore, nuk ka aplikuar në asnjë rast si masë shtrënguese ndaj subjekteve debitorë, barrë siguroese dhe ose barrë hipotekore, në kundërshtim me nenin 91 të Ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Po ashtu nuk rezulton që të jetë zbatuar edhe kërkesat e neneve 92,93,94,95 dhe 96, që kanë të bëjnë me sekuestrimin e pasurisë për llogari të shlyerjes së detyrimit tatimor.

5) Nga administrata tatimore nuk është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht :

-Të gjitha praktikat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit.

-Ne dosje nuk administrohej asnjë dokumentacion ligjorë i subjektit qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë,

Mungojnë dokumentet si më poshtë:

1. Certifikata e regjistrimit nga QKB
2. Certifikata e pronësisë ose Kontrata e Qerasë
3. Planvendosjes e objektit
4. Karta e identitetit
5. Njoftimi i biznesit nga ana e Bashkisë për detyrimet që ka gjatë vitit .
6. Vlerësimet ose rivlerësimet gjatë periudhave.

Veprimi në kundërshtim, me kërkesat e Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 24, ku përcaktohet se: “Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë : a) të evidencojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë, c) të dorëzojnë dokumentet në arkivat shtetërore, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të këtij ligj, dhe me rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave “Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” kapitulli II-Rregulla për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore, neni 21 dhe neni 27.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligji nr.68/2017, “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”

Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar

Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar

Ligjit 106/2017, datë 30.11.2017, “Mbi taksën e pasurisë”

Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Për sa më sipër mbanjë përgjegjësi, z. L. B., ish-Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 01.01.2023 deri 28.08.2023, znj.I. Zh., me detyrë të deleguar Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 17.08.2023 deri 31.12.2023, znj. N. A., Specialiste për mbledhjen e Borxhit.

Observacionet e subjektit: Me shkresë nr. 1134/1, datë 13.03.2025, Bashkia Sarandë ka paraqitur kundërshtimet lidhur me konstatimin mbi tarifën e qerasë për lokalet R. dhe S., ku referuar aneksit A të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, tarifa prej 200 lekë/m² është për qytetin e Vlorës specifikisht dhe jo për çdo qytet brenda Qarkut. Kështu që për Sarandën që është jashtë qytetit të Vlorës aplikohet tarifa 100 lekë/m².

Lidhur me gjendjen juridike të pronës lokale S., Bashkia Sarandë ka dërguar kërkesë informacioni pranë AShK dhe ka marrë përgjigje me shkresë nr. 2036/1, datë 17.02.2023, e cila dërgohet

bashkëlidhur observacionit.

Qendrimi i grupit të auditimit: Lidhur me pretendimin se tarifa prej 200 lekë/m² është vetëm për qytetin e Vlorës, sqarojmë se përcaktimi i tarifave sipas këtij kategorizimi bëhet për të diferencuar tarifimin brenda dhe jashtë qytetit, pra ka si bazë nivelin ekonomik të jetesë i cili në qytete është më i lartë se jashtë qyteteve dhe për këtë arsye në aneks qytetet janë për qendrat Bashki, siç është edhe Saranda. Pra për secilin qark është marrë si referim qyteti përfaqësues. Në rast se tarifat do ishin specifike vetëm për Vlorën, atëherë nuk kishte pse ndarja të bëhej sipas qarqeve, por listoheshin specifikisht të gjithë qytetet me tarifat përkatëse. Sipas interpretimit tuaj, nuk ka sens që një pronë në qendër të qytetit të Sarandës të tarifohet me të njëjtën vlerë si fshatrat.

Lidhur me kërkuesën e informacionit pranë AShK, e cila mungonte në dosje, pas shqyrtimit të saj vënë në dispozicion me anë të observacioneve, grupi i auditimit merr parasysh observacionin dhe reflekton ndryshimet në projekt raport.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit në të “Nxehtë” Nr.188/8 Prot, datë 12.02.2024, i ndryshuar, në lidhje me vlerësimin e raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, u vlerësuan komponentët e mëposhtëm:

- Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike
- Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
- Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Në drejtim të vlerësimit të raportimit financiar, janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. Për auditimin e këtij drejtimi të programit të auditimit është shqyrtuar informacioni i mëposhtëm:

- Seti i plotë i Pasqyrave Financiar të Bashkisë Sarandë për vitin 2023 (Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Performancës, Pasqyra e ndryshimeve në Aktivitet Neto/ Fondet Neto, Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (Cash-Floë) dhe Shënimet shpjeguese);
- Kartelat e llogarive kontabël me tepricat dhe lëvizjet përgjatë vitit në nivel analitik;
- Ditarët e kontabilitetit për vitin 2023, regjistrat e llogarive analitike;
- Regjistri i aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata së bashku më lëvizjet;
- Regjistri i debitorëve dhe kreditorëve së bashku më lëvizjet;
- Urdhër shpenzime me zgjedhje së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- Pasqyrë e llogarisë bankare në bankë të nivelit të dytë;
- Akt rakordimet me Degën e Thesarit Sarandë për të ardhurat, shpenzimet, mjetet në ruajtje për vitin 2023;
- Dokumentacioni i mbajtur për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023;
- Vendime dhe urdhra të Bashkisë Sarandë në lidhje me të dhënat e pasqyrave financiare;
- Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH” i ndryshuar;

- Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Ligji Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar;
- VKM Nr.783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;
- UMF Nr.31, datë 13.12.2023, “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.9, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese;
- Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimit Nr.2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit - të përmirësuara;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore sipas shqyrtimit të rasteve specifike;

- Nxjerrja e Pasqyrave Financiare për vitin 2023.

Për vitin ushtrimor 2023, Pasqyrat financiare janë të nënshkruar nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Sarandë me shkresë përcjellëse nr.53/15 Prot, datë 09.02.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Nënkrjetari Bashkisë Sarandë Z. F. S. dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Drejtorisë Ekonomike Znj. T. S., në këtë rast kemi delegime të këtyre detyrave.

- Hartimi i Pasqyrave Financiare të Bashkisë Sarandë për vitin 2023:

Seti i pasqyrave financiare të Bashkisë Sarandë për vitin 2023, janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF Nr.5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, konkretisht si më poshtë:

- Formati Nr.1. “Pasqyra e pozicionit financiar”;
- Formati Nr.2. “Pasqyra e performancës financiare” (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);
- Formati Nr.3. “Pasqyra e flukseve monetare” (Cash Flow);
- Formati Nr.4. “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”;
- Formati Nr.5. “Pyetësor dhe shënimet shpjeguese”;
- Formati Nr.6. “Investimet dhe burimet e financimit”;
- Formati Nr.7/a. “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata” (Kosto Historike);
- Formati Nr.7/b. “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata” (Vlera Neto);
- Formati Nr.8. “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”.

- Rakordimi i Pasqyrave Financiare me Degën e Thesarit dhe Bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit të Bashkisë Sarandë.

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në Bashkinë Sarandë sistemi i kontabilitetit nuk është i organizuar me program profesional kontabiliteti por mbahet në programin "Excel" të paketës "Microsoft Office", i cili është format lehtësisht i manipulueshëm si dhe ka risk të lartë gabimi njerzorë gjatë mbartjes së informacionit. Pra nuk lejon ndjekjen dhe gjurmimin e veprimeve dhe regjistrimeve kontabël sipas një sistemi të kompjuterizuar kontabiliteti, duke ndërprerë vjiueshmërinë e gjurmës së auditimi, fakte këto që na japin arsye të mos kemi siguri të arsyeshme mbi pamjen e vërtetë dhe të drejtë të pasqyrave financiare si dhe plotësinë dhe saktësinë e vlerat të paraqitura.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Nuk është mbajtur libri i madh apo librat kontabël për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto

dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve ose në bazë të të drejtave të konstatuara, duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022. Nga verifikimi gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u analizuan të dhënat e disa prej llogarive kontabël konkretisht si më poshtë:

- Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Sarandë.

Inventarizimi i aktiveve është një element kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i audituar u konstatua se nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike janë hartuar listat e inventarit të cilat do të verifikohen nga anëtarët e komisionit dhe nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2023, kanë dalë urdhrat inventarizimi, konkretisht:

- Urdhëri nr.301, me nr.5165 prot, datë 17.11..2023 “Për inventarizimin e inventarit të imët”, të përbërë nga komisioni K. A., R. H., E. S., E. S., E. L. dhe Y. C..

- Urdhëri nr.303, me nr.5167 prot, datë 17.11.2023 “Për krijimin e komisionit për inventarizimit të aktiveve afatgjata, “Ndërtesa”, “Rrugë rrjete”, “Instalime teknike makineri pajisje e vegla pune”, me përbërje komisioni: R. S., Y. C., E. M., D. M. e E. S..

- Urdhëri nr.304, me nr.5168 prot, datë 17.11.2023 “Për inventarizimin e inventarit të imët”, të përbërë nga komisioni E. S., E. S., E. L. dhe B. D..

Nga të dhënat konstatohet se inventarizimi i Llogarisë Kontabël 218 për shumën 4,906,563 lekë është kryer për artikujt: “Inventar i pajisjeve dhe mobilieve” në vlerën 1,387,568 lekë, “Inventar elektronik” në vlerën 3,809,722 lekë, “Materiale në përdorim” në vlerën 1,187,118 lekë dhe “Kondicioner” në vlerën 105,000 lekë sipas listës bashkëlidhur relacionit të miratuar nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike Znj. T. S. dhe procesverbalit të miratuar nga titullari i njësisë Z. O. Ç.

Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e

inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF Nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 85, germa “c”, ku përcaktohet konkretisht që:

Pika 85. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: Germa “c”. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Sarandë nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe aktiveve afatgjata. Gjithashtu dhe në raste kur ai është kryer nuk është i plotë por vetëm për një pjesë, ku në hartimin e pasqyrave financiare është marrë për bazë gjendja kontabël e tyre dhe jo ajo fizike, veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare dhe në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III, pika 30.

Pasqyra e pozicionit financiar me tepricat e llogarive në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, krahasuar me pozicionet e një viti më parë, për Bashkinë Sarandë paraqiten në pasqyrën 1 në Anekse

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto = Aktivet - Pasivet = 2,867,370,131 lekë.

- Aktivet = 5,614,927,646 lekë

- Detyrimet = 744,776,815 lekë

- Aktivet Neto = 4,870,150,831 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 1,355,596,269 lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre” në shumën 651,705,360 lekë;

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 10,855,087 lekë;

- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 693,035,822 lekë

Fondi i Konsoliduar - Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)

Në llogarinë 101 është paraqitur në vlerën 2,867,370,131 lekë.

Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF2: Detajet e nënrubrikës “Teprica”, si më poshtë:

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria “101”		Zërat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Nxjerrje jashtë përdorimit	222,516,875	4,031,698,498	Çelje
Amortizim i vitit	233,967,399	695,161,977	Investime + Dhurime

		189,737	Ndryshim i gjendjes së inventarit
	456,484,274	4,727,050,212	
Shuma		4,270,565,938	

Sipas tabelës së mësipërme e përlllogaritur dhe sipas Udhëzimit Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, vlera e raportuar në bilanc është nënvlerësuar në vlerën 379,474 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
531	Mjete Monetare në arkë			
512	Mjete monetare në bankë			
520	Disponibilitete në thesar	651,705,360	447,533,416	204,171,944
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera			
54	Akreditiva dhe paradhënie			
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë			
	Totali	615,705,360	447,533,416	204,171,944

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, në shumën 651,705,360 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogarisë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 422,934,854 lekë, gjendja e llogarisë 12 “Rezultatet e mbartura” në shumën 177,029,513 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 51,740,993 lekë. Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 651,705,360 lekë, kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor", 12 “Rezultatet e mbartura” dhe 466 "Mjete në ruajtje". Me datë 31.12.2023 është mbajtur akt rakordimi i të ardhurave me Degën e Thesarit Sarandë për vitin 2023, si më poshtë:

1. Transfertë e pakushtëzuar dhe specifike për vitin 2023 e papërdorur, në vlerën 62,811,378 lekë.
2. Të ardhurat për vitin 2023 të papërdorura, në vlerën 537,152,989 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 599,964,367 lekë, fonde të cilat do të trashëgohen për vitin parardhës.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2021	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	4,022,601	4,080,020	-57,419
32	Inventar i imët	6,832,486	6,964,804	-132,318
33	Prodhim në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarëve			
	Totali	10,855,087	11,044,824	-189,737

Llogaritë e Klasës 3 sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Sarandë në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 10,855,087 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,022,601 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 6,832,486 lekë. Diferenca

me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën = -189,737 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 189,737 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 4,022,601 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	4,080,020
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	-
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	57,419
Gjendja në 31.12.2023	4,022,601

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton me një ulje për vitin ushtrimor prej 57,419 lekë, e cila përfaqëson zbritje të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2023. Kjo llogari është e analizuar për gjendjen datë 31.12.2023, në shumën 4,022,601 lekë, duke bërë sondazhe për 25 artikuj në inventarin fizik rezultoi se nuk ka diferenca.

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 6,832,486 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	6,964,804
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	-
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	132,318
Gjendja në 31.12.2023	6,832,486

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar Udhëzimi i MF Nr.30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Titullari i Bashkisë Sarandë ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit datë 19.10.2022, ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2023 është në vlerën 511,887,154 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 672,416,005 lekë, pra me rritje të vlerës së debitorëve të Bashkisë Sarandë në vlerën 160,528,851 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	511,887,154
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	160,600,851
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	72,000
Gjendja në 31.12.2023	672,416,005

Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr.470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë”, me kundërparti llogarinë nr.468, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar sipas Udhëzimit Nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Konstatimi: Në fund të vitit 2023 evidentohet një gjendje e konsiderueshme e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” prej 672,416,005 lekë, nga e cila: debitorët për taksat dhe tarifatat vendore për vlerën 487,483,824 lekë ose 72.5 % të totalit dhe vlera e lartë e gjendjes prej 184,932,181 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH-ja, në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat evidentohet fakti se nga Bashkia Sarandë nuk është kryer asnjë veprim për arkëtimin e tyre, si dhe nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore duke kaluar afatet e kërkitimit. Gjithashtu evidentohet dhe fakti se megjithëse janë debitorë ndaj kësaj bashkie, këto shoqëri vijnë të lidhin kontrata me Bashkisë Sarandë pa munduruar likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe mos lejimin e tyre në procedura. Në lidhje me debitorët e taksave, rezultojnë se ka një rritje të debitorëve nga viti 2022 në shumën 139,416,382 lekë nga taksat dhe tarifatat vendore çka tregon një performancë të ulët në garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara të mëparshme. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me Ligjin Nr.110/2015, datë 15.10.2015, neni 9, 11 dhe 12.

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 511,887,154 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 672,416,005 lekë. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF11: “Operacione me shtetin (detyrime)”, si më poshtë.

Emërtimi i llogarive	2023	2022
Debitorë të ndryshëm llog. 468	672,416,005	511,887,154
Totali	672,416,005	511,887,154

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është regjistruar në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (detyrime) paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Në rubrikën 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik, paragrafi 21, shtohet pika c me përmbajtje: c) Për njohjen (me konstatimin) e të drejtave për t’u arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë: Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16 (e), administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njëjësive si më poshtë: Për konstatimin paraprak të të drejtave për t’u arkëtuar debitorët llogaritet përkatëse të klasës 4 (411/468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritjes të ardhura për tu marrë”.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 20,619,817 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 20,619,817 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF6: “Të tjera operacione me shtetin”, si më poshtë.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	1,132,200
Paga personeli llog 42	8,901,280
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	777,471
Sigurime shoqërore llog.435	2,674,085
Sigurime shëndetësore llog.436	371,111

Organizma të tjera shtetërore llog. 437,438	62,160
Kreditorë të ndryshëm llog 467	6,701,510
Totali	20,619,817

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur e kuadruar me llogaritë e klasës 4 të Pasivitet të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar.

Aktivitet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 13,549,208 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 8,106,991 lekë. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF7: “Aktive afatgjata jo materiale”, si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë (Kosto Historike)	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	119,561,177
Shtesa gjatë vitit 2022(D)	272,152
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	84,118,703
Gjendja në 31.12.2022 (D)	35,442,474

Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” sipas informacionit analitik të përcjellë nga Drejtoria e Financës Bashkia Sarandë në fillim të viti 2023 ka pasur si çelje vlerën 119,516,177 e përbërë nga 114 projekte, gjatë vitit 2023 ka pasur shtesë vetëm 1 projekt në vlerën 27,152 lekë “projekt për varrezat” dhe pakësime me 105 projekte për të cilat kanë përfunduar investimet gjatë vitit 2023 në këtë llogari, në vlerën totale 84,118,703 lekë.

Aktivitet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”, sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, paraqiten në shumën 4,259,331,377 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 4,020,653,674 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 238,677,703 lekë, shtesa që kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje , në Bashkinë Sarandë dhe NJ.A Administrative si dhe pakësimet nga amortizimi dhe lëvizjet brenda aktiveve në shumën. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën përkatëse në aneks.

Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme: Gjendja e Llog 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet me vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 77,350,197 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në anekset bashkëlidhur:

2. Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, është paraqitur në bilanc në fund të vitit 2022 në vlerën 31,804,000 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 83,323,79 lekë. Gjatë viti 2023 llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” ka pasur shtesa në vlerën 51,519,719 lekë. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF8: “Pyje, Kullota, Plantacione”, si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	31,804,000
Shtesa gjatë vitit 2023(D)	51,519,719
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	-
Gjendja në 31.12.2023(D)	83,323,719

Nr	Llog	Emërtimi	Gjendja	Sasia	Çmimi	Shtesa 2023	Gjendja
----	------	----------	---------	-------	-------	-------------	---------

			31.12.2022				31.12.2023
	211	Pyje, Kullota, Plantacione	31,804,000			51,519,719	83,323,719
1	211	Ullinj (Ish Komuna Ksamil)					
2	211	Pyllëzimi dhe gjelbërimi i kurorës së qytetit Sarandë	19,920,000	1	19,920,000		19,920,000
3	211	Investim gjelbërimi				1,788,653	1,788,653
4	211	Mbjellje pemësh				8,483,448	8,483,448
5	211	Lulishte				73,739	73,739
6	211	Parqe				1,669,977	1,669,977
7	211	Mbjellje peme dekorative rruga nr.4+supërvizime				3,526,241.00	3,526,241
8	211	Mbjellje peme dekorative rruga nr.5+supërvizime				3,526,260.00	3,526,260
9	211	Mbjellje peme dekorative rruga Limon, V.Pandi				3,022,880.00	3,022,880
10	211	Rritja e kapaciteteve të gjelbërta mbjellje peme				3,585,535.00	3,585,535
11	211	Mbjellje pemë dekorative rruga hyrëse				5,240,064.00	5,240,064
12	211	Ndërtim lulishte 2005				1,285,766.00	1,285,766
13	211	Ndërtim lulishte 2007				7,403,000.00	7,403,000
14	211	Pemë dekorative 2008				921,601.00	921,601
15	211	Ndërtim lulishte 2013				1,250,000.00	1,250,000
16	211	Hapësirë e gjelbëruar rekreative sportive				4,840,987.00	4,840,987
17	211	Mbjellje pemësh në rrugët publike 2023				4,901,568.00	4,901,568

Nga auditimi i llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM Nr.510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, cila pasqyron gjendjen asetëve për llogari të Bashkisë Sarandë, në fund të vitit 2022 rezulton me një vlerë 1,134,852,828 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me një vlerë neto 1,214,742,269 lekë. Diferenca në rritje vlere prej 79,889,441 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2023 nga viti 2022.

Llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione”, përbëhen nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	1,134,852,828
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	134,911,383
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	55,021,942
Gjendja në 31.12.2023(D)	1,214,742,269

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën 3.3 “Ndërtesa Konstruksione”.

Kapitalizimi për vitin 2022 është në vlerën 134,911,383 lekë për objektet si mëposhtë:

1. Rehabilitimi i ish-vendgrumbullimit të mbetjesve Volloder (4,498,380 lekë).
2. Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra (2,165,869 lekë).
3. Rikonstruksion i Stadiumit të futbollit Sarandë (33,220,160 lekë).
4. Sistemim i tregut fruta perimeve 3,285,939 lekë).

5. Ndërtim memoriali 2010 (1,496,400 lekë).
6. Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Adem Sheme janar-dhjetor 2023 (70,115,269 lekë).
7. Rehabilitimi i ish-vendgrumbullimit te mbetjeve Volloder (223,200lekë).
8. Investime për mirëmbajtjen e ambienteve te konvikteve te shkollës së mesme (2,984,358 lekë).
9. Rikonstruksioni i sallës së mbledhjeve bashki (4,714,800 lekë).
10. Rikonstruksioni i godinës së QKF (3,869,208 lekë).

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se në Llogarinë 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,134,852,828 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 1,214,742,269 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” konstatohet se, vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare, veprim i cili nuk është në përputhje me Udhëzimin e MFE Nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III, pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” i ndryshuar me Udhëzimin Nr.5 datë 21.02.2022, pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75.

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” cila pasqyron gjendjen 482 aseteve për llogari të Bashkisë Sarandë, në fund të vitit 2022 rezulton me një vlerë neto 2,860,647,676 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me një vlerë neto 3,075,565,133 lekë. Diferenca në rritje vlere prej 214,917,457 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2023 nga viti 2022. Kjo rritje në vlerë vjen për shkak të kapitalizimit të investimet e kryera në vitin 2023. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF11: “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, si më poshtë:

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, përbëhen nga:

Lëvizjet e llogarisë (Kosto Historike)	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	3,382,689,240
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	453,699,888
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	-
Gjendja në 31.12.2023(D)	3,836,389,128

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,382,689,240 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,836,389,128 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat në vlerën 453,699,888 lekë, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se, vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “Rikonstruksion”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimin e MFE Nr.5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 30, Aneksi 1

“Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2. Klasa 2 “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, kjo llogari paraqitet me vlerë neto më datë 31.12.2023 në shumën 40,230,912 lekë. Kjo llogari është shtuar në vlerën 140,856 lekë. Llogaria është pakësuar nga amortizimi vjetor në vlerën 3,805,885 lekë dhe mjete nxjerrë jashtë përdorimit në vlerën 1,764,498 lekë. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF12: “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, si më poshtë:

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	76,117,705
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	140,856
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	1,764,498
Gjendja në 31.12.2023(D)	74,494,063

Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Sarandë më datë 31.12.2023 në shumën 55,186,960 lekë. Kjo llogari është shtuar në vlerën 9,946,800 për blerjen e 2 mjeteve. Llogaria është pakësuar nga amortizimi vjetor në vlerën 6,628,767 lekë. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF13: “Mjete Transporti”, si më poshtë:

Llogaria 215 “Mjete Transporti”, përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	45,240,160
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	9,946,800
Pakësimet gjatë vitit 2023 (K)	-
Gjendja në 31.12.2023	55,186,960

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Konispol. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet në vlerën 41,527,068 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 218 “Inventari ekonomik” është rritur me vlerën 1,379,235 lekë. Analiza e llogarisë është paraqitur në Pasqyrën PF13: “Inventar Ekonomik”, si më poshtë:

Llogaria 218 “Inventar Ekonomik”

Lëvizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2023, vlera në lekë	
Çelje në 01.01.2023	40,147,833
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	5,098,680
Dalje (K)	3,719,445
Gjendja në 31.12.2023	41,527,068

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Sarandë në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (1,159,124,501) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2023. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të

qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (233,967,399) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2023.

Pasqyra statistikore nr.7.b “Aktivet afatgjata me vlerë neto” që ka të bëjë me amortizimin vjetor 2023. Pasqyra PF12: “Aktivet afatgjata me vlerë neto”.

Llog.	Teprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Pakësimet gjatë vitit		Teprica në fund		
	Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim i	Teprica
	Historike	Akumuluar	Neto	Historike	Amortizim	Historike	Amortizim	Historike	akumuluar	neto
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	119,561,177	106,011,969	13,549,208	0	-78,676,486	84,118,703	0	35,442,474	27,335,483	8,106,991
202	119,561,177	106,011,969	13,549,208	0	-78,676,486	84,118,703	-	35,442,474	27,335,483	8,106,991
21-28	4,826,249,599	819,145,133	4,007,104,466	695,161,977	312,643,885	138,398,172	0	5,383,013,404	1,131,789,018	4,251,224,386
210	115,397,833	0	115,397,833	39,844,651	0	77,892,287	-	77,350,197	0	77,350,197
211	31,804,000	0	31,804,000	51,519,719	0		-	83,323,719	0	83,323,719
212	1,134,852,828	202,461,600	932,391,228	134,911,383	64,903,220	55,021,942	-	1,214,742,269	267,364,820	947,377,449
213	3,382,689,240	522,041,564	2,860,647,676	453,699,888	238,782,431		-	3,836,389,128	760,823,995	3,075,565,133
214	76,117,705	30,457,266	45,660,439	140,856	3,805,885	1,764,498	-	74,494,063	34,263,151	40,230,912
215	45,240,160	30,715,078	14,525,082	9,946,800	2,905,016		-	55,186,960	33,620,094	21,566,866
218	40,147,833	33,469,625	6,678,208	5,098,680	2,247,333	3,719,445	-	41,527,068	35,716,958	5,810,110
Shuma	4,945,810,776	925,157,102	4,020,653,674	695,161,977	233,967,399	222,516,875	0	5,418,455,878	1,159,124,501	4,259,331,377

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Sarandë, janë si më poshtë:

1. Ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5%;
2. Inventarin ekonomik (Aktive të tjera afatgjata materiale mbi bazë grupimi) 20%;
3. Për pajisjet kompjuterike, informatike (Mbi bazë grupimi) 25%;
4. Për mjetet e transportit 20%;
5. Për aktivet afatgjata jomateriale (Metoda Lineare) 15%.

Aktivet Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2022 dhe 2023 në vlerën 0 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2023 është paraqitur në vlerën zero siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar - Bashkia Sarandë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të “Klubi i Futbollit Butrinti” SH.A, me NUIS“L14717801V”, e cila është shoqëri aksionare me objekt: “Projektim, financim, zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve të sporteve të të gjitha llojeve me qëllim nxitjen dhe masivizimin e sportit. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 2,000,000 lekë.

- Bashkia Sarandë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 34.62% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë” SH.A, me NUIS “M24828802U” e cila është shoqëri aksionare me objekt: “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 34,620 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,462,000 lekë.

Vlerat e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në

kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit Nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit Nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje”. Në këtë rast investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (Kosto) 5,462,000 lekë dhe investitori është Bashkia Sarandë. Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në Pjesëmarrje me vlerë kontabël 5,462,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

Konstatimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2023 në vlerën 4,251,224,386 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 77,350,197 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 83,323,719 lekë, 212 “Ndërtesa Konstrukione” në vlerën 947,377,449 lekë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,075,565,133 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 40,230,912 lekë. Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstrukione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, ka një regjistër kontabël analitik të këtyre zërave por nuk ka informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet. Gjithashtu për këto objekte nuk është kryer inventar dhe verifikim fizik pasi nuk janë pajisur me certifikatë pronësie, për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (Çertifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor), pasi dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: - Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6; - Udhëzimin e MF Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, Kapitulli III, pika 35, pika 74; - Udhëzimin Nr.5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II, pika 5, 36 dhe Kreu III, pika 30. - VKM Nr.510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, ku cilësohet: “1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSJH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtron të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj. 2. NJSJH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen”.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Sarandë më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj, pasqyruar në aneksin bashkëlidhur.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2023 është në vlerën 1,132,200 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Sarandë më 31.12.2023. Lëvizja e llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Lëvizjet për shtesa e pakësime gjatë vitit 2023.

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Çelje e vitit 2023	1,163,220
Shtesa (K)	-
Pakësime (D)	31,020
Gjendja në 31.12.2023 (K)	1,132,200

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 1,132,200 lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara për projekt artistik, sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr.	Objekti	Operatori ekonomik	Vlera
1	Projekt artistik	Andi Pashollari	1,132,200
	TOTALI		1,132,200

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Sarandë, paraqitet në vlerën 8,901,280 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lëvizjet për shtesa e pakësime gjatë vitit 2022.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2023	7,475,731
Shtesa (K)	1,425,549
Pakësime (D)	-
Gjendja në 31.12.2023(K)	8,901,280

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		
Numër	Datë	Vlera
1	03.01.2024	7,122,455
2 2	03.01.2024	189,108
3	03.01.2024	97,715
4	03.01.2024	62,054
5	03.01.2024	1,025,429
11	08.01.2024	342,343
12	08.01.2024	62,176
Totali		8,901,280

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 777,471 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2023	617,791
Shtesa (K)	159,680
Pakësime (D)	-
Gjendja në 31.12.2023 (K)	777,471

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		
Numër	Datë	Vlera
1	08.01.2024	777,471
Totali		777,471

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”,

Llog. 466 " Kreditore për mjete nën ruajtje "	
Çelje e vitit 2023	40,484,979
Shtesa (K)	23,734,115
Pakësime (D)	12,478,101
Gjendja në 31.12.2023 (K)	51,740,993

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara shërbime të cilat për vitin 2022 paraqiten në shumën 6,701,510 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2023 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2023	10,291,475
Shtesa	-
Pakësime	3,589,965
Gjendja në 31.12.2023	6,701,510

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Nr	Faturën.	Datë	Emërtimi i detyrimit. Llog467	Shuma Lekë
			v.2023	
			Objekti	
1	Zyra përmbarimore B.	14.09.2010	Vendime gjyqësore	1180000
2	Nr i fat 9466	07.05.2020	Mallra	26500
3	Nr i fat 1	10.05.2018	Shërbime	17200
4	Fat dhjetor 2023	31.12.2023	Energji	3,449,584
5	Fat dhjetor 2023	31.12.2023	Uji	93,120
6	Fatura dhjetor 2023	31.12.2023	Telefon	25,105
7	Fat dhjetor 2023	31.12.2023	Shërbim	1,564,293
8	Fat dhjetor 2023	31.12.2023	Shërbim posta	269,708
9	Fat dhjetor 2023	31.12.2023	Shërbim	76,000
			Totali (Llog 467)	6,701,510

Pasqyra e Performancës Financiar sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin Nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”, paraqitet në anekset bashkëlidhur:

- Analiza e llogarive të të ardhurave sipas Pasqyrës së Performancës për vitin 2023:

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 1,375,891,571 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Sarande paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin

2023 në vlerën 557,959,625 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike 7000 “Tatim mbi Biznesin e vogël” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 763,227 lekë e cila përfshin tatimin mbi të ardhurat personale, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 111,556,809 lekë e cila përfshin tatim mbi pasurinë e paluajtshme, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë 7029 “Te tjera tatime mbi pasurinë” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 15,410,957 lekë e cila përfshin taksën e kalimit te pronësisë se mjeteve, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

ç. Gjendja e llogarisë 7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 430,228,632 lekë e cila përfshin taksa e ndërtimeve te reja, taksa e fjetjes ne hotel, taksë për zënie hapësire publike, taksë tabele, reklame, etj

- Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 169,193,042 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë 7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 9,347,034 lekë, e cila përfshin te ardhurat nga qiratë (ndërtese & truall), e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 158,559,700 lekë, e cila përfshin llogarinë 7110 “Tarifa administrative dhe rregullatore” ku përfshihen tarifatat për shërbimin e pastrimit, për leje transporti, licenca etj ,” në vlerën 150,399,600 lekë, llogaria 7111 “Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh”, ku përfshihen tarifa parkimi, të ardhura nga çerdhe e kopshte” në vlerë 6,301,500 lekë, llogaria 7113 “Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve” ne vlere 425,500 lekë llogaria 7114 “Te ardhura nga biletat” ne vlere 153,100 lekë llogaria 7115 “Te ardhura nga gjobat e ç’dëmtime” në vlere 1,280,000 leke.. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë 719 “Të ardhura të tjera jo tatimore” në vlerë 1,286,308 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Analiza e llogarive të shpenzimeve sipas Pasqyrës së Performancës për vitin 2023:

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 952,956,717 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli” për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 127,217,485 lekë.

- Gjendja e llogarisë 601 “Kontribute për sigurime” për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 21,076,685 lekë

- Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 286,877,072 lekë e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korrente te brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 300,323,176 lekë ku përfshihen transferta për degët e varësisë për klubin e futbollit dhe për Prefekturën Vlorë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” paraqitet në

bilanc për vitin 2023 në vlerën 216,272,562 lekë, ku përfshihen pagesa paaftësie, ndihme ekonomike, bursa etj, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

Për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është 1,375,891,571 lekë dhe totali shpenzimeve është 952,956,717 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 422,934,854 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultatit e ushtrimit”. Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën 189,737 lekë.

- Rregullshmëria e veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit tarifave administrative vendore dhe pagesa të kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitet e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinaconit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinaconit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi ligjshmërinë dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë, rezultoi se në 26 raste janë zhvilluar projekte artistike, aktivitete kulturore me vlerë 17,315,695 lekë, për të cilat nuk janë kryer nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e këtyre shpenzimeve është kryer sipas Vendimit Nr.51, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë me shkresën Nr.2/1 Prot., datë 17.01.2022. Nga Bashkia Sarandë për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, rezultoi se është likuiduar shuma 17,315,695 lekë, e cila përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik, sikurse parashikuar në Ligjin Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 7, 9 dhe nenet 65-70, Ligjin Nr.25/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10/352, datë 18.11.2010, “Për Artin dhe Kulturën”, neni 20, 26, 29 dhe 32 si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM Nr.710, datë 24.11.2021, neni 8.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Z. A. G., Z. O. Ç. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Znj. T. S. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Në zbatim të programit të auditimit, u kërkuar informacion në lidhje me evidentimin e të dhënave mbi pronat që Bashkisë Sarandë të cilat i janë transferuar me VKM në periudha të ndryshme ushtrimore nga ku rezultoi se:

Numri i pronave të transferuara me VKM sipas listës përfundimtare të inventarit dhe se sa prej tyre janë regjistruar në ASHK, pasqyrohen në tabelën si më poshtë vijon:

Nr		VKM		Në përdorim	Në pronësi	Nga këto
		Numër	Datë	Në numër	Në numër	regjistruar
1	Bashkia Sarandë	Nr.20	09.10.2008	336	4	4
		Nr.336	31.05.2006			
		Nr.46	16.01.2008			
		Nr.1108	30.12.2015			
		Nr.235	23.03.2011			
		Nr.297	20.04.2016			
		Nr.458	26.07.2018			
2	Ish Komuna Ksamil	Nr.476	29.06.2011	2	40 (Objekte dhe truall)	1

Pronat e regjistruara sipas objekteve dhe certifikatës së pronësisë evidentohen, në aneksin bashkëlidhur

Kërkese sipas VKM Nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive”, VKM-në Nr.684 datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në 433”, i janë kaluar në pronësi sipërfaqe pyje, kullota, toka inproduktive, shkëmbore e ujore sipërfaqja gjithsej 5133.81 ha, nga të cilat:

Pyje 230.27 ha;

Kullotë 1233.21 ha;

Toka joproduktive 169 ha;

Shkëmbore dhe ujore 1,335.33 ha, konkretisht sipas tabelës më poshtë:

Lloji	ha
Pyje	230.27
Kullota, livadhe	1,233.21
Toke bujqësore	2166
Urbane	1,165.30
Djerr (eroduar)	169
Shtrat lumi	15.5
Ujore	154.53
Total	5,133.81

Pra në total Bashkisë Sarandë i janë transferuar 5,133.81 ha nga VKM përkatëse, nga të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie për një sipërfaqe pyjore 712.4 ha dhe 149.2 ha kullotë. Në total 861.6 ha të regjistruar, Bashkia Sarandë me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.115 datë 28.07.2023 “Për miratimin e planit të menaxhimit” shprehur ligjshmëria me shkresën nr.731/1 datë 09.08.2023 të Prefektit të Qarkut Vlorë.

Në lidhje me verifikimin fizik dhe regjistrimin e tyre nga administrata e bashkisë.

Aktualisht lidhur me situatën e pasurive të paluajtshme është miratuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.28 datë 27.01.2023 “ Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, janë përcaktuar e procedurat e përditësimit të plotë apo të pjesshëm të pronave të paluajtshme shtetërore, të inventarizuara ose jo, në pronësi ose përdorim apo përgjegjësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe regullat e bashkërendimit të veprimtarisë midis Bashkisë dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, gjatë procesit të përditësimit.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr.28 datë 27.01.2023 i cili përfaqëson saktësimin e listës dhe/ose të dhënave të pronës së inventarizuar apo që do të inventarizohet, sipas gjendjes reale nga konstatimi në terren dhe gjendjes juridike në raport me titujt e pronësisë private.

Sipas pikës 3, Kreu II Njësia e Vetëqeverisjes Vendore, për kryerjen e procedurës së përditësimit vepron, si më poshtë vijon:

a) Struktura e posaçme pranë institucionit qendror apo njësisë së vetëqeverisjes vendore, me asistencën apo pjesëmarrjen e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, identifikon listën/pronën që do t'i nënshtrohet përditësimit dhe grumbullon dokumentacionin tekniko-ligjor, arkivor, që disponon për të.

b) Kryen evidentimin faktik në terren të pronës, për rastin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të Kreut II, të këtij vendimi.

c) Administron nga ASHK-ja informacion për gjendjen juridike të pronës, në përputhje me Ligjin Nr.111/2018, “Për kadastrën”, dhe Vendimin Nr.389, datë 13.05.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar, përfshirë dhe informacionin për proceset kalimtare të pronësisë, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe harton relacionin përkatës.

ç) Harton planin e rievimit të pronës sipas modelit dhe në përputhje me standardet teknike të përcaktuara në Vendimin Nr.782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

d) Harton listën e përditësuar të pronës/pronave, ku janë saktësuar emërtesa, vendndodhja, komponentët dhe destinacioni i përdorimit.

dh) Paraqet për shqyrtim pranë ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, në mënyrë që të procedohet me hartimin e projektvendimit për miratimin e listës përfundimtare të pronave shtetërore nga Këshilli i Ministrave.

Lista që paraqitet për shqyrtim shoqërohet nga relacioni i gjendjes juridike dhe plani i rievimit.

Për pronat që përditësohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, lista e pronave, sëbashku me relacionin dhe planin e rievimit i nënshtrohet vendimmarrjes nga Këshilli Bashkiak dhe verifikimit të ligjshmërisë nga prefekti, përpara se të përcillet për shqyrtim pranë ASHK-së. Bashkia Sarandë me qëllim fillimin e këtij procesi ka ngritur me Urdhrin Nr.33 datë 23.02.2024 “Grupin e punës për ndjekjen e të gjitha procedurave lidhur me përditësimin e listës së pronave shtetërore të bashkisë Sarandë dhe Njesisë Administrative Ksamil deri në kalimin përfundimtar të pronësisë”, me përbërje Znj. I. M. me detyrë zv.Kryetar i Bashkisë, Znj. I. Zh. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, Z. Z.B. Drejtor i DPKT, Znj. T. S. me detyrë Drejtor Ekonomik dhe Znj. A. Sh. me detyrë jurist pranë Drejtorisë Juridike.

Pronat në pronësi/përdorim të çertifikuar ose jo, për të cilat janë lëshuar me kontratë qiraje evidentohen sipas anekseve bashkëlidhur:

Konstatimi: Bashkia Sarandë nuk ka marrë masat e duhura për të reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse, në total nuk ka të regjistruara 5,133.81 ha, nga të cilat, 430.9 hektarë të sipërfaqeve të pyjeve dhe 783.3 hektarë të sipërfaqeve të kullotave të kaluara në favor të saj sipas VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 59, shtojca me nr.57, e ndryshuar dhe VKM-në Nr.684 datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në 433”. Kjo sjell rrjedhimisht mospasqyrim të saktë dhe të drejtë të llogarisë 211, në mbyllje të Pasqyrave financiare të vitit 2023. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimin e MFE Nr.5 datë 21.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE Nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika 2.1.

- Nuk janë ngritur komisione për kryerjen e verifikimeve të aktiveve për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, e cila paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 83,323,719 lekë.

- Nuk është hartuar raport lidhur me inventarizimit fizik të aktiveve, vlerësim paraprak për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtje lidhur me karakterin nëse ka diferenca apo jo për gjendjen e aktiveve.

- Gjatë vitit 2023 janë marrë 8 çertifikata pronësie të llojit të pasurisë kullotë dhe pyll nga të cilat 4 çertifikata me sipërfaqe totale 712.4 ha të llojit “Kullotë” dhe 149.2 ha të llojit “Pyll”. Këto çertifikata pronësie nuk rezultojnë të evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2023 në llogarinë (211), të Bashkisë Sarandë.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me ligjin Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe nenin 15, me Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

Për veprimet dhe mosveprimet e, mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Znj. T. S. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

Për vitin ushtrimor 2023, Bashkia Sarandë ka kryer gjithsej 46 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit 282,047,049 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur 267,184,308 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 14,862,741 lekë pa TVSh.

Procedurat e periudhës 01.01.2023-31.12.2023	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
Gjithsej	46	282,047,049	252,209,308
- E hapur ndërkombëtare	1	131,855,000	129,808,930
- Të hapura	4	57,225,433	54,462,460
- E hapur e thjeshtuar	12	71,397,481	66,274,880
- Të vogla	29	21,569,135	16,63,038

U audituan me zgjedhje 12 procedura, nga të cilat 10 të realizuara gjatë vitit 2023 me fond limit 219,021,663 lekë dhe 2 procedura të nisura në vitin 2022 dhe të përfunduara në vitin 2023, me

fond limit 59,166,666 lekë, nga ku rezultoi si vijon:

“Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për Bashkinë Sarandë”

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane për Bashkinë Sarandë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 3 datë 4.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. B. D., Kryetar 2. R. H., Anëtar 3. A. B., Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 3/1, datë 14.02.2023 1. R. S., Kryetar 2. K. A., Anëtar 3. J. M., Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur, shërbime, mbi kufirin e lartë monetar”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 131,855,000 lekë	6. Oferta fituese: OE “A. I. C.” ShPK me ofertë 129,808,930 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 3, datë 03.07.2023, me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 2,046,070 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 31.05.2023	9. Burimi Financimit: Buxheti Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) Skualifikuar 3 OE c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK: Ska	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Ska

Llogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike:

Procedura me objekt pastrimin e qytetit është miratuar në Buxhetin për vitin 2023 në vlerën 158,226 mijë lekë me TVSh në zërin shpenzime, llog. 602 dhe do të mbulohet nga të ardhurat e veta të Bashkisë. Kjo procedurë ka qenë e planifikuar për t’u zhvilluar në vitin 2022, nga ku është përlllogaritur një fond limit prej 213,750,000 lekë pa TVSh për 36 muaj. Për këtë procedurë ka patur ankimime në KPP pikërisht për përlllogaritjen e fondit limit dhe për këtë arsye, me Vendimin nr. 1033/2022, me nr. 1889/16 prot., datë 21.10.2022 të KPP-së, kjo procedurë është anuluar. Referuar këtij Vendimi ka rezultuar se ankimimi për fondin limit qendron dhe bazuar në përlllogaritjet e ekspertit të fushës për këtë çështje, fondi limit duhej të ishte në vlerën 131,855,469 lekë për 12 muaj.

Në përlllogaritjen e fondit limit nga AK, janë konstatuar mangësi sa i takon mos aplikimit të vlerës së pagës minimale sipas ndryshimeve të fundit ligjore, përfshirja si shpenzime të operatorit të vlerës 15% të kostos së shërbimit, si kosto administrative për mbledhjen e taksave, ndërkohë që operatori ekonomik është subjekt privat dhe nuk ka rolin e agjentit tatimor për Bashkinë, si dhe mangësi në përlllogaritjen e orëve të punës për punëtorët. Referuar Vendimit të KPP, kërkohet anulimi i procedurës dhe ripërsëritja e saj duke mbajtur parasysh sugjerimet e ekspertit të fushës në përlllogaritjen e fondit limit gjatë ri përsëritjes së procedurës.

Për ripërsëritjen e procedurës, ka dalë urdhëri nr. 3, datë 31.01.2023 i titullarit, z. A. G. për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, me përbërje B. D., R. H. dhe A.B.. Nga auditimi rezulton se në rend kronologjik, pas ngritjes së njësisë së prokurimit me urdhër për hartimin e specifikimeve teknike, kritereve të kualifikimit dhe fondit limit, ka dalë urdhri i titullarit po me nr. 3 datë 14.02.2023 për zhvillimin e procedurës së prokurimit, në të cilin evidentohen fondi limit, lloji i procedurës, si dhe kërkohet përgatitja e dokumenteve të tenderit.

Nga auditimi rezulton se urdhri i prokurimit nga titullari ka dalë pa u përgatitur dokumentacioni nga njësia e prokurimit mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit, dokumentacion që faktikisht është mbajtur më datë 26.04.2023, provuar

nga procesverbali i mbajtur për këtë qëllim në këtë datë dhe pa nr. Prot, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Të gjithë urdhrat dhe procesverbalet e mësipërme nuk janë të protokolluar në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur nga njësia e prokurimit për përlllogaritjen e fondit limit, rezultoi se kontrata e shërbimit është parashikuar të përmbajë 22 aktivitete, ku për secilin prej tyre është përlllogaritur një çmim/njësi. Nga auditimi rezultoi se, referuar edhe VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, çmimi/njësi është përlllogaritur duke përfshirë një sërë elementësh që do të shpenzohen sipas secilit aktivitet, ku bëjnë pjesë pagesa e punëtorëve, kosto për veshje, vegla pune, mjete e pajisje, konsum karburanti, shpenzime mirëmbajtje, taksa e siguracione mjetesh, qira ambjentesh parkimi, etj.

Nga auditimi rezultoi se krahas elementëve të mësipërm, pjesë e çmimit/njësi është edhe zëri shpenzime administrative në masën 5% të koston totale të aktivitetit. Referuar pikës 1.6 të VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, ky zë përbëhet nga *shpenzimet e nevojshme për të drejtuar të gjithë sistemin, zhvilluar strategji dhe politika, për të siguruar eficiencë dhe efektivitet, ofruar trajnime dhe aftësime etj. Në këtë zë të koston futen dhe nevojat për infrastrukturë mbështetëse për personelin, që përfshin uniforma, mjete për grumbullimin, pastruesit kimikë etj. Kostot administrative mund të përfshijnë koston e nevojshme për rikuperimin e kostove dhe për fushatat e ndërgjegjesimit publik.*

Nga auditimi rezulton se zëri kosto administrative është i dubluar pasi:

- Së pari, njësia e prokurimit i ka përfshirë njëherë në përlllogaritje shpenzimet për infrastrukturë mbështetëse për personelin, që përfshin uniforma, mjete për grumbullimin, pastruesit kimikë etj;
- Së dyti, shërbimi në fjalë nuk hyn tek veprimtaritë që kërkon shpenzime për të zhvilluar strategji dhe politika;
- Së treti, për sa i përket shpenzimeve për fushata ndërgjegjesimi, referuar nenit 14, pika 14.1 të kontratës së shërbimit, ky detyrim është përcaktuar të mbulohet nga Bashkia.

Pra, për sa më lart rezulton se njësia e prokurimit nuk duhet të përfshinte në përlllogaritjen e çmimit zërin kosto administrative prej 5%, pasi në këtë rast rezulton se janë përfshirë 2 herë shpenzimet për mbështetje infrastrukture.

Referuar edhe pikës 1 të shtojcës 1 të VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, modeli i përlllogaritjes së kostove për menaxhimin e integruar të mbetjeve është standard dhe përbëhet nga elementët e koston si vijon:

1. Të dhënat e përgjithshme për njësinë administrative apo zonën e shërbimit;
2. Investimet kapitale (kamionët dhe kazanët e nevojshëm);
3. Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel);
4. Kostoja për trajtim në landfill (tarifa e trajtimit);
5. Kostot e amortizimit (riinvestimit);
6. Kostot administrative (siç u përmendën më lart)
7. Përlllogaritja e kostove totale të shërbimit.

Po kështu konstatohet se në modelin e përlllogaritjes së çmimit/njësi për mbledhjen dhe largimin e

mbetjeve sipas zonave, është përfshirë edhe kosto e amortizimit të kazanëve. Nga auditimi rezulton se kazanët në qytetin e Sarandës janë në pronësi të vetë Bashkisë, pra janë të inventarizuar dhe vlerësuar në regjistrat e aseteve të Bashkisë dhe amortizimi i tyre është një kosto që Bashkia e pasqyron njëherë në regjistrin e saj të aktiveve dhe nuk mund të shpenzohet dy herë duke ja paguar edhe operatorit ekonomik pasi nuk është një zhvlerësim që i ndodh asetve të operatorit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, pika III/30, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Përfshirja e këtij elementi në zërin “Grumbullim, transport dhe depozitim i mbetjeve”, ka shkaktuar një rritje të cmimit/njësi për këtë zë.

Në total, rezulton se nga aplikimi jo i drejtë i kostove administrative dhe përfshirja e amortizimit të kontenierëve si shpenzim i operatorit ekonomik, fondi limit është rritur në një vlerë jo reale prej 8,388,166 lekë, pasqyruar në aneksin bashkëlidhur.

Hartimi i kritereve të kualifikimit:

- Në pikën 2.2.1., është kërkuar që OE të paraqesin “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit...” Kjo kërkesë është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, pasi vlera minimale e xhiros vjetore jo më e vogël se 40% aplikohet për rastet e procedurave nën kufirin e ulët monetar dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndërkohë që për rastin në fjalë, pra procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, kriteri për garantimin e kapacitetit ekonomik e financiar duhej të ishte “xhiro minimale vjetore nuk duhet të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.

Në pikën 2.3.1., kërkohet që OE të ketë “...dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate...”, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 3, pasi kriteri sipas përcaktimit ligjor është një vlerë jo më e madhe se 40% e vlerës së fondit limit. Pra në këtë rast AK ka përjashtuar nga konkurrimi operatorët me vlera kontrate për punë të ngjashme nën 40% të fondit limit.

Në pikën 2.3.4., kërkohet që OE të disponojë “...I (një) punonjës të licencuar si “Kordinator i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”...”, pozicioni i cili rregullohet nga VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Referuar kësaj rregullore, pozicioni i kordinatorit të sigurisë dhe shëndetit në punë ka të bëjë me punime ndërtimi në kantjerë të përhershëm apo të lëvizshëm dhe objekti i prokurimit në fjalë, pra pastrimi i qytetit nuk përfshihet në aneksin 1 të kësaj Rregulloreje. Për sa më lart, kriteri i kërkuar është jashtë objektit të kontratës dhe i pa nevojshëm për llojin e shërbimit të prokuruar.

Së fundi, konstatohet se për të gjitha mjetet teknologjike ose jo, të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi, është kërkuar të kenë një vit prodhimi jo më poshtë se viti 2010. Ky kriter pengon konkurrencën, për sa kohë mjetet kanë procedura verifikuese dhe miratuese për qarkullimin dhe funksionalitetin e tyre nga autoritete përkatëse. Për këtë qëllim, kërkohen edhe një sërë dokumentash, ashtu sic edhe njësia e prokurimit ka vepruar, të cilat garantojnë funksionalitetin e tyre pavarësisht vitit të prodhimit. Nga auditimi rezulton se ky kriter është vendosur jo për të gjithë mjetet, por vetëm për një pjesë të tyre dhe nga verifikimi i dokumentacionit të fituesit rezulton se

ky operator zotëron pikërisht ato makineri që janë kërkuar me vit prodhimi jo më poshtë se 2010 dhe nuk zotëron brenda këtij kriteri pikërisht ato makineri për të cilat nuk është vënë një kufizim në vitin e prodhimit.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga B. D., R. H. dhe A. B.,

Vlerësimi i ofertave:

Nga auditimi i procedurës u konstatua se është mbajtur PV pa datë dhe numër protokollit për hapjen e ofertave, nga ku konstatohet pjesëmarrja e gjashtë OE për të cilët është vendosur si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	A. I. C.	128,808,930	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	A.G.	131,423,506	Skualifikuar pasi: Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës
3	C. C.	0	Skualifikuar pasi: Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
4	P. S.	128,446,019	Skualifikuar pasi: Në Formularin e Vetëdeklarimit nuk janë specifikuar të dhënat e mjeteve të transportit.
5	F.	131,215,835	Kualifikuar
6	R.	131,843,812	Kualifikuar

Nga shqyrtimi dokumentacionit të operatorit fitues, rezulton se zotëron Leje mjedisi tipi B, me objekt “pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierëve për tu ripërdorur”, si dhe Licensë të tipit III.2.B me objekt “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezkshme”. Nga auditimi rezulton se në Akt-miratimin e kësaj leje me nr. 2596, datë 20.04.2023, nuk pasqyrohen kodet e mbetjeve urbane, por përgjithësisht bëhet fjalë për kodet e mbetjeve nga punime civile, faktuar kjo edhe me Licensën e veprimtarisë së Operatorit Ekonomik me nr. NZ6094/2 e cila është lëshuar vetëm për kategoritë e punimeve në ndërtim.

Sa i takon disponimit të mjeteve, rezulton se OE ka paraqitur mjetin me targa AB....IR të cilin në vetëdeklaratën për posedimin e mjeteve e ka kategorizuar për llogari të kriterit mjet teknologjik transportues me kapacitet 10-15 ton. Nga auditimi rezulton se ky mjet në lejen e qarkullimit kategorizohet si kamion dhe jo mjet teknologjik. Po kështu, ky mjet ka një kapacitet mbajtës prej 26 ton, pra shumë më tepër se sa është kërkuar nga njësia e prokurimit dhe një tonazh i tillë ndikon ndjeshëm në rritjen e normave të konsumit të karburantit, apo variablave të tjerë gjatë transportit të përlllogaritura në modulën e miratuar sipas VKM përkatëse.

Së fundmi, për mjetin në fjalë nuk janë paraqitur as certifikata e pronësisë, as certifikata e kontrollit teknik dhe as taksa vjetore. Në 2 fotot e paraqitura, mjeteve është fotografuar jo i plotë, ku nuk dallohet nëse korrespondon marka me atë të lejes së qarkullimit.

Për mjetin me targa AB....JN për llogari të kriterit mjet teknologjik transportues me kapacitet 10-15 ton, rezulton se nuk është dorëzuar certifikata e pronësisë.

Për mjetin me targa AB....IR për llogari të kriterit mjet teknologjik transportues me kapacitet 10-15 ton, rezulton se nuk është dorëzuar certifikata e pronësisë dhe as taksa vjetore.

Për mjetin me targa AB....U për llogari të kriterit mjet teknologjik transportues me kapacitet 10-15 ton, rezulton se kapaciteti mbajtës është 16 ton dhe një tonazh i tillë ndikon ndjeshëm në rritjen e normave të konsumit të karburantit, apo variablave të tjerë gjatë transportit të përlllogaritura në modulën e miratuar sipas VKM përkatëse. As për këtë mjet nuk është dorëzuar certifikata e pronësisë.

Për mjetin me targa AB....HX për llogari të kriterit mjet vetëshkarkues jo më pak se 3 ton, rezulton se nuk është paraqitur certifikata e pronësisë.

Për mjetet me targa AB....JX dhe AB....JZ paraqitur për llogari të kriterit makinë transportuese

vetëshkarkuese me kapacitet jo më shumë se 1.5 ton, rezulton se nga verifikimi i lejes së qarkullimit mjetet kanë funksion transporti njerëzish dhe mallrash. Kjo dallohet qartë edhe nga fotot e paraqitura, ku mjetet janë modifikuar, pasi janë të tipit Ford Ranger dhe Dacia Dokker dhe mbi karroceri i është vendosur një kazan.

Krahas sa më lart, kapaciteti mbajtës është 3 ton për rastin e parë dhe 2 ton për rastin e dytë, pra më tepër se sa është kërkuar nga njësia e prokurimit (për të dyja rastet bëhet fjalë kapaciteti i vetë mjetit aq sa është pasqyruar në dokumentacionin zyrtar dhe nuk ka të dhëna se sa mund të shkojë ky kapacitet me modifikimin që u është bërë duke ju vendosur kazanët sipër) dhe një tonazh i tillë ndikon ndjeshëm në rritjen e normave të konsumit të karburantit, apo variablave të tjerë gjatë transportit të përlllogaritura në modulin e miratuar sipas VKM përkatëse. Për këto mjete nuk është dorëzuar certifikata e pronësisë dhe as taksa vjetore.

Për mjetin me targa AMMT... të tipit makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve nuk janë dorëzuar certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik të mjetit dhe taksa vjetore. Dokumentet që i janë bashkëlidhur këtij mjeti i korrespondojnë mjetit me targa AGMT..., pra një tjetër mjet.

Për mjetin me targa AB....IO i cili është deklaruar mjet për larjen e rrugëve, rezulton se nga leja e qarkullimit është mjet transporti mallrash të rrezikshme.

Sa i takon kriterit për posedimin e një sipërfaqe trualli jo më pak se 1000m² për parkimin e mjeteve dhe larjen e dezinfektimit e kazanëve, rezulton se OE fitues ka paraqitur një kontratë qeraje për truallin me sipërfaqe 1400m², i cili ndodhet në Kavajë. Kjo vendodhje është tepër larg dhe jashtë mundësisë që automjetet e punës të përshkojnë këto distanca brenda orareve të përcaktuar në grafikët e punës. Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike të cilat janë edhe detyrim kontraktor rezulton se AK ka të drejtë penalizimin e operatorit në rast se pas njoftimit për mos realizim të punimeve, ai nuk paraqitet të realizojë këto punime brenda një afati prej 5 orë. Duke marrë aparasysh se makinat teknologjike kanë një limit lëvizje sa i takon shpejtësisë, është e pa mundur që këto mjete me marrjen e njoftimeve, të mbërrijnë në Sarandë, si dhe të kenë përfunduar shërbimin të gjitha brenda një harku kohor prej 5 orë. Për më tepër, nuk rezulton që kjo hapësirë të jetë pikë e autorizuar lavazhi për kontenierët dhe e pajisur me lejet përkatëse.

Nga auditimi rezulton se nga kjo procedurë KVO ka skualifikuar 3 OE dhe përkatësisht

-A. G. me vlerë oferte 131,423,506 lekë për mos paraqitjen e sigurimit të ofertës;

-C. C. për mos paraqitjen e ofertës ekonomike;

-P. S. me vlerë oferte 128,446,019 lekë, pasi në formularin e vetëdeklarimit të paraqitur në sistem për posedimin e automjeteve të punës, nuk ka pasqyruar të gjitha detajet e kërkuara nga njësia e prokurimit si tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për secilin mjet. Nga auditimi rezulton se P. S. sh.p.k në vetëdeklarimin e dorëzuar për mjetet ka pasqyruar llojin teknik, numrin e mjeteve që disponon për secilin lloj, kapacitetin e tyre mbajtës dhe llojin e pronësisë. Ndërkohë nga shqyrtimi i vetëdeklarimit të operatorit të shpallur fitues rezulton se krahas elementëve të mësipërm, ka deklaruar edhe targat (element i cili nuk është kërkuar në kriteret e kualifikimit).

Për sa më lart rezulton se KVO ka gjykuar jo në mënyrë të paanshme duke qenë se asnjëri nga operatorët nuk ka deklaruar për mjetet as nr. e shasisë, as markën, ndërkohë skualifikimi i P. S. është bërë për mos deklarimin e vitit të prodhimit dhe targave (një element që në fakt nuk është kërkuar). Devijimi nga deklarimi për elementë kaq të ngjashëm nga të dy operatorët duhet të bënte që KVO të kryente verifikimin e mjeteve në terren, ashtu sic parashikuar në kriteret e kualifikimit, duke qenë se bëhet fjalë për një diferencë të konsiderueshme oferte prej 1,362,911 lekë më të lartë.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të ofertave R. S.j, K. A. dhe J. M.

Zbatimi i kontratës

Me shpalljen e fituesit është lidhur edhe Kontrata e shërbimit me nr. 3, datë 03.07.2023, me kohëzgjatje 365 ditë, me vlerë 155,770,716 lekë me TVSh, mes Bashkisë Sarandë përfaqësuar nga Zv.Kryetari F. S. dhe operatorit A. I. C. përfaqësuar nga administratori A. A.. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës rezultoi se:

Nuk janë paraqitur raporte mujore nga sipërmarrësi, të cilat pasqyrojnë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe pajisjeve që përdoren për këtë shërbim, në kundërshtim me pikën 8.1 të Kontratës.

Për monitorimin e zbatimit të kontratës, sektori i shërbimit të pastrimit mban procesverbale ditore në dy hapësira orare, në orën 7:00 për verifikimin e shërbimit të natës dhe në orën 15:30 për verifikimin e shërbimit të ditës. Nga auditimi rezulton se procesverbalet e mbajtura janë tepër formale ku për secilin aktivitet vihet vetëm shënimi “kryer shërbimi” dhe nuk përcaktohen as volumet e kryera si sipërfaqet apo pesha e mbetjeve të grumbulluara dhe as elementë të tjerë të detyrueshëm për tu zbatuar sic përcaktuar në kontratën e shërbimit, të tilla si oraret e operimit, llojin, targën dhe itinerarin e mjeteve, numrin e punëtorëve që janë angazhuar, etj. Po kështu, konstatohet se grafiku i punimeve me volumet e punës plotësohet dhe nënshkruhet vetëm nga operatori ekonomik dhe nuk rezulton të jetë konfirmuar nga sektori i shërbimit të pastrimit në Bashki.

Krahas procesverbaleve të mbajtura pa asnjë tregues sasior apo cilësor konstatohet se ka mangësi të theksuara në dokumentimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe konkretisht:

Nuk është e dokumentuar shërbimi i larjes dhe dezinfektimit të kontenierëve. Referuar pikës 24.6 të Kontratës, operatori duhet të kryejë këtë shërbim mesatarisht për 7 kontenierë/ditë, duke bërë zëvendësimin e tyre për periudhën e kryerjes së shërbimit të larjes. Po kështu, referuar pikës 24.9 të Kontratës, *të gjitha lëndët dezinfektuese dhe aromatike dhe uji i përdorur për larjen e kontenierëve, pra përbërja dhe leja e përdorimit duhet të jenë të miratuara fillimisht nga organet shtetërore shëndetësore dhe më pas edhe nga autoriteti kontraktor. Mos miratimi i lëndëve kimike të përdorura e bën të pa vlefshëm këtë shërbim dhe nuk mund të kryhet pagesa.* Nga auditimi nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë për verifikimin e zbatimit të këtij detyrimi nga operatori ekonomik pasi nuk evidentohet asnjë dokument miratues mbi produktet kimike të pastrimit as nga organet shëndetësore dhe as nga vetë autoriteti kontraktor. Pavarësisht kësaj, janë vijuar pagesat për larje e dezinfektim të cilat për periudhën objekt auditimi (korrik-dhjetor 2023) janë në vlerën 481,712 lekë.

Po kështu, nga auditimi rezulton se kontrata e shërbimit është nënshkruar mes palëve më datë 03.07.2023, ndërkohë që rezulton se për muajin korrik operatori ka faturuar shërbime edhe para kësaj date, që më 01.07.2023 kur kontrata nuk ka qenë në fuqi, në një vlerë prej 1,080,488.2 lekë pa TVSh.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi njësia e shërbimit të pastrimit dhe supervizori i kontratës, A. B., S. N., P. Sh. dhe R. S..

“Rikualifikim i rrugëve te brendshme me asfalt ne Gjashte , Sarande”

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikim i rrugëve te brendshme me asfalt ne Gjashte , Sarande”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 6 datë 14.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 6 datë 14.02.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 6/1 datë 14.02.2023
4. Lloji i Procedurës:	1. B. D.	1. J. M.

E hapur e thjeshtuar	2. R. H. 3. A. B.	2. K. A. 3. R. C.
5. Fondi Limit: 7,916,666 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE S. ShPK, me vlerë 7,268,256 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 6, datë 18.04.2023, me afat 25 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 648 mijë lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 21.03.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Zhvillimi i procedurës

Me urdhër nr. 6, datë 02.02.2023 të titullarit është caktuar eksperti i fushës A. T. për hartimin e projektit, kërkesave të vecanta apo specifikime që lidhen me objektin e prokurimit “*Rikualifikim i rrugëve te brendshme me asfalt ne Gjashte , Sarande*”, si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë objekt.

Nga auditimi rezulton se për përllogaritjen e fondit limit, eksperti i fushës është bazuar në cmimet referencë përcaktuar në manualin teknik të ndërtimit, nga ku ka rezultuar një vlerë preventivi prej 7,917,072 lekë pa TVSh, shoqëruar me specifikimet teknike dhe grafikun e punës. Nga auditimi rezulton se në dosje nuk administrohet marrja në dorëzim e projektit dhe anekset përkatëse. Po kështu konstatohet se në buxhet ky projekt investimi është miratuar në vlerën 4,554 mijë lekë me TVSh nga ku konkludohet se Bashkia ka marrë angazhime për kryerjen e procedurës pa patur të gjithë fondin e nevojshëm për këtë investim, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Me urdhër nr. 6, datë 14.02.2023, është caktuar njësia e prokurimit me përbërje B. D., R. H. dhe A. B. për zhvillimin e procedurës së prokurimit mre objekt “*Rikualifikim i rrugëve te brendshme me asfalt ne Gjashte , Sarande*” me fond limit 7,917,666 lekë pa TVSh. Ndërkohë me procesverbal datë 09.03.2023, njësia e prokurimit ka hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit.

Sa i takon aftësi teknike dhe profesionale, në pikën 2.3.1 është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme në një objekt më vete në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit. Po kështu është kërkuar që punimet e ngjashme të marra sëbashku për pesë vitet e fundit, të kenë një vlerë kufi jo më të vogël se 100% e vlerës së kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55 pika 4 ku përcaktohet se në rastet e procedurave të prokurimit të hapur të thjeshtuar, vlera e punimeve të ngjashme kërkohet jo më e madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, ose vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet, duke bërë që të kufizohet pjesëmarrja e operatorëve.

Në pikën 2.3.4 kërkohet që operatori ekonomik të ketë një numër të punësuarish jo më të vogël se 18 persona. Për këtë kriter nuk ka asnjë argument vlerësues sasior duke përllogaritur numrin e nevojshëm të punonjësve sipas zërave të punimeve apo grafikut të punës, në kundërshtim me nenin 2 pika 2c të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në pikën 2.3.6 kërkohet që OE duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij 1 saldator, me argumentimin se ky punonjës nevojitet për garantimin e përmbushjes së zërave të punimit. Nga auditimi rezulton se në preventivin e zërave të punimeve nuk konstatohet asnjë veprimtari, apo materiale që lidhen me saldimit.

Për sa më lart ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit A. B., B. D. dhe R. H.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhër nr. 6/1, datë 14.02.2023 të titullarit është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje R. C., K. A. dhe J. M.. Me procesverbal nr.1 datë 21.03.2023, KVO ka bërë hapjen e ofertave nga ku rezulton se ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik S. sh.p.k me vlerë oferte 7,268,256 lekë pa TVSh. Me procesverbal nr. 2, datë 23.03.2023, pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar në sistem, KVO ka konkluduar në kualifikimin e këtij operatori, i cili përmbush kriteret e kualifikimit, si dhe është vijuar me shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës nr. 6 datë 18.04.2023.

“Rikonstruksion i rrugës 47”

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës 47”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 4 datë 14.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 4 datë 07.03.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 4/1 datë 07.03.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur	1. B. D. 2. R. H. 3. A. B.	1. R. C., Kryetar 2. J. M., Anëtar 3. K. A., Anëtar
5. Fondi Limit: 5,583,333 lekë pa TVSh. REF-61533-03.06.2023	6. Oferta fituese: OE I. ShPK, me vlerë 5,457,780 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 4, datë 18.04.2023, me afat 20 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 126 mijë lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 20.3.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Zhvillimi i procedurës

Me urdhër nr. 4, datë 02.02.2023 të titullarit është caktuar eksperti i fushës A. K. për hartimin e projektit, kërkesave të vecanta apo specifikime që lidhen me objektin e prokurimit “Rikonstruksioni i rrugës 47”, si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë objekt. Nga auditimi rezulton se për përllogaritjen e fondit limit, eksperti i fushës është bazuar në cmimet referencë përcaktuar në manualët teknike të ndërtimit, nga ku ka rezultuar një vlerë preventivi prej 5,582,162 lekë pa TVSh, shoqëruar me specifikimet teknike dhe grafikun e punës. Nga auditimi rezulton se në dosje nuk administrohet marrja në dorëzim e projektit dhe anekset përkatëse.

Me urdhrin nr. 4 datë 14.02.2023 të titullarit është caktuar njësia e prokurimit me përbërje B. D., R. H. dhe A. B. për zhvillimin e procedurës së prokurimit mre objekt “Rikonstruksioni i rrugës 47” me fond limit 5,583,333 lekë pa TVSh. Me procesverbalin datë 07.03.2023 njësia e prokurimit ka hartuar kriteret e kualifikimit, nga ku rezultoi se sa i takon aftësive teknike dhe profesionale, në pikën 2.3.1 është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme në një objekt më vetë në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit. Po kështu është kërkuar që punimet e ngjashme të marra sëbashku për pesë vitet e fundit, të kenë një vlerë kufi jo më të vogël se 100% e vlerës së kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55 pika 4 ku përcaktohet se në rastet e procedurave të prokurimit të hapur të thjeshtuar, vlera e punimeve të ngjashme kërkohet jo më e madhe se 30 %

e vlerës së përlllogaritur të kontratës, ose vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet, duke bërë që të kufizohet pjesëmarrja e operatorëve.

Në pikën 2.3.4 kërkohet që operatori ekonomik të ketë një numër të punësuarish jo më të vogël se 20 persona. Për këtë kriter nuk ka asnjë argument vlerësues sasior duke përlllogaritur numrin e nevojshëm të punonjësve sipas zërave të punimeve apo grafikut të punës, në kundërshtim me nenin 2 pika 2c të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në pikën 2.3.7 është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar një arkeolog për veprimtarinë vëzhgim arkeologjik pasi rruga ku do të kryhen punimet ndodhet në zonën A të Arkeologjisë. Nga auditimi rezulton se kjo rrugë nuk ndodhet në zonë arkeologjike A. Nga përfaqësuesit e Bashkisë u deklarua se pavarësisht se objekti i prokurimit është rikonstruksioni i rrugës 47, në këtë objekt prokurimi është futur edhe rikonstruksioni i një sheshi që ndodhet në zonën Arkeologjike A.

Nga auditimi rezulton se kjo gjë nuk është e shprehur në asnjë nga dokumentet e mbajtura për zhvillimin e kësaj procedure. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk rezulton të ketë të dhëna, sipërfaqe apo zëra punimesh për rikonstruksion sheshi, por flitet vetëm për rrugën.

Për sa më lart ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit A. B., B. D. dhe R. H.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhër nr. 4/1, datë 14.02.2023 është ngritur Komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë nga R. C., K. A. dhe J. M.. Me procesverbal nr. 1 datë 20.03.2023 është bërë hapja e ofertave nga ku rezultojnë 2 pjesëmarrës, I. sh.p.k me vlerë oferte 5,457,780 lekë dhe N.sh.p.k me vlerë oferte 5,566,110 lekë. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertuesve, me procesverbalin nr.2, datë 27.03.2023 është konkluduar se të dy operatorët i përmbushin kërkesat për kualifikim dhe është vijuar me shpalljen fitues të operatorit me vlerë oferte më të ulët, I. sh.p.k me vlerë oferte 5,457,780 lekë, me të cilin është lidhur edhe kontrata me nr. 4, datë 18.04.2023.

Objekti “Rehabilitim të kanalizimeve në rrugën Vangjel Pandi”

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim të kanalizimeve në rrugën Vangjel Pandi”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 9 datë 27.3.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 9 datë 27.3.2023	3. Komisioni Vlerësimi i Ofertave: Nr. 9/1 datë 27.03.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. B. D. 2. R. H. 3. A. B.	1. R. S. (Kryetar/Jurist) 2. K. A. (Ing. Elektronik) 3. J. M. (Ekonomist)
5. Fondi Limit: 12,000,000 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE Sh. ShPK, me vlerë 11,600,000 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 9, datë 19.05.2023, me afat 30 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 400,000 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 18.04.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Zhvillimi i procedurës

Me urdhër nr. 9, datë 06.03.2023 të titullarit është caktuar eksperti i fushës K. K. për hartimin e projektit, kërkesave të vecanta apo specifitime që lidhen me objektin e prokurimit “Rehabilitim i

kanalizimeve në rrugën Vangjel Pandi”, si dhe përlllogaritjen e fondit limit për këtë objekt. Nga auditimi rezulton se për përlllogaritjen e fondit limit, eksperti i fushës është bazuar në cmimet referencë përcaktuar në manualët teknike të ndërtimit, nga ku ka rezultuar një vlerë preventivi prej 12,000,000 lekë pa TVSh, shoqëruar me specifikimet teknike dhe grafikun e punës.

Nga auditimi rezulton se ky investim është miratuar me hartimin e buxhetit për këtë vit në vlerën 15,100 mijë lekë me TVSh. Dokumentacioni i dorëzuar nga projektuesi që përmban preventivin e punimeve me zërat përkatës, projektin dhe specifikimet teknike është miratuar nga zv.Kryetari. z.R. Ç.. Nga auditimi rezulton se specifikimet teknike të përgatitura nga projektuesi dhe të miratuara nga zv.Kryetari i Bashkisë nuk përmbajnë asnjë të dhënë, shpjegim apo përlllogaritje mbi rrjetin e kanalizimeve, apo punimet që do të kryhen për këtë qëllim, por fokusohen vetëm në lidhje me punimet e shtrimit pas ndërhyrjeve, si dhe në të dhënat mbi asfaltobetonin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me objektin e prokurimit dhe kontratën (pa nr.prot) datë 06.03.2023 lidhur mes projektuesit K. K. dhe titullarit të Bashkisë A. G., neni 6 ku citohet se ndër të tjera projektuesi duhet të dorëzojë brenda afatit 1 javor specifikimet teknike sipas zërave të punimeve dhe në këtë rast, mungojnë specifikimet teknike për zërat 4,5,6,8,9,10 të preventivit.

Me urdhrin nr. 9 datë 27.03.2023 të titullarit është caktuar njësia e prokurimit me përbërje, R. H., B. D. dhe A. B. për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt *“Rehabilitim i kanalizimeve në rrugën Vangjel Pandi”* me fond limit 12,000,000 lekë pa TVSh. Me procesverbal datë 03.04.2023 njësia e prokurimit ka hartuar kriteret e kualifikimit nga ku rezulton se sa i takon aftësive teknike dhe profesionale, në pikën 2.3.1 është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme në një objekt më vetë në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit.

Po kështu është kërkuar që punimet e ngjashme të marra sëbashku për pesë vitet e fundit, të kenë një vlerë kufi jo më të vogël se 100% e vlerës së kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 55 pika 4 ku përcaktohet se në rastet e procedurave të prokurimit të hapur të thjeshtuar, vlera e punimeve të ngjashme kërkohet jo më e madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës, ose vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet, duke bërë që të kufizohet pjesëmarrja e operatorëve.

Në pikën 2.3.4 kërkohet që operatori ekonomik të ketë një numër të punësuarish jo më të vogël se 25 persona. Për këtë kriter nuk ka asnjë argument vlerësues sasior duke përlllogaritur numrin e nevojshëm të punonjësve sipas zërave të punimeve apo grafikut të punës, në kundërshtim me nenin 2 pika 2c të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

Për sa më lart ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit A. B., B. D. dhe R. H.

Vlerësimi i ofertave

Me urdher nr. 9/1, datë 27.03.2023 të titullarit është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje J. M., R. S. dhe K. A.. Me procesverbal nr. 1, datë 18.04.2023 KVO ka hapur ofertat në sistemin elektronik, nga ku rezulton se ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik Sh. sh.p.k me vlerë oferte 11,600,000 lekë pa TVSh. Me procesverbal nr.2, datë 20.04.2023, pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar në sistem, KVO ka konkluduar se operatori ekonomik Sh. sh.p.k plotëson kriteret e kualifikimit dhe është shpallur fitues. Me operatorin fitues është lidhur dhe kontrata e punimeve nr. 9, datë 19.05.2023. Nga auditimi rezulton se i gjithë dokumentacioni i mbajtur për këtë procedurë nuk është i protokolluar në kundërshtim me *“Normat tekniko-*

profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar fizikisht nga operatori fitues rezulton se për mjetin grejder të markës Volvo nuk është dorëzuar asnjë dokument që vërteton regjistrimin e mjetit apo kolaudimin dhe siguracionet, por është dorëzuar vetëm deklarata e zhdoganimit. Për mjetin e llojit Iveco me targa AA....KP të deglaruar nga operatori si autobot uji me sprucator, rezulton se referuar lejes së qarkullimit disponon kod karrocierie C3 që i korrespondon cisternave për transport mallrash të rrezikshme të ndezshme apo naftë.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi R. S., K. A. dhe J. M.

Objekti “Rehabilitim i ish vendgrumbullimit të mbetjeve Vulloder”

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitim i ish vendgrumbullimit të mbetjeve Vulloder”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 15 datë 16.08.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. T. M.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 15/1 datë 16.08.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	2. R. H. 3. A. B.	1. R. S. 2. K.A. 3. B. D.
5. Fondi Limit: 5,833,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE A. ShPK, me vlerë 4,169,700 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 15, datë 04.12.2023, me afat 365 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 1,663,633 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 18.09.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 9 OE b) Skualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar: 6 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Zhvillimi i procedurës

Me urdhër nr. 15 datë 01.08.2023 të titullarit është caktuar eksperti i fushës K. K. për hartimin e projektit, kërkesave të vecanta apo specifikime që lidhen me objektin e prokurimit “Rehabilitim i ish vendgrumbullimit të mbetjeve Vulloder”, si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë objekt. Nga auditimi rezulton se për përllogaritjen e fondit limit, eksperti i fushës është bazuar në cmimet referencë përcaktuar në manualin teknik të ndërtimit, nga ku ka rezultuar një vlerë preventivi prej 5,833,333 lekë pa TVSh, shoqëruar me specifikimet teknike dhe grafikun e punës. Nga auditimi rezulton se ky investim është miratuar me hartimin e buxhetit për këtë vit në vlerën 7,000 mijë lekë me TVSh.

Dokumentacioni i dorëzuar nga projektuesi nuk është marrë në dorëzim apo miratuar nga përfaqësues të bashkisë, si dhe nuk përmban datë, në kundërshtim me pikën 6.3 të kontratës së shërbimit ku përcaktohet se projekti do merret në dorëzim nga përfaqësues të Urbanistikës.

Me urdhrin nr. 15 datë 16.08.2023 të titullarit është caktuar njësia e prokurimit me përbërje, R. H., T. M. dhe A. B. për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitim i ish vendgrumbullimit të mbetjeve Vulloder” me fond limit 5,833,333 lekë pa TVSh. Me procesverbal datë 06.09.2023 njësia e prokurimit ka hartuar kriteret e kualifikimit nga ku rezulton se sa i takon kapacitetin ekonomik dhe financiar, janë kërkuar bilancet e viteve 2019, 2020 dhe 2021 të cilat nuk duhet të kenë rezultat negativ, ndërkohë që referuar nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, pra duhej të kërkohej periudha 2020-2022.

Në pikën 2.3.1 është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme në një objekt më vetë në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit. Po kështu është kërkuar që punimet e ngjashme të marra sëbashku për pesë vitet e fundit, të kenë një vlerë kufi jo më të vogël se 100% e vlerës së kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55 pika 4 ku përcaktohet se në rastet e procedurave të prokurimit të hapur të thjeshtuar, vlera e punimeve të ngjashme kërkohet jo më e madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, ose vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet, duke bërë që të kufizohet pjesëmarrja e operatorëve.

Në pikën 2.3.4 kërkohet një punësim mesatar jo me pak se 10 punonjes, kërkesë e cila është e paargumentuar dhe e pa mbështetur në përllogaritje sipas zërave të punimeve, vëllimeve dhe kohëzgjatjes. Në pikën 2.3.6 sa i takon makinerive dhe pajisjeve teknike, ndër të tjera janë kërkuar 2 kamionë me kapacitet mbi 10 ton, të cilat janë konsideruar të nevojshme për realizimin e kontratës sipas zërave të punimeve. Nga auditimi rezulton se nevoja për 2 kamionë nuk është e argumentuar teknikisht dhe gjithashtu vihet re se në zërat e punimeve nuk parashikohet transport materiale.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi T. M., R. H., A. B..

Vlerësimi i ofertave

Me urdhër nr. 15/1, datë 16.08.2023 të titullarit është ngritur Komisioni për vlerësimin e ofertave me përbërje K. A., R. S. dhe B. D.. Me procesverbal nr.1 datë 18.09.2023 KVO ka hapur ofertat në sistemin elektronik, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 9 operatorë. Me procesverbal nr. 2 datë 22.11.2023 është bërë vlerësimi i ofertave nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 6 operatorë dhe janë skualifikuar 3 operatorë. Dhe konkretisht

“J.”SH.P.K me ofertë 4,148,900 lekë për mos përmbushje të kriterit për paraqitjen e punëve të ngjashme;

“T .SH.P.K me ofertë 3,873,500 lekë pasi nuk përmbush kriteret për kapacitetin teknik, por pa sqaruar konkretisht se cilin kriter;

“T.”SH.P.K me ofertë 3,958,000 lekë për mos paraqitjen e formularëve të vlerësimit për punët e ngjashme.

Në përfundim KVO ka konkluduar se operatori fitues është A. sh.p.k me vlerë oferte 4,169,700 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues rezulton se për punimet e ngjashme nuk ka dorëzuar certifikatën përfundimtare të marrjes në dorëzim, ndërkohë që për të njëjtën mangësi pjesë e dokumentacionit për punët e ngjashme (mos dorëzim i formularit të vlerësimit për punët e ngjashme), është skualifikuar ofertuesi T.SH.P.K me vlerë oferte 211,700 lekë më pak.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi R. S., K. A., B. D.

Objekti “Rikualifikim dhe riveshje të rrugëve “Onhezmi” dhe “Adem Sheme”

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikim dhe riveshje të rrugëve “Onhezmi” dhe “Adem Sheme”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 19 datë 01.11.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 19 datë 01.11.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 19/1 datë 01.11.2022
4. Lloji i Procedurës:	1. B. D.	1. R. Ç., Kryetar

E hapur	2. R. H. 3. M.Zh.	2. J. M., Anëtar 3. K.A., Anëtar
5. Fondi Limit: 33,333,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE Sh.ShPK, me vlerë 31,487,601 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 19, datë 27.03.2023, me afat 120 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 1,845,732 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 06.02.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 5 OE b) Skualifikuar: 4 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Zhvillimi i procedurës

Me urdhër nr. 19 datë 10.10.2022 të titullarit është caktuar eksperti i fushës K. K. për hartimin e projektit, kërkesave të vecanta apo specifikime që lidhen me objektin e prokurimit “*Rikualifikim dhe riveshje e Onhezmi dhe Adem Sheme*”, si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë objekt.

Nga auditimi rezulton se për përllogaritjen e fondit limit, eksperti i fushës është bazuar në cmimet referencë përcaktuar në manualët teknike të ndërtimit, nga ku ka rezultuar një vlerë preventivi prej 33,333,333 lekë pa TVSh, shoqëruar me specifikimet teknike dhe grafikun e punës. Përllogaritja e fondit limit është bërë bazuar në 4 kategori punimesh, riveshje me asfalt rruga Onhezmi në vlerën totale prej 9,611,040 lekë, riveshje me asfalt rruga Adem Sheme me vlerë totale 4,729,300 lekë, punime tubacione të shkarkimit të ujrave të bardha me vlerë totale 963,050 lekë dhe punime trotuari e ndricime me vlerë totale 18,029,943 lekë.

Nga auditimi rezulton se kategoria C e punimeve në preventiv që lidhet me punimet në tubacionet e shkarkimit të ujrave të bardha përbëhet ndër të tjera nga zëri puseta shiu me kapak zgare hekuri 20 copë, të cilat nuk identifikohen në projektin e dorëzuar nga projektuesi dhe marrë në dorëzim nga zv.Kryetari R. Ç.. Po kështu, as në dokumentin e specifikimeve teknike të hartuar nga projektuesi, nuk ka asnjë të dhënë apo specifikim për asnjë prej zërave që përmban kategoria C e punimeve që lidhen me shkarkimin e ujrave të bardha. I gjithë dokumentacioni mbi specifikimet teknike përmban vetëm të dhëna lidhur me 3 kategoritë e tjera të punimeve.

Me urdhrin nr. 19 datë 01.11.2023 të titullarit është caktuar njësia e prokurimit me përbërje, B. D., R. H., dhe M. Zh. për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “*Rikualifikim dhe riveshje e rrugëve Onhezmi dhe Adem Sheme*” me fond limit 33,333,333 lekë pa TVSh. Me procesverbal datë 04.01.2023 njësia e prokurimit ka hartuar kriteret e kualifikimit nga ku rezulton se në pikën 2.3.1 është kërkuar a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet...”, kërkesa këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 39, pika 5, sipas të cilës punët e ngjashme duhet të jenë në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës ose jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës. Po kështu, sa i takon paraqitjes së punëve të ngjashme, rezulton se njësia e prokurimit e cila është në cdo procedurë e njëjta, ka vepruar me dy standarde pasi në pjesën më të madhe të rasteve kërkon që për punimet e ngjashme ndër të tjera të paraqiten edhe formulari i vlerësimit dhe certifikata e marrjes në dorëzim, ndërkohë për objektin në fjalë nuk janë kërkuar këto dy dokumente që provojnë realizimin e suksesshëm të kontratës. Për këtë konstatim, theksojmë edhe faktin se në raste të tjera, për mos disponimin e njërit prej këtyre dokumenteve, operatorët ekonomikë janë

skualifikuar.

Në pikën 5 kërkohet një punësim mesatar jo me pak se 30 punonjes, kërkesë e cila është e paargumentuar dhe e pa mbështetur në përlllogaritje sipas zërave të punimeve, vëllimeve dhe kohëzgjatjes.

Sa i takon profilit të punonjësve, konstatohet se në procedura të tjera ku ndër të tjera ka patur edhe punime që lidhen me shkarkimet e ujrave të bardha, është kërkuar punonjës i certifikuar hidroteknik, ose hidraulik, ndërkohë që në këtë rast nuk është kërkuar një i tillë edhe pse në preventiv janë përfshirë këto zëra.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi B. D., R. H., M. Zh.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhër nr. 19/1, datë 01.11.2022 është ngritur Komisioni për vlerësimin e ofertave me përbërje R. C., K. A. dhe J. M.. Me procesverbal nr. 1 datë 06.02.2023 është bërë hapja e ofertave në sistemin elektronik nga ku ka rezultuar se kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik. Me procesverbal nr. 2 datë 01.03.2023 është bërë vlerësimi i ofertave nga ku ka rezultuar si vijon:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	Sh.	31,487,601	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	K.	28,570,860	Skualifikuar pasi: OE nuk përmbush kriteret e dst-ve pasi tek shtojca 8 Formulari permbledhes i vetedeklarimit B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” Nuk ka deklaruar asnjë punonjës sipas pikes 7.te dst-ve ku ofertuesi duhet te kete te perfshirene stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues),si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi 1 (nje) muaj nga data e hapjes së ofertave, jo me pak se: Shtues rrugesh -3 (tre) Shtues pllakash -3(tre) OE nuk përmbush as piken 8. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Nr. Mjetet Sasia Gjendja Eskavator me goma 1 cope Në pronësi ose me qera Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, taksa, duhet të shoqerohet me kontraten përkatëse noteriale të qerese (nese eshte me qera), e vlefshme për të gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik “K” ShPK, në përmbushje të kriterit për mjetin fadromë me goma, sqarojmë se, referuar legjislacionit të fushës përkatëse, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se mjetet e mësipërme duhet të regjistrohen në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të rrethit përkatës, të cilët lëshojnë lejen e qarkullimit për pronarin e mjetit Kjo Oe per përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur vertetim zhdoganimi nr.0063741 dhe jo leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, taksa.
3	C.	28,691,240	Skualifikuar pasi: OE nuk përmbush kriteret e dst-ve pasi ne piken 8 eshte kerkuar .Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Asfaltoshtruese 1cope Në pronësi ose me qera Ne shtojcen 8 kjo OE ne piken C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” Ka deklaruar mjetin Asfaltoshtruese DEMAG me targa DF 130 P dhe me nr. Shasie 32091 dhe F.doganore 20430 date 27.04.2005.

			Te njejtin mjet per kete procedure e ka deklaruar dhe shoqeria "S" ShPK e cila ka kontrate qiraje me shoqerine "C" ShPK me nr.2003rep , nr.1101 kol me date 21.06.2017 deri ne 21.06.2027
4	S.	30,649,866	Skualifikuar pasi: OE nuk permbush kriteret edst-ve pika 8.Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: a) Fabrika duhet të jetë e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendodhje jo më larg se 50 km nga objekti dhe e paisur me leje mjedisore. Pra fabrika duhet të jetë aktualisht e montuar dhe në gjendje pune dhe me leje mjedisore për këtë vendodhje. Gjithashtu duhet të paraqitet edhe planvendosja edhe fotografi të fabrikës në vendodhjen aktuale brenda kriterëve. Pasi fabrika e asfaltobetonit e paraqitur nga kjo oe eshte ne distance me te madhe se 50 km.
5	Sh.	25,000,000	Skualifikuar pasi: OE nuk permbush kriteret edst-ve pika 8. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: e) Fabrika duhet të jetë e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendodhje jo më larg se 50 km nga objekti dhe e paisur me leje mjedisore. Pra fabrika duhet të jetë aktualisht e montuar dhe në gjendje pune dhe me leje mjedisore për këtë vendodhje. Gjithashtu duhet të paraqitet edhe planvendosja edhe fotografi të fabrikës në vendodhjen aktuale brenda kriterëve. Pasi fabrika e asfaltobetonit e paraqitur nga kjo oe eshte ne distance me te madhe se 50 km.

Nga auditimi rezulton se vlerësimi i ofertave është bërë në tejkallim të afateve të përcaktuara në nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertuesve, konstatohet se është skualifikuar operatori ekonomik Sh. sh.p.k me vlerën më të ulët të ofertës prej 25,000,000 lekë me argumentin se nuk plotëson kriteret për kapacitetin teknik pasi fabrika e asfaltobetonit e paraqitur është në një distancë më tepër se 50 km. Nga auditimi rezulton se për disponimin e fabrikës së asfaltobetonit, operatori sh. sh.p.k ka dorëzuar një deklaratë sqaruese mbi distancën e fabrikës ku shprehet se disponon një fabrikë në një distancë prej 146 km, duke vijuar me argumentimin se referuar VKM nr. 628, datë 15.07.2015, “Për miratimin e Rregullave teknike për projektimin dhe ndërtimin e rrugëve”, temperatura e përzieries bituminoze në pikën e daljes nga mikseri duhet të jetë për BIT 80, 145°C-160°C dhe për BIT 60, 145°C-165°C. Temperatura e përzierjes prodhuar nga Sh. 07 sh.p.k është 160°-170° dhe ulët me 10° cdo 60 minuta. Duke llogaritur që disanca nga fabrika në vendin e shtrimit është 150 minuta, konkludohet se përzierja mbërrin në vendin e shtrimit me një temperaturë prej 140°C, pra brenda standardeve të përcaktuara në manulet teknike. Për këtë sqarim, nuk rezulton që KVO të ketë kërkuar opinionin e një eksperti të fushës apo të projektuesit i cili ka hartuar specifikimet teknike, duke marrë parasysh faktin se referuar pikërisht specifikimeve teknike, në kapitullin d) “Prodhimi dhe transporti i asfaltobetonit”, pika d,g dhe m-2 përcaktojnë se Bitumi në prodhimin e asfaltobetonit futet në gjendje të nxehtë, por temperatura e tij nuk duhet të jetë mbi 170°C për ta mbrojtur nga djegia. Temperatura e masës së asfaltobetonit mbas shkarkimit nga përzierësi duhet të jetë në kufijtë 140 deri 160°C. Kur temperatura e mjedisit të jashtëm është 5 deri në 10°C, kufiri më i ulët i asfaltobetonit do të jetë jo më pak se 150°C. Asfaltobetoni që ka temperaturë brenda kufirit të lejuar (140-160°C) lëshon avull në ngjyrë jeshile dhe mjedisi sipër tij ngrohet.

Për sa më lart, temperatura e mbërritjes në vendin e shtrimit deklaruar nga operatori ekonomik është brenda normës së parashikuar nga eksperti i fushës në specifikimet teknike, duke theksuar këtu se afati i aplikimit të asfaltobetonit sipas periudhës së zhvillimit të procedurës dhe kontratës së nënshkruar, është prill-korrik, pra një periudhë kur temperaturat mesatare në vendin tonë nuk janë në intervalin 5° me 10°, por më të larta dhe nga ky fakt nuk rrezikohet ftohja e materialit përtej normave. Për sa më lart KVO duhej të kishte vlerësuar mundësinë e konsultimit me ekspertë të fushës, sidomos kur bëhet fjalë për një diferencë fondi prej 6,487,601 lekë.

Po kështu, sa i takon operatorit të renditur i dyti me vlerë oferte më të vogël, K. sh.p.k me ofertë ekonomike 28,570,860 lekë, rezulton se është skualifikuar për mos deklarimin e punonjësve shtrues pllakash dhe shtrues rrugësh, si dhe për mjetin eskavator ka deklaruar vetëm numrin e shasisë dhe deklaratën doganore dhe nuk ka deklaruar targën dhe numrin e lejes së qarkullimit. Nga auditimi rezultoi se, KVO ka shpallur fitues me mangësi në përmbushjen e kriterëve operatorin Sh. sh.p.k me vlerë oferte 31,487,601 lekë, nga dokumentacioni i të cilit konstatohet se nuk disponon 2 kamionë mbajtës me kapacitet mbi 5 ton, pasi në vetëdeklarim ka pasqyruar vetëm 1 kamion. Po kështu, rezulton se ky operator ka deklaruar vetëm 2 shtrues pllakash dhe 2 shtrues rruge, ndërkohë që në kriteret e kualifikimit janë kërkuar 3 shtrues pllakash dhe 3 shtrues rruge. Për sa më lart, rezulton se për mangësi të njëjta, KVO ka shpallur fitues operatorin Sh. shpk me vlerë oferte 2,916,741 lekë më të lartë se operatori K. Shpk.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi R. Ç., K. A. dhe J. M.

Objekti “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në lagjen 3 dhe Lugu i Dardhës”

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në lagjen 3 dhe Lugu i Dardhës”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 10 datë 27.03.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. B. D. 2. R. H. 3. A. B.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 10/1 datë 27.03.2023 1., J. M. Kryetar 2., R.S.Anëtar 3. K. A., Anëtar
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar		
5. Fondi Limit: 6,666,666 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE M. ShPK, me vlerë 6,631,300 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 10, datë 11.05.2023, me afat 20 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 35,366 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 30.03.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Zhvillimi i procedurës

Me urdhër nr. 10 datë 06.03.2023 të titullarit është caktuar eksperti i fushës A. T. për hartimin e projektit, kërkesave të vecanta apo specifikime që lidhen me objektin e prokurimit “*Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në lagjen 3 dhe Lugu i Dardhës*”, si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë objekt.

Nga auditimi rezulton se për përllogaritjen e fondit limit, eksperti i fushës është bazuar në cmimet referencë përcaktuar në manualët teknike të ndërtimit, nga ku ka rezultuar një fond limit prej 6,666,666 lekë pa TVSh, shoqëruar me specifikimet teknike dhe grafikun e punës. Nga auditimi rezulton se në dokumentacionin e dorëzuar nga projektuesi, i cili nuk është marrë në dorëzim nga asnjë përfqësues i bashkisë, gjendet një preventiv me zëra punimesh dhe pa cmime dhe vlera, si dhe një preventiv me zëra punimesh, cmime dhe vlera nga ku ka dalë edhe fondi limit. Mes këtyre dokumenteve ka diferenca sa i takon numrit të objekteve, pasi në preventivin pa cmime dhe vlera janë pasqyruar punime në rrugën 13 bilbilenj, në rrugët e brendshme të Lugut të Dardhës, si dhe sistemim i hapësirës pas shtëpisë së oficerëve, ndërkohë që në preventivin e rregullt i cili përmban cmimet dhe vlera, janë parashikuar punime vetëm në rrugën 13 bilbilenj dhe në rrugët e brendshme të Lugut të Dardhës.

Po kështu, vihet re se për rrugën 13 bilbilenj, nuk korrespondojnë sasi të zërave mes dy preventivave. Lidhur me objektin e tretë, atë të hapsirës pas shtëpisë së oficerave, konstatohet se nuk është pjesë e projektit të hartuar nga projektuesi, pasi nuk ka asnjë të dhënë apo paraqitje

grafike lidhur me këtë hapësirë, sic është vepruar për projektimin e dy rrugëve të tjera. Me urdhrin nr. 10 datë 27.03.2023 të titullarit është caktuar njësia e prokurimit me përbërje, B. D., R. H., dhe A. B. për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në lagjen 3 dhe Lugu i Dardhës*” me fond limit 6,666,666 lekë pa TVSh. Me procesverbal datë 30.03.2023 njësia e prokurimit ka hartuar kriteret e kualifikimit nga ku rezultojnë se në pikën 2.2 kërkohet dorëzimi i bilanceve vjetore për periudhën 2019-2021 me një rezultat jo negativ, ndërkohë që referuar nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, pra duhej të kërkohej periudha 2020-2022, duke qenë se cdo njësi publike apo private ka afatin e fundit për mbylljen e bilanceve cdo datë 30 mars.

Në pikën 2.3.1 është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme në një objekt më vete në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit. Po kështu është kërkuar që punimet e ngjashme të marra sëbashku për pesë vitet e fundit, të kenë një vlerë kufi jo më të vogël se 100% e vlerës së kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55 pika 4 ku përcaktohet se në rastet e procedurave të prokurimit të hapur të thjeshtuar, vlera e punimeve të ngjashme kërkohet jo më e madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës, ose vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet, duke bërë që të kufizohet pjesëmarrja e operatorëve.

Në pikën 2.3.4 kërkohet një punësim mesatar jo me pak se 20 punonjës, kërkesë e cila është e pa argumentuar dhe e pa mbështetur në përlllogaritje sipas zërave të punimeve, vëllimeve dhe kohëzgjatjes.

Në pikën 2.3.7 është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar në listëpagesat e tij një inxhinier restorator me argumentin se objekti i punimeve ndodhet në zonën A Arkeologjike. Nga auditimi rezultojnë se dy rrugët objekt prokurimi nuk ndodhen në zonën A Arkeologjike. Po kështu, referuar preventivit të punimeve, nuk konstatohet asnjë zë që lidhet me restaurimin, por vetëm punime shtrimi me beton në Rr.13 Bilbilentë dhe Rrugët e brendshme Lugu i Dardhës. Po kështu edhe referuar specifikimeve teknike, nuk rezultojnë asnjë specifikim që lidhet veprimtari që duhet të mbahen në vëmendje dhe të kihet kujdes gjatë punimeve në zonën arkeologjike. Nga shqyrtimi i hartave rezultojnë se në zonën A Arkeologjike pozicionohet objekti i tretë i përfshirë vetëm në preventivin pa cmime, hapësira pas shtëpisë së oficerave, që në fakt i korrespondon sheshit për të cilin nga përfaqësuesi i Bashkisë u deklarua se ka qenë objekt punimesh në prokurimin me objekt “*Rikonstruksioni i rrugës 47*”, trajtuar më lart.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi B. D., R. H., A. B.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr. 10/1 datë 27.03.2023 të titullarit është ngritur Komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje, J. M., R.S. dhe K. A.. Me procesverbal nr. 1, datë 11.04.2023 KVO ka bërë hapjen e ofertave në sistemin elektronik nga ku ka rezultuar se kanë marrë pjesë operatorët ekonomik M. sh.p.k me vlerë oferte 6,631,300 lekë dhe M. I. Group me vlerë oferte 6,656,060 lekë. Me procesverbal nr. 2, datë 14.04.2023 është bërë shqyrtimi i ofertave nga ku rezultojnë se M. I. Group është skualifikuar për mos paraqitjen e sigurimit të ofertës dhe është kualifikuar e shpallur fitues M. sh.p.k.

Objekti “Rikualifikim i rrugëve të brendshme me beton, Metoq, Berdenesh, Cuke, Manastir”

8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikim i rrugëve të brendshme me beton, Metoq, Berdenesh, Cuke, Manastir”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5 datë 14.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 5 datë 14.02.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 5/1 datë 14.02.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar punë	1. B. D. 2. R. H. 3. A. B.	1. R. C. 2. K. A. 3. J. M.
5. Fondi Limit: 6,666,666 lekë pa TVSh. REF-59314-02-20-2023	6. Oferta fituese: JV “T.+ C.” sh.p.k, me vlerë 6.478.720 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 5, datë 18.04.2023, me afat 30 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 188 mijë lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 20.3.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 3 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 2 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Fondi limit dhe Projekti:

Preventivi, specififikimet teknike dhe projekti janë hartuar nga ing. K. K., në bazë të kontratës së shërbimit datë 02.02.2023. Nuk ka referencë për çmimet e vendosura a janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar; në dosje nuk administrohet projekt ideja e propozimit për miratimin në buxhet, si dhe akt marrja në dorëzim të projektim me gjithë anekset në zbatim të nenit 6 të kontratës datë 02.02.2023.

Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 179, datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2023”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 32/1, datë 18.01.2023, për 8,000,000 lekë me TVSh konkretisht:

- Rikualifikim i rrugëve të brendshme me beton Çukë, Manastir për 2,500,000 lekë;
- Rikualifikim i rrugëve të brendshme me beton Metoq dhe Varrezat Shelegar për 2,500,000 lekë;
- Rikualifikim i rrugëve të brendshme me beton Berdenesh për 5,000,000 lekë;

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.1, në DST, është kërkuar që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Grupi i auditimit, konstaton se vendosja e kriterëve 2.3.1. nga njësia e prokurimit miratuar nga Titullari i AK, është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55 pika 4 ku thuhet se :

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 30% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.”

- Në pikën 2.3.4., në DT, ndërmjet të tjerave është kërkuar që OE të disponojë certifikatën ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit mjedisor”. Kjo kërkesë është e paargumentuar për natyrën e kësaj kontrate, pasi ndikimi në mjedis gjatë zbatimit të kontratës, konsiderohet i ezauruar në projekt.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemit SPE, rezulton:

1. BOE i shpallur fitues “T.+ C.” sh.p.k me ofertë ekonomike 6,478,720 lekë pa TVSh nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

- Nga subjekti “T.” sh.p.k, që ka marrë përsipër realizmit e 80 % të punimeve sipas të gjithë zërave në marrëveshjen e bashkëpunimit; nuk paraqet ing. Topograf/Gjeodet.

Sa më sipër BOE “T.+ C.” sh.p.k nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE “T.+ C.” sh.p.k dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, por të anulonte procedurën dhe vijonte me procedurën me operatorin tjetër në garë, veprime në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, ku përcaktohet:

“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

Si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2, ku përcaktohet:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”

2. Operatori ekonomik M. sh.p.k. me ofertë ekonomike 5,599,800 lekë pa TVSh, sipas procesverbalit nr. 2, datë 27.03.2023 mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është shkualifikuar pasi: *oferta e paraqitur nuk është në përputhje me të gjithë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit duke rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit “Për prokurimin publik”*

Operatori ekonomik rezulton i angazhuar në kontrata të tjera të nënshkruara me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Sarandë, për pasojë nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3. “Aftësitë Teknike dhe Profesionale” të Dokumenteve standarde të Tenderit.

Nga sa më sipër rezulton se: shkualifikimi i OE “M.” nuk është i bazuar në prova e fakte. Dokumentacioni i paraqitur nga OE “M.” për plotësimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për objektin e prokurimit është në përputhje me kërkesat e dokumenteve standarde të tenderit shtojca 7. Në procesverbal nuk është specifikuar dokumentacioni i munguar apo që nuk plotëson kriteret e kërkuara. Pretendimi që OE rezulton i angazhuar në kontrata të tjera të nënshkruara me Autoritetin Kontraktor nuk qëndron pasi nuk janë paraqitur a kërkuar grafikët e punimeve.

Veprime në kundërshtim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet:

.....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e

operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

si dhe me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku përcaktohet:

....Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

Referuar sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar Operatorin Ekonomik “M.” duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë ***një efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë për 878,920 lekë pa TVSh*** i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e BOE “T.& C.” prej 6,478,720 lekë dhe ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të OE “M.” prej 5,599,800 lekë pa TVSh.

Objekti “Ndërhyrje në infrastrukturën e brendshme Ksamil”

9. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturën e brendshme Ksamil”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 7 datë 14.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 7 datë 14.02.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 8/1 datë 14.02.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur, punë	1. B. D. 2. R. H. 3. A. B.	1. R. C. (Kryetar/Jurist) 2. K. A. (Ing. Elektronik) 3. J. M. (Ekonomist)
5. Fondi Limit: 15,833,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE J. C. ShPK, me vlerë 15,275,405 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 7, datë 20.04.2023, me afat 40 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 557,928 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 27.03.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Fondi limit dhe Projekti:

- Preventivi, specififikimet teknike dhe projekti janë hartuar nga ing. K. K., në bazë të kontratës së shërbimit datë 31.01.2023. Nuk ka referencë për çmimet e vendosura a janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar; në dosje nuk administrohet projekt ideja e propozimit për miratimin në buxhet, si dhe akt marrja në dorëzim të projektit me gjithë anekset në zbatim të nenit 6 të kontratës datë 02.02.2023.

- Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 179, datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2023”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 32/1, datë 18.01.2023.

Kriteret e vlerësimit:

Me urdhrin e prokurimit nr. 7, datë 14.02.2023 nxjerrë nga Titullari i AK, është përcaktuar fondi limit 15,833,333 lekë pa TVSh, për llojin e procedurës “Procedurë e Hapur, Punë” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin 7/1, datë 14.02.2023, KVO dhe data e hapjes së tenderit 27.03.2023.

Nga Njësia e Prokurimit, referuar urdhrorit të prokurimit 8, datë 14.02.2023, është mbajtur PV datë 28.02.2023, pa numër protokollit për hartimin e dokumenteve të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike dhe Dokumentet e Tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet “a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.....”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5. Ku përcaktohet:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur

të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së

njoftimit të kontratës;

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

- Në pikën 2.3.4., në DT, ndërmjet të tjerave është kërkuar që OE të disponojë certifikatën ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit mjedisor”. Kjo kërkesë është e paargumentuar për natyrën e kësaj kontrate, pasi ndikimi në mjedis gjatë zbatimit të kontratës, konsiderohet i ezauruar në projekt.

- Në pikën 2.3.6., në DT, ndërmjet të tjerave është kërkuar që OE të disponojë Makinë (autobot me aksesoret përkatës) për pastrim të ujrave të zeza). Kjo kërkesë është e paargumentuar për natyrën e kësaj kontrate dhe mund të kufizojë pjesëmarrjen e OE ofertues.

Vendosja e këtyre kriterëve nuk është në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

Këto kriterë, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d) dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga A. B. me detyrë supervisor i pastrimit, R. H. specialist IT Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe B. D. Specialiste në Drejtorinë Ekonomike

Vlerësimi i ofertave:

- Me PV nr. 1, datë 27.03.2023, nga KVO është bërë hapja e ofertave në SPE, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE.

- Me PV nr. 2, datë 28.03.2023, nga KVO është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë.

Rezultatet e vlerësimit sipas raportit të vlerësimit në SPE, janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	J. C.	15,275,405	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	N.	15,655,975	Skualifikuar pasi: OE nuk permbush kriteret e dst-ve pika 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Kjo OE nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertes .
3	Sh.	13,995,650	Skualifikuar pasi: OE nuk permbush kriteret e dst-ve pika 6. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Fadrome me goma 1 cope Në pronësi ose me qera Ne shtojcen nr.8 Formulari permbledhës i vetedeklarimit pika C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” OE nuk ka paraqitur asnje te dhene per kete lloj mjetei.

Me shkresën datë 03.04.2023 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit paraprak, shpallur në buletin e APP nr. 32 datë 11.04.2023.

Me shkresën datë 11.04.2023, është plotësuar formulari i njoftim të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, shpallur në buletin e APP nr. 34 datë 18.04.2023.

Me shkresën datë 11.04.2023 është hartuar Raporti Përmbledhës, i miratuar nga titullari. Ankesa nuk ka pasur.

Konkluzioni:

Nga auditimi, u konstatua se vlerësimi nga KVO është bërë në përputhje me LPP.

Objekti “Azhornime të tokës bujqësore”

10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Azhornime të tokës bujqësore”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 17 datë 11.11.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 17 datë 23.11.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 17/1 datë 23.11.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur	1. T. M. 2. R. H. 3. K. A.	1. M. L., Kryetar 2. B. D., Anëtar 3. K. A., Anëtar
5. Fondi Limit: 10,833,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “G. shpk, me vlerë 10,383,000 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 2387, datë 08.05.2024, me afat 12 muaj	7. Diferenca me fondin limit: 50,000 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 10.01.2024	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Fondi limit dhe Projekti:

- Preventivi, specifikimet teknike dhe projekti janë hartuar nga M. L., në bazë të Urdhrit nr. 17 datë 07.11.2023. Nuk ka dokumentacion për referencë të nivelit të çmimeve

- Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 179, datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2023”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 32/1, datë 18.01.2022.

Kriteret e vlerësimit:

Me urdhrin e prokurimit nr. 17, datë 23.11.2023 nxjerrë nga Titullari i AK, është përcaktuar fondi limit 10,833,333 lekë pa TVSh, për llojin e procedurës “*Procedurë e Hapur, Shërbim*” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin 17/1, datë 23.11.2023, KVO dhe data e hapjes së tenderit 10.01.2024.

Nga Njësia e Prokurimit, referuar urdhrin të prokurimit 17, datë 23.11.2023, është mbajtur PV datë 07.12.2023, pa numër protokolli për hartimin e dokumenteve të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike dhe Dokumentet e Tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet: *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës në një vlerë jo më të vogël se 50% të fondit limit të kësaj kontrate.*

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 41, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*”, pika 3. Ku përcaktohet:

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Në dokumentet e tenderit “Njoftimi i shkurtuar i Kontratës” pika 6 ka përcaktuar afatin për zbatimin e kontratës: “120 ditë”

Njoftimi për ndryshimin e dokumenteve të tenderit publikuar më 15.12.2023:

Shtojca 6 është ndryshuar duke përcaktuar afatin për zbatimin e kontratës: “12 muaj”

Shtojca 7 është ndryshuar duke shtuar “Përshkrimi i punës Regjistrimi fillestar” ku janë përcaktuar Objektivat; Vendodhja e Zonës Kadastrale; Kohë zgjatja e kontratës dhe fazat e punës (pa përcaktuar afatet).

Në Kontratën e shërbimit nr.2389, datë 08.05.2024 në “Kushtet e veçanta të kontratës” ne: nenin 4 “Afati i kontratës” “Afati i shërbimit do të bëhet në një afat “12 muaj” nga data e lidhjes së kontratës.

Nenin 6 “Kushtet e pagesës” a) *pagesa për shërbimet do të bëhet në dy faza, në fazën e parë do të bëhet pagesa 70 % të vlerës së fondit në momentin e dorëzimit të produktit dixhital.....ndërsa faza e dytë e pagesës 30 % e vlerës së fondit limit do të bëhet me dorëzimin e fazës përfundimtare të projektit.*

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 41, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*”, pika 1. Ku përcaktohet:

Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

Përgjegjësi mbajnë: Hartuesit e dokumenteve të tenderit, T. M., R. H., K. A., Specialist i Njesisë se Prokurimit E. L.

Objekti “Rikualifikim dhe shtrim i rrjetit rrugor Ksamil”

11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikim dhe shtrim i rrjetit rrugor Ksamil”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 8 datë 14.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 8 datë 14.02.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 8/1 datë 14.02.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur, punë	1. B. D. 2. R. H. 3. A. B.	1. R. C. (Kryetar/Jurist) 2. K. A. (Ing. Elektronik) 3. J. M. (Ekonomist)
5. Fondi Limit: 15,833,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE N. ShPK, me vlerë 15,001,855 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 8, datë 05.05.2023, me afat 40 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 831,478 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 03.04.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 3 OE b) Skualifikuar: 2 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Jo

Fondi limit dhe Projekti:

Preventivi, specifikimet teknike dhe projekti janë hartuar ing. A. T., në bazë të kontratës së shërbimit datë 31.01.2023. Nuk ka referencë për çmimet e vendosura a janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar; në dosje nuk administrohet projekt ideja e propozimit për miratimin në buxhet, si dhe akt marrja në dorëzim të projektim me gjithë anekset në zbatim të nenit 6 të kontratës datë 02.02.2023.

Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 179, datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2023”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 32/1, datë 18.01.2023, për 19,150,000 lekë me TVSh konkretisht:

Kriteret e vlerësimit:

Me urdherin e prokurimit nr. 8, datë 14.02.2023 nxjerrë nga Titullari i AK, është përcaktuar fondi limit 15,833,333 lekë pa TVSh, për llojin e procedurës “Procedurë e Hapur, Punë” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin 8/1, datë 14.02.2023, KVO dhe data e hapjes së tenderit 03.04.2023.

Nga Njësia e Prokurimit, referuar urdhrin të prokurimit 8, datë 14.02.2023, është mbajtur PV datë 06.03.2023, pa numër protokollin për hartimin e dokumenteve të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike dhe Dokumentat e Tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet “a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.....”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.

- Në pikën 2.3.6., në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 2 shtrues pllakash, kërkesë e cila nuk është e argumentuar dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi në preventiv nuk parashikohen shtrime pllakash.

- Në pikën 2.3.7., në DT, kërkohet që OE të disponojë 1 specialist Ekspert Zjarrfikës, kërkesë e

cila nuk është e argumentuar dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi punimet e parashikuara nuk paraqesin rrezik zjarri.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d) dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga A. B., me detyrë supervisor i pastrimit, R. H., me detyrë specialist IT në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe B. D., me detyrë Specialiste në Drejtorinë Ekonomike

Vlerësimi i ofertave:

- Me PV datë 03.04.2023, nga KVO në prani të Njësia e Prokurimit është bërë hapja e ofertave në SPE, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE.

Rezultatet e vlerësimit sipas raportit të vlerësimit në SPE, janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	N.	15,001,855	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	I.	15,130,905	<p>Skualifikuar pasi: OE nuk përmbush kriteret e dst-ve pika 6. OE ofertuesi duhet te kete te perfshirene stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar certifikues personeli (Trup Certifikues),si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi 1 (nje) muaj nga data e hapjes së ofertave, jo me pak se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Teknik Ndertimi - 1 (tre); <input type="checkbox"/> Elektracist - 2 (dy) <input type="checkbox"/> Shtrues pllakash - 2 (dy) <input type="checkbox"/> Shtrues rruges - 3 (tre); <p>Ne shojcen nr.8 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit pika B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” Oe nuk ka paraqitur te dhena per shtrues pllakash , shtrues rruges, teknik ndertimi.</p>
3	Sh.	13,473,150	<p>Skualifikuar pasi: Operatori ekonomik rezulton i angazhuar në kontrata të tjera të nënshkuara me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Sarande, për pasojë nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale të dokumenteve standarde të tenderit.</p>

Me shkresën datë 11.04.2023 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit paraprak, shpallur në buletin e APP nr. 34 datë 18.04.2023.

Me shkresën datë 20.04.2023, është plotësuar formulari i njoftim të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, shpallur në buletin e APP nr. 39 datë 02.05.2023.

Me shkresën datë 11.04.2023 është hartuar Raporti Përmbledhës, i miratuar nga titullari.

Ankesa nuk ka pasur.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se OE N.nuk ka paraqitur certifikata të sigurimit teknik për elektracistët V. G. dhe A. I..

Konkluzion:

I. Operatori ekonomik “N.” ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. Komisioni i Verifikimit të Ofertave nuk duhet të kishte kualifikuar OE “N.” ShPK dhe nuk duhet t’i kishte

propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2. Operatori Ekonomik “N.” ShPK duhet të ishte shkualifikuar.

2. Operatori ekonomik “Sh.” sh.p.k. me ofertë ekonomike 13,473,150 lekë pa TVSh, sipas procesverbalit nr. 2, datë 07.04.2023 mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është shkualifikuar pasi: *oferta e paraqitur nuk është në përputhje me të gjithë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit duke rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit “Për prokurimin publik” për rrjedhje nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo-ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.*

Operatori ekonomik rezulton i angazhuar në kontrata të tjera të nënshkruara me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Sarandë, për pasojë nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3. “Aftësitë Teknike dhe Profesionale” të Dokumenteve standarde të Tenderit.

Nga sa më sipër rezulton se: skualifikimi i OE “Sh.” nuk është i bazuar në prova e fakte. Dokumentacioni i paraqitur nga OE “Sh.” për plotësimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për objektin e prokurimit është në përputhje me kërkesat e dokumenteve standarde të tenderit shtojca 7.

Në procesverbal e shqyrtimit të ofertave datë 07.04.2023 nuk është specifikuar dokumentacioni i munguar apo që nuk plotëson kriteret e kërkuara. Pretendimi që OE rezulton i angazhuar në kontratën e lidhur në datë 27.03.2023 me Bashkinë Sarandë për “Rikualifikim e riveshje të rrugëve “Onhezmi” dhe rrugës “Adem Sheme” me afat 120 ditë të nënshkruara me Autoritetin Kontraktor, nuk qëndron pasi nuk janë paraqitur a kërkuar grafikët e punimeve për të dy prokurimet.

Nga krahasimi i përcaktimeve në Shtojcën nr. 8 të dokumenteve të tenderit “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” paraqitur nga Operatori ekonomik “Sh.”, rezultojnë mjete të ndryshme sipas secilit nga objektet e prokuruar.

Veprime në kundërshtim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet:

.....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

si dhe me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku përcaktohet:

....Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

Referuar sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar Operatorin Ekonomik “Sh.” duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë **një efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë për 1,528,705 lekë pa TVSh** i ardhur nga diferenca e ofertës së

shpallur fituese e “N.” prej 15,001,855 lekë dhe ofertës të dhe ofertës të skualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të OE “Sh.” prej 13,473,150 lekë pa TVSh.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi KVO, e përbërë nga R. C., Kryetar/Jurist, K. A., Inxhinier Elektronik dhe J. M., Ekonomist.

Objekti “Rikualifikim rrugë të brendshme Sarandë”

12. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikim rrugë të brendshme Sarandë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 20 datë 01.11.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 20 datë 01.11.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 20/1 datë 01.11.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur	1. B. D. 2. R. H. 3. M. Zh.	1. R. C., Kryetar 2. J. M., Anëtar 3. K. A., Anëtar
5. Fondi Limit: 25,833,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE A. ShPK, me vlerë 24,284,397 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 20, datë 20.04.2022, me afat 120 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 1,548,936 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 06.02.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 5 OE b) Skualifikuar: 4 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Fondi limit dhe Projekti:

- Preventivi, specifikimet teknike dhe projekti janë hartuar nga ing. K. K., në bazë të kontratës së shërbimit datë 11.10.2022. Nuk ka referencë për çmimet e vendosura a janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre*”, i ndryshuar; në dosje nuk administrohet projekt ideja e propozimit për miratimin në buxhet, si dhe akt marrja në dorëzim të projektim me gjithë anekset në zbatim të nenit 6 të kontratës datë 02.02.2023.

- Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 116, datë 21.07.2022 “*Për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Sarandë*”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 675/2, datë 27.07.2022.

Kriteret e vlerësimit:

Me urdhrin e prokurimit nr. 20, datë 01.11.2022 nxjerrë nga Titullari i AK, është përcaktuar fondi limit 25,833,333 lekë pa TVSh, për llojin e procedurës “*Tender i Hapur, Punë*” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin 20/1, datë 01.11.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit 06.02.2023.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur PV me datë 04.01.2023, pa numër protokolli për hartimin e dokumenteve të tenderit, referuar urdhrin të prokurimit 20, datë 01.11.2022, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike dhe Dokumentat e Tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet “*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.....*”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.

- Në pikën 2.3.6., në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 1 fabrikë për prodhim pllakash, kërkesë e cila nuk është e argumentuar dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi në preventiv nuk parashikohen punime pllakash apo trotuaresh.

- Në pikën 2.3.6., në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 1 “Fabrikë për prodhim Asfaltobetonit jo me pak se 50 km nga objekti”. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, specifikohet që fabrika të jetë 50 km nga objekti, “për faktin që binderi dhe asfaltobetonit të kenë temperaturën e duhur gjatë hedhjes në objekt, kjo në bazë dhe të VKM 628 datë 15.07.2015, “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”. Pavarësisht se për këtë procedurë nuk ka pasur ankesa dhe as kërkesa për sqarim të “lapsusit” në hartimin e DT, vendosja e këtij kriteri është bërë në mënyrë të gabuar, pasi paraqitja në tabelën e mjeteve është në kundërshtim me sqarimin në procesverbal. Mënyra e vendosjes së këtij kriteri është konfuzuese për OE pjesëmarrës dhe ul numrin e OE pjesëmarrës në procedurë.

Këto kriterë, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d) dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga M. Zh., me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve, R. H., me detyrë specialist IT Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe B. D., me detyrë Specialiste në Drejtorinë Ekonomike

Vlerësimi i ofertave:

- Me PV nr. 1, datë 06.02.2023, nga KVO është bërë hapja e ofertave në SPE, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 5 OE.

- Me PV nr. 2, datë 20.03.2023, nga KVO është bërë bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë.

Rezultatet e vlerësimit sipas raportit të vlerësimit në SPE, janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	A.	24,284,397	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	C.	22,223,911	Skualifikuar pasi: OE nuk përmbush kriteret e dst-ve pasi stafi teknik dhe mjetet janë të angazhuara në kontrata të tjera në të cilat kjo OE është shpallur fitues me Autoritetin rrugor Shqiptar
3	Sh.	21,000,000	Skualifikuar pasi: OE nuk përmbush kriteret e DST-ve pika 6. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Fabrika duhet të jetë e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendndodhje jo më larg se 50 km nga objekti dhe e pajisur me leje mjedisore. Pra fabrika duhet të jetë aktualisht e montuar dhe në gjendje pune dhe me leje mjedisore për këtë vendndodhje. Gjithashtu duhet të paraqitet edhe planvendosja edhe fotografi të fabrikës në vendndodhjen aktuale brenda kriterëve. Pasi fabrika e asfaltobetonit e paraqitur nga kjo OE është në distance më të madhe se 50 km
4	S.	23,578,582	Skualifikuar pasi:

			<p>OE nuk permbush kriteret e DST-ve pika 6. Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:</p> <p>Fabrika duhet të jetë e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendndodhje jo më larg se 50 km nga objekti dhe e pajisur me leje mjedisore. Pra fabrika duhet të jetë aktualisht e montuar dhe në gjendje pune dhe me leje mjedisore për këtë vendndodhjen. Gjithashtu duhet të paraqitet edhe planvendosja edhe fotografi të fabrikës në vendndodhjen aktuale brenda kriterëve.</p> <p>Pasi fabrika e asfaltobetonit e paraqitur nga kjo OE është në distance me të madhe se 50 km.</p>
5	K. T.	24,024,589	<p>Skualifikuar pasi:</p> <p>OE nuk permbush kriteret e dst-ve pika 2.3 Kapaciteti teknik:ku eshte kerkuar</p> <p>1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:</p> <p>a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose</p> <p>b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.</p> <p>Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.</p> <p>Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.</p> <p>Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:</p> <p>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.</p> <p>Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontratën/at e Sipërmarrjes - situacion punimesh - Fatura tatimore për situacionin përfundimtar te punimeve - Akt kolaudimi; <p>Kjo OE per te përmbushur kete kriter ka paraqitur si pune te ngjashme objektin :”Sistemim Asfaltim i Rrugës “Haxhi Brari” me date fillim punimesh datën 26.09.2018 dhe date përfundim punimesh data 13.02.2019 dhe me vlere 12,449,682 leke me TVSh .Kjo OE nuk e përmbush këtë kriter pasi vlera e kërkuar për këtë objekt është 12 916 666,5 leke ndërsa vlera e paraqitur nga kjo OE është 10,374,261,7</p>

Me shkresën datë 23.03.2023 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit paraprak, shpallur në buletin e APP nr. 28 datë 27.03.2023.

Me shkresën datë 07.04.2023, është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit, shpallur në buletin e APP nr. 34 datë 18.04.2023.

Me shkresën datë 03.04.2023 është hartuar Raporti Përmbledhës, i miratuar nga titullari. Ankesa nuk ka pasur.

Konkluzion:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertuesve, konstatohet se është shkualifikuar operatori ekonomik “Sh.” sh.p.k me vlerën e ofertës 21,000,000 më të ulët se oferta shpallur fitues prej 3,284,397 lekë me argumentin se nuk plotëson kriteret për kapacitetin teknik pasi fabrika e asfaltobetonit e paraqitur është në një distancë më tepër se 50 km.

Nga auditimi rezulton se për disponimin e fabrikës së asfaltobetonit, operatori “Sh.” sh.p.k ka dorëzuar një deklaratë sqaruese mbi distancën e fabrikës ku shprehet se: *disponon një fabrikë në një distancë prej 146 km, duke vijuar me argumentimin se referuar VKM nr. 628, datë 15.07.2015, “Për miratimin e Rregullave teknike për projektimin dhe ndërtimin e rrugëve”, temperatura e përzierjes bituminoze në pikën e daljes nga mikseri duhet të jetë për BIT 80, 145°C-160°C dhe për BIT 60, 145°C-165°C. Temperatura e përzierjes prodhuar nga “Sh.” sh.p.k është 160° -170° dhe ulët me 10° çdo 60 minuta. Duke llogaritur që distanca nga fabrika në vendin e shtrimit është 150 minuta, konkludohet se përzierja mbërrin në vendin e shtrimit me një temperaturë prej 140°C, pra brenda standardeve të përcaktuara në manualët teknike. Për këtë sqarim, nuk rezulton që KVO të ketë kërkuar opinionin e një eksperti të fushës apo projektuesit i cili ka hartuar specifikimet teknike. Për faktin se referuar pikërisht specifikimeve teknike, në kapitullin d) Prodhimi dhe transporti i asfaltobetonit, pika d,g dhe m² përcaktojnë se Bitumi në prodhimin e asfaltobetonit futet në gjendje të nxehtë, por temperatura e tij nuk duhet të jetë mbi 170°C për ta mbrojtur nga djegia. Temperatura e masës së asfaltobetonit mbas shkarkimit nga përzierësi duhet të jetë në kufijtë 140 deri 160°C. Kur temperatura e mjedisit të jashtëm është 5 deri në 10°C, kufiri më i ulët i asfaltobetonit do të jetë jo më pak se 150°C. Asfaltobetoni që ka temperaturë brenda kufirit të lejuar (140-160°C) lëshon avull në ngjyrë jeshile dhe mjedisi sipër tij ngrohet.*

Për sa më lart, temperatura e mbërritjes në vendin e shtrimit deklaruar nga operatori ekonomik është brenda normës së parashikuar nga eksperti i fushës në specifikimet teknike, duke theksuar këtu se afati i aplikimit të asfaltobetonit sipas kontratës së nënshkruar, është Maj-Gusht, pra një periudhë kur temperaturat mesatare në vendin tonë nuk janë në intervalin 5° me 10°, por më të larta dhe nga ky fakt nuk rrezikohet ftohja e materialit përtej normave. Për sa më lart KVO duhej të kishte vlerësuar mundësinë e konsultimit me ekspertë të fushës, sidomos kur bëhet fjalë për një diferencë fondi prej 3,284,397 lekë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kishte kualifikuar Operatorin Ekonomik “Sh.” duke renditur në vend të parë në klasifikimin e ofertuesve si dhe duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij, mos veprim që ka sjellë një efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë për 3,284,397 lekë pa TVSh i ardhur nga diferenca e ofertës së shpallur fituese e “A.” prej 24,284,397 lekë dhe të ofertës të shkualifikuar në mënyrë të pa mbështetur në ligj të OE “Sh.” prej 21,000,000 lekë pa TVSh.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi KVO, e përbërë nga R. C., Kryetar/Jurist, K. A., Inxhinier Elektronik dhe J. M., Ekonomist.

Krahas sa më lart, u audituan edhe procedurat e prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, nga ku rezultoi se janë realizuar 29 procedura me fond limit total në vlerë në 21,569,135 lekë dhe vlerë kontrate 16,638,038 lekë ose 77% e fondeve të parashikuara.

Nga auditimi rezultoi se në 9 raste, vihet re copëzim i fondit limit për realizimin e blerjeve me të njëjtën natyrë dhe thuajse zëra të njëjtë shpenzimesh, me pasojë shmangien e procedurave të rregullta të prokurimit në sistemin elektronik dhe konkretisht:

1. Shpenzime për blerje uniformash me vlerë totale fondi limit 1,541,667 lekë

Blerje uniforma për Policinë Bashkiake	625,000	Small Value	213,600	14/11/2023	V. Gj.
Uniforma speciale Policia Bashkiake	916,667	Small Value	244,000	08.07.2023	G. S.

2. Shpenzime për rehabilitime apo rikonstruksione me natyrë të njëjtë zërash punime me vlerë totale të fondit limit 6,140,483 lekë

Rehabilitim ne ksamil dhe ne zonen Turzem Kanali i Cukes	1,000,000	834,000	22/05/2023	I.
Blerje derrase dhe llamarine metalike	734,650	700,000	06/10/2023	I.
Rehabilitim ne lagjen nr.1	1,000,000	846,990	10/03/2023	A.Co
Rehabilitim në lagjen Nr.3 Sarandë	1,000,000	935,200	05/07/2023	S.
Ndehyreje per sistemim e ambienteve	1,000,000	742,000	22/05/2023	I.
Kopështi Metoq / Izolimi I çatisë	405,833	400,000	28/08/2023	I.
Rikonstruksion rruge ne fshatin gjashte	1,000,000	760,000	06/12/2023	I.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se “Përzgjedhja e metodës që përdoret për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre 13 rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë”.

Për sa më lart ndarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël E. S., R. H. dhe K. A.

Mbi auditimin e zbatimit të kontratave për punë publike të cilat kanë përfunduar në periudhën nën auditim

Për auditimin e zbatimit të kontratave të punimeve u analizuan regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023 dhe kontrata të realizuara që periudha e garancisë së punimeve është brenda periudhës së audituar. Për periudhën e auditimit në Bashkinë Sarandë u audituan **7** dosje/objekte të prokuruar (Tabela në vijim), në vlerën totale të kontratave **551,492,576 lekë me TVSh**, mbi zbatimin e kontratave për punë publike.

Nr	Objekti	Kontraktori Sipërmarrës	Vlera e kontratës me TVSh
1	Rikualifikim i rrugëve të brendëshme me beton, Metoq, Berdenesh, Çukë, Manastir	BOE “T.” ShPK & “C.” ShPK	7,774,464
2	Ndërrhyrje në Infrastrukturën e brendshme Ksamil	OE “J. K” ShPK	18,330,486
3	Rikualifikim rrugë të brendëshme në Sarandë	OE “A.” ShPK	29,141,277
4	Rikualifikim rrugë të brendëshme me asfalt në Gjashtë, Sarandë	OE “S.” ShPK	8,721,907
5	Rikualifikim dhe riveshje e rrugëve “Onhezmi” dhe rrugës “Adem Sheme”	OE “Sh.” ShPK	37,784,758
6	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme”	OE “V. K” ShPK	70,902,705
7	Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës	BOE “E. K.” & “Sh.”	378,836,979

Nr	Objekti	Kontraktori Sipërmarrës	Vlera e kontratës me TVSh
	faza II (loti përfundimtar)	ShPK	
	Shuma në lekë me TVSh		551,492,576

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:

1. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Rikualifikim i rrugëve të brendëshme me beton, Metoq, Berdenesh, Çukë, Manastir”, Bashkia Sarandë, Viti 2023

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 5 prot., datë 11.04.2023, lidhur midis AK Bashkia Sarandë, përfaqësuar nga z. A. G. kryetar në cilësinë e Titullarit dhe Kontraktorit BOE “T.” ShPK & “C.” ShPK, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor D. Th.. Vlera e kontratës është 7,774,464 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 ditë nga lidhja e kontratës. Për këtë objekt nuk ka shtesë afati të për përfundimin e punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 8 të kushteve të veçanta të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e këtij shërbimi me nr. 5/1 prot., datë 18.04.2023, me vlerë 35,000 lekë pa TVSh, midis AK Bashkia Sarandë dhe Mbikëqyrësit K. K. me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0453/3.

- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 5/2 prot., datë 18.04.2023, me vlerë 10,000 lekë pa TVSh, midis AK Bashkia Sarandë dhe A. K., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1011.

Projektpreventivi Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Sarandë.

Zbatimi i punimeve

Në dosjen teknike administrohet vetëm librezja e masave përfundimtare e cila përgjithësisht korrespondon me situacionin përfundimtar. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se dokumentacioni përkatës i mbajtur mes palëve si njoftimi i fillimit të punimeve dhe njoftimi i përfundimit të punimeve nuk janë protokolluar pranë AK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikualifikim i rrugëve të brendëshme me beton, Metoq, Berdenesh, Çukë, Manastir”, Bashkia Sarandë”,		
1.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 5 me nr. 3420 prot., datë 11.04.2023, midis AK Bashkia Sarandë dhe Kontraktorit BOE “T.” ShPK & “C.” ShPK	2.Vlera e kontratës (me TVSh): 7,774,464 lekë.	3. Leje ndërtimi për punimet e objektit-Jo
4- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit	5.Afati i kontratës në muaj Parashikuar: 30 ditë nga lidhja e kontratës Fillimi punimeve: 18.04.2023 Përfundimi i punimeve i	6. Zgjatja e kontratës-Jo

	parashikuar sipas kontratës: 11.05.2023 Përfundimi faktik i punimeve: 28.04.2023	
7. Mbikëqyrësi i punimeve: Kontratë mbikëqyrje midis AK Bashkia Sarandë dhe K. K.	Licenca Nr: MK. 0453/3	
8. Kolaudatori i punimeve Kontratë kolaudimi midis AK Bashkia Sarandë dhe Kolaudatorit A. K.	Licenca Nr: MK. 1011	
9. Akt Kolaudimi	Datë 01.05.2023	
10. Akt marrje në dorëzim-Jo		

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlekë pa TVSh.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +		
							Vol.	Vlera	
I	Sistemim dhe betonim rruge Metoq L=298ml b=3m								
3	Shtresë stabilizant t=10cm	m ²	440	894	894	0	894	393,360	
	Sistemim dhe Betonim rruge Berdenesh L=357ml b=3 m								
3	Shtresë stabilizant t=10cm	m ²	440	1,070	1,070	0	1,070	470,800	
	Sistemim dhe Betonim rruge Çuke Manastir L=298ml b=3m								
3	Shtresë stabilizant t=10cm	m ²	440	894	894	0	894	393,360	
								1,257,520	

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit pjesa e materialit fotografik u vu re se në rrugët e kësaj kontrate nuk ishte vendosur zëri “Shtresë stabilizanti t=10cm” gjë e cila çënon përcaktimet sipas projektit dhe preventivit të objektit.

Në objektin: “Sistemim dhe betonim rruge Metoq L=298ml b=3m”

Zëri 3 “Shtresë stabilizant t=10cm” Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 804 m² me çmim 440 lekë/ m². Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 804 m². Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 804 m², i detajuar i detajuar në gjatësinë e rrugës Metoq. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se në gjatësinë e rrugës Metoq nuk është vendosur stabilizant. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në objektin: “Sistemim dhe betonim rruge Berdenesh L=357ml b=3 m

Zëri 3 “Shtresë stabilizant t=10cm” Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1,070 m² me çmim 440 lekë/ m². Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1,070 m². Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1,070 m², i detajuar

i detajuar në gjatësinë e rrugës Berdenesh. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se në gjatësinë e rrugës Berdenesh nuk është vendosur stabilizant. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në objektin: “Sistemim dhe Betonim rruge Çukë Manastir L=298m b=3m

Zëri 3 “Shtresë stabilizant t=10cm” Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 804 m² me çmim 440 lekë/ m². Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 804 m². Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 804 m², i detajuar i detajuar në gjatësinë e rrugës **Çukë Manastir**. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se në gjatësinë e rrugës **Çukë Manastir** nuk është vendosur stabilizant. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se kontraktorit të punimeve i janë likuiduar tepër **1,257,520 lekë pa TVSh** për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Kjo vlerë do të konsiderohet si dëm ekonomik për shkak të llogaritjeve të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punimeve të parrealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo miratimit të situacionit përfundimtar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** z. K. K., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve në zbatim të urdhërit me nr. 5/1 prot, datë 11.04.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** z. A. K., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

3) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

4) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

- a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
- b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

5) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit të datë 11.04. 2023.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. K. K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. A. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Ndërhyrje në Infrastrukturën e brendshme Ksamil”, Bashkia Sarandë 2023.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 7 prot., datë 20.04.2023, lidhur midis AK Bashkia Sarandë, përfaqësuar nga A. G. kryetar në cilësinë e Titullarit dhe Kontraktorit OE “J. K” ShPK, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor S. Ç.. Vlera e kontratës është 18,330,486 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 40 ditë nga lidhja e kontratës. Për këtë objekt nuk ka ndodhur shtesë afati.

Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 8 të kushteve të veçanta të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi nr. 7/1 prot., datë 20.04.2023, midis AK Bashkia Sarandë dhe Mbikëqyrësit K. K., me vlerë ekonomike të shërbimit 65,000 lekë pa TVSh, me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0453/3.

- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi më datë 20.04.2023, midis AK Bashkia Sarandë dhe A. K., me vlerë ekonomike të shërbimit 30,000 lekë pa TVSh me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1011.

Projektpreventivi Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Sarandë.

Zbatimi i punimeve

Në dosjen teknike administrohet vetëm librezja e masave përfundimtare e cila përgjithësisht korrespondon me situacionin përfundimtar.

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se dokumentacioni përkatës i mbajtur mes palëve si njoftimi i fillimit të punimeve dhe njoftimi i përfundimit të punimeve nuk janë protokolluar pranë AK. Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është më datë 01.06.2023.

- Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit dhe verifikimit në terren, u konstatua se rruga “Magdalena”, rruga “Sami Frashëri”, rruga “Liqeni” ishin të mbivendosura ose të mbuluara plotësisht, për shkak të investimeve që po kryehish në proces zbatimi nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit Programit sipas programit të “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”. Rrugët lokale që ishin të investuara nga Bashkia Sarandë në Maj të 2023, konsistonin vetëm me shtresë binderi.

Referuar marrëveshjes kuadër nr. 2845 prot., datë 21.08.2023 të nënshkruar me FSHZH dhe OE “Sh.” ShPK me objekt: “Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike, faza III, 2 lote Rajonet 3 & 4”, me vlerë të marrëveshjes kuadër 378,000,000 lekë me TVSh, me REF-74334-07-05-2023. Në përshkrimin e marrëveshjes kuadër “Raporti Teknik” citohet se mënyra e ndërhyrjes për përmirësimin e shtresave rrugore do të realizohet në varësi të kushteve fizike dhe teknike të rrugës

ekzistuese, ku parashikohet të ndërhyhet në disa kategori punimi. Zërat e punimeve në marrëveshjen kuadër janë 18 copë, ku përfshihen nga gërmimet, transportet, skarifikime, frezime, mbushje, paketë shtresash (cakëll, stabilizant), bindera dhe asfaltobetone me trashësi të ndryshme, betone dhe tibacione. *Pra në funksion të rrugës ekzistuese do të realizohet ndërhyrja në objekte.*

Në objektet e investuara nga Bashkia Sarandë, në vlerën totale të 2 kontratave publike janë më poshtë:

1. “Ndërhyrje në infrastrukturën e brendshme Ksamil” vlera 18,330,486 lekë me TVSh;
2. “Rikualifikim dhe shtrim i rrjetit rrugor Ksamil” vlera 18,001,449 lekë me TVSh;

Në total vlera për të dy kontrata është 36,331,935 lekë me TVSh. Në këto investime u parashikuan dhe u realizuar rrugë me gjerësi deri në 5 m (vetëm binder) dhe nga FShZh në këto rrugë do të realizohet zgjerim deri në 6-9m.

Pra nga Bashkia Sarandë dhe FSHZH, nuk janë realizuar saktë rakordimet ose bashkëpunimet me FSHZH, për shkak të mbivendosjes së punimeve ose për mosparashik të qartë të investimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërhyrje në Infrastrukturën e brendshme Ksamil”, Bashkia Sarandë”, Viti 2023		
1.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr.7 prot., datë 20.04.2023, midis AK Bashkia Sarandë dhe Kontraktorit OE “J. K” ShPK	2.Vlera e kontratës (me TVSh): 18,330,486 lekë.	3. Leje ndërtimi për punimet e objektit-Jo
4- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit	5.Afati i kontratës në muaj Parashikuar: 30 ditë nga lidhja e kontratës Fillimi punimeve: 27.04.2023 Përfundimi i punimeve i parashikuar sipas kontratës: 30.05.2023 Përfundimi faktik i punimeve: 29.05.2023	6. Zgjatja e kontratës-Jo
7. Mbikëqyrësi i punimeve Kontratë mbikëqyrje nr. 7/1 datë 20.04.2023 midis AK Bashkia Sarandë dhe Z. K. K.	Liçensa MK.0453/3	
8. Kolaudatori i punimeve Kontratë kolaudimi nr. 7/1 datë 20.04.2023 midis AK Bashkia Sarandë dhe Kolaudatorit z. A. K.	Licenca Nr: MK. 1011	
9. Akt Kolaudimi datë 31.05.2023	Datë 31.05.2023	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **106,594 lekë pa TVSh**.

III. Nga verifikimi në terren në rrugën “Magdalena” (e cila ishte duke u s’karifikuar nga Investimi i FSHZH), u konstatua se gjerësia e rrugës nuk ishte 4.93 m por 4.6 - 4.7 m. Duke përllogaritur me gjatësinë e verifikuar konstatohet pasaktësi si më poshtë:

Emërtimi	Gjatë m	Gjerë Fakt m	Gjerës i sipas L.M	Shuma sipas Situa	Shuma Fakt m ²	Cmimi Lek/m ²	Vlera Fakt Lek	Vlera sipas Situaci	Difer
Rrafshim, nivelim skarifikim t=10 cm	204	5.7	5.94	1,211.95	1,162.8	433	503,492	524,776	21,284
Shtresë stabilizanti	204	5.7	5.94	1,211.95	1,162.8	430	500,004	521,140	21,136
Shtresë binderi me granil gur kave 6 cm	204	4.7	4.93	1,006.54	959	1,350	1,294,650	1,358,824	64,174
Total									106,594

Në mënyrë të përmblodhur për këtë investim rezultoi se Kontraktorit të punimeve i janë likuiduar tepër **106,594** lekë **pa TVSh** për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Kjo vlerë do të konsiderohet si dëm ekonomik për shkak të llogaritjeve të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punimeve të porealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo miratimit të situacionit përfundimtar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve z. K. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

6) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

7) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve në zbatim të urdhërit me nr. 7/1 prot, datë 20.04.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve z. A. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

8) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

9) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

10) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit të datë 20.04. 2023.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. K. K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. A. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Rikualifikim rrugë të brendëshme në Sarandë”, Bashkia Sarandë 2023.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 20 prot., datë 20.04.2023, lidhur midis AK Bashkia Sarandë, përfaqësuar nga A. G. kryetar në cilësinë e Titullarit dhe Kontraktorit OE “A.” ShPK, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor A. P.. Vlera e kontratës është 29,141,277 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga lidhja e kontratës. Për këtë objekt nuk ka ndodhur shtesë afati. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 17 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e këtij shërbimi me nr. 20/1 prot., datë 18.04.2023, me vlerë 85,000 lekë pa TVSh, midis AK Bashkia Sarandë dhe Mbikëqyrësit K. K., me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0453/3.

- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata këtij shërbimi me nr. 20/2 prot., datë 18.04.2023, me vlerë 35,000 lekë pa TVSh, midis AK Bashkia Sarandë dhe A. K., me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1011. Në dosjen teknike administrohet vetëm librezja e masave përfundimtare e cila përgjithësisht korrespondon me situacionin përfundimtar.

Projektpreventivi Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Sarandë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se dokumentacioni përkatës i mbajtur mes palëve si njoftimi i fillimit të punimeve dhe njoftimi i përfundimit të punimeve nuk janë protokolluar pranë AK. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 20.04.2023. Procesverbali i piketimit dhe i fillimit të punimeve është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 20.04.2023. Më datë 20.04.2023 nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, kërkohet rishikim i projektit si rezultat i piketimit të objektit. Rishikimi i projektit qëndron në punimet e trotuarit dhe ndricimit, ku rezultoi se trotaret nuk janë plotësisht të lira dhe kërkohet ndërhyrje e lirimit të sheshit të ndërtimit. Gjithashtu kërkohet miratim nga AK për verifikim të gjendjes ekzistuese dhe miratimin e ndryshimeve të nevojshme. Me shkresën nr. 20/1 prot., datë 27.04.2023 të AK miratohet preventivi i rishikuar. Njoftimi i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është më datë 01.06.2023. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 02.06.2023. Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është më datë 02.06.2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikualifikim rrugë të brendëshme në Sarandë”, Bashkia Sarandë”, Viti 2023		
1.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr.20 prot., datë 20.04.2023, midis AK Bashkia Sarandë dhe Kontraktorit OE “A.” ShPK	2.Vlera e kontratës (me TVSh): 29,141,277 lekë.	3. Leje ndërtimi për punimet e objektit-Jo

4- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit	5.Afati i kontratës në muaj Parashikuar: 120 ditë nga lidhja e kontratës Fillimi punimeve: 20.04.2023 Përfundimi faktik i punimeve: 01.06.2023	6. Zgjatja e kontratës-Jo
7. Mbikëqyrësi i punimeve Kontratë mbikëqyrje nr. 7/1 datë 20.04.2023 midis AK Bashkia Sarandë dhe K. K.	Liçensa MK.0453/3	
8. Kolaudatori i punimeve Kontratë kolaudimi nr. 7/1 datë 20.04.2023 midis AK Bashkia Sarandë dhe Kolaudatorit A. K.	Licenca Nr: MK. 1011	
9. Akt Kolaudimi	Datë 02.06.2023	
10. Akt marrje në dorëzim-Po	Datë 02.06.2023	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **178,730 lekë pa TVSh**.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit përgjithsisht përputhen dokumentacioni me volume, duke bashkëlidhur planimetri të rrugëve, foto të punimeve dhe rakordohen në librezat e masave.

- Nga verifikimit i dokumentacionit fotografik, në kapitullin rikualifikim me asfalt i rrugës 47, konstatohet se në këtë rrugë nuk dokumentohet shtresa e stabilizantit, në sipërfaqen 140 m², i cili nuk përputhet edhe me sipërfaqet e shtresës së binderit dhe asfaltit. Pra zëri “*Shtresë stabilizanti t=15 cm*” në sipërfaqen 140 m² me cmimin 293 lekë/m², nuk dokumentohet dhe konsiderohet i pa realizuar, ku sipërmarrësi ka përfituar vlerën prej 41,020 lekë pa TVSh.

- Nga verifikimit i dokumentacionit fotografik, në kapitullin rikualifikim me asfalt i rrugës Adem Sheme (pjesa mbi rrugën Gjergj Araniti), konstatohet se në këtë rrugë nuk dokumentohet shtresa e stabilizantit, në sipërfaqen 170 m², i cili nuk përputhet edhe me sipërfaqet e shtresës së binderit dhe asfaltit. Pra zëri “*Shtresë stabilizanti t=15 cm*” në sipërfaqen 170 m² me cmimin 293 lekë/m², nuk dokumentohet dhe konsiderohet i pa realizuar, ku sipërmarrësi ka përfituar vlerën prej 49,810 lekë pa TVSh.

- Nga verifikimit i dokumentacionit fotografik, në kapitullin rikualifikim me asfalt i rrugës Teki Haderi, konstatohet se në këtë rrugë nuk dokumentohet shtresa e stabilizantit, në sipërfaqen 300 m², i cili nuk përputhet edhe me sipërfaqet e shtresës së binderit dhe asfaltit. Pra zëri “*Shtresë stabilizanti t=15 cm*” në sipërfaqen 300 m² me cmimin 293 lekë/m², nuk dokumentohet dhe konsiderohet i pa realizuar, ku sipërmarrësi ka përfituar vlerën prej 87,900 lekë pa TVSh.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 178,730 lekë pa TVSh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve K. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

11) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

12) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 20/1 prot, datë 22.04.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve K. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

2) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit 20/2 prot., datë 22.04.2023.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. K. K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. A. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Rikualifikim rrugë të brendëshme me asfalt në Gjashtë, Sarandë”, Bashkia SarandëViti 2023.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 6 prot., datë 18.04.2023, lidhur midis AK Bashkia Sarandë, përfaqësuar nga A. G. kryetar në cilësinë e Titullarit dhe Kontraktorit OE “S.” ShPK, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor A. K.. Vlera e kontratës është 8,721,907 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga lidhja e kontratës. Për këtë objekt nuk ka ndodhur shtesë afati. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 17 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në

preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e këtij shërbimi me nr. 6/1 prot., datë 12.04.2023, me vlerë 35,000 lekë pa TVSh, midis AK Bashkia Sarandë dhe Mbikëqyrësit person fizik Ing. A. T., me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1010/1.

-Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e këtij shërbimi me nr. 6/2 prot., datë 18.04.2023, me vlerë 30,000 lekë pa TVSh, midis AK Bashkia Sarandë dhe A.K., me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1011.

Hartimi i projektit Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Sarandë.

Zbatimi i punimeve

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se dokumentacioni përkatës i mbajtur mes palëve si njoftimi i fillimit të punimeve dhe njoftimi i përfundimit të punimeve nuk janë protokolluar pranë AK.

Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 26.05.2023. Procesverbali i piketimit dhe i fillimit të punimeve është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 26.05.2023. Më datë 30.05.2023 nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, kërkohet rishikim i projektit si rezultat i piketimit të objektit. Rishikimi i projektit qëndron në punimet që duhet të zbriten, ku kërkohet miratim nga AK për verifikim të gjendjes ekzistuese dhe miratimin e ndryshimeve të nevojshme. Preventivi i rishikuar dhe përdorimi i fondit rezervë është miratuar nga AK.

Njoftimi i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është më datë 12.06.2023.

Akti i kolaudimit është realizuar më datë 12.06.2023 dhe Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar më datë 13.06.2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikualifikim rrugë të brendëshme me asfalt në Gjashtë, Sarandë” Viti 2023		
1.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 6 prot., datë 18.04.2023, midis AK Bashkia Sarandë dhe Kontraktorit OE “S.” ShPK	2.Vlera e kontratës (me TVSh): 8,721,907 lekë.	3. Leje ndërtimi për punimet e objektit-Jo
4- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit	5.Afati i kontratës në muaj Parashikuar: 120 ditë nga lidhja e kontratës Fillimi punimeve: 26.05.2023 Përfundimi faktik i punimeve: 12.06.2023	6. Zgjatja e kontratës-Jo
7. Mbikëqyrësi i punimeve Kontratë mbikëqyrje midis AK Bashkia Sarandë dhe Ing. A. T.	Licensa MK.1010/1	
8. Kolaudatori i punimeve Kontratë kolaudimi midis AK Bashkia Sarandë dhe Kolaudatorit A. K.	Licenca Nr: MK. 1011	
9. Akt Kolaudimi	12.06.2023	
10. Akt marrje në dorëzim-jo	13.06.2023	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si

dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **180,056 lekë pa TVSh**.

	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
I	Punime shtresash ne rrugë							
1	Skarifikim shtrese asfalti me makineri	m ²	200				124	24,831
	Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4 cm	m ²	1,250				124	155,225
							Total	180,056

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, nuk janë pasqyruar gjerësitë e seksioneve tërthore, duke u përllogaritur në librezën e masave. Pas verifikimit të rrugës Gjashtë në terren, u konstatua se gjatësia e rrugës ishte në përputhje me projektin e azhurnuar, por gjerësia e rrugës varionte nga 4.7 m- 5.1 m, duke mos argumentuar apo justifikuar sasinë shtesë të asfaltit. Situacioni përfundimtar përbëhet vetëm nga 3 zëra punimesh si më poshtë:

- Skarifikim shtrese asfalti me makineri 4,324 m²;
- Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm me makineri 644 m²;
- Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4 cm me makineri 4,324 m².

Nga 9 (nëntë) zëra punime që përmban preventive i punimeve të prokuruar.

Referuar tabelës së lëvizjes së volumeve, kostatohet se është shtuar vetëm 124 m² (skarifikim + asfalt). Bazuar në librezën e masave, projektin e azhurnuar vetëm në planimetri (pa profile gjatësore, tërthorë të rrugës), nuk është llogaritur e detajuar sasia e shtresës së asfaltobetonit dhe skarifikimit, por është vendosur sasia totale prej 4,380 m² (në librezën e masave) dhe likuiduar në situacion përfundimtar 4,324 m². Referuar përllogaritjes për gjatësi 880 ml rrugë, rezulton se gjërësia e përllogaritur është 4,324 m² / 880 m = 4.91 ml, por në fakt kjo gjërësi varionte në pjesë të ndryshme të rrugës.

Në mungesë të përllogaritjeve të sakta të gjerësisë së rrugës referuar piketave të rrugës, nga kontraktori nuk argumentohet shtesa e asfaltobetonit prej 124 m². Si përfundim, nuk argumentohen shtesat e zërave me cmimet përkatëse sim ë poshtë:

<i>Emërtimi i punimeve</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi</i>	<i>Vlera</i>
Skarifikim shtrese asfalti me makineri	124 m ²	200	24,831
Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4 cm	124 m ²	1,250	
Shuma			180,056
TVSh 20%			36,011
Total			216,067

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **180,056 pa TVSh e përfituar më tepër nga sipërmarrësi**, për mos llogaritje dhe argumentime nga fakti i punës së realizuar

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 180,056 lekë pa TVSh sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm**

ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve z. A. T.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

13) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

14) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve në zbatim të urdhërit me nr. 6/1 prot, datë 12.04.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve z. A. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

15) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

16) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

- a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.*
- b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.*
- c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.*
- ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes*

17) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit të datë 12.04. 2022.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. T. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. A. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

5. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Rikualifikim dhe riveshje e rrugëve “Onhezmi” dhe rrugës “Adem Sheme”, Bashkia Sarandë Viti 2023.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 6 prot., datë 27.03.2023, lidhur midis AK Bashkia Sarandë, përfaqësuar nga z. A. G. kryetar në cilësinë e Titullarit dhe Kontraktorit OE “Sh.” ShPK, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. Y. B.. Vlera e kontratës është 37,784,758 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga lidhja e kontratës. Për këtë objekt nuk ka ndodhur shtesë afati. Preventivi dhe lloji i kontratës

është me çmim njësie, ku bazuar nenit 17 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata në zbatim të vendimit 19/1, datë 27.03.2023 të titullarit të AK e këtij shërbimi, midis AK Bashkia Sarandë dhe Mbikëqyrësit K. K., vlera ekonomike e shërbimit 85,000 lekë pa TVSh, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0453/3.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata, në zbatim të vendimit 19/2, datë 27.03.2023 të titullarit të AK përkatëse e këtij shërbimi, midis AK Bashkia Sarandë dhe A. K., vlera ekonomike e shërbimit 35,000 lekë pa TVSh me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1011.

Hartimi i projektit

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Sarandë.

Zbatimi i punimeve

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se dokumentacioni përkatës i mbajtur mes palëve si njoftimi i fillimit të punimeve dhe njoftimi i përfundimit të punimeve nuk janë protokolluar pranë AK. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 28.03.2023. Procesverbali i piketimit dhe i fillimit të punimeve është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 28.03.2023. Njoftimi i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është më datë 25.05.2023. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 16.06.2023 dhe Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar më datë 21.06.2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikualifikim dhe riveshje e rrugëve “Onhezmi” dhe rrugës “Adem Sheme” Viti 2013		
1.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 19 prot., datë 27.03.2023, midis AK Bashkia Sarandë dhe Kontraktorit OE “Sh.” ShPK	2.Vlera e kontratës (me TVSh): 37,784,758 lekë.	3. Leje ndërtimi për punimet e objektit-Jo
4- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit	5.Afati i kontratës në muaj Parashikuar: 120 ditë nga lidhja e kontratës Fillimi punimeve: 28.03.2023 Përfundimi faktik i punimeve: 25.07.2023	6. Zgjatja e kontratës-Jo
7. Mbikëqyrësi i punimeve Kontratë mbikëqyrje nr. 7/1 datë 20.04.2023 midis AK Bashkia Sarandë dhe K. K.	Liçensa MK.0453/3	
8. Kolaudatori i punimeve Kontratë kolaudimi midis AK Bashkia Sarandë dhe Kolaudatorit A. K.	Licenca Nr: MK. 1011	
9. Akt Kolaudimi	16.06.2023	
10. Akt marrje në dorëzim-jo	21.06.2023	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje

me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **163,350 lekë pa TVSh.**

	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
A	Riveshje me Asfalt Rr. Onhezmi							
4	Vijezim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm, Termoplastike (sprajt)	ml	220	1,900	1,900	83%	17%	72,930
B	Riveshje me Asfalt Rr. Adem Sheme							
4	Ulluk shkarkimi vertikal me baker Ø 120	ml	220	1100	1100	83 %	17%	41,140
D	Rikualifikim rruge me beton							
	Rrafshim, nivelim, skarifikim t=10 cm	m ²	32	1,540	1,540	-	1,540	49,280
							Total	163,350

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, përgjithsisht përputhen dokumentacioni me volume, duke bashkëlidhur planimetri të rrugëve, foto të punimeve dhe rakordohen në librezat e masave. Preventivi dhe oferta nuk përmbajnë fond rezervë. Projekti dhe Situacioni përfshin punime riveshje me asfalt rrugës “Onhezmi” dhe rrugës “Adem Sheme”, skarifikim shtresës së asfaltit, shtresë binderi, shtresë asfaltobetonit dhe vijëzime gjatësore.

A. RIVESHJE ME ASFALT RR. “ONHEZMI”

Zëri 4 “Vijezim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm, Termoplastike (sprajt)”

Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në gjatësinë/anësoret të rrugës “Onhezmi” në suprinën e rrugës në sasinë 2,500 ml. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 1,950 ml.

Nga verifikimit në terren, në rrugën “Onhezmi” dhe dokumentacioni fotografik, konstatohet se në këtë rrugë nuk është realizuar sipas specifikimeve të projekt preventivit zëri “*Vijezim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm termoplastike*”. Vijëzimi gjatësor dhe anësor është realizuar me gjerësi 10 cm, pra me diferencë 17 %. Sasia e situacionuar 1,950 ml me çmimin 220 lekë/ml dhe me vlerë të situacionuar 429,000 lekë, duhet zbritur ose të korrigjohet gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Pra $429,000 \text{ lekë} \times 17\%$ (trashësia e vijëzimit) = 72,930 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

B. RIVESHJE ME ASFALT RR. “ADEM SHEME”

Zëri 4 “Vijezim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm, Termoplastike (sprajt)”

Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në gjatësinë/anësoret të rrugës “Adem Sheme” në suprinën e rrugës në sasinë 900 ml. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 1,100 ml.

- Nga verifikimit në terren, në rrugën “Adem Sheme” dhe dokumentacioni fotografik, konstatohet se në këtë rrugë nuk është realizuar sipas specifikimeve të projekt preventivit zëri “*Vijezim shirita Gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm termoplastike*”. Vijëzimi gjatësor dhe anësor është realizuar me gjerësi 10 cm, pra me diferencë 17 %. Sasia e situacionuar 1,100 ml me çmimin 220 lekë/ml dhe me vlerë të situacionuar 242,000 lekë, duhet zbritur ose të korrigjohet gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Pra $242,000 \text{ lekë} \times 17\%$ (trashësia e vijëzimit) = 41,140 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

C. RIKUALIFIKIM RRUGA ME BETON.

Zëri “Rrafshim, nivelim, skarifikim t=10 cm”

Në preventivin bazë ky zë pune nuk është i vendosur në gjatësinë/trupin e rrugëve. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 1,100 ml.

Nga verifikimi i dosjes së punimeve, dokumentacionet fotografike, konstatohet se në rrugës me beton nuk është realizuar zëri “Rrafshim, nivelim, skarifikim t=10 cm”, pasi në këto rrugë janë hedhur shtresa e çakëllit, stabilizantit dhe betoni t=12 cm. Rrjedhimisht sipërmarrësi e ka përfituar padrejtësisht vlerën prej 49,280 lekë të zërit “Rrafshim, nivelim, skarifikim t=10 cm”.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **167,970 lekë pa TVSh e përfituar më tepër nga sipërmarrësi**, për mos realizim sipas specifikimeve teknike dhe nga fakti i punës së realizuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve z. K. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

18) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

19) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve në zbatim të urdhërit me nr. 19/1 prot, datë 27.03.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve z. A. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

20) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

21) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

22) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit të datë 27.03. 2023.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. K. K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. A. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

6. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Adem Sheme, Sarandë”. Bashkia Sarandë 2022.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 13 prot., datë 22.12.2022, lidhur midis AK Bashkia Sarandë, përfaqësuar nga z. A. G. kryetar në cilësinë e Titullarit të AK dhe OE “V. K” ShPK, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. B. L.. Vlera e kontratës është 70,902,705 lekë me TVSh. Financimi është realizuar nga Buxheti i Shtetit dhe Bashkia Sarandë. Projekti është miratuar me VKB nr. 225 datë 22.12.2022.

Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 8 muaj nga lidhja e kontratës. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nën 17 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi, në zbatim të Vendimit nr. 13/1, datë 22.12.2022 midis AK Bashkia Sarandë dhe Mbikëqyrësit person fizik Ing. A. T., me vlerë të kontratës 95,000 lekë pa TVSh, me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1010/1.

- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi, në zbatim të Vendimit nr. 13/2, datë 22.12.2022 midis AK Bashkia Sarandë dhe z. K. K., me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.0453/3.

Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Sarandë.

Zbatimi i punimeve

- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori është realizuar me shkresën nr. 189 prot., datë 22.12.2022. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 22.12.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 22.12.2022.

Procesverbali i përfundimit të punimeve dhe njoftimi i përfundimit nga mbikëqyrësi është më datë 21.08.2023. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 27.10.2023 dhe Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar më datë 06.11.2023.

-Kontrata përbëhet nga 3 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me librezë masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 8.1; "Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 "Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave". Në dosjen teknike administrohet vetëm librezë e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

- Me kërkesën e sipërmarrësit nr. 25/6 prot., datë 10.04.2023 dhe të mbikëqyrësit datë 15.04.2023,

kërkohet miratimi i ndryshimit të volumeve, për shkak të mospërputhjeve të zërave të parashikuara në preventiv dhe atyre të realizuara në fakt. Bashkëlidhur kërkesës ndodhej preventivi i rishikuar me tabelën e lëvizjes së volumeve të cilat janë miratuar nga AK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion Shkolla 9-vjecare Adem Sheme, Sarandë” Viti 2022		
1.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 13 prot., datë 22.12.2022, midis AK Bashkia Sarandë dhe Kontraktorit OE “V. K” ShPK	2.Vlera e kontratës (me TVSh): 70,902,705 lekë	3. Leje ndërtimi për punimet e objektit-po
4- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit	5.Afati i kontratës në muaj Parashikuar: 8 muaj nga lidhja e kontratës Fillimi punimeve: 22.12.2022 Përfundimi faktik i punimeve: 21.08.2023	6. Zgjatja e kontratës-Jo
7. Mbikëqyrësi i punimeve Kontratë mbikëqyrje nr. 13/1 prot., datë 22.12.2022 midis AK Bashkia Sarandë dhe Ing. A. T.	Liçensa MK.1010/1	
8. Kolaudatori i punimeve Kontratë kolaudimi midis AK Bashkia Sarandë dhe Kolaudatorit K. K.	Liçensa MK.0453/3	
9. Akt Kolaudimi	27.10.2023	
10. Akt marrje në dorëzim-po	06.11.2023	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **4,608,563.36 lekë pa TVSh**.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
I	PUNIME PRISHJE NË SHKOLLËS							
7	Ç'montim kangjella metalike	m ²	340	67	67	0	67	22,780
8	Prishje suvatim i brendshëm	m ²	6,045	150	6,045	5,784.5	260.5	39,075
11	Prishje suvatimi i jashtëm	m ²	350	1,556	1,556	0	1,556	544,600
								606,455
III	PUNIME ÇATIE							
3	Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat	copë	1,040	12	12	0	12	12,480
V	PUNIME SHITESASH							
7	F.V Shkalle mermeri komplet, t = 3 cm	m ²	6,520	56	56	2/3	1/3	121,706.67
8	F.V Plintus mermeri t = 10 cm	ml	520	32	32	520-300	220	7,040
								128,746.67

VI PUNIME SUVATIMI E BOJATISJEJE TË BRENDESHME								
3	Suva brenda mur guri h~4m me krah, llaç përzier M 25	m ²	730	6,045	6,045		266	194,180
4	Patinim muri allçi (stuko)	m ²	240	185	185	0	185	44,400
5	Lyerje muri të brendshëm me bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë	m ²	380	6,045	6,045		266	101,080
								339,660
VII PUNIME DYERSH E DRITARESH								
1	FV. Dritare d/alumimi plastike me dopio xham	m ²	14,990	370.55		57%	43%	2,391,032.63
3	F.V. dyer të brendëshme druri importi cilësi e I-rë.	m ²	21,400	102.03		57%	43%	941,030.06
								3,332,062.69
B PUNIME TË NDËRTIMIT TË PALESTRËS								
VII I PUNIME SUVATIMI E BOJATISJEJE TË JASHTËME								
1	Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm+rrjetë+suva	m ²	2,800	1,556	1,558	1,947/2,869	67.86 %	1,530,979.52
PUNIME ELEKTRIKE								
XI	Sistemi i mbrojtjes atmosferike							
1	FV Elektoda tokëzimi të xinguar. Kryq 35x35x35 L=1.2m	copë	1,850	25	25	0	25	46,250
2	FV Shirit tokëzimi i xinguar horizontal 30x3mm	ml	260	310	310	0	310	80,600
3	FV Shtizë me malë të xingur l =.6m d=16mm	copë	1,500	30	30	0	30	45,000
4	FV Morseteri bashkuese tip "TI"	copë	130	30	30	0	30	3,500
5	FV Morseteri bashkuese tip Kryq	copë	200	13	13	0	13	2,600
6	FV Morseteri bashkuese lidhje paralele	copë	213	12	12	0	12	2,556
7	FV Shkëputës për matjen e tokëzimit ndarës seksionuese Zn Tip 22CP	copë	240	8	8	0	8	1,920
								182,826
PUNIME HIDROSANITARE DHE MBROJTJA NGA ZJARRI								
	Furnizimi me ujë (Uji i ftohtë)							
17	F.V Tabela hidranti	copë	2,120	3	3	03		6,360
							Total	4,608,563.36

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave dhe verifikimit në objekt datë 17.12.2024, u konstatua parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

I. PUNIME PRISHJE NË SHKOLLËS

1. Zëri nr. 7 “Ç’montim kangjella metalike”. Në preventivin bazë ky zë pune është 67 m² me çmim të ofertës 340 lekë/ m². Në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 67 m² dhe në librezën e masave nuk pasqyrohet përlllogaritja ose realizimi i punimeve sasisë që rezultoi sipas situacionit 67 m². Ndërkohë në kapitullin e punimeve B “Punime prishje të territorit” zëri nr. 3 “Ç’montim kangjella dhe dyer metalike”, pasqyrohet sasia prej 100 m² e llogaritur nga kangjellat e shkallëve hyrëse dhe në hyrje të shkollës në 2 krahë. Rrjedhimisht zëri nr. 7 “Ç’montim kangjella metalike” është i mbivendosur dhe i paargumentuar në sasinë prej 67 m² dhe me çmimin prej 340 lekë/m², rezulton vlera prej 22,780 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri nr. 8 “Prishje suvatim i brendshëm”, Në preventivin bazë ky zë pune është 5,659 m² me çmim të ofertës 150 lekë/ m². Në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 6,045 m² dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 6,045 m². Libreza e masave pasqyron volumet për të 3 katet (Përdhe, kati I, kat II), duke i përlllogaritur me perimetërin e ambienteve (m) x lartësinë (3m). Librezat e masave për prishjet e suvatimeve dhe suvatimet, kanë rezultuar vetëm prodhim pozitiv pra (Perimetër x Lartësi) dhe nuk kanë zbritur prodhimet negative që rezultojnë nga dritaret dhe dyert e objektit.

Referuar librezave të masave për sasinë e dritareve, metalike, d/alumini, sipas zërit nr. 5 “Ç’montim dritare, metalike, d/alumini dhe druri” janë në sasinë prej 362.6 m².

Referuar librezave të masave për sasinë e dyerve, metalike, d/alumini, sipas zërit nr. 6 “Ç’montim dyer, metalike, d/alumini dhe druri” janë në sasinë prej 158.5 m².

Në total sasia e dyer dritareve është 521 m² (362.6 m² + 158.5 m²). Duke e përgjysmuar sasinë 521 m² / 2 = 260.5 m² (e cila i përket fashaturave të dyerve dhe dritareve), sasia prej 260.5 m² është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 150 lekë/m² i zërit “Prishje suvatim i brendshëm”, rezulton vlera prej 39,075 lekë pa TVSh.

3. Zëri “Prishje suvatim i jashtëm”, Në preventivin bazë ky zë pune është 1,213 m² me çmim të ofertës 350 lekë/ m². Në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 1,556 m² dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 1,556 m². Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 1,040 lekë/copa, rezulton vlera prej 544,600 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

III. PUNIME ÇATIE

4. Zëri nr. 3 “Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat”. Në preventivin bazë ky zë pune është 12 copë me çmim të ofertës 1,040 lekë/copë. Në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 12 copë dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 12 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 1,040 lekë/copa, rezulton vlera prej 12,480 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

V. PUNIME SHTRRESASH

4. “F.V Shkallë mermeri komplet, t = 3 cm” Në preventivin bazë ky zë pune është 12 copë me çmim të ofertës 1,040 lekë/copë. Në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 12 copë dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 12 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 1,040 lekë/copa, rezulton vlera prej 12,480 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

5. “F.V Plintus mermeri t = 10 cm” Në preventivin bazë ky zë pune është 12 copë me çmim të ofertës 1,040 lekë/copë. në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 12 copë dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 12 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 1,040 lekë/copa, rezulton vlera prej 12,480 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

VI. PUNIME SUVATIMI E BOJATISJEJE TË BRENDËSHME

6. Gjithashtu e njëjtë me arsyetimin e mësipërm, në kapitullin e punimeve të suvatimit e bojatisjeve të brendshme, zëri nr. 3 “*Suva brenda mur guri h-4m me krah, Ilaç përzier M 25*”, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 6,045 m² dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 6,045 m². Libreza e masave pasqyron volumet për të 3 katet (Përdhe, kati I, kat II), duke i përlllogaritur me perimetërin e ambienteve (m) x lartësinë (3m). Librezat e masave për suvatimet, kanë rezultuar vetëm prodhim pozitiv pra (Perimetër x Lartësi) dhe nuk kanë zbritur prodhimet negative që rezultojnë nga dritaret dhe dyert e objektit.

Referuar librezave të masave për sasinë e dritareve, metalike, d/alumini, sipas zërit nr. 1 “*Fv dritare d/alumini plastike me dopio xham*” janë në sasinë prej 370.95 m².

Referuar librezave të masave për sasinë e dyerve, metalike, d/alumini, sipas zërit nr. 3 “*Fv dyer brendshme dryri importi cilësia I-rë*” janë në sasinë prej 102.3 m².

Referuar librezave të masave për sasinë e dyerve, metalike, d/alumini, sipas zërit nr. 4 “*Fv dyer blinduara importi*” janë në sasinë prej 2.15 m².

Referuar librezave të masave për sasinë e dyerve, metalike, d/alumini, sipas zërit nr. 5 “*Fv derë d/alumini pa xham me mbushje d/a*” janë në sasinë prej 46.13 m².

Referuar librezave të masave për sasinë e dyerve, metalike, d/alumini, sipas zërit nr. 3 “*Fv dyer emergjence rezistente ndaj djegies*” janë në sasinë prej 10.35 m².

Në total sasia e dyer dritareve është 532 m² (370.95m² + 102.3m² + 2.15m² + 46.13 m² + 10.35 m²).

Duke e përgjysmuar sasinë 532 m² / 2 = 266 m² (e cila i përket fashaturave të dyerve dhe dritareve), sasia prej 266 m² është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 730 lek/m² i zërit “*Suva brenda mur guri h-4m me krah, Ilaç përzier M 25*”, rezulton vlera prej 194,180 lekë pa TVSh.

7. Gjithashtu e njëjtë me arsyetimin e mësipërm, në kapitullin e punimeve të suvatimit e bojatisjeve të brendshme, zëri nr. 5 “*Lyerje muri të brendshëm me bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë*”, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 6,045 m² dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 6,045 m². Libreza e masave pasqyron volumet për të 3 katet (Përdhe, kati I, kat II), duke i përlllogaritur me perimetërin e ambienteve (m) x lartësinë (3m). Librezat e masave për suvatimet, kanë rezultuar vetëm prodhim pozitiv pra (Perimetër x Lartësi) dhe nuk kanë zbritur prodhimet negative që rezultojnë nga dritaret dhe dyert e objektit.

Në total sasia që duhej zbritur e dyer dritareve është 532 m² (370.95m² + 102.3m² + 2.15m² + 46.13 m² + 10.35 m²). Duke e përgjysmuar sasinë 532 m² / 2 = 266 m² (e cila i përket fashaturave të dyerve dhe dritareve), sasia prej 266 m² është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Me çmimin përkatës prej 380 lek/m² i zërit “*Lyerje muri të brendshëm me bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë*”, rezulton vlera prej 101,080 lekë pa TVSh.

8. Në kapitullin e punimeve të suvatimit e bojatisjeve të brendshme, zëri nr. 4 “*Patinim muri allçi*

(stuko)", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 185 m² dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 185 m². Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 240 lekë/m², rezulton vlera prej 44,400 lekë pa TVSh.

VI "PUNIME DYERSH E DRITARESH"

9. Zëri 2.375.1 "FV. Dritare d/alumimi plastike me dopio xham" Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen perimetrale të shkollës në sasinë 325 m². Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 370.95 m². Në shënimet teknike për "Dyer & Dritare" citohet: *"Dritaret plastike me dopio xham termik 6 mm, të mbushur me gaz argon 90%, me profile plastike ose alumin termik 70mm kanë kofiqent shumë të ulët të përcjelljes termik. Dyert e jashtëme janë të mbushura me një shtresë leshi guri të dendur për izolim më të mirë"*.

Nga auditimi në terren konstatohet që: xhamat nuk janë termik dhe nuk është i mbushur me argon; alumini i përdorur për dritares nuk është termik, (është profill i thjeshtë 40mm) Sa më sipër vlera e dritareve është 57% e vlerës të përlllogaritur në situacionin e punimeve.

10. Zëri 3 "F.V. Dyer të brendshme druri importi cilësi e I-rë". Në preventivin bazë ky zë pune është 93 m² me çmim të ofertës 21,400 lekë/m². në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 102.03 m² dhe në librezën e masave pasqyrohet e njëjta sasi prej 102.03 m². Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi ishte realizuar në vepër sias zërit 2.388/1" **F,V. dyer të brendëshme tamburate të rimesuara**". Me çmimin përkatës 14,279 lekë/m² sipas manualit të çmimeve. (14,279 lekë/m²; 21,441 lekë/m² = 0.67) rezulton vlera prej 941,030.06 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

VIII. PUNIME SUVATIMI E BOJATISJE TË JASHTËME

11. Zëri "Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjetë + suva" Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen e perimetrale të shkollës nën grafiatos në sasinë 1,213 m². Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 1,556 m². Në situacionin përfundimtar dhe librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1,556 m². Nga auditimi në objekt u konstatua që poshtë suprinës së grafiatos është vendosur polisterol i thjeshtë t=5cm me çmim 1,947 lekë/m² sipas manualit të punimeve të ndërtimit nga 2,869 lekë/m² që është zëri "Veshje fasade me polisterol jeshil". Vlera e punimeve "Veshje muri me polisterol të thjeshtë t=5cm rrjetë+suva" është e barazvlerëshme me 67.86% e vlerës të zërit situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi punimi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

XI. SISTEMI I MBROJTJES ATMOSFERIKE

12. "FV Elektoda tokëzimi të xinguar. Kryq 35x35x35L=1.2m" Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen perimetrale të shkollës në sasinë 24 copë. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 25 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 1,800 lekë/copa, rezulton vlera prej 46,350 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

13 "FV Shirit tokëzimi i xinguar horizontal 30x3mm" Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen perimetrale të shkollës në sasinë 303 ml. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 310 ml. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 260 lekë/ml, rezulton vlera prej 80,600 lekë pa

TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

14. “FV Shtizë me majë të xingur l =.6m d=16mm” Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen perimetrale të shkollës në sasinë 24 copë. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 30 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 1,500 lekë/copa, rezulton vlera prej 45,000 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

15. “FV Morseteri bashkuese tip “TI” Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen perimetrale të shkollës në sasinë 24 copë. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 30 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 130 lekë/copa, rezulton vlera prej 3,500 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

16. “FV Morseteri bashkuese tip Kryq” Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen perimetrale të shkollës në sasinë 13 copë. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 13 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 200 lekë/copa, rezulton vlera prej 2,600 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

17. “FV Morseteri bashkuese lidhje paralele” Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen perimetrale të shkollës në sasinë 12 copë. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 12 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 213 lekë/copa, rezulton vlera prej 2,556 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

18. “FV Shkëputës për matjen e tokëzimit ndarës seksionuese Zn Tip 22CP” Në preventivin bazë ky zë pune është i vendosur në sipërfaqen perimetrale të shkollës në sasinë 8 copë. Në preventivin e rishikuar ky zë pune figuron në sasinë totale prej 8 copë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 240 lekë/copa, rezulton vlera prej 1,920 lekë pa TVSh, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

19. Në kapitullin e punimeve të furnizimit me ujë, zëri nr. 18 “*F.V tabelë fikse zjarri me pluhur*”, në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 6 copë dhe nga verifikimi në objekt u konstatua se ky zë punimi nuk ishte realizuar në vepër. Me çmimin përkatës 2,590 lekë/copa, rezulton vlera prej 15,540 lekë pa TVSh.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 4,608,563.36 lekë pa TVSh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** A. T., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

23) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

24) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 13/1 prot, datë 22.12.2022.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve K. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

4) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

5) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

6) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me datë 13.12.2022.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. T. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. K. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

7. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës faza II (loti përfundimtar)”, Bashkia Sarandë 2021

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 10 prot., datë 22.10.2021, lidhur midis AK Bashkia Sarandë, përfaqësuar nga A. G. kryetar në cilësinë e Titullarit dhe Kontraktorit BOE “E. K” & “Sh.” ShPK, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor C. S. dhe Y. B.. Vlera e kontratës është 378,836,979 lekë me TVSh. Financimi është realizuar nga Buxheti i Shtetit. Oponenca teknike e projektit është realizuar nga Instituti i Ndërtimit me nr. 477/3 prot., date 17.03.2021. Me shkresën nr. 3932/2 prot., date 16.11.2021 të Ujësjetës Kanalizime ShA Sarandë (UKS), dërgohet projekte objekt *“Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës faza II (loti përfundimtar)”*, me projektues shoqërinë “I. D.” ShPK.

Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 365 ditë nga lidhja e kontratës, e cila ka pësuar 2 amendime kontrate të miratura nga palët për shtyrje të afatit të punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 17 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar,

me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi, midis AK Bashkia Sarandë dhe Mbikëqyrësit operatorit ekonomik “I.D.” ShPK, me përfaqësues A. H. dhe me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1886/6.

- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi, midis AK Bashkia Sarandë dhe K. K., me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.0453/3.

Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga OE “D.” ShPK.

Zbatimi i punimeve

- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori është realizuar me shkresën Datë 12.10.2021. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 12.10.2021. Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 12.10.2021. Me shkresa të shumta të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve, janë kërkuar disa herë shtyrje të afatit të punimeve, kryesisht për pengesa nga banorët në zona të linjave të tubacioneve dhe për shkak të fluksit të sezoneve turistike në qytetin e Sarandës. Me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 3622/6 prot., datë 01.08.2023 dhe me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 2660 prot., datë 02.06.2023, specifikohet orari i lejimit i punimeve të ndërtimit dhe të mjeteve të rënda në gjithë Bashkinë e Sarandës, për shkak të fluksit turistik në qytet. Procesverbali i përfundimit të punimeve dhe njoftimi i përfundimit nga mbikëqyrësi nuk është realizuar për shkak të punimeve ende në proces.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës faza II (loti përfundimtar)”		
1.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 10 prot., datë 12.10.2021, midis AK Bashkia Sarandë dhe Kontraktorit BOE “E. K” & “Sh.” ShPK	2.Vlera e kontratës (me TVSh): 378,836,979 lekë	3. Leje ndërtimi për punimet e objektit-po
4- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit	5.Afati i kontratës në muaj Parashikuar: 365 muaj nga dorëzimi i sheshit të punimeve Fillimi punimeve: 12.10.2021 Afati Sipas Amend. 1, 31.05.2023 Afati Sipas Amend. 2, 30.09.2023 - 15.01.2024 Afati Sipas Amend. 3, 15.01.2024 - 30.04.2024	6. Zgjatja e kontratës-po
7. Mbikëqyrësi i punimeve Kontratë mbikëqyrje nr. 13/1 prot., datë 22.12.2022midis AK Bashkia Sarandë dhe OE “I.D.” ShPK	Liçensa MK. 1886/6.	
8. Kolaudatori i punimeve Kontratë kolaudimi midis AK Bashkia Sarandë dhe Kolaudatorit K. K.	Liçensa MK.0453/3	
9. Akt Kolaudimi	Nuk është realizuar	
10. Akt marrje në dorëzim-jo	Nuk është realizuar	

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj

buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,871,980 lekë pa TVSh**.

-Kontrata përbëhet nga 6 situacione pjesore progresive, të cilat janë shoqëruar me librezë masash pjesore, por nuk përputhen emërtimet e punimeve me sasi të në preventiv, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 8.1; "Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 "Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave".

Situacionet	Urdher shpenzimet	Fatura	Pogresivi sipas shumes me TVSh
Situacioni 1	Nr.648 dt 29.12.2021	Nr.142 dt 06.12.2021	27,476,274
Situacioni 2	Nr.668 dt 30.12.2021	Nr.158 dt 23.03.2021	49,873,001
Situacioni 3	Nr.360 dt 02.08.2022	Nr.39 dt 27.07.2022	64,612,618
Situacioni 4	Nr.199 dt 02.05.2023	Nr.19 dt 03.04.2023	34,990,801
Situacioni 5	Nr.560 dt 22.11.2023	Nr.79 dt 20.11.2023	101,569,394
Situacioni 6	Nr.641 dt 29.12.2023	Nr.97 dt 29.12.2023	48,439,805
TOTALI			326,961,893

II. Nga kontrolli i dokumentacionit pjesor tekniko-ligjor i dosjes të objektit, situacioneve pjesore, dhe librezave të masave dhe verifikimit në objekt, u konstatua parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

1. Në kapitullin A, të punimeve të rrjetit shpërndarës, sipas preventivit dhe situacioneve pjesore parashikohen gërmimet për diametrat e ndryshëm (d=63, d=75, d=90, d=110, d=125, d=140, d=180, d=200, d=450), ku 8 zëra gërmimesh i përkasin shkëmb mesatar dhe 1 zë punimi i përket shkëmbit të fortë. Cmimi për shkëmbin e fortë është 3,885 lekë/m³ dhe cmimi për shkëmb mesatar është 1,734 lekë/m³. Referuar preventivit të rishikuar dhe situacionit pjesor nr. 6, konstatohet se është rritur sasia e shëmbit të fortë nga 4,056 m³ (në preventiv) dhe në situacion pjesor shkon në 17,165 m³. Ndërkohë sasi të e shkëmbinjve mesatar kanë pësuar zbritje të tyre. Nga auditimi i dosjes pjesore të pa plotësuar ende gjatë procesit të auditimit, konstatohet se nuk disponohet asnjë raport gjeologjik që të përcaktojë saktë shkëmbinjtë (fortë, mesatar) për likudimin e volumeve të gërmimeve.

Mungesa e raportit gjeologjik nuk argumenton dhe nuk justikon volumet e përdorura për cdo zë punimi, ku nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve, duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për përcaktimin e saktë të llojit të formacionit shkëmbor në gjatësitë e rrjetit shpërndarës.

2. Në kapitullin C, të punimeve për rezervuarin 2000 m³, pjesa e hidroizolimit dhe Akserorëve ekzistonin zëra punimesh përealizuara por të likuiduara. Më poshtë paraqiten në formë tabelare punimet e përealizuara në situacionin pjesor nr. 6.

Nr	Nr. Anal	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa mapej (muret brenda)	m2	392	1,340	525,280
2	2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa mapej (Kollonat dhe	m2	135	1,340	180,900

		kapiteli)				
3	2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa mapej (Dyshemeja)	m2	435	1,340	582,900
4	2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa mapej (Tavani)	m2	435	1,340	582,900
		Shuma Total				1,871,980

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,871,980 lekë pa TVSh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve A. H.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

25) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

26) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 10/1 prot, datë 22.10.2021.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve K. K.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

7) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

8) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

9) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit 10/2 prot., datë 22.10.2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. H. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. K. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 188/8 prot; datë 12.09.2024, i ndryshuar, me

objekt: “**Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2023**, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E-leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Sarandë ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** (këtu e në vazhdim PPV) dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT), nr. 03, datë 16.10.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi. Kjo PPV është ndryshuar me Vendim nr. 06, datë 28.01.2020, të KKT-së, “Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Sarandë, të miratuar me Vendim nr. 03, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe është korrigjuar me Vendim nr. 3, datë 27.07.2022, të KKT-së, “Për miratimin e korrigjimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Sarandë, të miratuar me Vendim nr. 03, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, i rishikuar”.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit.

Lejet e ndërtimit, zhvillimit dhe përdorimit për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Sarandë, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2023**, ka pasur **708 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht: 77 aplikime për leje zhvillimi, 13 aplikime për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m², 31 aplikime për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m², 33 aplikime për çertifikata përdorimi, 2 aplikime për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, 507 aplikime për deklarata paraprake për kryerje punimesh dhe 18 aplikime për ndryshim funksioni, të evidentuara në tabelën e mëposhtme:

Tabelë: Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023-31.12.2023

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	77	40	37
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	13	13	0
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	31	31	0
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. deri në 250 m ²	9	9	0
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. më të madhe se 250 m ²	2	2	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	4	4	0

Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	1	1	0
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	507	141	366
Leje rind., rikonst. dhe ripar. të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndrysh. funk.	-	0	-
Çertifikatë përdorimi	33	7	26
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	2	1	1
Leje për ndryshim funksioni	18	17	1
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	0	0	0
Njoftim fillim punimesh	-	-	-
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	2	1	1
Leje infrastrukture	9	8	1

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (këtu e në vazhdim DPZHT) e Bashkisë Sarandë, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara më poshtë:

Tabelë – Rastet e audituara

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratar	Prevetivi
Leje ndërtimi				
1	Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	H. Ç. dhe M. M.	24.02.2023	61.014.007 lekë
2	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E.Group” ShPK	30.03.2023	90,554,781 lekë
3	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	“S. R. E. Group” ShPK	04.04.2023	94,582,204 lekë
4	Strukturë banimi 7 kate (1 kat parkim i hapur + 6 kate banim) dhe shërbime me 4 kate parkim nën tokë	“M. I.” ShPK	12.04.2023	182,815,762 lekë
5	Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë	“O. & A.” ShPK	28.04.2023	150,469,426 lekë
6	Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	L. Gj.	10.05.2023	54,008,307 lekë
7	Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	E. Ob.	17.05.2023	61,887,416 lekë
8	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S.-A.” ShPK	17.05.2023	46,691,186 lekë
9	Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S.-A.” ShPK	13.06.2023	99,773,546 lekë
10	Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group” ShPK	15.06.2023	71,173,318 lekë
11	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group” ShPK	15.06.2023	71,173,318 lekë
12	Objekt banimi 2 kat dhe 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë	E. D.	29.09.2023	58,325,640 lekë
Çertifikata përdorimi				
13	Godinë banimi dhe shërbimesh	L. P.	21.03.2023	-

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në lidhje me auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se në të gjitha rastet, pra në trembëdhjetë raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me zhvillues z. H. Ç. dhe z. M. M., miratuar në 24.02.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 71 ditësh pune;
- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik dhe raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon plani i piketimit të strukturës, plani i mbulimit me kuotat përkatëse në plan, kuotat në parapete, mbi elementet teknike, si dhe kullimet, fasadat teknike nuk janë të dimensionuara, si dhe mungojnë detaje të elementeve konstruktive të strukturës;
- Projekti konstruktiv nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna në lidhje me mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet (mure mbajtëse, pilota, palankola, etj.);
- Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungojnë planimetritë dhe detajet e lidhjes me rrjetin K.U.Z. të qytetit, plani i rrjetit për largimin e ujrave të shiut, planimetri dhe detaje të lidhjes me rrjetin K.U.B.;
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-prites;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqëruar (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetimi i NIPT-it);
- Dokumentat e pronësisë nuk janë ngarkuar të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Më konkretisht, kjo problematikë është evidentuar në kartelën e pasurisë së paluajtëshme dhe hartën treguese të saj. Rifreskimi i tyre është kryer në datën 15.03.2022 dhe 30.12.2021, ndërkohë që aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 21.11.2022;
- Dokumentat e pronësisë nuk janë të plota, pasi mungojnë çertifikata e pronësisë të dy prej bashkëpronarëve, më konkretisht, mungon çertifikata e pronësisë për znj. F. Ç., si bashkëpronar e gjysmës së pasurisë me nr. 15/701, Z.K. 8641, si dhe mungon çertifikata e pronësisë për z. H. Ç., si bashkëpronar gjysmës së pasurisë me nr. 15/300, Z.K. 8641;
- Mungon marrëveshja midis pronarëve të pronave me zhvilluesin;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG;

2. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv, ngrohje-ventilim, mbrojtjes nga zjarri, hidrosanitar, elektrik dhe raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje të elementeve konstruktive të strukturës, mungon një prerje teknike (nga dy që do të duhej të ishin), fasadat teknike nuk janë të dimensionuara, mungon projekti dhe detajet e pishinës;
- Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungojnë planimetritë dhe detajet e lidhjes me rrjetin K.U.Z. të qytetit, plani i rrjetit për largimin e ujrave të shiut, planimetri dhe detaje të lidhjes me rrjetin K.U.B.;
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-prites dhe detajet e instalimeve elektrike;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin

shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);

- Mungon projekti i mbrojtjes nga zjarri;

- Mungon licenca individuale e hartuesit të projektit të ngrohje-ventilim dhe hidrosanitar (z. S. K.), e hartuesit të projektit elektrik (z. S. H.), si dhe çertifikata e audituesit të efikasitetit të energjisë (z. A. N.);

- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit mekanik që ka hartuar projektin e ngrohje-ventilimit dhe hidrosanitar (z. S. K.);

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale e inxhinierit mekanik që ka hartuar projektin e ngrohje-ventilimit dhe hidrosanitar (z. S. K.), hartuesit të projektit elektrik (z. S. H.), si dhe hartuesit të raportit të efikasitetit të energjisë (z. A. N.);

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DWG;

- Dokumentat e pronësisë nuk janë të plotë, pasi mungon çertifikata e pronësisë të pronës me nr. 18/480, në pronësi të bashkëpronarëve me mbiemër M.;

- Preventivi i punimeve nuk është i plotë, pasi në të nuk janë cilësuar zërat ndërtimor të pishinës.

3. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me zhvillues “S. R. E. G” ShPK, miratuar në 04.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 227 ditësh pune;

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë;

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë plani i piketimit të strukturës, plani i mbulimit me kuotat përkatëse në plan dhe në parapete, mbi elementet teknike, si dhe kullimet, fasadat teknike nuk janë të dimensionuara, detaje të elementeve konstruktive të strukturës, si dhe mungon projekti dhe detajet e pishinës;

- Projekti konstruktiv nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna në lidhje me mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet;

- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);

- Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungojnë planimetritë dhe detajet e lidhjes me rrjetin K.U.Z. të qytetit, plani i rrjetit për largimin e ujrave të shiut, planimetri dhe detaje të lidhjes me rrjetin K.U.B.;

- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-prites;

- Mungon licenca individuale e hartuesit të projektit hidrosanitar (znj. L. D.);

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG;

- Preventivi i punimeve nuk është i plotë, pasi në të nuk janë cilësuar zërat ndërtimor të pishinës.

4. Leje ndërtimi për “Strukturë banimi 7 kate (1 kat parkim i hapur + 6 kate banim) dhe shërbime me 4 kate parkim nën tokë”, me zhvillues “M. I.” ShPK, miratuar në 12.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv, ngrohje-ftohje-ventilim, hidrosanitar, elektrik, si dhe raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë;

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e elementeve konstruktive të strukturës, fasadat teknike nuk janë të dimensionuara, gjithashtu pamjet tredimensionale nuk përputhen me projektin teknik;

- Projekti konstruktiv nuk është i plotë, pasi mungojnë plani i piketimit të kolonave dhe mureve në çdo kat, si dhe të dhëna në lidhje me mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);
- Mungon projekti i mbrojtjes nga zjarri;
- Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungojnë planimetritë dhe detajet e lidhjes me rrjetin K.U.Z. të qytetit, plani i rrjetit për largimin e ujrave të shiut, planimetri dhe detaje të lidhjes me rrjetin K.U.B., gjithashtu, të gjitha planimetritë teknike të këtij projekti nuk janë të dimensionuara;
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rufe-prites, skema elektrike e boksit të matjeve, si dhe detajet e instalimeve elektrike;
- Mungon licenca individuale e hartuesit të projektit konstruktiv dhe elektrik;
- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit konstruktor që ka hartuar projektin konstruktiv;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale e hartuesit të projektit konstruktiv dhe elektrik;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG;
- Mungon preventivi i punimeve;
- Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistemin *e-lejet*, më konkretisht nga detajet e aplikimit, marrim informacionin se vlera e parashikuar për kryerjen e punimeve është 182,815,762 lekë. Në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ‘Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit’, të ndryshuar”, pika 1, nën-pika b, ky objekt do të duhej të ishte pajisur me oponencë teknike të kryer nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, si ndërtim jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë.

5. Leje ndërtimi për “Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë”, me zhvillues “O. & A.” ShPK, miratuar në 28.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon plani i piketimit të strukturës, plani i organizimit të punimeve, plani i mbulimit me kuotat përkatëse në plan, kuotat në parapete, mbi elementet teknike, kullimet, detaje të elementeve konstruktivë të strukturës, si dhe mungon projekti dhe detajet e pishinës;
- Projekti konstruktiv nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna në lidhje me mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet (mure mbajtëse, pilota, palankola, etj.), si dhe plani i piketimit të kullonave dhe mureve b/a në çdo kat;
- Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungojnë planimetritë dhe detajet e lidhjes me rrjetin K.U.Z. të qytetit, plani i rrjetit për largimin e ujrave të shiut, planimetri dhe detaje të lidhjes me rrjetin K.U.B.;
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rufe-prites;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);
- Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë është jashtë afatit të mbulimit, pra jo-e vlefshme, pasi aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 14.02.2023, ndërsa polica është e vlefshme deri në datën 24.01.2023;

- Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistemin *e-lejet*, më konkretisht nga preventivi i punimeve, marrim informacionin se vlera e parashikuar për kryerjen e punimeve është 150,469,426 lekë. Në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ‘Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit’, të ndryshuar”, pika 1, nënpika b, ky objekt do të duhej të ishte pajisur me oponencë teknike të kryer nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, si ndërtim jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;
- Dokumentat e pronësisë nuk janë ngarkuar të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Më konkretisht, kjo problematikë është evidentuar në kartelën e pasurisë së paluajtëshme dhe hartën treguese të saj. Rifreskimi i tyre është kryer në datën 18.08.2022 dhe 06.10.2022, ndërkohë që aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 14.02.2023;
- Preventivi i punimeve nuk është i plotë, pasi në të nuk janë cilësuar zërat ndërtimor të pishinës;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG.

6. Leje ndërtimi për “Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues L. Gj., miratuar në 10.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejkgjatura prej 118 ditësh pune;
- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv, mbrojtjes nga zjarri, hidrosanitar dhe raportit të auditimit të efencës së energjisë;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon projekti dhe detajet e pishinës;
- Mungon projekti konstruktiv;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);
- Mungon projekti elektrik;
- Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit të ngrohje-ventilim është jashtë afatit të mbulimit, pra jo-e vlefshme, pasi aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 01.11.2022, ndërsa polica është e vlefshme deri në datën 04.10.2022;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit të mbrojtjes nga zjarri, projektit hidrosanitar dhe raportit të auditimit të efencës së energjisë;
- Preventivi i punimeve nuk është i plotë, pasi në të nuk janë cilësuar zërat ndërtimor të pishinës;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG.

7. Leje ndërtimi për “Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues E. O., miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv, ngrohje-ftohje-ventilim, hidrosanitar dhe raportit të auditimit të efencës së energjisë;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje të elementeve konstruktivë të strukturës;
- Mungon licenca profesionale e hartuesit të projektit konstruktiv, mungon licenca personale profesionale e hartuesit të ngrohje-ftohje-ventilim dhe hidrosanitar;
- Për projektin e ngrohje-ftohje-ventilim dhe hidrosanitar nuk është e qartë se cili është hartuesi i projektit, pasi licenca profesionale e subjektit “6. P.” (pjesë e të cilit janë z. S. K. dhe znj. E. M.) dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale janë nënshkruar elektronikisht nga z. S. K., ndërsa projekti teknik dhe relacioni shoqërues janë nënshkruar nga znj. E. M.. Znj. E. M. është në

cilësinë e aplikuesit, gjithashtu ka hartuar projektin arkitektonik dhe të mbrojtjes nga zjarri. Në dokumentacionin e ngarkuar për projektet e sipërcituar, nuk është konstatuar në asnjë nga pikat e licencës së znj. M. gëzon të drejtën e hartimit të projekteve mekanike. Marrja në konsideratë e projekteve të nënshkruar elektronikisht nga persona të tjerë dhe jo nga hartuesit respektivë nuk është në përputhje me nenin 26 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 5;

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit konstruktiv, ndërsa për hartuesin e projektit elektrik është jashtë afatit të mbulimit, pra jo-e vlefshme, pasi aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 01.05.2023, ndërsa polica është e vlefshme deri në datën 19.01.2023;

- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit mekanik që ka hartuar projektin e ngrohje-ftohje-ventilimit dhe hidrosanitar;

- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-prites dhe detajet e instalimeve elektrike;

- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqëruar (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);

- Mungon projekti hidraulik;

- Dokumentat e pronësisë nuk janë ngarkuar të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Më konkretisht, kjo problematikë është evidentuar në kartelën e pasurisë së paluajtëshme dhe hartën treguese të saj. Rifreskimi i tyre është kryer në datën 09.11.2021, ndërkohë që aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 01.05.2023;

- Mungon projekti arkitektonik në formatin DĒG.

8. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “S.-A.” ShPK, miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv dhe raportit të auditimit të efencës së energjisë;

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje të elementeve konstruktivë të strukturës dhe një prerje teknike (është ngarkuar vetëm një prerje teknike, ndërkohë që duhet të ishin dy të tilla), mungon projekti dhe detajet e pishinës;

- Mungon licenca profesionale e hartuesit të projektit konstruktiv, mungon licenca personale profesionale e hartuesit të ngrohje-ftohje-ventilim dhe hidrosanitar;

- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-prites dhe detajet e instalimeve elektrike;

- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqëruar (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);

- Projekti ndërtimor nuk është i plotë, pasi në asnjë prej projekteve përbërës të tij nuk jepen të dhëna në lidhje me pishinën;

- Dokumentat e pronësisë nuk janë ngarkuar të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Më konkretisht, kjo problematikë është evidentuar në kartelën e pasurisë së paluajtëshme dhe hartën treguese të saj. Rifreskimi i tyre është kryer në datën 17.11.2022, ndërkohë që aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në

datën 28.03.2023;

- Preventivi i punimeve nuk është i plotë, pasi në të nuk janë cilësuar zërat ndërtimor të pishinës;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG;

9. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “S.-A.” ShPK, miratuar në 13.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv, ngrohje-ftohje-ventilim, hidrosanitar, elektrik dhe raportit të auditimit të efencës së energjisë;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje të elementeve konstruktivë të strukturës një prerje teknike (është ngarkuar vetëm një prerje teknike, ndërkohë që duhet të ishin dy të tilla) dhe projekti dhe detajet e pishinës;
- Mungon licenca profesionale e hartuesit të projektit konstruktiv dhe elektrik, mungon licenca personale profesionale e hartuesit të ngrohje-ftohje-ventilim dhe hidrosanitar;
- Projekti konstruktiv nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna në lidhje me mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet (mure mbajtëse, pilota, palankola, etj.);
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-prites dhe detajet e instalimeve elektrike;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);
- Projekti ndërtimor nuk është i plotë, pasi në asnjë prej projekteve përbërës të tij nuk jepen të dhëna në lidhje me pishinën;
- Dokumentat e pronësisë nuk janë ngarkuar të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime, për dy prej tre pasurive të vendosura në dispozicion të zhvillimit. Më konkretisht, kjo problematikë është evidentuar në kartelat e pasurive të paluajtëshme dhe hartat treguese të tyre, për pasuritë me nr. 27/515 dhe 27/516, ZK 8642. Rifreskimi i tyre është kryer në datën 02.09.2022, ndërkohë që aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 13.03.2023;
- Preventivi i punimeve nuk është i plotë, pasi në të nuk janë cilësuar zërat ndërtimor të pishinës;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG.

10. Leje ndërtimi për “Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv, ngrohje-ftohje-ventilim, hidrosanitar, elektrik dhe raportit të auditimit të efencës së energjisë;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje të elementeve konstruktivë të strukturës, projekti dhe detajet e pishinës;
- Mungon licenca personale profesionale e hartuesit të ngrohje-ftohje-ventilim dhe hidrosanitar, si dhe e hartuesit të projektit elektrik;
- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e hartuesit të projektit elektrik;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale e hartuesit të projektit elektrik (z. S. H.);
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-prites dhe detajet e instalimeve elektrike;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);

- Dokumentat e pronësisë nuk janë ngarkuar të plota dhe të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Më konkretisht, kjo problematikë është evidentuar në dokumentat e pronësisë të të dyja parcelave që marrim pjesë në zhvillim. Nuk janë ngarkuar kartelat e pasurive të paluajtëshme për asnjë nga pronat, si pjesë e dokumentacionit të pronësisë. Në hartën treguese të pasurisë me nr. 23/440, data e rifreskimit të saj nuk është e lexueshme, ndërsa në hartën treguese të pasurisë me nr. 23/440, data e rifreskimit është 13.11.2021, ndërkohë që aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 11.05.2023;
- Mungon marrëveshja midis palëve për zhvillimin e objekteve fqinje me faqe kallkan. Objekti në zhvillim është propozuar me faqe kallkan në fasadën jugore. Në sistemin elektronik të lejeve nuk është ngarkuar marrëveshja me zotëruesin e pasurisë nr. 23/155;
- Preventivi i punimeve nuk është i plotë, pasi në të nuk janë cilësuar zërat ndërtimor të pishinës;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG.

11. Leje ndërtimi për “Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon certifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv, ngrohje-ftohje-ventilim, hidrosanitar, elektrik dhe raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje të elementeve konstruktive të strukturës, projekti dhe detajet e pishinës;
- Mungon licenca personale profesionale e hartuesit të ngrohje-ftohje-ventilim dhe hidrosanitar, si dhe e hartuesit të projektit elektrik;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale e hartuesit të projektit konstruktiv dhe elektrik;
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë detajet e montimit të sistemit rrufe-prites dhe detajet e instalimeve elektrike;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqëruar (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);
- Dokumentat e pronësisë nuk janë ngarkuar të plota dhe të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Më konkretisht, kjo problematikë është evidentuar në dokumentat e pronësisë të të dyja parcelave që marrim pjesë në zhvillim. Kartelat e pasurive të paluajtëshme janë rifreskuar në datat 28.02.2022 (për pasurinë me nr. 23/436) dhe 30.06.2021 (për pasurinë me nr. 23/464), ndërkohë që aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është kryer në datën 14.05.2023;
- Mungon marrëveshja midis palëve për zhvillimin e objekteve fqinje me faqe kallkan. Objekti në zhvillim është propozuar me faqe kallkan në fasadën veriore. Në sistemin elektronik të lejeve nuk është ngarkuar marrëveshja me zotëruesin e pasurisë nr. 23/150;
- Preventivi i punimeve nuk është i plotë, pasi në të nuk janë cilësuar zërat ndërtimor të pishinës;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG;

12. Leje ndërtimi për “Objekt banimi 2 kat dhe 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues znj. E. D., miratuar në 29.09.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejkëqitura prej 189 ditësh pune;
- Mungon certifikata e regjistrimit në QKB për hartuesin e projektit konstruktiv, elektrik dhe raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë;

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon një prej prerjeve;
- Projekti konstruktiv nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna në lidhje me mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet (mure mbajtëse, pilota, palankola, etj.), relacioni teknik shpjegues dhe llogaritjet përkatëse;
- Mungon licenca individuale e ekspertit zjarrëfikës;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale e hartuesit të projektit ngrohje-ftohje-ventilimit, mbrojtjes nga zjarri, hidrosanitar dhe elektrik;
- Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungojnë planimetritë, skema dhe detajet e lidhjes me rrjetin K.U.Z. të qytetit, plani i rrjetit për largimin e ujrave të shiut, planimetri dhe detaje të lidhjes me rrjetin K.U.B.;
- Projekti elektrik nuk është i plotë, pasi mungojnë plani i ndriçimit, plani i prizave të secilit kat, i telefonisë, televizionit, citofonisë, plani i furnizimit, për secilin kat, detajet e montimit të rufepritëses dhe detajet e instalimeve elektrike;
- Mungon studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqëruar (deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale, licenca individuale e hartuesit, vërtetim i NIPT-it);
- Dokumentat e pronësisë nuk janë ngarkuar të plota dhe të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Më konkretisht, kjo problematikë është evidentuar në mungesën e kartelës së pasurisë së paluajtëshme, si pjesë përbërëse e dokumentacionit të pronësisë, referuar përcaktimeve të nenit 17 të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, pika 4;
- Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG.

13. Çertifikata përdorimi për “Godinë banimi dhe shërbimesh”, me zhvillues z. L. P., miratuar në 21.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 509 ditësh pune;
- Mungon licenca e kolaudatorit, brenda afatit të vlefshmërisë, e cila duhet të ishte e bashkëlidhur me kontratën midis zhvilluesit dhe kolaudatorit;
- Mungon kontrata me mbikëqyrësin e punimeve, si dhe licenca e tij, brenda afatit të vlefshmërisë, e cila duhet të ishte e bashkëlidhur me kontratën midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve;
- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane;
- Mungon situacioni përfundimtar i kryerjes së punimeve;
- Mungon projekti ‘as-built’. Duke qenë se projekti i zbatuar ka ndryshime të dukshme nga projekti i miratuar, projekti as-built do të ishte i nevojshëm për të llogaritur diferencën e sipërfaqeve, nëse kjo vlerë do të ishte më e madhe se 1% e sipërfaqes totale ose jo, në zbatim të përcaktimeve të nenit 27 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1;
- Mungon çertifikata përfundimtare e auditimit të efikasitetit të energjisë, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e nenit 16 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar, pika 5, nën-pika b), ku citohet se auditimet energjetike të detyrueshme kryhen çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm;
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve.

Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe

Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 44, pika 2; Ligjin nr. 124/2015 “Për eficientë e energjisë”, i ndryshuar, pika 5, nënpika b); Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, neni 54; VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b), ç), dh), e), ë), g); pika 1/1, nënpika i), ii), iii), iv); neni 20; neni 21; neni 26, pika 5; neni 27/2, pika 1, nënpika c), d), e), ë), g), gj), l); neni 34, pika 6; VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”, shtojca 2.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. P.**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 1 - 12);
- **Z. P. Zh.**, në cilësinë e ish - drejtorit të DPZHT (për rastet 3, 13);
- **Z. H. K.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastet 1, 2, 4; 6 - 11);
- **Z. A. B.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastet 3, 13);
- **Z. T. H.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastet 12, 13);

(Gjerësisht, problemet mbi shkeljet e konstatuara në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 7, dorëzuar në protokoll, në Bashkinë Sarandë)

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në njëmbëdhjetë raste, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, si janë distancat urbane (nga objektet kufitare – 5 raste; nga kufiri i pronës – 3 raste; nga trupi i rrugës – 3 raste); lartësia maksimale e lejuar e katit përdhe (1 rast); lartësia maksimale e lejuar e objektit (1 rast); numri minimal i lejuar i vendparkimeve (5 raste); intensiteti maksimal i lejuar (9 raste); koeficienti i lejuar i shfrytëzimit të territorit (2 raste); objekti i miratuar del jashtë kufirit të pronësisë (1 rast); aksesimi për në pronë kryhet mbi një pronë mbi të cilën nuk ka asnjë informacion (1 rast). Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për **“Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me zhvillues z. H. Ç. dhe z. M. M., miratuar në 24.02.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton lartësinë e katit përdhe me përdorim shërbim, pasi në nenin 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3, nënpika c), përcaktohet se lartësia minimale e lejuar dysHEME-dysHEME për hapësirat me përdorim ‘shërbim’ është 4.00 m. Lartësia faktike e katit përdhe (me përdorim shërbim) është **3.74 m**;

- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve, të parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor. Referuar nenit 44 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për hapësirat e banimit është 1 vend-parkim / apartament, ndërsa për hapësirat e shërbimit është 1 vend-parkim / 50 - 100 m². Referuar këtyre përcaktimve dhe llogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, ku rezultojnë se numri total i apartamenteve është 14, dhe sipërfaqja me funksion shërbim është 333 m², shprehemi se numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 18. Numri faktik i vend-parkimeve është **8**;

- Objekti i miratuar del jashtë kufirit të pronësisë në katet nëntokësore, duke shkelur kështu një nga kriteret dhe të drejtat kryesore, atë mbi pronësinë. Këto veprime nuk janë në përputhje me nenin 1 të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika d).

Sipërfaqja që del jashtë kufirit të pronësisë ndodhet në katin nëntokë dhe është rreth 10.7 m².

2. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 2.5. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se $I_{faktike} = 3.62$ (e përlllogaritur sipas formulës: 3421 m^2 të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës / 944 m^2). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përftuar më shumë se ajo e lejuar është **1061 m²**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 37 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1.

3. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me zhvillues “S. R. E. G” ShPK, miratuar në 04.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 2.2. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se $I_{faktike} = 2.417$ (e përlllogaritur sipas formulës: 2151.2 m^2 të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës / 890 m^2). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përftuar më shumë se ajo e lejuar është **193 m²**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 37 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1. Kjo diferencë ka ardhur si rrjedhojë e shmangies nga llogaritja e intensitetit të sipërfaqeve të ballokoneve, kur në fakt, të vetmet sipërfaqe që nuk llogariten në intensitetin e objektit janë verandat dhe sipërfaqet e shfrytëzueshme të hapura, që përftohen nga tërheqja e volumeve si pasojë e distancave dhe/ose arkitekturës.

- Nuk respekton distancat nga kufiri i pronës në fasadën jug-lindore. Kjo fasadë ka çarje të ndryshme, si dritare dhe ballkone. Si e tillë, nuk konsiderohet ‘faqe kallkan’. Distanca faktike që kjo fasadë do të duhej të ruante nga kufiri jug-lindor, llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1 (d= nr.k +1m, ku: d – distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr.k – numri i kateve). Distanca e miratuar nga kufiri i pronës është **0.13 m**. Distanca minimale e lejuar nga kufiri i pronës është **7 m**.

- Nuk respekton distancat nga kufiri i pronës në fasadën veri-perëndimore. Fasada veri-perëndimore e objektit në zhvillim ka çarje në formë llozhash, për këtë arsye nuk mund të konsiderohet ‘faqe kallkan’. Si rrjedhojë do të duhej të kishte respektuar përcaktimet e nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1. Distanca e miratuar nga kufiri i pronës është **1 m**. Distanca minimale e lejuar nga kufiri i pronës është **7 m**;

- Nuk respekton distancat nga objektet kufitare në pjesën veriore dhe atë jugore. Dy objektet fqinje të objektit të miratuar kanë çarje në fasadat respektive. Distanca e miratuar nga objekti 7 katësh në veri është 12.5 m, ndërkohë që do të duhej të ishte **15 m.**, e llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2 (d = nr.k obj.A + nr.k obj.B +2m, ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve; nr.k - numri i kateve). Distanca e miratuar nga objekti 5 katësh në jug është 2.2 m, ndërkohë që do të duhej të ishte **13 m**. Mosrespektimi i këtyre distancave nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 14, ku citohet: “Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis

ndërtimeve”.

5. Leje ndërtimi për **“Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë”**, me zhvillues “O. & A.” ShPK, miratuar në 28.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton distancat nga objektet kufitare në pjesën lindore dhe perëndimore. Dy objektet fqinje të objekteti të miratuar kanë çarje në fasadat respektive. Distanca e miratuar nga objekti 11 katësh në lindje është 6.7 m (për seksionin 4 katësh) dhe 8.8 m (për seksionin 6 katësh), ndërkohë që do të duhej të ishte **17 m** (për seksionin 4 katësh) dhe **19 m** (për seksionin 6 katësh), e llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2 (d = nr.k obj.A + nr.k obj.B +2m, ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve; nr.k - numri i kateve). Distanca e miratuar nga objekti 6 katësh në perëndim është 7 m (për seksionin 4 katësh) dhe 8 m (për seksionin 6 katësh), ndërkohë që do të duhej të ishte 12 m (për seksionin 4 katësh) dhe 14 m (për seksionin 6 katësh). Mosrespektimi i këtyre distancave nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 14, ku citohet: “Pavarësisht sa përcaktohet në këtë nen, hapësirat që krijohen nga distancat duhet të jenë të tilla që për çdo ndërtim të sigurohet akses i drejtpërdrejtë nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në të paktën 2 faqe të ndërtimit dhe midis ndërtimeve”.

- Koeficienti i Shfrytëzimit të Territorit (KSHT) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 50%. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se **KSHT_{faktike} = 51.3%** (e përlllogaritur sipas formulës: 580 m² të ndërtuar në katin përdhe / 1130 m²). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 36 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1;

- Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 2.5. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se **I_{faktike} = 3** (e përlllogaritur sipas formulës: 3410 m² të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës / 1130 m²). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përftuar më shumë se ajo e lejuar është **585 m²**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 37 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1.

6. Leje ndërtimi për **“Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues L. Gj., miratuar në 10.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton distancat nga objekti kufitar në pjesën veriore. Distanca e miratuar nga objekti 9 katësh në veri është 10.1 m, ndërkohë që do të duhej të ishte **17 m**, e llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2 (d = nr.k obj.A + nr.k obj.B +2m, ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve; nr.k - numri i kateve);

- Aksesit për në pronë kryhet mbi një pasuri për të cilën nuk ka asnjë informacion mbi poseduesin ose dakordësi për dhënien e të drejtës së kalimit. Pasuria në zhvillim, me nr. pasurie 8/259, ZK 8642, ndahet nga rruga nga pasuria me nr. 8/58, për të cilën nuk është dhënë asnjë informacion në lidhje me poseduesin e saj ose dhënien e dakordësisë nga ana e këtij të fundit, si do të ishte marrëveshja për servitut kalimi, kjo jo në përputhje me nenin 14 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2.

7. Leje ndërtimi për **“Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues E.O., miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 2.5. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se **I_{faktike} = 3.1** (e përlllogaritur

sipas formulës: 1583 m^2 të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës / 500 m^2). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përftuar më shumë se ajo e lejuar është 333 m^2 . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 37 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1;

- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve, të parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor. Referuar nenit 44 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për hapësirat e banimit është 1 vend-parkim / apartament, ndërsa për hapësirat e shërbimit është 1 vend-parkim / $50 - 100 \text{ m}^2$. Referuar këtyre përcaktimve dhe llogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, ku rezulton se numri total i apartamenteve është 15, dhe sipërfaqja me funksion shërbim është 208 m^2 , shprehemi se numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 18. Numri faktik i vend-parkimeve është **8**.

8. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “S.-A.” ShPK, miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 2.5. Nga përllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se $I_{\text{faktike}} = 2.92$ (e përllogaritur sipas formulës: 1113 m^2 të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës / 381 m^2). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përftuar më shumë se ajo e lejuar është $160,5 \text{ m}^2$. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 37 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1;

- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve, të parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor. Referuar nenit 44 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për hapësirat e banimit është 1 vend-parkim / apartament. Referuar këtyre përcaktimve dhe llogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, ku rezulton se numri total i apartamenteve është 17, shprehemi se numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 17. Numri faktik i vend-parkimeve është **7**;

- Nuk respekton distancat nga trupi i rrugës. Referuar përcaktimeve të nenit 36 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3, nënpika b), marrim informacionin se distanca që objektet duhet të respektojnë nga rruga, për gjerësi rruge, përfshirë trotualet, 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) metra, është 3 (tre) metra. Distanca e miratuar nga trupi i rrugës është **1.4 metra**.

9. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “S.-A.” ShPK, miratuar në 13.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve, të parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor. Referuar nenit 44 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për hapësirat e banimit është 1 vend-parkim / apartament. Referuar këtyre përcaktimve dhe llogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, ku rezulton se numri total i apartamenteve është 28, shprehemi se numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 28. Numri faktik i vend-parkimeve është **8**.

10. Leje ndërtimi për “Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 2.6. Nga përllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se $I_{\text{faktike}} = 2.87$ (e përllogaritur sipas formulës: 2159 m^2 të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës / 752.1 m^2). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përftuar më shumë se ajo e lejuar është 203.5 m^2 . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 37 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1;

- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve, të parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor. Referuar nenit 44 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për hapësirat e banimit është 1 vend-parkim / apartament. Referuar këtyre përcaktimve dhe llogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, ku rezulton se numri total i apartamenteve është 24, shprehemi se numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 24. Numri faktik i vend-parkimeve është **13**;
- Nuk respekton distancat urbane nga kufiri jugor i pronës. Objekti në zhvillim është propozuar me faqe kallkan në fasadën jugore. Në sistemin elektronik të lejeve nuk është ngarkuar marrëveshja me zotëruesin e pasurisë nr. 23/155, që të vërtetonte dhënien e dakordësisë së këtij të fundit. Distanca që objekti do të duhej të ruante nga kufiri jugor në kushtet e mosmarrjes së dakordësisë nga kufitari dhe në kushtet e zhvillimit të objektit me faqe kallkan, do të ishte minimalisht 1 m. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 4;
- Nuk respekton distancat nga trupi i rrugës. Referuar përcaktimeve të nenit 36 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3, nënpika b), marrim informacionin se distanca që objektet duhet të respektojnë nga rruga, për gjerësi rruge, përfshirë trotuaret, 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) metra, është 3 (tre) metra. Distanca e miratuar nga trupi i rrugës është **1.3 metra**.

11. Leje ndërtimi për “Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 2.6. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se $I_{faktike} = 2.77$ (e përlllogaritur sipas formulës: 2254 m^2 të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës / 812.5 m^2). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përfutur më shumë se ajo e lejuar është **141.5 m²**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 37 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1;
- Koeficienti i Shfrytëzimit të Territorit (KSHT) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 40%. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se $KSHT_{faktike} = 41.3\%$ (e përlllogaritur sipas formulës: 336 m^2 të ndërtuar në katin përdhe / 812.5 m^2). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore në katin përdhe të përfutur më shumë se ajo e lejuar është **11 m²**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 36 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1;
- Nuk respekton distancat urbane nga kufiri verior i pronës. Objekti në zhvillim është propozuar me faqe kallkan në fasadën veriore. Në sistemin elektronik të lejeve nuk është ngarkuar marrëveshja me zotëruesin e pasurisë nr. 23/150, që të vërtetonte dhënien e dakordësisë së këtij të fundit. Distanca që objekti do të duhej të ruante nga kufiri jugor në kushtet e mosmarrjes së dakordësisë nga kufitari dhe në kushtet e zhvillimit të objektit me faqe kallkan, do të ishte minimalisht 1 m. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 4;
- Nuk respekton distancat nga trupi i rrugës. Referuar përcaktimeve të nenit 36 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3, nënpika b), marrim informacionin se distanca që objektet duhet të respektojnë nga rruga, për gjerësi rruge, përfshirë trotuaret, 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) metra, është 3 (tre) metra. Distanca e miratuar nga trupi i rrugës është **1 metër**;
- Nuk respekton distancat nga objekti kufitar në pjesën perëndimore. Objekti fqinj me objektin e miratuar kanë çarje në fasadat respektive. Distanca e miratuar nga objekti 5 katësh në perëndim

është 10 m, ndërkohë që do të duhej të ishte **13 m.**, e llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2 (d = nr.k obj.A + nr.k obj.B +2m, ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve; nr.k - numri i kateve). Distanca e miratuar nga objekti 5 katësh në jug është 2.2 m, ndërkohë që do të duhej të ishte 13 m.

12. Leje ndërtimi për “**Objekt banimi 2 kat dhe 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë**”, me zhvillues znj. E. D., miratuar në 29.09.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 1.8. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se **I_{faktike} = 2.1** (e përlllogaritur sipas formulës: 978 m² të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës / 463.7 m²). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përfutur më shumë se ajo e lejuar është **139 m²**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 37 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Sarandë, pika 1;

- Nuk respekton distancat urbane nga objekti në lindje. Referuar përcaktimeve të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 2, marrim informacionin se distanca që objektet fqinje duhet të respektojnë llogaritet sipas formulës ‘d = nr.k obj.A + nr.k obj.B +2m’, ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve dhe nr.k - numri i kateve. Distanca që objektet duhet të respektonin nga njëri-tjetri është 7 metra. Distanca e miratuar është **6.4 metra**;

- Nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar, e matur me numër katesh. Referuar përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Sarandë, më konkretisht tabelës së të dhënave urbane të njësisë strukturore SA.UB.8.308, marrim informacionin se lartësia maksimale e lejuar, e matur me numër katesh, është 4 kate. Referuar auditimit të ushtruar mbi projektin ndërtimor (prerjet teknike), si dhe përcaktimeve të nenit 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënika c); pika 2; pika 3, nënpika b); është konstatuar se lartësia e objektit në fasadën perëndimore është **5 kate**, edhe jo 4 kate, si është specifikuar në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-lejet.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. P.**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 1 – 3; 4 - 12);
- **Z. P. Zh.**, në cilësinë e ish - drejtorit të DPZHT (për rastet 3, 13);
- **Z. H. K.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastet 1, 2; 6 - 11);
- **Z. A. B.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastet 3, 13);
- **Z. T. H.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastet 12, 13);

(Gjerësisht, problemet mbi shkeljet e konstatuara në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 7, dorëzuar në protokoll, në Bashkinë Sarandë)

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në katër raste, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (këtu e në vazhdim DKZHT) e Bashkisë Sarandë nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6, DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Gjithashtu, në dispozitat nënligjore të sipërcituara, specifikohet gjithashtu se

informacioni, që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

- Në të gjitha rastet, pra në dymbëdhjetë raste, leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat rregullatorë të sipërcituara shprehet qartësisht se informacioni, që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën;

- Në dhjetë raste (për rastet 1 – 4; 6 – 11, referuar tabelës së procedurave të audituara) nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Rajonale të Ujësjetës – Kanalizime;

- Për lejen e ndërtimit **“Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023, nuk është respektuar mendimi i Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, e cila nuk e ka miratuar aplikimin, si dhe është shprehur se aplikanti duhet të plotësojë dokumentacionin me: *“1.Projektin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH); 2.Lejen për ushtrimin e profesionit “Ekspert privat zjarrfikës” nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së”*. Edhe pse në këto kushte, ky aplikim është miratuar nga DPZHT, Bashkia Sarandë;

- Për lejen e ndërtimit **“Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues L. Gj., miratuar në 10.05.2023, nuk është respektuar mendimi i AZHT, si dhe leja e ndërtimit është miratuar pa marrë miratim nga ky autoritet. AZHT, me anë të shkresës me nr. 358 prot; datë 19.01.2023, i është drejtuar aplikantit duke kërkuar, ndër të tjera, edhe përmirësimin e plotë të projektit arkitektonik në përputhje me tipologjinë e objektit. Asnjë ndryshim nuk është reflektuar në projektin arkitektonik / ndërtimor, përveç eliminimit të dritareve në faqet kallkan. Gjithashtu, nuk është respektuar mendimi i OSHEE, e cila është shprehur me anë të shkresës me nr. 14 prot; datë 10.01.2023, se zhvillimi i këtij objekti paraqet problem për rrjetin e shpërndarjes dhe linjave 20 KV, 10 KV, 6 KV, 0.4 KV, që administrohen prej OSSH. Edhe pse në këto kushte, Bashkia Sarandë ka vazhduar me miratimin e lejes së ndërtimit;

- Për lejen e ndërtimit **“Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues E. O., miratuar në 17.05.2023, nuk është ri-kërkuar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, e cila në mendim-dhënien e saj është shprehur se *“... është në proces shqyrtimi për Procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.”*

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. P.**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 1 - 12);
- **Z. P. Zh.**, në cilësinë e ish - drejtorit të DPZHT (për rastin 3);
- **Z. H. K.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastet 1, 2, 4; 6 - 11);
- **Z. A. B.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastin 3);
- **Z. T. H.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastin 12);

(Gjerësisht, problemet mbi shkeljet e konstatuara në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 7, dorëzuar në protokoll, në Bashkinë Sarandë)

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në të gjitha rastet, pra në dymbëdhjetë raste, Zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin “Njoftim për fillimin e punimeve”. “Njoftimi për fillimin e punimeve” është dokumenti që jepet pas marrjes së sigurisë se zhvilluesi ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe kushtet e nevojshme për të filluar punimet. Gjithashtu, ky dokument shënon datën e saktë të fillimit të punimeve, referuar së cilës llogaritet respektimi ose jo i grafikut të punimeve dhe afatit të përfundimit të punimeve. Duke iu referuar pikës 8 të dokumentit të lejes së ndërtimit, si dhe nenit 40 të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 1, afati për fillimin e punimeve është një vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit. Kjo problematikë është evidentuar në rastet e mëposhtme:

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar
1	Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	H. Ç. dhe M. M.	24.02.2023
2	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E. Group” ShPK	30.03.2023
3	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	“S. R. E. Group” ShPK	04.04.2023
4	Strukturë banimi 7 kate (1 kat parkim i hapur + 6 kate banim) dhe shërbime me 4 kate parkim nën tokë	“M. I.” ShPK	12.04.2023
5	Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë	“O. & A.” ShPK	28.04.2023
6	Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	L. Gj.	10.05.2023
7	Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	E. O.	17.05.2023
8	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.” ShPK	17.05.2023
9	Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.” ShPK	13.06.2023
10	Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group” ShPK	15.06.2023
11	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group” ShPK	15.06.2023
12	Objekt banimi 2 kat dhe 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë	E. D.	29.09.2023

Për rastet 1 – 5, referuar tabelës së mësipërme, ndërtimi i objektit ka filluar në mungesë të dokumentit “Njoftim për fillimin e punimeve”.

Gjithashtu, për çertifikatën e përdorimit të miratuar me Vendim Nr. 4, datë 21.03.2023, të Kryetarit të Bashkisë Sarandë për objektin **“Godinë banimi dhe shërbimesh”**, me adresë në Sarandë, me subjekt zhvillues z. L. P. dhe subjekt ndërtues shoqëria “A.” ShPK, nga auditimi i ushtruar mbi projektin ndërtimor të objektit të ndërtuar, krahasuar kjo me fotot e objektit në të gjitha drejtimet janë konstatuar ndryshime, si janë:

- Çarje në pjesën e sipërme të muraturës së katit përdhe, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në projekt, por janë realizuar;
- Ballkoni perimetral në katin e parë, i cili nuk ka qenë i parashikuara në projekt, por është realizuar;
- Mbulesa me çati me tjegulla e ballkonit në katin e fundit, e cila nuk ka qenë e parashikuara në projekt, por është realizuar;
- Nuk është realizuar ballkoni perimetral në katin e fundit, i cili ka qenë i parashikuar në projekt dhe nuk është realizuar.

Në praktikën e ngarkuar në sistemin *e-lejet* nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë miratimin e këtyre ndryshimeve, si do të ishte leja e ndërtimit për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, ose kopje e gjobës së vendosur nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 42 të Ligjit 107/2014, “Për planifikimin e zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1.

Për lejimin e fillimit të punimeve në kushtet e mungesës së dokumentit të miratuar “Njoftim për Fillimin e Punimeve”, ngarkohet me përgjegjësi:

- **Z. A. M.**, në cilësinë e kryeinspektorit të IMTV (për rastet 1, 2, 3, 4, 5).

Për miratimin e certifikatës së përdorimit, si dhe vlerësimit pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi:

- **Z. P. Zh.**, në cilësinë e drejtorit të DPKZHT;

- **Z. T. H.**, në cilësinë e nëpunësit të DPKZHT;

- **Z. A. B.**, në cilësinë e specialistit DPKZHT;

(Gjerësisht, problemet mbi shkeljet e konstatuara në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 7, dorëzuar në protokoll, në Bashkinë Sarandë)

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tetë raste, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur e saktë. Referuar nenit 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se: “Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.”, si dhe pika 2: “Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror”. Çmimi mesatar referues i shitblerjes në qytetin e Sarandës është 56.000 lekë/m². Bashkia Sarandë aplikon dy lloje të ndryshme përqindjesh, 4% dhe 6%, sipas hartës së zonave fiskale. Kjo problematikë është evidentuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me zhvillues z. H. Ç. dhe z. M. M., miratuar në 24.02.2023, me problematika si më poshtë vijon:

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përlllogaritja e TNI-së, e kryer nga grupi i auditimit:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	285	56,000 lekë/m ²	6%	0.7	670,320 lekë
Shërbim	333	56,000 lekë/m ²	6%	1.5	1,678,320 lekë
Banim	1742	56,000 lekë/m ²	6%	1	5,833,120 lekë
TOTALI					8,201,760 lekë

Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **7,241,136 lekë**. Diferenca prej **960,624 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

2. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përlllogaritja e TNI-së, e kryer nga grupi i auditimit:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	1356	56,000 lekë/m ²	6%	0.7	3,189,312 lekë
Banim	2950	56,000 lekë/m ²	6%	1	9,912,000 lekë

TOTALI	13,101,312 lekë
---------------	------------------------

Vlera e TNI-së e përlogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **8,157,632 lekë**. Diferenca prej **4,943,680 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë. Gjithashtu, kësaj vlere do të duhej t'i ishte shtuar gjashtë për qind e vlerës së preventivuar të ndërtimit të pishinës, vlerë e cila nuk është pjesë e preventivit të punimeve, dhe për këtë arsye nuk mund të llogaritet nga grupi i auditimit.

3. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me zhvillues “S. R. E. G” ShPK, miratuar në 04.04.2023, me problematika si më poshtë vijon: Kjo taksë është llogaritur e saktë vetëm për objektin, por kësaj vlere do të duhej t'i ishte shtuar gjashtë për qind e vlerës së preventivuar të ndërtimit të pishinës, vlerë e cila nuk është pjesë e preventivit të punimeve, dhe për këtë arsye nuk mund të llogaritet nga grupi i auditimit. Pishina është pjesë e investimit, si e tillë, referuar përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për **“Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”**, i ndryshuar, pika 1, do të duhej të ishte bërë pjesë e vlerës totale të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

5. Leje ndërtimi për **“Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë”**, me zhvillues “O. & A.” ShPK, miratuar në 28.04.2023, me problematika si më poshtë vijon: Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përlogaritja e TNI-së, e kryer nga grupi i auditimit:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	1614	56,000 lekë/m ²	6%	0.7	3,796,128 lekë
Banim	3643	56,000 lekë/m ²	6%	1	12,240,480 lekë
Pishina	5,205,522 lekë (sipas preventivit) * 6%				312,331 lekë
TOTALI					16,348,939 lekë

Vlera e TNI-së e përlogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **15,118,656 lekë**. Diferenca prej **1,230,283 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

6. Leje ndërtimi për **“Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues L. Gj., miratuar në 10.05.2023, me problematika si më poshtë vijon: Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë **54,008,307 lekë**. Sipas VKB-së me nr. 160, datë 01.12.2022, për **“Miratimin e paketës fiskale të vitit 2023”**, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet në funksion të turizmit është **3%** mbi vlerën e punimeve (preventivi i punimeve). Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

54,008,307 lekë * 3% = 1,620,249 lekë
--

Vlera e TNI-së e përlogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **1,478,657 lekë**. Diferenca prej **141,592 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

7. Leje ndërtimi për **“Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues E. O., miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përlogaritja e TNI-së, e kryer nga grupi i auditimit:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	433	56,000 lekë/m ²	4%	0.7	678,944 lekë

Shërbim	208	56,000 lekë/m ²	4%	1.5	698,880 lekë
Banim	1375	56,000 lekë/m ²	4%	1	3,080,000 lekë
TOTALI					4,457,824 lekë

Vlera e TNI-së e përlogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **3,604,160 lekë**. Diferenca prej **853,664 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

8. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “S.-A.” ShPK, miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:
Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përlogaritja e TNI-së, e kryer nga grupi i auditimit:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	325	56,000 lekë/m ²	4%	0.7	509,600 lekë
Banim	1113	56,000 lekë/m ²	4%	1	2,493,120 lekë
TOTALI					3,002,720 lekë

Vlera e TNI-së e përlogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **2,810,528 lekë**. Diferenca prej **192,192 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë. Gjithashtu, kësaj vlere do të duhej t'i ishte shtuar gjashtë për qind e vlerës së preventivuar të ndërtimit të pishinës, vlerë e cila nuk është pjesë e preventivit të punimeve, dhe për këtë arsye nuk mund të llogaritet nga grupi i auditimit.

11. Leje ndërtimi për “Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përlogaritja e TNI-së, e kryer nga grupi i auditimit:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	710	56,000 lekë/m ²	4%	0.7	1,113,280 lekë
Banim	2254	56,000 lekë/m ²	4%	1	5,048,960 lekë
TOTALI					6,162,240 lekë

Vlera e TNI-së e përlogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **6,025,600 lekë**. Diferenca prej **136,640 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë. Gjithashtu, kësaj vlere do të duhej t'i ishte shtuar gjashtë për qind e vlerës së preventivuar të ndërtimit të pishinës, vlerë e cila nuk është pjesë e preventivit të punimeve, dhe për këtë arsye nuk mund të llogaritet nga grupi i auditimit.

Minimalisht, diferenca midis taksës së ndikimit në infrastrukturë të llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Sarandë, për rastet e audituara, është **8,458,675 lekë**.

Për përlogaritjen e gabuar të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, duke shkaktuar të ardhura të munguara për Bashkinë Sarandë, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. P.**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 11);

- **Z. T. H.**, në cilësinë e specialistit pranë DPZHT (për rastin 5).

(Gjerësisht, problemet mbi shkeljet e konstatuara në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 7, dorëzuar në protokoll, në Bashkinë Sarandë)

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dhjetë raste, dokumentat e emetuar nga Bashkia Sarandë nuk janë të saktë. Këto pasaktësi kanë të bëjnë me mungesën e përcaktimit të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në dokumentin e Vendimit të miratimit të lejes së ndërtimit, miratimin e një afati për përfundimin e punimeve të ndryshim nga ai i përlllogaritur nga inxhinieri konstruktor, mos-pasqyrimin e saktë të ndryshimeve që aplikanti duhet të kryejë në projektin ndërtimor, etj. Më konkretisht, këto problematika janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me zhvillues z. H. Ç. dhe z. M. M., miratuar në 24.02.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Në dokumentin e Vendimit për miratimin e Lejes së Ndërtimit, nr. 20/1, datë 24.03.2023, nuk është përcaktuar vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 23 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1;

- Afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në dokumentin e Lejes së Ndërtimit (24 muaj) nuk është i njëjët me atë të përlllogaritur nga ing. konstruktor në grafikun e punimeve (48 muaj). Nëse nga ana e Bashkisë Sarandë është konsideruar e nevojshme ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve, kjo kërkesë do të duhej t’i ishte drejtuar aplikantit nëpërmjet sistemit *e-lejet*, sipas përcaktimeve të nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 3;

- Në dokumentin me lëndë *“Njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit”*, Bashkia Sarandë ka njoftuar aplikantin se duhet të reflektojë ndryshimet: *“Ndryshimin e projektit arkitektonik”*, pa specifikuar se çfarë ndryshime duhet të kryhen, pa dhënë arsyet ligjore përkatëse, veprim ky në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 3.

2. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Dokumenti me lëndë *“Njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit”* nuk është i saktë, pasi Bashkia Sarandë ka njoftuar aplikantin se duhet të reflektojë ndryshimet: *“Ndryshimin e projektit arkitektonik”*, pa specifikuar se çfarë ndryshime duhet të kryhen, pa dhënë arsyet ligjore përkatëse, veprim ky në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 3.

4. Leje ndërtimi për “Strukturë banimi 7 kate (1 kat parkim i hapur + 6 kate banim) dhe shërbime me 4 kate parkim nën tokë”, me zhvillues “M. I.” ShPK, miratuar në 12.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Në dokumentin me lëndë *“Njoftim për vlerësim pozitiv të projektit dhe pagesë të taksës së ndikimit në infrastrukturë”*, nr. 3582/2, datë 11.04.2023, nuk është përcaktuar vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 23 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1;

- Afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në dokumentin e Lejes së Ndërtimit (48 muaj) nuk është i njëjët me atë të përlllogaritur nga arkitekti në grafikun e punimeve (24 muaj). Nëse nga ana e Bashkisë Sarandë është konsideruar e nevojshme ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve, kjo kërkesë do të duhej t’i ishte drejtuar aplikantit nëpërmjet sistemit *e-lejet*, sipas përcaktimeve

të nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3.

5. Leje ndërtimi për “Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë”, me zhvillues “O. & A.” ShPK, miratuar në 28.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të lejes së zhvillimit. Duke iu referuar nenit 36 të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 1 dhe 2, si dhe nenit 9 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja nga autoritetet vendore. Duke qenë se për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti nuk është parashikuar hartimi i Planit të Detajuar Vendor, shprehemi se leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të lejes së zhvillimit;

- Afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në dokumentin e Lejes së Ndërtimit (24 muaj) nuk është i njëjët me atë të përlllogaritur nga ing. konstruktor në grafikun e punimeve (36 muaj). Nëse nga ana e Bashkisë Sarandë është konsideruar e nevojshme ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve, kjo kërkesë do të duhej t’i ishte drejtuar aplikantit nëpërmjet sistemit *e-lejet*, sipas përcaktimeve të nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3;

- Në dokumentin me lëndë “Njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit”, Bashkia Sarandë ka njoftuar aplikantin se duhet të reflektojë ndryshimet: “a) Planimetria e sheshit në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor; b) Projekti Teknik në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor”, pa specifikuar se çfarë ndryshime duhet të kryhen, pa dhënë arsyet ligjore përkatëse, veprim ky në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3.

6. Leje ndërtimi për “Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues L. Gj., miratuar në 10.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk plotëson kriteret e përcaktuara për objektet të cilat zhvillohen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit. Parcela në zhvillim bën pjesë në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe hartës bashkëlidhur. Referuar përcaktimeve të Vendimit nr. 41, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, pika 3, nën-pika b) dhe c), objektet të cilat zhvillohen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit duhet të marrin mendim pozitiv nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si dhe akt përputhshmërie nga AZHT. Për procedurën nën shqyrtim, nuk është kërkuar dhe marrë mendim pozitiv nga MTM, si dhe nuk është marrë mendim pozitiv nga AZHT. Në zbatim të pikës 4 të vendimit të sipërcituar, të gjitha lejet e miratuara në kushtet e mungesës apo dhënies së një përgjigje negative nga këto autoritete, do të konsiderohet nul dhe e pavlefshme;

- Në dokumentin e Vendimit për miratimin e Lejes së Ndërtimit, nr. 53/1, datë 10.05.2023, nuk është përcaktuar vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 23 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1;

- Afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në dokumentin e Lejes së Ndërtimit (36 muaj) nuk është i njëjët me atë të përlllogaritur nga ing. konstruktor në grafikun e punimeve (24 muaj). Nëse nga ana e Bashkisë Sarandë është konsideruar e nevojshme ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve, kjo kërkesë do të duhej t’i ishte drejtuar aplikantit nëpërmjet sistemit *e-lejet*, sipas

përcaktimeve të nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3;

- Në dokumentin me lëndë “Njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit”, Bashkia Sarandë ka njoftuar aplikantin se duhet të reflektojë ndryshimet: “Përmirësimin e plotë të projektit arkitektonik në përputhje me tipologjinë e objektit”, pa specifikuar se çfarë ndryshime duhet të kryhen, pa dhënë arsyet ligjore përkatëse, veprim ky në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3.

7. Leje ndërtimi për “Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues E. O., miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti në zhvillim nuk pozicionohet në njësinë strukturore, e cila citohet nga aplikanti dhe zhvilluesi. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin *e-lejet* është konstatuar se, sipas aplikantit / zhvilluesit, pasuria ndodhet në njësinë strukturore SA.UB.7.223/1. Nga kontrolli i kryer nga grupi i auditimit është konstatuar se parcelat në zhvillim ndodhen në njësinë strukturore SA.UB.8.303. Disa nga parametrat e zhvillimit të parashikuara për këto njësi janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	SA.UB.7.223/1	SA.UB.8.303
	Nj. str. sipas aplikantit dhe zhvilluesit	Nj. str. në të cilën realisht ndodhen parcelat
Lartësia në kate	7	6
Lartësia në metra	24	21
Intensiteti	3	2.5
KSHT	50%	50%

Si dallohet, parametrat e zhvillimit midis dy njërive ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Objekti i miratuar nuk do të respektonte Intensitetin, nëse do të krahasosheshin me ato të njësisë strukturore SA.UB.8.303. Marrja në konsideratë e dokumentacionit me informacion jo-të saktë është në kundërshtim me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 2, nënpika b);

- Afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në dokumentin e Lejes së Ndërtimit (36 muaj) nuk është i njëjti me atë të përlogaritur nga hartuesit e projektit ndërtimor në grafikun e punimeve (24 muaj). Nëse nga ana e Bashkisë Sarandë është konsideruar e nevojshme ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve, kjo kërkesë do të duhej t’i ishte drejtuar aplikantit nëpërmjet sistemit *e-lejet*, sipas përcaktimeve të nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3;

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve është konstatuar se zhvilluesi i objektit nën shqyrtim është z. E. O., i cili ka arritur marrëveshjen me pronarët e parcelës në zhvillim, si dhe në favor të të cilit është miratuar leja e zhvillimit. Dokumenti i lejes së ndërtimit është miratuar në favor të zhvilluesit “E. G” ShPK, me subjekt ndërtues “M.-K.” ShPK. Miratimi i lejes së ndërtimit në favor të një subjekti tjetër, i cili nuk është subjekti që ka aplikuar për t’u pajisur me leje ndërtimi, nuk është në përputhje me nenin 13 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, 2, 3, 4, pasi transferimi i lejes së ndërtimit kryhet sipas procedurave të parashikuara në dispozitat rregullatore të sipërcituar.

8. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “S.-A.” ShPK, miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Në dokumentin e Vendimit për miratimin e Lejes së Ndërtimit, nr. 56/1, datë 17.05.2023, nuk është përcaktuar vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 23 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1.

9. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “S.-A.” ShPK, miratuar në 13.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Në dokumentin e Vendimit për miratimin e Lejes së Ndërtimit, nr. 56/1, datë 17.05.2023, nuk është përcaktuar vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 23 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1;

- Afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në dokumentin e Lejes së Ndërtimit (36 muaj) nuk është i njëjët me atë të përlogaritur nga ing. konstruktor në grafikun e punimeve (24 muaj). Nëse nga ana e Bashkisë Sarandë është konsideruar e nevojshme ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve, kjo kërkesë do të duhej t'i ishte drejtuar aplikantit nëpërmjet sistemit *e-lejet*, sipas përcaktimeve të nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 3.

10. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Në dokumentin e Vendimit për miratimin e Lejes së Ndërtimit, nr. 20/1, datë 24.03.2023, nuk është përcaktuar vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 23 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1;

- Afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në dokumentin e Lejes së Ndërtimit (36 muaj) nuk është i njëjët me atë të përlogaritur nga ing. konstruktor në grafikun e punimeve (24 muaj). Nëse nga ana e Bashkisë Sarandë është konsideruar e nevojshme ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve, kjo kërkesë do të duhej t'i ishte drejtuar aplikantit nëpërmjet sistemit *e-lejet*, sipas përcaktimeve të nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 3.

11. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Në dokumentin e Vendimit për miratimin e Lejes së Ndërtimit, nr. 20/1, datë 24.03.2023, nuk është përcaktuar vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 23 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1;

- Afati i përfundimit të punimeve të përcaktuar në dokumentin e Lejes së Ndërtimit (36 muaj) nuk është i njëjët me atë të përlogaritur nga ing. konstruktor në grafikun e punimeve (24 muaj). Nëse nga ana e Bashkisë Sarandë është konsideruar e nevojshme ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve, kjo kërkesë do të duhej t'i ishte drejtuar aplikantit nëpërmjet sistemit *e-lejet*, sipas përcaktimeve të nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 3.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. P.**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 1, 2; 4 - 11);

- **Z. H. K.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT (për rastet 1, 2, 4; 6 - 11);

(Gjerësisht, problemet mbi shkeljet e konstatuara në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 7, dorëzuar në protokoll, në Bashkinë Sarandë)

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në gjashtë raste, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, kanë ndaj fundit publik për strehim social. Referuar përcaktimeve të nenit 19 të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, marrim informacion se: “Çdo subjekt privat që aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi.”. Këto problematika janë evidentuar në rastet e mëposhtme:

2. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 2950 m², nga të cilat 88.5 m² do të duhej t’i kalonin të fondit publik të banesave sociale.

3. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me zhvillues “S. R. E. G” ShPK, miratuar në 04.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 2151,2 m², nga të cilat 64.5 m² do të duhej t’i kalonin të fondit publik të banesave sociale.

5. Leje ndërtimi për “Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë”, me zhvillues “O. & A.” ShPK, miratuar në 28.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se sipërfaqja e dakordësuar për të kaluar në favor të fondit publik të banesave sociale është 84.75 m². Nga llogaritja e kryer nga grupi i auditimit është konstatuar se sipërfaqja e saktë do të duhej të ishte 109.29 m² (e llogaritur sipas formulës 3642 m² me funksion banim * 3%). Diferenca midis sipërfaqes së dakordësuar dhe asaj të llogaritur nga grupi i auditimit është 24.54 m².

9. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “S. –A.” ShPK, miratuar në 13.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 2234 m², nga të cilat 67 m² do të duhej t'i kalonin të fondit publik të banesave sociale.

10. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 2159 m², nga të cilat 64.77 m² do të duhej t'i kalonin të fondit publik të banesave sociale.

11. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 2254 m², nga të cilat 67.62 m² do të duhej t'i kalonin të fondit publik të banesave sociale.

Diferenca midis sipërfaqes totale që subjektet private, për të cilat janë miratuar leje ndërtimi me sipërfaqe me të madhe se 2,000 m² banim, do të duhet të kalonin në favor të fondit publik për strehim social, të llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Sarandë është **377 m²**.

Për llogaritjen e gabuar të sipërfaqes që subjektet private do të duhet të kalonin në favor të fondit publik për strehim social, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. R. P.**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 2, 3, 5, 9, 10, 11);

- **Z. P. Zh.**, në cilësinë e ish - drejtorit të DPZHT (për rastin 3).

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste, një prej ortakëve të shoqërisë në favor të së cilës është miratuar leja e ndërtimit, rezulton të jetë punonjës në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Lejet e ndërtimit janë miratuar në favor të shoqërisë “E. G” ShPK, me NIPT M.....A. Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentin e ekstraktit historik të regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit, është konstatuar se z. H. K. është aksioner në këtë shoqëri i 25% të aksioneve, vërtetuar kjo dhe nga kontrata e themelimit të kësaj shoqërie, në datën 26.10.2021. Gjithashtu, z. K. është edhe punonjës (në cilësinë e nëpunësit) në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), Bashkia Sarandë. Z. K. ka qenë pjesë e grupit të punës që ka kontrolluar dokumentacionin e lejeve të miratuara, të listuara më poshtë. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, ku citohet se: *“Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues të parashikuar në nenin 31 dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut*

të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.”. Lejet e miratuara të sipërcituara, janë:

2. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023;

7. Leje ndërtimi për **“Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues E. O., miratuar në 17.05.2023;

10. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023;

11. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023.

Për miratimin e lejeve të ndërtimit, në kushtet e konfliktit të interesit, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. H. K.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPZHT.

Nga auditimi i certifikatave të përdorimit është konstatuar se në një rast, objekti i ndërtuar ka ndryshime nga projekti i miratuar. Nga auditimi i ushtruar mbi projektin ndërtimor të objektit të ndërtuar, krahasuar kjo me fotot e objektit në të gjitha drejtimet janë konstatuar ndryshime, si janë:

- Çarje në pjesën e sipërme të muraturës së katit përdhe, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në projekt, por janë realizuar;

- Ballkoni perimetral në katin e parë, i cili nuk ka qenë i parashikuara në projekt, por është realizuar;

- Mbulesa me çati me tjegulla e ballkonit në katin e fundit, e cila nuk ka qenë e parashikuara në projekt, por është realizuar;

- Nuk është realizuar ballkoni perimetral në katin e fundit, i cili ka qenë i parashikuar në projekt dhe nuk është realizuar.

Në praktikën e ngarkuar në sistemin *e-lejet* nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë miratimin e këtyre ndryshimeve, si do të ishte leja e ndërtimit për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, ose kopje e gjobës së vendosur nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 42 të Ligjit 107/2014, “Për planifikimin e zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1.

Për miratimin e certifikatës së përdorimit, për një objekt i cili ka reflektuar ndryshime nga projekti i miratuar, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. P. Zh.**, në cilësinë e drejtorit të DPKZHT;

- **Z. T. H.**, në cilësinë e nëpunësit të DPKZHT;

- **Z. A. B.**, në cilësinë e specialistit DPKZHT.

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit:

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, u konstatua se në të gjitha rastet, pra në trembëdhjetë raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i

projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me mungesën e vërtetimeve të regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore, mungesat e licencave profesionale të tyre, mungesa e policia e sigurimit dhe deklaratat e përgjegjësive profesionale, mangësi dhe mangësi në projektet ndërtimore, mangësi në dokumentacionin që vërteton të drejtat pronësore, projektin në formatin DËG, studimin sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, preventivin e punimeve, oponencën teknike, marrëveshja midis palëve për zhvillimin e objekteve fqinje me faqe kallkan, etj. Në lidhje me miratimin e certifikatave të përdorimit janë konstatuar problematika si mungesa e licencës së kolaudatorit, kontrata me mbikëqyrësin e punimeve, si dhe licenca e tij, akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, situacioni përfundimtar i kryerjes së punimeve, projekti ‘as built’, projektit për mirëmbajtjen e objektit, certifikata përfundimtare e auditimit të efikasitetit të energjisë, etj.

2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në njëmbëdhjetë raste, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, si janë distancat urbane (nga objektet kufitare – 5 raste; nga kufiri i pronës – 3 raste; nga trupi i rrugës – 3 raste); lartësia maksimale e lejuar e katit përdhe (1 rast); lartësia maksimale e lejuar e objektit (1 rast); numri minimal i lejuar i vendparkimeve (5 raste); intensiteti maksimal i lejuar (9 raste); koeficienti i lejuar i shfrytëzimit të territorit (2 raste); objekti i miratuar del jashtë kufirit të pronësisë (1 rast); aksesit për në pronë kryhet mbi një pronë mbi të cilën nuk ka asnjë informacion (1 rast).

3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në katër raste, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (këtu e në vazhdim DKZHT) e Bashkisë Sarandë nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Në të gjitha rastet, pra në dymbëdhjetë raste, leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat rregullatorë të sipërcituara shprehet qartësisht se informacioni, që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur. Në dhjetë raste nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Rajonale të Ujësjellës – Kanalizime. Në një rast nuk është respektuar mendimi i Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, e cila nuk e ka miratuar aplikimin. Në një rast nuk është respektuar mendimi i AZHT, si dhe leja e ndërtimit është miratuar pa marrë miratim nga ky autoritet. Gjithashtu, nuk është respektuar mendimi i OSHEE. Në një rast nuk është ri-kërkuar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

4. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në të gjitha rastet, pra në dymbëdhjetë raste, zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin “Njoftim për fillimin e punimeve”. “Njoftimi për fillimin e punimeve” është dokumenti që jepet pas marrjes së sigurisë se zhvilluesi ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe kushtet e nevojshme për të filluar punimet. Gjithashtu, ky dokument shënon datën e saktë të fillimit të punimeve, referuar së cilës llogaritet respektimi ose jo i grafikut të punimeve dhe afatit të përfundimit të punimeve. Duke iu referuar pikës 8 të dokumentit të lejes së ndërtimit, si dhe nenit 40 të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 1, afati për fillimin e punimeve është një vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit.

5. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tetë raste, taksa

e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur e saktë. Në pesë raste, në përlllogaritjen e TNI-së, nuk është përfshirë vlera e pishinave. Në shtatë raste, vlera e TNI-së është llogaritur gabim. Minimalisht, diferenca midis taksës së ndikimit në infrastrukturë të llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Sarandë, për rastet e audituara, është 8,458,675 lekë.

6. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dhjetë raste, dokumentat e emetuar nga Bashkia Sarandë nuk janë të saktë. Këto pasaktësi kanë të bëjnë me mungesën e përcaktimit të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në dokumentin e Vendimit të miratimit të lejes së ndërtimit, miratimin e një afati për përfundimin e punimeve të ndryshim nga ai i përlllogaritur nga inxhinieri konstruktor, mos-pasqyrimin e saktë të ndryshimeve që apliknati duhet të kryejë në projektin ndërtimor, etj.

7. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në gjashtë raste, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, kanë ndaj fundit publik për strehim social. Diferenca midis sipërfaqes totale që subjektet private, për të cilat janë miratuar leje ndërtimi me sipërfaqe me të madhe se 2,000 m² banim, do të duhet të kalonin në favor të fondit publik për strehim social, të llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Sarandë është **377 m²**.

8. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste, një prej ortakëve të shoqërisë në favor të së cilës është miratuar leja e ndërtimit, rezulton të jetë punonjës në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Lejet e ndërtimit janë miratuar në favor të shoqërisë “E. G” ShPK, me NIPT M.....A. Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentin e ekstraktit historik të regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit, është konstatuar se z. H. K. është aksioner në këtë shoqëri i 25% të aksioneve. Gjithashtu, z. K. është edhe punonjës (në cilësinë e nëpunësit) në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), Bashkia Sarandë. Z. K. ka qenë pjesë e grupit të punës që ka kontrolluar dokumentacionin e lejeve të miratuara, të listuara më poshtë.

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore

Në zbatim të pikës 6 (gjashtë), të programit të auditimit nr. 188/8 prot., datë 12.09.2024, shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes;
2. Vendimet e masave administrative (gjobave);
3. Vendimet e pezullimeve të punimeve;
4. Vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme;
5. Planet mujore, tremujore dhe/ose vjeçare të punës;
6. Dokumentacioni i IMTV-së në lidhje me gjobat e vendosura, arkëtimet, urdhrat ekzekutivë, vendimet e gjykatës etj;
7. Dokumentacioni financiar në lidhje me kontabilizimin dhe arkëtimet e gjobave;
8. Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga IMTV dhe Drejtoria e Financës.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;

Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;

VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

Për kryerjen e aktivitetit të tij, IMTV disponon vetëm një automjet për nevoja të inspektimit ditor, ndërsa përsa i përket rasteve të prishjes së ndërtimeve të kundërligjshme bashkëpunon me Ndërmarrjen e Shërbimeve pranë Bashkisë Sarandë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, dhe përputhshmërisë me dispozitat ligjore, konstatohet se:

6.1 Mbi strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, struktura organizative e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me Urdhër nr. 36, datë 06.02.2023 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë. Referuar vendimit të sipërcituar dhe strukturës organizative të IMTV-së, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, IMTV ka pasur në strukturën e tij, punonjësit sipas tabelës në vijim:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Data e fillimit	Data e largimit	Shënime
1	A. M.	Kryeinspektor	Akademia Ushtarake	25.11.2022	29.06.2023	Aktualisht i larguar nga detyra, larguar nga Kryeinspektor 29.06.2023, ne drejtori tjetër
2	N. H.	Kryeinspektor	Akademia Ushtarake	29.06.2023	Në vazhdim	Prej datës 29.06.2023 – 23.11.2023, larguar në 23.11.2023 dhe rikthyer në datën 18.12.2024 në cilësinë Kryeinspektor.
3	P. I.	Specialist Jurist	Drejtësi	19.06.2023	Në vazhdim	Prej datës 19.06.2023 – 05.12.2023 në cilësinë e specialist jurist, 05.12.2023-18.12.2023 në cilësinë e Kryeinspektor, 18.12.2023 - në vazhdim specialist jurist.
4	A. H.	Inspektor	Biokimi	21.07.2023	Në vazhdim	
5	V.Q.	Inspektor	I mesëm	01.01.2023	Në vazhdim	Inspektor i IMT deri në 10.01.2023, larguar ne drejtori tjetër, rikthyer ne cilesine e Inspektorit ne datën 07.07.2023

6	R. M.	Inspektor	I mesëm	07.08.2023	06.02.2024	Dorëheqje
7	H. K.	Spec. ndërtimi	Inxhinieri Ndërtimi	26.06.2023	Në vazhdim	
8	V. Xh.	Inspektor	Akademia e Rendit	01.01.2023	24.07.2023	Larguar nga puna
9	B. K.	Inspektor	I mesëm	10.01.2023	07.07.2023	Larguar nga puna
10	E. Z.	Inspektor	I mesëm	10.01.2023	31.07.2023	Larguar nga puna
11	S. A.	Inspektor	Gjuhë e huaj	10.01.2023	29.03.2023	Transferuar në drejtori tjetër
12	K.R.	Inspektor	I mesëm	01.01.2023	10.01.2023	Transferuar në drejtorit tjetër 10.01.2023, rikthyer në pozicionin e inspektorit datë 04.04.2024

Ashtu si konstatohet nga tabela e mësipërme, vetëm dy nga punonjësit e IMTV Bashkia Sarandë plotësojnë kriteret ligjore të nenit 11 të ligjit nr. 9780, datë 16/07/2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Asnjë nga punonjësit e tjerë (të larguar ose që vazhdojnë të jenë pjesë e IMTV) nuk është i arsimuar në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit. Pesë prej punonjësve nuk kanë arsim të lartë (kanë arsim të mesëm).

6.2 Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:

6.2.1 Mbi planifikimin e inspektimeve:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t’i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tri-mujore dhe/ose vjeçare të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”, nënpika b.ii. Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë. Nga ana e IMTV nuk është hartuar asnjë plan pune, i miratuar nga kryeinspektori.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV për periudhën 01.01.2023-29.06.2023, për mos-hartimin e planeve të punës;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për mos-hartimin e planeve të punës.

6.2.2 Mbi raportimin periodik:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t’i japë të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licensave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr.9780, datë 16/07/2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, pika f). Nga ana e IMTV është vendosur në dispozicion vetëm një raportim për periudhën 29.06.2023 – 30.10.2023. Si konstatohet, raportimi nuk është kryer periodik, si dhe nuk është kryer i plotë, për të gjithë periudhën nën auditim.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV për periudhën 01.01.2023-29.06.2023, për mos-kryerjen e raportimit periodik ndaj IKMT;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për mos-kryerjen e raportimit ndaj IKMT, në mënyrë periodike dhe gjithëpërfshirëse.

6.3 Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve dhe proceseve të prishjeve me evidenca fotografike:

6.3.1 Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve:

Në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të kundërvajtjes së konstatuar me foto ose video, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se në 40 raste (nga 126 procedura që ka mbajtur IMTV) kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi ose video dhe nuk është bërë pjesë e dosjes individuale për secilën praktikë. Rastet e sipërcituara janë paraqitur në Aneksin: Rastet kur konstatimi nuk është dokumentuar me foto.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. N. H., në cilësinë e kryeinspektorit pranë IMTV, për një rast, më konkretisht për rastin 28, të paraqitura në Aneks;
- Z. V. Xh., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për 39 nga 40 raste të paraqitura në Aneks (përveç rastit nr. 28);
- Z. K. R., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për dy raste, më konkretisht për rastet 1 dhe 2 të paraqitura në Aneks;
- Z. V. Q., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për tre raste, më konkretisht për rastet 1, 2 dhe 28, të paraqitura në Aneks;
- Z. B. K., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për 26 raste, më konkretisht për rastet 3-10, 12, 15-25, 27, 29-40, të paraqitura në Aneks;
- Z. E. Z., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për 36 raste, më konkretisht për rastet 3-27, 29-33, 35-40, të paraqitura në Aneks;
- Z. S. A., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për tre raste, më konkretisht për rastet 11, 13 dhe 14, të paraqitura në Aneks;
- Z. A. H., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për një rast, më konkretisht për rastin 28, të paraqitura në Aneks;
- Z. R. M., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për një rast, më konkretisht për rastin 28, të paraqitura në Aneks.

6.3.2 Mbi dokumentimin e procesit të prishjes së objekteve të kundërligjshëm:

Në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast, të procesit të prishjes së objektit të kundërligjshëm, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se për 124 raste për të cilat kryeinspektori i IMTV ka nxjerrë vendimin e prishjes, në njëmbëdhjetë raste ky vendim nuk ka qenë i ekzekutueshëm, pasi kundërvajtësi ka marrë masë sigurie nga gjykata ose gjykata ka shfuqizuar vendimet e IMTV. Për rastet e ngelura, pra për 113 raste, në 75 raste vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar. Për 38

rastet në të cilat ky vendim është ekzekutuar, në shtatë raste ky proces nuk është dokumentuar me evidenca fotografike. Rastet e sipërcituara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë: Rastet, për të cilat është ekzekutuar vendimi i prishjes, por nuk është dokumentuar

Nr.	Proces-verbali i konstatimit		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Datë		
1	000200	11.01.2023	V. V.	Ndertim muri me material guri dhe llaci
2	000022	16.03.2023	M. I.	Rritje e siperfaqes ndertimore duke shkelur lejen e ndertimit
3	000057	18.05.2023	Pa ID	Ndertimi I nje muri rrethues me gjatesi 26m, punime shtese 97m2
4	000198	09.01.2023	A. Zh.	Ndertim I nje str. metalike me llamarine per ndertimin e nje ballkoni
5	000044	10.05.2023	Pa ID	Ndertim I nje objekti me tulla dhe lac me permasa 80m2
6	000051	16.05.2023	Pa ID	Objekti me prof. metal. mbuluar me llamarine me permasa 3m x 2m
7	000028	04.04.2023	L. D.	Ndertim muri me llac ne hapesipre publike

Gjithashtu, nga informacioni i vendosur në dispozicion nga IMTV, Bashkia Sarandë, konstatohet se në dy nga këto raste, më konkretisht për rastet 3 dhe 5, referuar tabelës së mësipërme, ekzekutimi i vendimit të prishjes është kryer nga IKMT, pa praninë e inspektorëve të IMTV, Bashkia Sarandë.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e kryeinspektorit pranë IMTV, për rastin 4, referuar tabelës së mësipërme;
- Z. V. Xh., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për rastet 2, 4, 6, 7, referuar tabelës së mësipërme;
- Z. B. K., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për rastet 1, 2, 6, 7, referuar tabelës së mësipërme;
- Z. E. Z., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, për rastet 1, 2, 4, 6, 7, referuar tabelës së mësipërme.

6.4 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve:

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim nxirret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak, për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë. Një vendim i tillë merret në rastet kur:

subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit;

mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;

plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;

vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Nga ana e kryeinspektorit janë nxjerrë në total tre vendime për pezullimin e punimeve, në lidhje me kundërvajtje si: “Shkelja e lejes së ndërtimit, pa krijuar shtim volumi”; “Shkelje e deklaratës paraprake”; “Mungesë e dokumentacionit tekniko-ligjor”.

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se në 4 raste nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, kur do të duhej t'i ishte dhënë kohë subjektit të konstatuar për plotësimin e dokumentacionit ose përmirësimin e masave të sigurimit teknik në objekt dhe shtimin e mjeteve mbrojtëse të jetës së punëtorëve, paraqitur në tabelën e mëposhtme. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Tabelë: Rastet për të cilat nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve

Nr.	Proces-verbali i konstatimit		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Datë		
1	000099	20.07.2023	K. M.	Shkela e deklaratës paraprake
2	000018	07.03.2023	A.	Shkelje deklarate paraprake
3	000022	16.03.2023	M. I.	Rritje e sipërfaqes ndertimore duke shkelur lejen e ndertimit
4	000131	13.12.2023	A. L.	Shkelja e afateve te mbarimit te punimeve

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023, për rastet 2 dhe 3, referuar tabelës së mësipërme;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për rastet 1 dhe 4, referuar tabelës së mësipërme.

6.5 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të dënimit me masë administrative gjobë:

Vendimi për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë merret për të gjitha rastet kur konstatohen shkelje në veprimtarinë ndërtimore. Ky vendim bashkë-shoqëron gjithmonë vendimin për pezullimin e punimeve dhe vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Vlera e masës administrative përcaktohet sipas dispozitave ligjore, ndërsa për objektet e ndërtuar pa marrë paraprakisht miratimin e autoriteteve vendore ose qëndrore, gjoba përcaktohet në raport të drejtë me vlerën e investimit.

Nga ana e kryeinspektorëve të IKMT, Bashkia Sarandë janë nxjerrë në total 125 vendime për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, me vlerë totale 141,760,550 lekë. Në katër raste kur IMTV nuk ka nxjerrë vendimin e dënimit me masë administrative gjobë, kundërvajtësi ka qenë i pidentifikuar.

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se:

- Në 71 raste, të pasqyruara në Aneksin “Rastet kur vlera e masës administrative nuk është llogaritur e saktë”, vlera e masës administrative dënim me gjobë është vendosur e pabazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Në të gjitha rastet e cituara në aneks vlera e gjobës është 500,000 lekë. Kjo vlerë fikse nuk është e parashikuar në asnjë nga pikat dhe nënpikat e nenit 52 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin Nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Procedurat e cituara në aneks kanë të bëjmë me punime të kryera pa leje ndërtimi, për të cilat, vlera e gjobës llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), ku citohet: “kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi...”.

Duke qenë se në përshkrimin e kundërvajtjes në akt-konstatim nuk ka të dhëna të mjaftueshme, si materialet e përdorura, përmasat, etj., nuk është e mundur kryerja e përlllogaritjes së saktë të vlerës së masës administrative.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023, për rastet 1-40, 45-60, 62-71, referuar Aneksit;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për rastet 41-44, 61, referuar Aneksit.

- Për rastet kur vlera e masës administrative është llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), janë konstatuar problematikat e mëposhtme:

Nr.	Nr. serie	Data	Konstatimi	Kundërvajtësi
1	000091	03.07.2023	Ndërtim tende me strukturë të lehtë metalike me 72 m ²	V. V.
2	000108	12.09.2023	Nd. str. metal mbuluar me panele “sanduiç” 15m*4m	E. Sh.
3	000076	07.06.2023	Ndërtim platforme betoni	B. Gj.
4	000112	20.10.2023	Mbyllja e verandës me material tulle dhe alfa bllok 19m ²	S.A.
5	000113	23.10.2023	Ndërtim strukture me dru, mbuluar me llamarinë, 39m ²	F. S.
6	000117	30.10.2023	Ndërtim strukture metalike, 225m ²	S.Xh.
7	000122	20.11.2023	Mbyllja e ballkonin të banesës, 9 m ²	P. B.
8	000139	20.12.2023	Nd. mbulese me panele sanduiç, riparim muri në pronë	A. I.
9	000085	03.07.2023	Ndërtim strukture me konstruksion metalik 4.7m x 5m	E. D.
10	000115	30.10.2023	Ndërtim muri me blloqe betoni	V. A.

Për këto raste është konstatuar se vlera e gjobës është llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika e). Gjithësesi, në këto raste nuk janë respektuar plotësisht këto dispozita, pasi vlera 35,000 lekë/m², e përdorur për llogaritjen e gjobave, nuk gjen zbatim në këtë rast, pasi asnjë prej këtyre kundërvajtjeve nuk janë objekte. Ndërtimi i tendave, strukturave metalike, platformave të betonit, mbylljet e verandave dhe ballkoneve, etj. nuk kanë të njëjtën kosto ndërtimi me ndërtesat. Shpesh herë, përlllogaritja e masës administrative duke përdorur njësinë “për m²” nuk është e saktë dhe nuk jep një vlerë të gjobës në proporcion të drejtë me kundërvajtjen e konstatuar. Në rastet e sipërcituara, vlera e gjobës do të duhej të ishte llogaritur si shumatorja e punimeve të kryera pa leje. Përlllogaritja e vlerave të sakta të këtyre gjobave nga ana e grupit të auditimit, nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së të dhënave (materiale, përmasa, sasi).

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023, për rastin 3, referuar tabelës së mësipërme;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për rastet 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, referuar tabelës së mësipërme.

- Në së paku dy raste, nga ana e kryeinspektorit të IMTV, vlera e masës administrative dënim me

gjobë nuk është llogaritur e saktë. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika e.V), kur objekti pa lejet përkatëse ndërtohet për qëllime fitimi në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, vlerës së gjobës i shtohet dhe penalteti prej 5,000,000 lekë. Rastet në të cilat nuk janë zbatuar këto dispozita janë si më poshtë:

Nr.	Nr. serie	Data	Konstatimi	Kundërvajtësi
1	000104	24.08.2023	Ndërtim beach bari me strukturë druri	O. S.
2	000107	30.08.2023	Nd. strukt. beach bari me dru, mbuluar me sanduiç	R. Z.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për rastet 1 dhe 2, referuar tabelës së mësipërme.

- Në së paku 6 raste, konstatimet e kryera nga inspektorët e IMTV, janë klasifikuar (nga ana e kryeinspektorit), si punime për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi. Faktikisht, punimet e konstatuar dhe të evidentuara në tabelën e mëposhtme, janë punime për të cilat duhet pajisja me deklaratë paraprake punimesh (rastet 1, 3) dhe leje ndërtimi (rastet 2, 4, 5, 6), referuar përcaktimeve të nenit 7 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3, nënpika ii) dhe nenit 11, pika 1, nënpika a). Gjobat janë përlllogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika d), ndërkohë që do të duhej të llogariteshin sipas përcaktimeve të pikës 1, nënpika e). Përlllogaritja e vlerave të sakta të këtyre gjobave nga ana e grupit të auditimit, nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së të dhënave (materiale, përmasa, sasi).

Nr.	Nr. serie	Data	Konstatimi	Gjoha	Kundërvajtësi
1	000102	18.08.23	Nd. struk. me konst. dru dhe vetratë xhami në ballkon në pronë të vetë	50,000 lekë	V. P.
2	000135	25.12.23	Ndërtim platforme betoni	100,000 lekë	E. O.
3	000123	21.11.23	Nd. struk. metalike, mbuluar me sandwich	50,000 lekë	A. V.
4	000125	24.11.23	Nd. verande betoni mbi strukt. metalike 30m ²	50,000 lekë	M. D.
5	000132	15.12.23	Ndërtim mur betoni 21 ml	100,000 lekë	V. V.
6	000103	21.08.23	Nd. muri tulle me llac mbi nje shtrese betoni	50,000 lekë	T. C.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për rastet 1 - 6, referuar tabelës së mësipërme.


6.6 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të prishjes së objektit të kundërligjshëm dhe ekzekutimin e tyre:

Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga ana e

kryeinspektorëve të IKMT, Bashkia Sarandë janë nxjerrë në total 124 vendime për prishjen e objekteve të kundërligjshëm. Referuar informacionit të marrë nga IMTV, si dhe auditimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se në njëmbëdhjetë raste, ekzekutimi i vendimit të prishjes nuk mund të kryhet, për arsyet e sqaruara në tabelën e mëposhtme:

Tabelë: Rastet kur ekzekutimi i vendimit të prishjes nuk mund të kryhet

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Arsyeja e mos-ekzekutimit të vendimit të prishjes
	Nr. serie	Datë		
1	000197	30.12.2022	J. M.	Masë sigurie, datë 16.01.2023
2	000069	29.05.2023	V. L.	Rrëzuar të dy vendimet e IMT nga gjykata
3	000100	03.08.2023	E.D.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata, vendimi nr. 184/2023
4	000058	18.05.2023	A. I.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
5	000075	06.06.2023	R. P.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata, masë sigure
6	000039	05.05.2023	K. D.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
7	000055	18.05.2023	G. P.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
8	000031	18.04.2023	A. S.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
9	000018	07.03.2023	A.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
10	000010	22.02.2023	G. B.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
11	000068	29.05.2023	F. O.	Rrëzuar vendimi i prishjes nga gjykata, ulur masa e gjobës në 50.000 lekë



Nga 113 kundërvajtje të konstatuara, për të cilat IMTV, Bashkia Sarandë ka nxjerrë vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, ky vendim është ekzekutuar vetëm në 37 raste (28 prej këtyre rasteve janë faktuar me foto); në një rast objekti është kthyer në gjendjen e mëparshme nga kundërvajtësi; në 75 raste nuk është

ekzekutuar vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm, të paraqitura në Aneksin “Rastet kur nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes”, bashkëlidhur këtij dokumenti. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, pika d), si dhe në kundërshtim me neni 52 të Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 6.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023, për 40 raste referuar Aneksit;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për 35 raste referuar Aneksit.

6.7 Mbi respektimin e afateve për nxjerrjen e vendimeve pas konstatimit të kundërvajtjes:

Pas mbajtjes së procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, brenda një afati 10-ditor, kryeinspektori i IMTV-së, duhet të nxjerrë vendimet sipas rastit në lidhje me shkeljen e konstatuar, si: vendim për pezullimin e punimeve, prishjen e objektit të kundërligjshëm, vendim për dënimin me masë administrative gjobë ose kallëzim penal për kundërvajtësin.

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se në tre raste, nga ana e kryeinspektorit, nuk është respektuar afati dhjetë ditor për nxjerrjen e vendimeve vijuese sipas rastit, në funksion të kundërvajtjes së evidentuar në procesverbalin e konstatimit. Më konkretisht, këto raste janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabelë: Rastet kur nuk është respektuar afati dhjetë ditor

Nr.	PVKK		Vendim prishje		Vendim për gjobë		Kundërvajtësi
	Nr. serie	Data	Nr. serie	Data	Nr. serie	Data	
1	000015	06.03.2023	000116	17.03.2023	000094	17.03.2023	Pa ID
2	000076	07.06.2023	000117	16.06.2023	000113	18.09.2023	B. Gj.
3	000016	06.03.2023	000117	17.03.2023	000065	17.03.2023	Pa ID

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023.

6.8 Mbi nisjen e procedurave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësit:

Në respektim të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse, sipas legjisllacionit në fuqi. Duke marrë në konsideratë informacionin e vendosur në dispozicion nga ana e IMTV, Bashkia Sarandë, si dhe nga auditimi i dokumentacionit, është konstatuar se:

- Nga 129 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Sarandë, vetëm 2 raste nuk përbëjnë vepër penale, sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal;
- Nga 127 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Sarandë, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal, në 32 raste kundërvajtësi është i paidentifikuar;
- Nga 95 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Sarandë, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal dhe kundërvajtësi është i identifikuar, në 10 raste gjykata ka shfuqizuar vendimet e IMTV, ose kundërvajtësi i pretenduar ka marrë masë sigurie;
- Nga 85 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Sarandë, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal dhe IMTV do të duhej të ishte drejtuar organeve ligj-zbatuese për dërgimin pranë tyre të indicies për vepër penale, kjo procedurë është kryer në 50 raste, ndërsa në 35 raste IMTV nuk e ka nisur procedurën e kallëzimit penal (shiko Aneksin “Rastet kur nuk është përcjellë indicia për vepër penale”);

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023, për 24 raste referuar Aneksit;

- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, për 11 raste referuar Aneksit.

- Nga ana e kryeinspektorit, z. A. M., nuk është respektuar i njëjti standard në lidhje me përgatitjen e kallëzimeve penale, pasi për procedurat e mbajtura gjatë periudhës që ka qenë kryeinspektor,

është konstatuar se për procedurat:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Kundërvajtja
	Nr. serie	Datë		
1	000073	05.06.2023	G. S.	Ndërtimi I një muri me beton
2	000037	27.04.2023	A. T.	Ndërtim muri me gur dhe llac

është përgatitur kallëzim penal, ndërsa për të gjitha procedurat e tjera nuk është përgatitur, edhe pse kanë të bëjnë me shkelje të ngjashme ose më të rënda si: “Platformë betoni 9.3 m * 8m; Mur rrethues me gur dhe llac; Cati mbi soletë ekzistuese me dru; Ndërtim objekti me mur guri dhe llac; Ndërtim i një muri me gjatësi 27 ml, lartësi 1m -1.6m; Ndërtim i një garazhi mbi objekt ekzistues me mur guri dhe llac, 8m²”, etj.

- Nga ana e kryeinspektorit, z. N. H., nuk është respektuar i njëjti standard në lidhje me përgatitjen e kallëzimeve penale, pasi për procedurat e mbajtura gjatë periudhës që ka qenë kryeinspektor, është konstatuar se për procedurat:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Kundërvajtja
	Nr. serie	Datë		
1	000103	21.08.2023	T. C.	Ndërtim muri tulle me llac mbi një shtresë beton
2	000105	28.08.2023	A. M.	Ndërtim muri me gure dhe llac
3	000106	28.08.2023	A. K.	Ndërtim muri me guri dhe llac, porte metalike
4	000102	18.08.2023	V. P.	Ndërtim strukture me kosntrukcion druri dhe vetrare xhami në ballkonin në prones të vet

nuk është përgatitur kallëzim penal, ndërsa për kundërvajtje të tjera të ngjashme kryeinspektori ka përcjellë në institucionet ligj-zbatuese indicien e veprës penale. Rastet e ngjashme, për të cilat nuk është përgatitur kallëzim penal janë si më poshtë:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Kundërvajtja
	Nr. serie	Datë		
1	000110	03.10.2023	A. B.	Ndërtim mur mbajtes
2	000121	18.11.2023	F. M.	Ndërtim muri me gure pa llav
3	000122	20.11.2023	P. B.	Mbyllja e ballkonin të banesës, sip 9m ²
4	000132	15.12.2023	V. V.	Ndërtim mur betoni 21ml
5	000134	23.12.2023	T. B.	Ndërtim muri guri dhe llaci

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023.

6.9 Mbi arkëtimin e masave administrative:

Inspektorati i Mbrotjes së Territorit Vendor, Bashkia Sarandë, për vitin 2023, ka vendosur në total 76 masa administrative dënim me gjobë (nuk janë përfshirë masat administrative kur kundërvajtësi është i paidentifikuar), me vlerë 102,097,550 lekë. Nga këto, janë paguar vullnetarisht 11 gjoba (14.5 % e numrit total të gjobave), me vlerë 1,476,000 lekë (1.4 % e vlerës totale të gjobave). Nga ana e kryeinspektorit, z. A. M., për 72 vendime për dënim me masë administrative gjobë, vetëm në 24 raste është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e gjobës. Në 48 raste ky njoftim nuk është bërë. Nga ana e kryeinspektorit, z. N. H., për 53 vendime për dënim me masë administrative gjobë, në 48 raste është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e gjobës. Në 5 raste ky njoftim nuk është bërë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010

“Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar, pika 1, nënpika c).

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023.

6.10 Mbi inspektimin e objekteve në zhvillim, me leje të miratuar nga Bashkia Sarandë

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, pika a), Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Nga auditimi i aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, si dhe bashkëpunimit midis këtyre dy strukturave të mbrojtjes dhe planifikimit të territorit, janë konstatuar disa parregullsi gjatë auditimit në terren (nga grupi i auditimit) të objekteve të pajisur me leje ndërtimi, por ende në zhvillim, të evidentuara më poshtë:

a. Për leje ndërtimi për objektin “Godinë banimi + shërbime 1, 4, 5 kate, me 2 kate bodrum, (parkim) nën tokë”, me zhvillues z. A. B., me nr. 3763 prot.:

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se kemi të bëjmë me devijime të dukshme të projektit pasi në katin përdhe është shfrytëzuar pothuajse e gjithë sipërfaqja e truallit dhe katet e sipërme që ngrihen mbi katin përdhe ndryshojnë me projektin e miratuar;

b. Për leje ndërtimi për objektin “Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me zhvillues z. H. C. dhe z. M. M., me nr. 3093 prot.:

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se nuk është respektuar zbatimi i këtij projekti, pasi nuk është ndërtuar kati nëntokë (parkimi), por objekti fillon të zhvillohet direkt mbi kuotën e sistemit. Konsolat e dala të objektit ndryshojnë me projektin e miratuar, si dhe fasada mbrapa e objektit vihet re se ndryshon nga ajo e prerjes teknike;

c. Për leje ndërtimi për objektin “Objekt 3 kate dhe 1 kat podrum me funksion banimi”, me zhvillues z. A. B.:

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se kati nëntokësor është ndërtuar i gjithi mbi tokë. Në lejen e ndërtimit të miratuar nga DPZHKT, Bashkia Sarandë, objekti që do ndërtohet, bazuar mbi projektin e miratuar, jepet si objekt me faqe kallkan ngjitur me objektin ekzistues, ndërkohë që, në gjendjen faktike objekti duket një i gjithi dhe jo gjysëm objekti ekzistues dhe gjysëm objekt i ri. Hyrja për në parkim, referuar projektit të miratuar, është në anën e majtë të objektit dhe me një carje krahasuar me gjendjen faktike, ku kemi dy carje në anën e djathtë. Përsa i përket lartësisë totale të objektit vihet re një shfazim mes objektit të ri dhe atij ekzistues me një kat bazuar mbi projektin e miratuar ndërsa gjendja faktike e objektit ndryshon, është një i gjithi me katër kate mbi tokë;

d. Për leje ndërtimi për objektin “Objekt banimi 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nën tokë”, me zhvillues shoqëria “A.” ShPK:

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se nuk është respektuar projekti ndërtimor, pasi objekti është i gjithi mbi tokë, pa kat nëntokë, dhe lartësia e katit të parë teknik është më e madhe se katet e tjera.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për

inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, pika a).

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. M., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 01.01.2023-29.06.2023;
- Z. N. H., në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023;
- Z. V. Xh., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV;
- Z. K. R., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV;
- Z. V. Q., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV;
- Z. B. K., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV;
- Z. E.Z., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV;
- Z. S. A., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV;
- Z. A. H., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV;
- Z. R. M., në cilësinë e inspektorit pranë IMTV.

6.11. Mbi auditimin e procedurave të mbajtura nga IMTV, me përzgjedhje:

Nga auditimi u konstatua se:

- Për periudhën Janar- Qershor 2023 nga Gjykata nuk është pranuar praktika për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit pasi në dosjet e konstatimit të kundërvajtjeve mungon vërtetimi i njoftimit të subjekteve.
- Në 42 në praktikatat të IMT Bashkia Sarandë në bazë të databazës elektronike që disponojnë, Vendimet e Gjorbës janë mbajtur për subjekte ende të pa identifikuar.
- Në 10 raste vendimet e dënimit me gjorbë janë rrëzuar me vendim gjykate:

Nr.	PV Kundervajtje	Gjorba (nr, date)	Subjekti	Statusi
1	18, 07.03.2023	67, 17.03.2023	A.	Rrezuar me vendim gjykate
2	31, 19.04.2023	77, 20.04.2023	Dh. L.	Rrezuar me vendim gjykate
3	30, 18.04.2023	78, 24.04.2023	A. S.	Rrezuar me vendim gjykate
4	65, 29.05.2023	110, 05.06.2023	V.L.	Rrezuar me vendim gjykate
5	51, 18.05.2023	98, 23.05.2023	G. P.	Rrezuar me vendim gjykate
6	57, 22.05.2023	103, 25.05.2023	A.L.	Rrezuar me vendim gjykate
7	37, 05.05.2023	84, 09.05.2023	K. D.	Rrezuar me vendim gjykate
8	71, 06.06.2023	116, 12.06.2023	R. P.	Rrezuar me vendim gjykate
9	96, 03.08.2023	144, 03.08.2023	E. D.	Rrezuar me vendim gjykate
10	72, 07.06.2023	152, 18.09.2023	B. Gj.	Rrezuar me vendim gjykate

-Në 12 raste gjorbat janë paguar vullnetarisht:

Nr	Procesverbali nr., datë	Vendimi Gjorbës	Subjekti	Përshkrimi	Vlera
1	64, 29.05.2023	109, 05.06.2023	F. O.	Ekzekutuar vullnetarisht, ulur masa e gjorbës me vendim gjykate	50,000
2	103, 30.08.2023	150, 30.08.2023	R. Z.	Ekzekutuar vullnetarisht	150,000
3	102, 28.08.2023	149, 29.08.2023	A. K.	Ekzekutuar vullnetarisht	50,000
4	101, 28.08.2023	148, 29.08.2023	A. M.	Ekzekutuar vullnetarisht	50,000
5	02, 09.03.2023	02, 11.03.2023	E.P.	Ekzekutuar vullnetarisht, ulur masa e gjorbës me vendim gjykate	50,000
6	75, 29.06.2023	125, 04.07.2023	H. M.	Ekzekutuar vullnetarisht	150,000
7	100, 24.08.2023	147, 29.08.2023	O. S.	Ekzekutuar vullnetarisht	50,000
8	105, 21.09.2023	153, 28.09.2023	E. N.	Ekzekutuar vullnetarisht	50,000
9	119, 21.11.2023	165, 05.12.2023	A. V.	Ekzekutuar vullnetarisht	50,000
10	123, 30.11.2023	169, 08.12.2023	B. V.	Ekzekutuar vullnetarisht	476,000
11	125, 05.12.2023	162, 05.12.2023	R. Sh.	Ekzekutuar vullnetarisht	300,000
12	127, 13.12.2023	170, 13.12.2023	A. L.	Ekzekutuar vullnetarisht	100,000

- Në 6 raste IMT Bashkia Sarandë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për subjektet e mëposhtme:

Nr	Procesverbali nr., datë	Vendimi Gjobës	Subjekti	Përshkrimi
1	109, 23.10.2023	157, 30.10.2023	F. S.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 16.11.2023. Gjykata me vendimin nr.378(89-2023-1545), datë 30.11.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesës pasi nuk vërtetohet fakti se debitori ka marrë dijëni edhe pse në kërkesën e IMT është bashkëlidhur lajmërim marrje nr. RR526529726AA, që vërteton që subjekti është njoftuar me anë të shërbimit postar. Vendimi nr.378(89-2023-1545), datë 30.11.2023 është ankimuar nga IMT Bashkia Sarandë me ankimin nr.5464/1 prot, datë 13.12.2023.
2	106, 03.10.2023	154, 09.10.2023	A. B.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 16.11.2023. IMT Bashkia Sarandë ende nuk ka një vendim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë. Subjekti është njoftuar nga shërbimi postar me lajmërim marrjen nr.RR452951170AA.
3	112, 30.10.2023	160, 06.11.2023	S. G.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 16.11.2023. Gjykata me vendimin nr.374(89-2023-1544), datë 30.11.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesës pasi nuk vërtetohet fakti se debitori ka marrë dijëni edhe pse në kërkesën e IMT është bashkëlidhur lajmërim marrje nr. RR529585894AA, që vërteton që subjekti është njoftuar me anë të shërbimit postar. Vendimi nr. 374(89-2023-1544), datë 30.11.2023 është ankimuar nga IMT Bashkia Sarandë me ankimin nr.5462/1 prot, datë 13.12.2023.
4	98, 18.08.2023	145, 22.08.2023	V. P.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 16.11.2023. Gjykata me vendimin nr.(89-2023-1437) 223, datë 16.11.2023 ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit për titull ekzekutiv. Me shkresën nr.3071 prot, datë 03.06.2024 vendimi i është dërguar për ekzekutim Zyrës Përmbaremore Sarandë. Deri më tani IMT nuk ka informacion për ekzekutimin e vendimit nga Përmbaremi.
5	110, 27.10.2023	158, 30.10.2023	E. K.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 16.11.2023. Gjykata me vendimin nr.regj them 376(300001-01861-89-2023), datë 19.12.2023 ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit për titull ekzekutiv. Me shkresën nr.3070 prot, datë 03.06.2024 vendimi i është dërguar për ekzekutim Zyrës Përmbaremore Sarandë. Deri më tani IMT nuk ka informacion për ekzekutimin e vendimit nga Përmbaremi.
6	111, 30.10.2023	159, 06.11.2023	V. A.	Kërkesa për titull ekzekutiv në gjykatë është kryer në datën 16.11.2023. Gjykata me vendimin nr.(89-2023-1517)377, datë 30.11.2023 ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit për titull ekzekutiv. Me shkresën nr.3072 prot, datë 03.06.2024 vendimi i është dërguar për ekzekutim Zyrës Përmbaremore Sarandë. Me shkresën nr.334 regi/1223 prot, datë 03.12.2024 Zyra Përmbaremore Sarandë ka vendosur pushimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit pasi është vjelur gjoba e plotë të vlerën 682.500 lekë.

Për mos aplikimin e lëshimit të titullit ekzekutiv mbajnë përgjegjësi kryeinspektorët z. A. M., z. N. H. sipas periudhave përkatëse si dhe Juristi P. I..

- Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të konstatimit të kundërvajtjeve administrative u konstatua se:

Dosja e subjektit E. H. O.:

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 25.12.2023 nga Inspektoret **V. Q., R. M. dhe A.H.** në subjektin E. H. O. me adresë: Lagjia nr. 3 Ksamil Bashkia Sarandë, janë konstatuar punime pa leje që konsistojnë në hedhjen e një platforme betoni me përmasa 4.2m x 4.2 m dhe lartësi 10 cm. Të montuara në terren u gjendën 12 kolona me fitila hekuri të hedhura vite më parë.

Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 25.12.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 25.12.2023 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Në datë 28.12.2023 nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i është drejtuar Komisarariatit të Policisë për indetifikimin e personit që ka kryer ndërtim pa leje, në datë 05.01.2024 ka kthim përgjigje nga Komisarjati i Policisë Sarandë. Marrë në dorëzim më 09.01.2024.

Me datë 09.01.2024 nga K/Inspektori N. H. është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **100,000 lekë** për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 03.01.2024 nga Krye/Inspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 10.01.2024 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve..

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMTV-së **nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit F. Q. Ç. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 30.11.2023 nga Inspektoret **V. Q., R. M. dhe A. H.** në subjektin F. Q. Ç. me adresë: Fshati Metoq Bashkia Sarandë, janë konstatuar punime pa leje që konsistojnë në ndërtimi i objekti shtesë në objektin ekzistues me përmasa 11 m x 5 m x 2.9 m, me një sipërfaqe totale prej 55 m² me mur tulle e soletë beton arme.

Nga inspektoret e terrenit të IMTV-së me datë 30.11.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 30.11.2023 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 05.12.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **1,925,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 05.12.2023 nga Krye/Inspektori P. I. është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 13.12.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për

prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve..

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë nuk është vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit F. T. K.:

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 23.11.2023 nga Inspektorët **V. Q., R. M. dhe A. H.** në subjektin F. T. K. me adresë: Fshati Berdenesh (pranë shkollës) Bashkia Sarandë, janë konstatuar punime pa leje që konsistojnë në ndërtimi i objekti me përmasa 6 m x 3 m x 2.6 m, me një sipërfaqe totale prej 18 m² me trarë e blloqe beton.

Nga inspektorët e terrenit të IMTV-së me datë 23.11.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 23.11.2023 nga inspektorët është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 05.12.2023 nga K/Inspektori P. I. është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **630,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 05.12.2023 nga Krye/Inspektori është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyrë vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 13.12.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve. Ekzekutim i realizuar sipas Procesverbalit datë 27.12.2023.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit S. Xh. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 30.10.2023 nga Inspektorët **V. Q., R. M. dhe A. H.** në subjektin S. Xh. me adresë: Njësia Administrative Ksamil, Rruga “Butrinti”, Lagjia nr. 1, Godina nr. 25, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtim pa leje që konsistojnë në ndërtimi e strukturë metalike e mbuluar me dërrasa me përmasa 20.5 m x 11 m = 225.

Nga inspektorët e terrenit të IMTV-së me datë 30.10.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 30.10.2023 nga inspektorët është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi. Nga subjekti S.Xh. ka një përgjigje për IVMT Sarandë se është thjesht lysterje me boje e riparime jo ndërtim i ri dhe bashkëlidhur ka kontratën e qirasë së lidhur datë 22.06.2020

Me datë 06.11.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **7,875,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 07.11.2023 nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 06.11.2023 nga Krye/Inspektori N. H. është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin

për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 07.11.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë *me kallëzim penal* në ngarkim të shtetasit S. Xh., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

Dosja e subjektit E. D. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 03.08.2023 nga K/Inspektori **N. H.** dhe Inspektorët **V. Q., dhe A. H.** në subjektin E. D. me adresë: Njësia Administrative Ksamil, Rruga "Rinia", Kodra 26 Marsi, Bashkia Sarandë, është konstatuar një rindërtim i prishur më parë me mur tulle dhe i mbuluar me llamarinë me përmasa 84 m².

Nga inspektorët e terrenit të IVMT-së me datë 03.08.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 03.08.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **2,940,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 04.08.2023 nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 03.08.2023 nga Krye/Inspektori N. H. është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 04.08.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit E. D., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

Nga Kryeinspektori i IMTNJV-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.

Dosja e subjektit K. M. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 20.07.2023 nga Inspektorët **V. Xh. dhe E. Z.** në subjektin K. M. me adresë: Rruga "Onhezmi", Lagjia nr. 3, Bashkia Sarandë, është konstatuar një barakë metalike e mbuluar me panel sanduëic me përmasa 9.8m x 5m = 49 m².

Nga inspektorët e terrenit të IVMT-së me datë 20.07.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 28.07.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **50,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 02.08.2023 nuk është

shlyer nga subjekti.

Me datë 28.07.2023 nga Krye/Inspektori N. H. është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 02.08.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Nga subjekti në Gjykatën e Administrative të shkallës së parë Lushnjë është kërkuar “Sigurimi i padisë administrative” për të gjitha masat administrative të mara nga IVMT Sarandë Gjykata me Vendimin nr. 89-2023-814, datë 17.08.2023 ka rrezuar kërkesën e sigurimit të padisë.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë *me kallëzim penal* në ngarkim të shtetasit K. M., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/atë Kodit Penal.

Nga Kryeinspektori i IMTNjV-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit A. F. B.:

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 20.07.2023 nga Inspektoret **E. Z., B. K. dhe V. Xh.** në subjektin A. F. B. me adresë: Fusha e Palit Metoq, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtimi i objekti me blloqe betoni me përmasa 22m x 14m me lartësi 2.2 m.

Nga inspektoret e terrenit të IVMT-së me datë 04.07.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 12.07.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **10,780,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 18.08.2023 nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 12.07.2023 nga Krye/Inspektori N. H. është marrë vendim prishje duke njoftuar subjektin për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 18.07.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Nga subjekti në Gjykatën e Administrative të shkallës së parë Lushnjë është kërkuar “Sigurimi i padisë administrative” për të gjitha masat administrative të mara nga IMT Bashkia Sarandë Gjykata me Vendimin nr. regj. Themeltar 98 [31162-0100489-2023], datë 28.07.2023 ka rrezuar kërkesën e sigurimit të padisë.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit V. V. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 03.07.2023 nga Inspektoret **E. Z., B. K. dhe V. Xh.** në subjektin V. V. me adresë: Fusha e Palit Metoq, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtimi i një tendë hijezimi me strukturë të lehtë metalike e të mbuluar me mushama me përmasa 12m x 6m = 72m².

Nga inspektoret e terrenit të IMT-së me datë 03.07.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 12.07.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **2,520,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 18.07.2023 nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 12.07.2023 nga Krye/Inspektori N. H. është marrë vendim prishje dhe është njoftuar subjektin datë 18.07.2023 për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 18.07.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Nga subjekti në Gjykatën e Administrative të shkallës së parë Lushnjë është kërkuar “Sigurimi i padisë administrative” për të gjitha masat administrative të mara nga IMT Bashkia Sarandë Gjykata me Vendimin nr. Vendimi 89-2023-1465/394, datë 21.11.2023 ka rrezuar kërkesën e sigurimit të padisë.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit B. H. B. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 03.07.2023 nga Inspektoret **E. Z., B. K. dhe V. Xh.** në subjektin B. H. B. me adresë: Njësia Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtimi i një objekti me konstruksion metalik i mbulluar me panel sandëic me përmasa 12m x 6m = 72m².

Nga inspektoret e terrenit të IMT-së me datë 03.07.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 11.07.2023 nga inspektoret është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 12.07.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **2,520,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 19.07.2023 nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 12.07.2023 nga Krye/Inspektori N. H. është marrë vendim prishje dhe është njoftuar subjektin datë 19.07.2023 për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 19.07.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër*

ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.

Dosja e subjektit V. M., Th. B. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 30.06.2023 nga Inspektoret **E. Z., B. K. dhe V. Xh.** në subjektin V. M., Th. B. me adresë: Njësia Administrative Ksamil, lagjia 26 Marsi, Bashkia Sarandë, është konstatuar një shesh i shtruar me beton me sipërfaqe 189 m².

Nga inspektoret e terrenit të IMT-së me datë 30.06.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Nga inspektoret nuk ka Relacioni shpjegues drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 04.07.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për V. M. dhe gjobë në shumën prej **500,000** për Th. B. për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 13.07.2023 nuk është shlyer nga subjekti. Aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit)

Me datë 13.07.2023 nga Krye/Inspektori N. H. është marrë vendim prishje dhe është njoftuar subjektin datë 13.07.2023 për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Me datë 13.07.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Në datë 13.07.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është bërë Kallzim Penal pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë për shtetasin V. M. dhe Th. B..

Për mos konfirmim njoftimi i masave administrative në datë 28.07.2023 është bërë shpallja zyrtare e masave administrative në këndin e njoftimeve.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.

Dosja e subjektit B. Gj. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 07.06.2023 nga Inspektoret **E. Z., B. K. dhe V.Xh.** në subjektin i pa identifikuar (B. Gj.) me adresë: Rruga nacionale Metoq-Çukë, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtim pa leje që konsistonin në platformë betoni me përmasa 65 x 15 m me lartësi 25 cm në një sipërfaqe toke të rrethuar me blloqe betoni.

Nga inspektoret e terrenit të IMT-së E. Z., B. K. dhe V. Xh. me datë 07.06.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi për subjekt të pa identifikuar. Po në datë 07.06.2023 ka një relacion për Kryeinspektorin të nënshkruar edhe nga Juristi P. I.

Me datë 14.06.2023 nga K/Inspektori A. M. është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej

500,000 lekë për subjekt të paidentifikuar për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 27.06.2023 nuk është shlyer nga subjekti. Aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit).

Me datë 14.06.2023 nga Krye/Inspektori A. M. është marrë vendim prishje dhe është njoftuar subjektin e paidentifikuar në datë 27.06.2023 për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Në datë 27.06.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është bërë Kallzim Penal pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë për subjektin e pa identifikuar.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit me shkresën nr. 2949/7, datë 15.08.2023 ka tërhequr vëmendjen IMT Bashkisë Sarandë për raste të përsëritura të vendosjes së gjobës në subjekte të pa identifikuar.

Në datë 28.08.2023 IMT Bashkia Sarandë ka kërkuar informacion nga Komisariati Policisë Sarandë mbi subjektin e ndërtimit pa leje. Me nr. 2661/1, datë 08.09.2023 Komisariati i Policisë Sarandë ka identifikuar subjektin B. Gj.

Me datë 18.09.2023 nga K/Inspektori N. H. është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **34,125,000 lekë** për subjekt B. Gj. për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 22.09.2023 nuk është shlyer nga subjekti.

Me datë 22.09.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobë“, për subjektin B. Gj., në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë **nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm**, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit B. Gj., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë **nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit** prej **34,125,000 lekë** për subjekt B. Gj. në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit G.S. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 05.06.2023 nga Inspektorët **E. Z., B. K. dhe V.Xh.** në subjektin G. S. me adresë: Lagjia nr. 1, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtimi i një muri me strukturë betoni, për mbrojtje nga erozioni.

Nga inspektorët e terrenit të IMT-së me datë 05.06.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 05.06.2023 nga inspektorët është përgatitur Relacioni drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi të nënshkruar edhe nga Juristi P. I..

Me datë 12.06.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000**

lekë për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi, e cila edhe pse ka njoftim në datë 27.06.2023 nuk është shlyer nga subjekti. Në procesverbalin e gjobës aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit).

Me datë 12.06.2023 nga Krye/Inspektori A. M. është marrë vendim prishje dhe është njoftuar subjektin datë 27.06.2023 për prishjen në mënyre vullnetare të objektit të kundërligjshëm.

Në datë 27.06.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është bërë Kallëzim Penal pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë për subjektin G. S..

Me datë 27.06.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* prej 500,000 lekë për subjektin G. S. në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.

Dosja e subjektit J. B. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 29.05.2023 nga Inspektorët **E. Z. dhe V. Xh.** në subjektin J. B. me adresë: Lagjia nr. 4, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtimi i një platforme druri e mbuluar me materiale druri në hapësirë publike.

Nga inspektorët e terrenit të IMT-së me datë 29.05.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Relacioni shpjegues drejtuar Kryeinspektorit për vazhdimin e procedurës ligjore për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi nuk administrohet në praktikën dokumentare.

Me datë 30.05.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi. Në procesverbalin e gjobës aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit).

Me datë 30.05.2023 nga Krye/Inspektori A. M. është marrë vendim prishje e ndërtimit të pa ligjshëm.

Nga Kryeinspektori ka njoftim në datë 06.06.2023 për shlyerjen vullnetare të gjobës së vendosur dhe prishjen vullnetare të ndërtimit pa leje nga subjekti.

Me datë 06.06.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë *nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm*, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit J. B., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

-Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* prej 500,000 lekë për subjektin J. B. në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit

Dosja e subjektit G. M. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 16.05.2023 nga Inspektoret **B. K., E. Z. dhe V. Xh.** në subjektin G. M. me adresë: Rruga e Varrezave Ksamil, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtimi i 17 kollonave me hekur brenda.

Nga inspektoret e terrenit të IMT-së me datë 16.05.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 17.05.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi. Në procesverbalin e gjobës aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit).

Me datë 17.05.2023 nga Krye/Inspektori A. M. është marrë vendim prishje e ndërtimit të pa ligjshëm.

Nga Kryeinspektori ka njoftim në datë 06.06.2023 për shlyerjen vullnetare të gjobës së vendosur dhe prishjen vullnetare të ndërtimit pa leje nga subjekti.

Me datë 06.06.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Konkluzion: Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë ***nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm***, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit J. B., për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

-Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** prej 500,000 lekë për subjektin G. M. në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit I paidentifikuar :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 27.04.2023 nga Inspektoret **B. K., E. Z. dhe V. Xh.** në subjektin pa identifikuar me adresë: Pranë Plazhit Publik Ksamil, Bashkia Sarandë, është konstatuar ndërtimi i ndërtimi i dy kioskave me sipërfaqe 35 m² secila (sipas shkresës se IKMT me nr. 2949/8, datë 18.08.2023 janë ndërtime të pa ligjshme të përfunduara).

Nga inspektoret e terrenit të IMT-së me datë 27.04.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 02.05.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi. Në procesverbalin e gjobës drejtuar “I paidentifikuar) aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit).

Me datë 02.05.2023 nga Krye/Inspektori A. M. është marrë vendim prishje e ndërtimit të pa ligjshëm.

Nga Kryeinspektori ka njoftim në datë 17.05.2023 për shlyerjen vullnetare të gjobës së vendosur dhe prishjen vullnetare të ndërtimit pa leje nga subjekti i identifikuar.

Me datë 17.05.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për

prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve. Në datë 28.08.2023 i është kërkuar Komisarariatit të Policisë identifikimi i ndërtuesve të pa ligjshëm (nuk ka përgjigje). Prishja e është realizuar sipas Procesverbalit datë 02.02.2024

Konkluzion: -Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit “i paidentifikuar”, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

-Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* prej 500,000 lekë për subjektin “I pa identifikuar” në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit M. I. :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 16.03.2023 nga Inspektorët **B. K., E. Z. dhe V. Xh.** në subjektin M. I. me adresë: Fshati Cukë, Bashkia Sarandë, është konstatuar rritje e sipërfaqes ndërtimore duke kapërcyer kushtet e lejes së ndërtimit.

Nga inspektorët e terrenit të IMT-së me datë 16.03.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 24.03.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi. Në procesverbalin e gjobës drejtuar M. I. aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit).

Me datë 24.03.2023 nga Krye/Inspektori A. M. është marrë vendim prishje e ndërtimit të pa ligjshëm.

Nga Kryeinspektori ka njoftim në datë 11.04.2023 për shlyerjen vullnetare të gjobës së vendosur dhe prishjen vullnetare të ndërtimit pa leje nga subjekti i identifikuar.

Me datë 11.04.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektorët e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Prishja e është realizuar sipas Procesverbalit datë 18.02.2024

Konkluzion: -Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit “M. I.”, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

-Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* prej 500,000 lekë për subjektin “M. I.” në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit I paidentifikuar :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 06.03.2023 nga Inspektorët **B. K., E. Z. dhe V. Xh.** në subjektin pa identifikuar me adresë: Kodra e Marinës Ksamil, Bashkia Sarandë, është konstatuar vendosja e kioskave në hapësirë publike pa leje përkatëse.

Nga inspektorët e terrenit të IMT-së me datë 06.03.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 17.03.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi. Në procesverbalin e gjobës drejtuar “I paidentifikuar” aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit).

Me datë 17.03.2023 nga Krye/Inspektori A. M. është marrë vendim prishje e ndërtimit të pa ligjshëm.

Nga Kryeinspektori ka njoftim në datë 11.04.2023 për shlyerjen vullnetare të gjobës së vendosur dhe prishjen vullnetare të ndërtimit pa leje nga subjekti i identifikuar.

Me datë 11.04.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Prishja e është realizuar sipas Procesverbalit datë 25.09.2024

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura *brenda afatit 10 ditor* për nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobë”, për subjektin I paidentifikuar, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar

-Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë *me kallëzim penal* në ngarkim të shtetasit “i paidentifikuar”, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

-Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* prej 500,000 lekë për subjektin “I pa identifikuar” në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Dosja e subjektit I paidentifikuar :

Nga inspektimi i bërë në terren me datë 06.03.2023 nga Inspektoret **B. K., E. Z. dhe V. Xh.** në subjektin pa identifikuar me adresë: Kodra e Marinës Ksamil, Bashkia Sarandë, është konstatuar gërmim sipërfaqe në hapësirë publike pa leje përkatëse.

Nga inspektoret e terrenit të IMT-së me datë 06.03.2023 është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Me datë 17.03.2023 nga K/Inspektori është vendosur dënimi me gjobë në shumën prej **500,000 lekë** për kryerjen e objekti pa leje ndërtimi. Në procesverbalin e gjobës drejtuar “I paidentifikuar) aplikimi i masës së gjobës me 500,000 lekë nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore (neni, germa, specifikimet e ligjit).

Me datë 17.03.2023 nga Krye/Inspektori A. M. është marrë vendim prishje e ndërtimit të pa ligjshëm.

Nga Kryeinspektori ka njoftim në datë 11.04.2023 për shlyerjen vullnetare të gjobës së vendosur dhe kthimi i sipërfaqes në gjendjen e mëparshme nga subjekti i paidentifikuar.

Me datë 11.04.2023 nga IMT Bashkia Sarandë është nxjerrë Urdhërim i Ekzekutimit Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ku për ekzekutimin e këtij urdhri janë ngarkuar inspektoret e IMT-së, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve.

Konkluzion: Nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura *brenda afatit 10 ditor* për nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobë”, për subjektin I pa identifikuar, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar

-Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë *me kallëzim penal* në ngarkim të shtetasit “i paidentifikuar”, për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal.

-Nga Kryeinspektori i IMT Bashkia Sarandë-së *nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit* prej 500,000 lekë për subjektin “I pa identifikuar” në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

Për sa më lart mbajnë përgjegjësi:

1. N. H.

8 raste -Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

8 Raste -Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë ***nuk është vijuar ndërhyrja për Urdhër ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm***, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

4 Raste - Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë ***me kallëzim penal*** në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

1 Rast- Nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura ***brenda afatit 10 ditor*** për nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobjë“, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

2. P. I.

1 rast-Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë nuk është vijuar ndërhyrja ***për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm***, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

2 raste- Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

3. A. M.

4 raste-Nga ana e IMT-së Bashkia Sarandë nuk është vijuar ndërhyrja ***për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm***, në kundërshtim me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

7 raste- Nga Kryeinspektori i IMTV-së ***nuk është vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit*** në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar.

5 Raste -Nga IMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë ***me kallëzim penal*** në zbatim të nenin 199/a të Kodit Penal me kompetencat që i jep neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

2 Raste- Nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura ***brenda afatit 10 ditor*** për nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobjë”, në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Konkluzion i përgjithshëm mbi aktivitetin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

- 1.** IMTV ka në strukturën e saj vetëm dy punonjës që plotësojnë kriteret arsimore të parashikuara, të cilët kanë arsim në fushën e drejtësisë dhe inxhinierisë së ndërtimit. Asnjë nga punonjësit e tjerë (të larguar ose që vazhdojnë të jenë pjesë e IMTV) nuk është i arsimuar në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit. Pesë prej punonjësve nuk kanë arsim të lartë (kanë arsim të mesëm).
- 2.** Kryeinspektorët e IMTV, Bashkia Sarandë nuk kanë hartuar në mënyrë periodike planet e punës mujore, tremujore ose vjeçare, si dhe nuk kanë raportuar periodikisht pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
- 3.** Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, është konstatuar se në 40 raste (nga 126 procedura që ka mbajtur IMTV) kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi ose video dhe nuk është bërë pjesë e dosjes individuale për secilën praktikë. Për 113 raste për të cilat kryeinspektori i IMTV ka nxjerrë vendimin e prishjes, në 75 raste ky vendim nuk është ekzekutuar. Për 38 rastet në të cilat ky vendim është ekzekutuar, në shtatë raste ky proces nuk është dokumentuar me evidenca fotografike.
- 4.** Është konstatuar se në 4 raste nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, kur do të duhej t'i ishte dhënë kohë subjektit të konstatuar për plotësimin e dokumentacionit ose përmirësimin e masave të sigurimit teknik në objekt dhe shtimin e mjeteve mbrojtëse të jetës së punëtorëve.
- 5.** Në 71 raste vlera e masës administrative dënim me gjobë është vendosur e pabazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Në të gjitha këto raste vlera e gjobës është 500,000 lekë. Kjo vlerë fikse nuk është e parashikuar në asnjë nga pikat dhe nën-pikat e dispozitave ligjore. Procedurat e cituara kanë të bëjmë me punime të kryera pa leje ndërtimi, për të cilat, vlera e gjobës llogaritet e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 lekë/m², kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi.
- 6.** Në dhjetë raste është konstatuar se nuk janë respektuar plotësisht përcaktimet ligjore në lidhje me llogaritjen e vlerës së masës administrative, pasi vlera 35,000 lekë/m², e përdorur për llogaritjen e gjobave, nuk gjen zbatim në këtë rast, pasi asnjë prej këtyre kundërvajtjeve nuk janë objekte. Ndërtimi i tendave, strukturave metalike, platformave të betonit, mbylljet e verandave dhe ballkoneve, etj. nuk kanë të njëjtën kosto ndërtimi me ndërtesat. Në këto raste, vlera e gjobës do të duhej të ishte llogaritur si shumatorja e punimeve të kryera pa leje.
- 7.** Në së paku dy raste, nga ana e kryeinspektorit të IMTV, vlera e masës administrative dënim me gjobë nuk është llogaritur e saktë, pasi rastet e konstatuara janë objekte të ndërtuar pa leje ndërtimi, me qëllime fitime. Vlerës së masës administrative do të duhej t'i ishte shtuar penaliteti prej 5,000,000 lekë, si objekte të ndërtuar pa leje, për qëllime fitimi, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.
- 8.** Në së paku 6 raste, konstatimet e kryera nga inspektorët e IMTV, janë klasifikuar (nga ana e kryeinspektorit), si punime për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi. Faktikisht, punimet e konstatuar dhe të evidentuara në tabelën e mëposhtme, janë punime për të cilat duhet pajisja me deklaratë paraprake punimesh (për 2 raste) dhe leje ndërtimi (për 4 raste). Ky vlerësim i gabuar ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e vlerës së gjobës.
- 9.** Nga 113 kundërvajtje të konstatuara, për të cilat IMTV, Bashkia Sarandë ka nxjerrë vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, ky vendim është ekzekutuar vetëm në 37 raste (28 prej këtyre rasteve janë faktuar me foto); në një rast objekti është kthyer në gjendjen e mëparshme nga kundërvajtësi; në 75 raste nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm
- 10.** Është konstatuar se në tre raste, nga ana e kryeinspektorit, nuk është respektuar afati dhjetë

ditor për nxjerrjen e vendimeve vijuese sipas rastit, në funksion të kundërvajtjes së evidentuar në procesverbalin e konstatimit.

11. Nga 85 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Sarandë, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal dhe IMTV do të duhej të ishte drejtuar organeve ligj-zbatuese për dërgimin pranë tyre të indicies për vepër penale, kjo procedurë është kryer në 50 raste, ndërsa në 35 raste IMTV nuk e ka nisur procedurën e kallëzimit penal.

12. Nga ana e kryeinspektorëve, në lidhje me nisjen e indicies penale drejt organeve ligjzbatuese, nuk është respektuar gjithmonë i njëjti standard, pasi për të njëjtat kundërvajtje të konstatuara, në disa raste kryeinspektorët e kanë nisur indicien e veprës penale, në disa raste të tjera nuk e kanë bërë.

13. IMTV, për vitin 2023, ka vendosur në total 76 masa administrative dënim me gjobë (nuk janë përfshirë masat administrative kur kundërvajtësi është i paidentifikuar), me vlerë 102,097,550 lekë. Nga këto, janë paguar vullnetarisht 11 gjoba (14.5 % e numrit total të gjobave), me vlerë 1,476,000 lekë (1.4 % e vlerës totale të gjobave). Nga ana e kryeinspektorit, z. A. M., për 72 vendime për dënim me masë administrative gjobë, vetëm në 24 raste është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e gjobës. Në 48 raste ky njoftim nuk është bërë. Nga ana e kryeinspektorit, z. N. H., për 53 vendime për dënim me masë administrative gjobë, në 48 raste është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e gjobës. Në 5 raste ky njoftim nuk është bërë.

14. Nga rakordimi i aktivitetit të IMTV me lejet e miratuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, në katër raste (leje ndërtimi të miratuara dhe objektet janë në zhvillim) është konstatuar se zhvilluesi nuk ka respektuar projektin e miratuar, si dhe IMTV nuk ka marrë masa për këto subjekte. Devijimet e konstatuara kanë të bëjnë me: *“në katin përdhe është shfrytëzuar pothuajse e gjithë sipërfaqja e truallit dhe katet e sipërme që ngrihen mbi katin përdhe ndryshojnë me projektin e miratuar”*; *“nuk është ndërtuar kati nëntokë (parkimi), por objekti fillon të zhvillohet direkt mbi kuotën e sistemit”*; *“kati nëntokësor është ndërtuar i gjithi mbi tokë”*; *“objekti është i gjithi mbi tokë, pa kat nëntokë, dhe lartësia e katit të parë teknik është më e madhe se katet e tjera”*, etj.

7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nga auditimi i dokumentacionit që u vu në dispozicion, rezultoi se Bashkia Sarandë ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditë, me shkresën nr. 4122/2 prot., datë 10.10.2023, sipas të cilës janë pranuar të gjitha rekomandimet, është hartuar plani i masave për zbatimin e tyre, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për këtë qëllim.

Në urdhërin e titullarit nr. 254 prot., datë 10.10.2023 për realizimin e zbatimit të rekomandimeve janë ngarkuar për ndjekje znj. I. Zh., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm njëkohësisht e komanduar Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore, znj. T. S., Drejtor i zhvillimit Ekonomik Financiar, z. M. M., me detyrë Drejtor i Auditimit të Brendshëm, znj. G. K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike/Përgjegjës i Drejtorisë Juridike, znj. F. E., me detyrë Drejtor i Personelit dhe Burimeve Njerëzore, z. Z. B., me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, z. R. S., me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike, z. M. L., me detyrë Drejtor i Bujqësië, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, z. N. H., me detyrë Kryeinspektor i inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe z. A. L., me detyrë Drejtor i Policisë Bashkiake.

Sa i takon përcaktimeve në pikën nr. 2, neni 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, rezulton se Bashkia Sarandë nuk ka përcjellë brenda afatit raportin mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve i cili duhet të dërgohej brenda 6

muajsh.

Situata mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve jepet si vijon:

- a. Nga 41 masa organizative, janë pranuar 41 masa nga të cilat janë realizuar plotësisht 14 masa, janë realizuar pjesërisht 5 masa, në proces zbatimi 5 masa dhe nuk janë realizuar 17 masa.
- b. Nga 3 masa për shpërblim dëmi janë pranuar 3 masa, të cilat nuk janë zbatuar.
- c. Nga 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike, është pranuar por nuk është zbatuar kjo masë.
- d. Nga 23 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), janë pranuar 23 masa, janë në proces 3 masa dhe nuk janë zbatuar 21 masa.
- e. Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Sarandë, konstatohet se nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore, pra rekomandimi është i pazbatuar.

Në mënyrë të detajuar, nga auditimi rezultoi si vijon:

A. Masa Organizative:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Koment: Me Urdhër të Titullarit të Institucionit për vitin 2023 është caktuar Kordinatori i Riskut z.R. C. N/Kryetari i Bashkisë dhe për vitin 2024 është caktuar Kordinator i Riskut z.F. S. N/Bashkisë. Është hartuar Plani për Menaxhimin e Riskut, identifikimi i risqeve, vlerësimi i riskut etj.

Zbatuar

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit.

Koment: Nuk është blerë programi i ri kompjuterik për mbajtjen e kontabilitetit.

Pa zbatuar

1.3. Rekomandimi: Drejtori i Personelit dhe i Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit “Harta e proceseve të punës”.

Koment: Me Vendim nr.277, datë20.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë, është miratuar Rregullorja e Funksionimit Administrativ i Bashkisë dhe Institucioneve të Varrësisë, ku janë pasqyruar ndryshimet përkatëse, me detyreat funksionale për çdo drejtori e specialist, në zbatim të ligjit nr.10296, si dhe rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja. Në vijimësi, është programuar program trajnimi i stafit të Bashkisë, sipas drejtorive përkatëse dhe specialisteve, sipas programit të miratuar.

Zbatuar pjesërisht

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë, Drejtori i Personelit dhe i Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

- Hartimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm.
- Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Koment: Drejtorja e Auditit të Brendshëm ka hartuar Planin Strategjik 2022 – 2024 dhe Planin Strategjik 2023-2025 si dhe Planin Vjetor 2022 dhe 2023. Me shkresë nr.4886, datë 04.10.2021 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditin e Brendshëm. Për sa i takon Komitetit të Auditit të Brendshëm, nuk është bërë e mundur ngritja e kësaj strukture për mungesë të specialistëve.

Zbatuar pjesërisht

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

Koment: Njësia e Aiuditit të Brendshëm ka arshivuar në Arkivin e Bashkisë dosjet deri në vitin 2021, ndërsa dosjet e tjera në vazhdimësi janë arshivuar në ambientet e zyrës së Njesisë së auditit për mungesë hapësire në Arkivin e Bashkisë.

Zbatuar

2.3. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve, ndërmarrjen e shërbimit publik etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njesisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Koment: Në Planin Strategjik si dhe në Planin Vjetor, janë programuar auditime, çdo dy vjet, si në sistemin e prokurimeve, në Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, zbatimin e rekomandimeve të lëna në zbatim të Udhëzimit nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në Sektorin Publik”.

Zbatuar

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe sektorët e tjerë të bashkisë, të marrin masa për hartimin e një buxheti sa më real në raport me strukturën aktuale të bashkisë, të planifikimit të procedurave të prokurimit për investime/shërbime dhe blerje mallrash sipas nevojave që vetë bashkia ka dhe jo të planifikohen jashtë mundësive reale të cilat dështojnë në fazën e zbatimit të tij.

Koment: Nga auditimi që po realizohet aktualisht për vitin 2023 rezulton se buxheti paraqitet me realizim në masën 87%, pra vihet re një rritje e konsiderueshme e përmbushjes së objektivave të planifikuar krahasuar me një vit më parë.

Zbatuar

3.2. Rekomandim: Drejtorja Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektori i Menaxhimit të kontratave), të marrin masa për likuidimin e të gjitha faturave të depozituara me dokumentacion të rregullt ligjorë, si dhe të verifikojnë në çdo fazë afatet e përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të faturave. Në rast të evidentimit të vonesave të llogaritet penaltet për kamatëvonesë për mos mbyllje në afat të punimeve ose në rastet e paraqitjen me vonës të faturës nga vetë subjektet (pa shkak), t'i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë llogaritjen e penalteteve për

TVSh e shitjes për mos deklarim në kohë të faturave.

Koment: Nga auditimi që po zhvillohet aktualisht për vitin 2023 rezulton se ka një përmirësim të konsiderueshëm të vlerës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2023, ku nga të dhënat rezulton se Bashkia ka arritur të shlyejë rreth 85% të detyrimeve të prapambetura.

Zbatuar

3.3. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrin masa dhe të miratojnë në Këshillin Bashkiak radhën e faturave të pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore, duke likuiduar fillimisht ato me të hershmet, si dhe të rakordojë mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara në bilanc me të dhënat e Ministrisë së Financave.

Të miratojë raportet 4 mujorë dhe të vënë në dijeni Këshillin bashkiak mbi për ecurinë e buxhetit dhe pritshmërinë.

Koment: Referuar komentit trajtuar më lart konsiderohet i ezauruar edhe ky rekomandim.

Zbatuar

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për evidentimin në terren të të gjitha pronave (aseteve) të kaluara në pronësi/ përdorim bashkisë me VKM. Të hartojë regjistrin e pronave, duke evidentuar pronat të pashfrytëzueshme, prona të zaptuara nga të tretë, pronë të shfrytëzueshme për interes të bashkisë, si dhe të përgatisë dhe regjistrojë në ASHK Dega Sarandë të gjitha pronat aktive dhe në interes të bashkisë për realizimin e të ardhurave. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të ngrijnë Drejtorinë/Strukturën e administrimit të aseteve, si një strukturë e domosdoshme dhe efikase për administrimin e pronave të Bashkisë Sarandë.

Koment: Nga auditimi rezulton se është ngritur grupi i punës për regjistrimin e pronave të Bashkisë. Gjatë vitit 2023 Bashkia ka zhvilluar dhe proces tenderimi për azhurnimin e tokave bujqësore me qëllim vijimin e procedurave të aplikimit për pajisje me certifikatë pronësie.

Në proces zbatimi

5.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa si vijon:

- Hartimin dhe miratimin e një rregullore mbi përshkrimin e pozicioneve të punës në institucion, në bashkëpunim me nëpunësin civil, duke analizuar përshkrimet aktuale të pozicioneve të punës dhe për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil të jenë në përputhje me detyrat funksionale dhe kërkesat specifike të ligjit dhe VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionin e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

- Të planifikojë dhe të shpallë për tu plotësuar pozicionet e lira në shërbimin civil, në përputhje me strukturën e institucionit, duke u kujdesur që të realizojë procedurën në grup për kategorinë ekzistues.

- Të hartojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në fund të vitit 2022, në zbatim të afateve të përcaktuara në VKM nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin e pranimit në shërbimin civil”.

Koment: Nga auditimi rezultoi se edhe për vitin 2023 Bashkia Sarandë ka vijuar të ketë strukturë të pa plotësuar.

Pa zbatuar

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe

Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Sarandë sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit. **Koment:** Nga auditimi rezultoi se edhe gjatë vitit 2023 Bashkia Sarandë nuk ka patur sektor më vete për menaxhimin e borxhit.

Pa zbatuar

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit dhe Drejtorinë e të ardhurave, të marrin masa për rakordimet vjetore të vlerës së debitorëve në fund të periudhës për të gjitha llojet e Taksave. Tarifave vendore, duke kryer kontabilizimin e tyre në pasqyrat financiare. Të kontabilizohet në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlera prej 74,782,000 lekë për taksën e ndikimit nga ndërtimet informale (ALUZNI) dhe detyrimet nga abonentët familjarë sipas aktmarrëveshjes me Nd. UK Saranda në shumën 259,314,461 lekë, si dhe të kontabilizohen vlera shpërblim dëmi prej 10,317,550 lekë të rekomanduar dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 nga KLSH-ja, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 118, datë 22.7.2022.

Koment: Nga auditimi rezultoi se edhe gjatë vitit 2023, Bashkia Sarandë ka patur gjendje debitorë të cilat nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nuk i janë dërguar plotësisht Drejtorisë së Financës për kontabilizim.

Pa zbatuar

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e procedurave të prokurimit të mos lidh kontrata shërbimi/ zbatimi në subjektet që janë debitorë ndaj Bashkisë Sarandë për detyrimet debitorë të ardhura nga auditimet e KLSH-së apo institucionet të tjera.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomikë të marrin të gjitha masat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për vjeljen e detyrimeve në shumën 163,812,712 lekë, sipas listës analitike që disponon Sektori i Financës në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Koment: Nga auditimi rezultoi se nuk janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi

Pa zbatuar

7.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektorin e Menaxhimit të kontratave), Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llog. 202 “Studime dhe projekte”, duke evidentuar të gjitha projekteve të prokuruar dhe vënë në zbatim gjatë periudhave ushtrimore dhe vlera e tyre ti kapitalizohet investimet sipas destinacionit të llogarive 212 ose 213

Koment: Nga auditimi rezultoi se vlera e projekteve e zbritur nga llogaria “studime dhe projekte” “ne vleren 84,118,703 lek ju eshte shtuar vleres perkatese te aktiveve ne vleren 39,844,651 lek llog 210, “toka troje terrene” dhe 46,618,151 lek ne llog 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”

Zbatuar

8.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në shumën totale prej 115,397,833 lekë dhe për 16 artikujnë vlerën 78,696,463 lekë që nuk i përkasin kësaj llogaritë të kontabilizohen në llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në shumën 38,169,299 lekë për 4 artikuj dhe llog. 211 “Pyje dhe plantacione” në shumën 40,527,164 lekë për 12 artikuj, etj

Koment: Nga auditimi rezultoi se është sistemuar inventari sipas rekomandimit në fund të 2023.

Zbatuar

9.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,134,852,828 lekë duke i shtuar vlerën e konstruksionit ndër vite (investimit), si dhe sistemimin 25 artikuj aktive materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 8,282,128 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 40,376,675 lekë, llog. 202 “Studime e projekte” në vlerën 272,152 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 6,090,987 lekë, etj. Të inventarizohet me analizë të veçantë për çdo artikullvlera prej 1,761,146 lekë, e cila është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”.

Koment: Nga auditimi rezultoi se është bërë sistemimi në llogaritë përkatëse sipas vlerave të rekomanduara.

Zbatuar

11.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për transferimin e të gjitha aktiveve që nuk i përkasin kësaj bashkie, kryesisht të 6 artikuj në vlerën 582,222,531 lekë që i përkasin Ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizime Sarandë. Të analizohet me kujdes llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për investimet e kryera në fushën e ujësjetllës dhe për objektet e përfunduara dhe marrë në dorëzim të bëhet transferimi i tyre në Ndërmarrjen së Ujësjetllës Kanalizime Sarandë. Të analizohet vlera prej 29,568,137 lekë e cila është emërtuar “Rikonstruksion”, duke evidentuar çfarë përfaqëson.

Koment: Nga auditimi rezultoi se janë ngritur urdhrat e transferimit dhe po vijon puna për sistemimet në kontabilitet

Në proces zbatimi

13.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë bruto 76,117,705 lekë për kontabilizimin gabim të 8 artikuj aktive materiale në vlerën 1,814,418 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”.

Koment: Nga auditimi rezultoi se me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023, janë bërë sistemimet e vlerave sipas rekomandimit.

Zbatuar

14.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për zberthimin e llogarive 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 115,397,833 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 31,804,000 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,134,552,828 lekë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,382,659,240 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 76,117,705 lekë, në përcaktimin e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për A. kull, të vlerës së plotë të çdo aktivi, nga vlera fillestare dhe shtesat gjatë viteve.

Koment: Nga auditimi rezultoi se me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023, janë bërë sistemimet e vlerave sipas rekomandimit.

Zbatuar

14.2. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për hapjen e kartelave

kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Koment: Nga auditimi rezultoi se me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023, janë bërë sistemimet e vlerave sipas rekomandimit.

Zbatuar

14.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa për evidentimin dhe regjistrimin e pronave me certifikatë pronësi dhe në bashkëpunim me Eksperte vlerësuar të licencuar të aseteve për pronat e certifikuar me certifikatë pronësi por pa vlerë të bëhet vlerësimi i tyre dhe të futen në kontabilitet.

Koment: Nga auditimi rezultoi se është ngritur urdhri i punës dhe janë ndërmarrë hapat e parë për nisjen e aplikimeve për regjistrimin e pronave sipas VKM.

Në proces zbatimi

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave, të analizojë të gjitha investimet në proces për fazën në të cilët ato ndodhen, ku për investimet e përfunduara dhe marrë në dorëzim të bëhet kapitalizimi i llogarisë përkatëse sipas investimit. Ndërsa për investimet të cilat nuk janë mbyllur me akt marrje në dorëzim të bëhet kontabilizimi i tyre në llogarinë 231“Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në fazën e përfundimit.

Koment: Nga auditimi rezultoi se po punohet hap pas hapi sipas fazave të ecurisë së zbatimit të projekteve.

Në proces zbatimi

16.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Sarandë dhe me Degën e Thesarit të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet që janë marrë në dorëzim konform përcaktimeve në kontratë, të bëjnë njoftimet e subjekteve për marrjen e garancive të punimeve në masën 5%. Në rast mos plotësimi i kushteve ose refuzimit nga subjektet ti kërkohet Degës së Thesarit Sarandë kalimin e fondeve në favor të autoritetit kontraktor si e ardhur për mos përmbushje të kushteve të kontratës.

Koment: Nga auditimi rezultoi se Drejtoria Ekonomike operon rast pas rasti sipas njoftimeve nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pas marrjeve në dorëzim për secilin projekt.

Në proces zbatimi

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit (kryesisht aktivitet social kulturore), të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Koment: Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2023, shpenzimet kryesisht për aktivitete social kulturore janë realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël.

Zbatuar

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me

Drejtorinë Juridike (Njësia e Prokurimit), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën. Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

Koment: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të realizuara gjatë vitit 2023 rezulton se vijon të përsëriten këto mangësi.

Pa zbatuar

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë, të angazhojë persona të kualifikuar në komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

Koment: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2023 rezulton se në cdo rast kryesisht për objekte prokurimi që lidhen me punime civile, titullari ka angazhuar ekspert të fushës në përgatitjen e projekteve, specifikimeve teknike dhe fondit limit.

Zbatuar

19.2. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Sarandë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kritereve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Koment: Për sa më lart nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion

Pa zbatuar

19.3. Rekomandimi: Gjithashtu për 5 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përllogaritet penalteti përkatës dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Koment: Për sa më lart nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion

Pa zbatuar

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Sarandë sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

Koment: Nga auditimi rezultoi se edhe gjatë vitit 2023 Bashkia Sarandë nuk ka patur sektor më vete për menaxhimin e borxhit.

Pa zbatuar

21.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

Koment: Nga auditimi i procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit gjatë vitit 2023 rezultoi se

vijon të ketë mangësi në këtë aspekt.

Pa zbatuar

22.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Koment: Nga auditimi i procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit gjatë vitit 2023 rezultoi se vijon të ketë mangësi në këtë aspekt.

Pa zbatuar

23.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Koment: Nga auditimi i procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit gjatë vitit 2023 rezultoi se vijon të ketë mangësi në këtë aspekt.

Pa zbatuar

24.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Koment: Nga auditimi i procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit gjatë vitit 2023 rezultoi se vijon të ketë mangësi në këtë aspekt.

Pa zbatuar

25.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Koment: Nga auditimi i procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit gjatë vitit 2023 rezultoi se vijon të ketë mangësi në këtë aspekt.

Pa zbatuar

26.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe (KTP).

Koment: Nga auditimi i procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit gjatë vitit 2023 rezultoi se vijon të ketë mangësi në këtë aspekt.

Pa zbatuar

27.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane, të merren masa për të miratuar leje ndërtimin e shtesave të merret konfirmim nga inxhinieri i licensuar me anë të akt-ekspertizës së shtesa e ndërtuar mbi objektin ekzistues nuk ndikon në qëndrueshmërinë dhe aftësinë mbajtëse të strukturës

Koment: Nga auditimi i procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit gjatë vitit 2023 rezultoi se vijon të ketë mangësi në këtë aspekt.

Pa zbatuar

28.1. Rekomandim: Nga ana e IMT bashkia Sarandë të merren masa për të vendosur gjoba për kundërvajtjet e konstatuara sipas legjislacionit në fuqi konkretisht ligji 107/2014 neni 52 pika e.) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Koment: Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2023 është vijuar me vendosjen e gjobave por kjo nuk është shoqëruar me konfiskime për interes publik, po kështu edhe rastet e prishjeve kanë qenë shumë të rralla.

Zbatuar pjesërisht

29.1. Rekomandim: Nga ana e IMT bashkia Sarandë të merren masa për gjobat e vendosura të shoqërohen më relacion përkatës dhe shpjegues se çfarë lloj shkelje është konstatuar e shoqëruar me imazhe dhe sipërfaqe ekzakte.

Koment: Nga auditimi i procedurave gjatë vitit 2023 rezultoi se gjobat nuk shoqërohen me relacione shpjeguese apo imazhe.

Pa zbatuar

30.1. Rekomandim: Nga ana e IMT bashkia Sarandë të merren që kundërvajtjet e konstatuara të dalin me vendime sipas legjislacionit në fuqi ligji 9780 “Për inspektimin e ndërtimit” neni “Neni 13 Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet Brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit, inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës/qarkut/kombëtar nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.

Koment: Nga auditimi i procedurave gjatë vitit 2023 rezultoi se ky rekomandim nuk është aplikuar në të gjitha rastet.

Zbatuar pjesërisht

31.1. Rekomandim: Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren masa që kundërvajtjet e konstatuara dhe vendimet e mbajtura të ekzekutohen sipas legjislacionit në fuqi, Neni 13 “Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet” e Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, që shprehet: Vendimet e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë, sipas llojit të shkeljes. Përfundimisht, vendimet për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm kanë afat deri në 30 ditë për zbatimin e tyre.

Koment: Nga auditimi i procedurave gjatë vitit 2023 rezultoi se nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore për prishjen e objekteve.

Zbatuar pjesërisht

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 190,000 lekë pa TVSh nga OE “J. K.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 20.12.2020, me objekt “Rikualifikim dhe shtrim të rjetit rrugor Ksamil”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Koment: Për sa më lart nuk u dokumentua në asnjë lloj forme njoftimi apo arkëtimi i detyrimit.

Pa zbatuar

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 52,000 pa TVSh nga OE “N.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11 prot., datë 14.11.2022, me objekt: “Riveshje Rr. “Musa Demi”, Shiku & Trotuari Rr. “Lefter Talo” dhe rikualifikim i rrugës “Janaq Kumi”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera

Koment: Për sa më lart nuk u dokumentua në asnjë lloj forme njoftimi apo arkëtimi i detyrimit.

Pa zbatuar

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 78,900 lekë pa TVSh nga OE “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, rruga “Apostol Çuni” mbi “Adem Shemen”, mbi Komisariat dhe rikualifikim i rrugëve në Berdenesh, Çuk, Manastir”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera

Koment: Për sa më lart nuk u dokumentua në asnjë lloj forme njoftimi apo arkëtimi i detyrimit.

Pa zbatuar

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të ngrejë një grup pune për të evidentuar numrin e parkimeve të rezervuara nga subjekte private që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë si dhe të shikohet mënyra e taksimit e të gjitha parkimeve të rezervuara.

Koment: Për këtë rekomandim nuk është dokumentuar në asnjë lloj forme marrja e masave

Pa zbatuar

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 380,000 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë nga parkimet e rezervuara.

Koment: Për sa më lart nuk u dokumentua në asnjë lloj forme njoftimi apo arkëtimi i detyrimit

Pa zbatuar

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative

dhe ligjore për dy Subjektet “P.” ShPK dhe “I.-B.” ShPK, të cilët nuk kanë kontratë me Bashkinë Sarandë dhe kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kollusore pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet. Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë “P.” ShPK dhe “I.-B.” ShPK pa kontratë qiraje deri më 31.12.2022, të kërkohet detyrimi në vlerën 13,932,000 lekë, nga e cila: për shoqërinë “P.” shpk në vlerën 5,778,000 lekë dhe shoqërinë “I.-B.” ShPK në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

Koment: Për sa më lart nuk u dokumentua në asnjë lloj forme njoftimi apo arkëtimi i detyrimit.

Pa zbatuar

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe Drejtorja e Shërbimeve duhet të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të kryer verifikime në terren për të gjitha kontratat e lidhura me subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit, nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara.

Koment: Për këtë rekomandim nuk është dokumentuar në asnjë lloj forme marrja e masave

Pa zbatuar

3.2. Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik Financiar, të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore prej 6,106,500 lekë, nga subjektet e individ private.

Koment: Për sa më lart nuk u dokumentua në asnjë lloj forme njoftimi apo arkëtimi i detyrimit

Pa zbatuar

4.1. Rekomandimi: Drejtorja e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

Koment: Për këtë rekomandim nuk është dokumentuar në asnjë lloj forme marrja e masave

Pa zbatuar

4.2. Rekomandimi: Drejtorja e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 13,433 mijë lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Koment: Nga auditimi i realizimit të të ardhurave gjatë vitit 2023 rezulton se vijon të konstatohet fenomeni i mos arkëtimin të detyrimeve me pasojë të ardhura të munguaratë, ndërkohë që nuk është marrë ndonjë masë për vjeljen e detyrimit prej 13,433 lekë

Pa zbatuar

5.1. Rekomandimi: Drejtorja e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim

vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 321,676 mijë lekë.

Koment: Nga auditimi i realizimit të të ardhurave gjatë vitit 2023 rezulton të mbetet e njëjta problematikë sa i takon gjendjes debitore nga taksat dhe tarifat vendore.

Pa zbatuar

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 3,195,540 lekë, nga kontratat e qirave. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.

Koment: Për sa më lart nuk u dokumentua në asnjë lloj forme njoftimi apo arkëtimi i detyrimit

Pa zbatuar

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 85,315 mijë lekë, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë

Koment: Nga auditimi i realizimit të të ardhurave gjatë vitit 2023 rezulton të mbetet e njëjta problematikë sa i takon gjendjes debitore nga taksat dhe tarifat vendore.

Pa zbatuar

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

Koment: Nga auditimi i realizimit të të ardhurave gjatë vitit 2023 rezulton të mbetet e njëjta problematikë sa i takon gjendjes debitore nga taksat dhe tarifat vendore. Ndërkohë nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për ngritjen e grupeve të punës apo korrespondencë me Ministrinë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Pa zbatuar

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Sarandë të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrimit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 21,120,000 lekë.

Koment: Nga auditimi i realizimit të të ardhurave gjatë vitit 2023 rezulton të mbetet e njëjta problematikë sa i takon gjendjes debitore nga taksat dhe tarifat vendore.

Pa zbatuar

9.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të bashkërendojnë punën

për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt (Nius) sekondarë dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore. Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pa maturuar në vlerën 1,900,000 lekë ndaj 20 subjekteve.

Koment: Për sa më lart nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi

Pa zbatuar

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Administratorin e Njesisë Administrative Ksamil, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrin të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2022, rezultojnë 4,280,400 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Koment: Nga auditimi i realizimit të të ardhurave gjatë vitit 2023 rezulton të mbetet e njëjta problematikë sa i takon gjendjes debitore nga taksat dhe tarifatat vendore.

Pa zbatuar

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 87,396 mijë lekë.

Koment: Për sa më lart nuk rezulton të jenë marrë masa për ndjekien e të gjitha procedurave administrative dhe gjyqësore pasi gjendja debitore nga taksat familjare mbetet problematike.

Pa zbatuar

12.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Koment: Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 Bashkia Sarandë ka vijuar të arkëtojë gjoba të vendosura por ende ka gjendje debitore.

Në proces zbatimi

12.2. Rekomandimi: Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtitimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Sarandë.

Koment: Për sa më lart nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi

Pa zbatuar

13.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Koment: Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 Bashkia Sarandë ka vijuar të arkëtojë gjoba të vendosura por ende ka gjendje debitore.

Në proces zbatimi

13.2. Rekomandimi: Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Sarandë.

Koment: Për sa më lart nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi

Pa zbatuar

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 25,675 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Koment: Nga auditimi i realizimit të të ardhurave gjatë vitit 2023 rezulton të mbetet e njëjta problematikë sa i takon gjendjes debitore nga taksat dhe tarifatat vendore.

Pa zbatuar

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Kryeinspektorin e IMTV të ndjekin me përpikmëri të gjitha rrugët administrative dhe ligjore kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për arkëtimin e vlerës 22,515,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Koment: Për sa më lart nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi

Pa zbatuar

15.2. Rekomandimi: Gjithashtu, IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Koment: Për sa më lart nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi

Pa zbatuar

16. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me sektorin e policisë bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 521,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Koment: Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 Bashkia Sarandë ka vijuar të arkëtojë gjoba të vendosura por ende ka gjendje debitore.

Në proces zbatimi

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin e subjekteve dhe arkëtimin e vlerës 2,887,109 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët,

respektivisht:

- vlera 2,771,395 lekë nga investitorit Xh. M..

- vlera 115,624 lekë nga investitori Z. F..

Koment: Për sa më lart nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi

Pa zbatuar

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (Njësia e Prokurimit), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën. Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

Koment: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të realizuara gjatë vitit 2023 rezulton se vijon të përsëriten këto mangësi.

Pa zbatuar

E. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Sarandë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Koment: Nga auditimi rezulton se nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e masave disiplinore ndaj punonjësve.

Pa zbatuar

III. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë Sarandë, u konstatua se:

- Në lidhje me komponentin e “Mjedisi të Kontrollit”, nuk ka procedura të sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe vjetore të trajnimit për zhvillimin e stafit.

- Institucioni nuk ka një procedurë të miratuar në lidhje me vlerësimin e performancës së punonjësve; Nuk ka një plan menaxhimi për veprimet korrigjuese. Nga ana e njësive të varësisë nuk ka raporte në lidhje me veprimtaritë e tyre. Nuk ka një rregullore të brendshme, ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit.

-Në lidhje me komponentin e “Menaxhimit të Riskut”, nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Sarandë. Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë Bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA, si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë. Nuk ka një plan veprimi të mirfilltë për vlerësimin e një risku direkt me relizimin e objektivave specifike si dhe nuk është kryer vlerësimi i riskut të mashtrimit. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut.

- Në lidhje me komponentin e “Aktivitet e Kontrollit”, Bashkia Sarandë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm, si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT si dhe mungon gjurma e auditimit për funksionimin e sistemeve të IT.

- Në lidhje me komponentin e “Informimi dhe Komunikimi”, nuk ka një procedurë të shkruar për të siguruar që menaxherët dhe personeli i strukturave të bashkisë të informohen për vendimet dhe projektet që mund të ndikojnë në veprimet dhe përgjegjësitë e tyre, përveç rasteve kur e kërkon ligji për publikim. Nuk ka raporte periodike të performancës së bashkisë dhe as publike vjetore në lidhje me shërbimet publike.

- Në lidhje me komponentin e “Monitorimi”, konstatohet se mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka një monitorim të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen e objektivave, kryesisht mbi kontrollin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë mbi veprimtarinë, duke mbajtur në konsideratë parimet e ekonomicitetin, eficientë dhe efektivitetin.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 11, 15, 16, 18/1, 19, 21 dhe 27; si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 15-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Sarandë, të marrë masa për analizimin e mangësive, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në dobi të veprimtarisë Institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së strukturës së auditit të brendshëm në Bashkinë Sarandë, u konstatua se për vitin 2023 janë planifikuar 8 auditime, të cilat janë realizuar në numër. Megjithatë, është evidentuar se ka pasur devijime nga plani fillestar i auditimit, të cilat nuk janë të dokumentuara dhe shoqëruar me analiza të qarta ose argumentime që justifikojnë këto ndryshime. Kjo praktikë bie ndesh me parimet e planifikimit të bazuar në risk, duke cenuar

transparencën, objektivitetin dhe efektivitetin e funksionit të auditimit të brendshëm.

- Nga auditimi i dosjeve për vitin 2023 u konstatua se nuk është kryer një analizë e thelluar dhe e dokumentuar mbi identifikimin dhe vlerësimin e riskut. Gjithashtu, mungon dokumentimi i analizës për hartimin e testeve të auditimit si dhe planet e veprimit për adresimin e gjetjeve në entitetet e audituara.

- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2023 nuk ka hartuar një program të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me kërkesat e kuadrit rregullator për funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

- Gjatë vitit 2023, nuk janë mbuluar me auditim fushat e identifikuara me risk të lartë, si: vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, procesi i dhënies së lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, prokurimet publike dhe auditimi i subjekteve të teknologjisë së informacionit.

- Nga auditimi i projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare të auditimit, u konstatua mangësi në strukturën dhe formulimin e përmbajtjes së tyre, përfshirë në përgatitjen e opinioneve të auditimit, të cilat nuk janë hartuar në përputhje të plotë me standardet përkatëse.

- Nga auditimi i përbërjes së strukturës së auditimit të brendshëm rezultoi se prej 3 (tre) punonjësve në organikën e saj, 1 (një) prej tyre nuk është i certifikuar.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” nenet 10, 11, 12, 14, 19; UMF nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kreu VI dhe Kreu VII. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1., faqe 15-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Strukturat përkatëse në Bashkinë Sarandë, të marrin masat për plotësimin e strukturës me auditues të certifikuar, si dhe në hartimin e planit vjetor të analizohen e përfshihen subjekte me risk të lartë për sigurimin e mirë funksionimit të tyre në zbatim të legjislacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Strukturës së Drejtorisë së të Ardhurave, për vitin 2023 u konstatuan mangësi në mirë përcaktimin e sektorëve dhe specialistëve, pasi nuk është ngritur struktura e detyrimeve të pa mbledhura nga taksat dhe tarifat, duke sjellë një përkeqësim të dukshëm të situatës së detyrimeve, të cilat kanë vazhduar të rriten vit pas viti. Në vitin 2022, detyrimet e pa mbledhura ishin 409,072 mijë lekë, ndërsa në vitin 2023 ato arritën në 748,910 mijë lekë, me një rritje prej 339,837 mijë lekë. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se për mbledhjen e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave është angazhuar vetëm një specialist, situatë e cila cënon efikasitetin e monitorimit dhe mbledhjes së detyrimeve, duke mos shfaqur përmirësime në këtë fushë me risk të lartë.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 22.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2., faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe kryerjen e analiza periodike për ndjekjen e ecurisë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Për këtë periudhë, numri i bizneseve është rritur krahasuar me vitin 2022, me 619 subjekte të biznesit të vogël dhe 91 subjekte të biznesit të madh. Megjithatë, Drejtoria e të

Ardhurave në Bashkinë Sarandë nuk ka realizuar një analizë mbi impaktin e kësaj rritjeje në procesin e planifikimit të të ardhurave, dhe nuk ka vlerësuar nëse është marrë parasysh gjatë planifikimit tendenca në rritje e numrit të bizneseve. Kjo situatë tregon një planifikim të paargumentuar dhe pa një analizë të plotë dhe të detajuar nga ana e Bashkisë Sarandë. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se nuk janë mbajtur regjistra manualë për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar, me qëllim rritjen e sigurisë së informacionit të disponuar. Po ashtu, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk kanë administruar në dosjet e bizneseve të subjekteve të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin deklaratat tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore, si dhe nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore mbi xhiron e subjekteve, i cili do të ishte i nevojshëm për aplikimin e taksave vendore në përputhje me llojin e biznesit (fizik/juridik), pasi referuar VKB-së tarifat kanë nivele të ndryshme.

Sa më sipër veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 7 dhe neni 16.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2., faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Sarandë, të marrë masa konkrete që gjatë procesit të planifikimit të të ardhurave të realizohen analiza të detajuara dhe gjithëpërfshirëse mbi ndikimin që sjell tendenca e rritjes së numrit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet tregtar nga viti në vit në realizimin e të ardhurave, me qëllim identifikimin sa më të saktë të treguesve të të ardhurave, si në fazën e planifikimit, ashtu dhe në atë të realizimit. Gjithashtu, të marrë masa konkrete, që në administrimin e dosjeve të bizneseve të përfshihen deklaratat tatimore mbi xhiron vjetore të parashikuar, duke kryqëzuar informacionin e disponueshëm nga Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Menjëherë dhe vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të lejeve minerare të dhëna nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që ndodhen në territorin e Bashkisë Sarandë, u konstatua se 3 (tre) subjekte ushtrojnë aktivitetin si më poshtë:

1. Shoqëria “A.” ShPK me NIPT “J.....P”, është lidhur kontrata me Bashkinë Sarandë me nr.2860, datë 27.06.2022, me afat kohor 1 vjeçar, në shumën 1,069,594 lekë.

2. Shoqëria “P.” ShPK me NIPT “K.....G”, shfrytëzon aktivitetin nëpërmjet lejes minerare me nr.661/1, datë 19.12.2022, me sipërfaqe të shfrytëzueshme 10.7 ha.

3. Shoqëria “I.-B.” ShPK me NIPT “J.....E”, shfrytëzon sipërfaqe minerare prej 3.5 ha në pronësi të vet dhe sipërfaqe prej 15.1 ha në pronësi shtet.

Për sipërfaqet e mësipërme, rezulton se gjatë vitit 2023 Bashkia Sarandë është pajisur pjesërisht me certifikatë pronësie për fondin pyjor/kullor që i kanë kaluar në pronësi nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.18, datë 11.03.2020.

Nga ana e Bashkisë Sarandë, u konstatua se nuk është vepruar me vendimet e pezullimit të aktivitetit të këtyre subjekteve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë mbi sipërfaqet e pronësisë të certifikuara deri në zbritjen e fondit pyjor nga sipërfaqet e kaluara me VKM, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”, neni 17.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2., faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Bujqësisë, Pyje, Kullota dhe Kullimit në Bashkinë Sarandë, të marrë masa konkrete që për subjektet e evidentuara që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Sarandë, të hiqen nga fondi pyjor dhe kullor zona e lejuar e shfrytëzimit, duke i'u drejtuar me shkresa përcjellëse Ministrive të Linjës dhe të kalojnë si pasuri minerare në varësi të tyre. Gjithashtu të merren masa konkrete për ndalimin e aktivitetit për subjektet që ushtrojnë

veprimtarinë në fushën e shfrytëzimit me karrierë të mineraleve ndërtimore deri në momentin e heqjes së këtyre zonave nga fondi pyjor dhe kullësor i Bashkisë Sarandë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e papaguara deri më 31.12.2023 ndaj Bashkisë Sarandë arrinte në shumën prej 748,910,158 lekë.

Këto detyrime ndahen në dy grupe kryesore; 3,300 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh me një detyrim total prej 487,483,824 lekë dhe 18,915 familje debitorë me një detyrim total prej 261,426,334 lekë, për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore.

Debitorët nga subjektet fizik/juridik

Në fund të vitit 2022, kanë qenë 2,567 debitorë me një detyrim prej 321,676 mijë lekë, ndërsa deri në fund të vitit 2023 ky numër është rritur në 3,300 debitorë, me një detyrim total në shumën prej 487,483 mijë lekë. Gjatë vitit 2023, janë shtuar 733 debitorë, duke krijuar një rritje të detyrimeve në shumën prej 165,807 mijë lekë, situatë kjo e cila tregon një punë të dobët nga ana e Drejtorisë së Të Ardhurave në Bashkinë Sarandë për mbledhjen e detyrimeve, duke mos ndërmarrë plane konkrete dhe monitorime të vazhdueshme për të ulur numrin e tyre, i cili ka ardhur në përkeqësim nga viti në vit.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se Drejtoria e të Ardhurave nuk ka përllogaritur kamatëvonesën rast pas rasti për subjektet debitorë, si dhe për 312 bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt-konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit.

Debitorët familjarë

Në fund të vitit 2022, kishte 11,377 debitorë familjarë me një detyrim total në shumën prej 87,396 mijë lekë, ndërsa deri në fund të vitit 2023 ky numër është rritur në 18,915 debitorë, me një detyrim total në shumën prej 261,426 mijë lekë. Gjatë vitit 2023, ka pasur një rritje të konsiderueshme me 7,538 debitorë familjarë, duke sjellë një rritje të detyrimeve në shumën prej 174,030 mijë lekë, situatë kjo e cila tregon një punë të dobët nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave në Bashkinë Sarandë për mbledhjen e detyrimeve, duke mos ndërmarrë plane konkrete dhe monitorime të vazhdueshme për të ulur numrin e tyre, i cili ka ardhur në përkeqësim nga viti në vit. Në lidhje me familjet debitorë, u konstatua se edhe pse debitorët janë përcjellë në Drejtorinë e të Ardhurave nga zyrat e taksave në NJA, specialisti i mbledhjes së borxhit nuk ka ndërmarrë asnjë masë ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë, siç janë njoftimi i vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimi i llogarive bankare, etj.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88 deri 104, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 3 dhe 4, të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 64.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2., faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore e Bashkisë Sarandë, të marrë të gjitha masat administrative, për arkëtimin detyrimeve tatimore të pa arkëtuara nga 3,300 subjekteve fizik/juridik në shumën **487,483,824 lekë** dhe nga 18,915 familje në shumën **261,426,334 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksës bujqësore konstatohet se për vitin 2023, realizimi paraqitet në masën 58% ose nga 6,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 3,510 mijë

lekë. Nga auditimi i të dhënave sipas fondit të disponueshëm të tokës bujqësorë konstatohet se ka mospërputhje gjatë planifikimit të taksës së tokës bujqësore, ku nga ana e Bashkisë Sarandë për planifikimin e kësaj takse është përcaktuar në shumën 6,000,000 lekë, e cila krahasuar me fondin e disponueshëm të tokës prej 1,665 ha i kategorisë IV me çmim për ha prej 1,665 lekë, konstatohet se planifikimi është në shumën 6,993,000 lekë, për rrjedhojë nga ana e Bashkisë Sarandë është planifikuar më pak në shumën 993,000 lekë, duke mos paraqitur një planifikim real dhe të mirë analizuar.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2., faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Sarandë, të analizojnë faktorët dhe të marrin masa për planifikimin real dhe të bazuar të taksës për tu arkëtuar nga fondi i tokës bujqësore sipas kategorisë së saj.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Sarandë, mbi realizimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, u konstatua se nga ana e DVASHK Sarandë është dërguar informacion për secilin person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale në mënyrë të tillë që të kryhen përlllogaritjet e vlerës së taksës. Nga auditimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale konstatohet se nuk janë të gjitha masat për arkëtimin e shumës nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, për 2,323 subjekte në shumën 95,756,000 lekë në fund të vitit 2023.

Nga auditimi u konstatua se në fillim të vitit 2023 debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë mbi ndërtimet informale, paraqiten me një shumë prej 85,315,000 lekë. Gjatë vitit 2023, detyrimet janë rritur me shumën prej 10,441,000 lekë, duke e çuar totalin në fund të vitit 2023 në shumën prej 95,756,000 lekë. Kjo situatë e përkeqësuar e mbledhjes së të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, ka ardhur si pasojë e mos ndjekjes së të gjitha hapave dhe masave shtrënguese për arkëtimin e tyre.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 89, pika 2 dhe neni 4, pika 2, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 22/5, pika 1 dhe Paketën Fiskale të vitit 2023, pika A.4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2., faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në Bashkinë Sarandë, të analizojnë faktorët dhe të marrin masa për arkëtimin e detyrimeve të lindura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në shumën 95,756,000 lekë sipas listës së subjekteve në Aneksin nr.2.6.1.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, taksa e fjetjes në hotel në fillim të vitit është parashikuar në shumën 24,000 mijë lekë dhe është realizuar në fund të vitit 2023 në shumën 37,132 mijë lekë, ose me mbi realizim në masën 155%, i pa argumentuar dhe i pa analizuar nga ana e Bashkisë Sarandë. Në krahasim me vitin 2022, ku taksa e fjetjes në hotel është realizuar në shumën

18,456 mijë lekë, në vitin 2023 ka ardhur në rritje.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e Bashkisë Sarandë, aplikimi i tarifës bëhet sipas vetë deklarimeve të subjekteve. Drejtoria e të Ardhurave, përkatësisht Sektori i Terrenit, nuk ka ndërmarrë masa për monitorimin dhe evidentimin e dhomave dhe shtretërve në hotelet respektive, duke mos siguruar hartimin e një regjistri të detajuar. Mungesa e këtij regjistri e bën të pamundur verifikimin real të numrit të personave të akomoduar, veçanërisht gjatë sezonit turistik veror. Gjithashtu, u konstatua një rritje e ndjeshme e subjekteve debitorë ndaj kësaj takse. Në datën 31.12.2023, rezultojnë 789 subjekte debitorë me një detyrim total prej 97,098 mijë lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe Paketën Fiskale të vitit 2023, pika A.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2., faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore në Bashkinë Sarandë të marrë masa të menjëhershme për identifikimin dhe regjistrimin e plotë të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelierisë; Krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri të detajuar me të dhëna mbi kapacitetet e akomodimit të secilit subjekt (numri i dhomave, shtretërve, etj.); Monitorimin dhe përditësimin periodik të këtyre të dhënave për të garantuar korrektësinë e vetë-deklarimeve dhe mbledhjen e drejtë të taksave;

Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore të marrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjor, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në shumën prej 97,098 mijë lekë, nga subjektet që operojnë në fushën e hotelierisë, të identifikuar sipas Aneksit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në fund të vitit 2022, stoku i detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Sarandë është pasqyruar në shumën totale prej 7,833,710 lekë, nga të cilat 1,132,200 lekë janë të regjistruara në llogaritë 401–408, ndërsa 6,701,510 lekë në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Ndërsa, në raportimin zyrtar të dërguar në Ministrinë e Financave (MF), është deklaruar një shumë prej 1,223,700 lekë, duke rezultuar në një diferencë në shumën prej 6,610,010 lekë midis detyrimeve të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre të raportuara në nivel qendror. Kjo situatë tregon për mungesë përputhshmërie dhe transparence në raportimin financiar, si dhe për mungesë kontrolli të brendshëm në evidentimin dhe deklarimin e saktë të detyrimeve financiare. Gjithashtu, për periudhën ushtrimore të vitit 2023, u konstatua se nuk janë likuiduar 16 fatura në vlerën 5,897,452 lekë, brenda afatit 30 ditor nga momenti i paraqitjes së tyre.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe pikën 15 në UMFE nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për hartimin e një buxheti sa më real dhe të zbatueshëm, në përputhje me të ardhurat e pritshme dhe detyrimet ekzistuese. Gjithashtu, të sigurohet miratimi në Këshillin Bashkiak i një plani të detajuar për likuidimin e faturave të prapambetura, duke përcaktuar qartë radhën e shlyerjes së tyre, si dhe të kryhet rakordimi i plotë i detyrimeve të pasqyruara në pasqyrën financiare me të dhënat e raportuara në Ministrinë e

Financave, me qëllim garantimin e saktësisë dhe transparencës financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit, rezultoi se nga Bashkia Sarandë, është kryer verifikimi fizik për llogarisë 218 në shumën 4,906,563 lekë, për artikujt: Inventar i pajisjeve dhe mobileve në vlerën 1,387,568 lekë, Inventar elektronik në vlerën 3,809,722 lekë, materiale në përdorim në vlerën 1,187,118 lekë dhe kondicionerë në vlerën 105,000 lekë, sipas listës bashkëlidhur relacionit të miratuar nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe procesverbalit të miratuar nga titullari i Bashkisë Sarandë. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej Nëpunësit Autorizues të institucionit.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, u konstatua se nga Bashkia Sarandë nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit të aktiveve afatshkurtër dhe afatgjatë. Gjithashtu, edhe në rastet kur ky proces është realizuar nuk është i plotë dhe nuk përfshin të gjitha njësitë apo kategoritë e aktiveve Si rrjedhojë, në hartimin e pasqyrave financiare është marrë për bazë gjendja kontabël, pa u krahasuar dhe verifikuar me gjendjen reale fizike të aktiveve, duke cenuar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar të raportuar, si dhe duke mos garantuar saktësinë e pasqyrave financiare të Bashkisë.

Veprime në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, si dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në faqe 61-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve që disponon dhe hartimin e një regjistri të saktë të aktiveve, duke evidentuar vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia, për të gjitha aktivet.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në Bashkinë Sarandë u konstatua se:

- Nuk janë ngritur komisione për kryerjen e verifikimeve të aktiveve për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, e cila paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 83,323,719 lekë.

- Nuk është hartuar raport lidhur me inventarizimit fizik të aktiveve, vlerësim paraprak për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin nëse ka diferenca apo jo për gjendjen e aktiveve.

- Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, rezulton se nuk ka informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes një regjistrin kontabël ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me

gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për këto llogari dhe dhënien e opinionit për to. Për këto objekte nuk është kryer inventar dhe verifikim fizik pasi nuk janë pajisur me certifikatë pronësie, për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie, veprime në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 85, germa “c”.

- Nuk janë marrë masat e duhura për të reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse, 5,133.81 ha, nga të cilat 430.9 ha të sipërfaqeve të pyjeve dhe 783.3 ha të sipërfaqeve të kullotave të kaluara në favor të saj sipas VKM-së nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 59, shtojca nr. 57, e ndryshuar dhe VKM-në nr.684 datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në 433”. Kjo sjell rrjedhimisht mos pasqyrim të saktë dhe të drejtë të llogarisë 211, në mbyllje të Pasqyrave financiare të vitit 2023, veprime të cilat nuk janë në përputhje me UMFE nr.5 datë 21.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”” i ndryshuar pika 2.1.

- Gjatë vitit 2023 janë marrë 8 certifikata pronësie për pasuri të llojit kullotë dhe pyll, nga të cilat 4 certifikata me sipërfaqe totale 712.4 ha të llojit kullotë dhe 149.2 ha të llojit pyll. Këto certifikata pronësie nuk rezultojnë të evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2023 të Bashkisë Sarandë, në llogarinë 211, veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe nenin 15, me Ligjin nr.10 296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 74. (Më hollësisht trajtuar në faqe 61-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Struktura përkatëse për menaxhimin e aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa për evidentimin dhe regjistrimin e pronave me certifikatë pronësie dhe në bashkëpunim me Ekspertë vlerësues të licencuar të aseteve, të bëhet vlerësimi i pronave të regjistruara por pa vlerë, si dhe të vijohet me regjistrimin në kontabilitet.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023, rezultoi një gjendje e konsiderueshme e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën totale prej 672,416,005 lekë. nga e cila debitorë për taksa dhe tarifa vendore në shumën 487,483,824 lekë, ose 72.5% e totalit, dhe debitorë për detyrime të njohura si shpërblime dëmi, të rekomanduara ndër vite nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), në shumën 184,932,181 lekë, të trashëguara nga Bashkia dhe ish-Komunat.

Në lidhje me këto të fundit, rezultoi se Bashkia Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për arkëtimin e detyrimeve, dhe nuk ka ndjekur procedurat ligjore për ndjekjen e tyre brenda afateve përkatëse, duke kaluar afatet e kërimit për arkëtim.

Gjithashtu, u konstatua se disa prej subjekteve që figurojnë si debitorë ndaj Bashkisë, vijnë në përfshihen në procedura dhe të lidhin kontrata me të, pa mundur likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe mos lejimin e tyre në procedura.

Sa i përket debitorëve të taksave dhe tarifave vendore, evidentohet një rritje e debitorëve krahasuar me vitin 2022, në shumën 139,416,382 lekë, çka tregon për një performancë të ulët në mbledhjen

dhe menaxhimin e detyrimeve të akumuluar, duke ndikuar negativisht në të ardhurat e buxhetit të bashkisë dhe në planifikimin financiar afatmesëm. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10/2010, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015, neni 9, 11 dhe 12, me Ligjin nr.68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 40.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 61-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike, të analizojnë dhe të marrin masat për monitorimin dhe arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, në vlerën **totale prej 672,416,005 lekë** e cila përbëhet edhe nga vlera prej **184,932,181 lekë** të rekomanduara ndër vite nga KLSH-ja, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative e ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezultoi se në llogarinë 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,134,852,828 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,214,742,269 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, u konstatua se vlera 1,761,146 lekë është emërtuar “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare. Veprim në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 30, Aneksi 1, si dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (Më hollësisht trajtuar në faqe 61-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Sarandë të marrë masa për analizimin e llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për vlerën 1,761,146 lekë, e cila është emërtuar “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, duke evidentuar çfarë përfaqëson kjo vlerë dhe të bëhet klasifikimi përkatës në llogarinë kontabël.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,134,107,522 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,382,689,240 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat në vlerën 453,699,888 lekë, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, u konstatua se vlera 29,568,137 lekë është emërtuar “Rikonstruksion”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare. Veprim në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 30, Aneksi 1, si dhe me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75.

15.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë të marrë masat për analizimin e vlerës 29,568,137 lekë, e cila është emërtuar “Rikonstruksion”, duke evidentuar çfarë përfaqëson kjo vlerë dhe të bëhet klasifikimi përkatës në llogarinë kontabël.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi ligjshmërinë dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë, rezultoi se në 26 raste janë zhvilluar projekte artistike, aktivitete kulturore me vlerë 17,315,695 lekë, *për të cilat nuk janë kryer nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit*. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e këtyre shpenzimeve është kryer sipas Vendimit Nr.51, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë me shkresën Nr.2/1 Prot., datë 17.01.2022. Nga Bashkia Sarandë për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, rezultoi se është likuiduar shuma 17,315,695 lekë, e cila përbën shpenzime të kryera në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 7, 9 dhe nenet 65-70, Ligjin nr.25/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10/352, datë 18.11.2010, “Për Artin dhe Kulturën”, neni 20, 26, 29 dhe 32, si dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM-së nr.710, datë 24.11.2021, neni 8.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 61-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për të garantuar që të gjitha shpenzimet që lidhen me aktivitete kulturore dhe artistike, pavarësisht natyrës apo përmasës së tyre, të realizohen në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe standardet që rregullojnë përdorimin e fondeve publike. Ky proces duhet të jetë i hapur, i dokumentuar dhe i verifikueshëm, duke përfshirë zhvillimin e procedurave të rregullta të prokurimit për çdo projekt, me qëllim sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe konkurrencës në përdorimin e burimeve financiare publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që u vu në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezultoi se Bashkia Sarandë ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditë, me shkresën nr. 4122/2 prot., datë 10.10.2023, sipas të cilës janë pranuar të gjitha rekomandimet, është hartuar plani i masave për zbatimin e tyre, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për këtë qëllim. Sa i takon përcaktimet në pikën nr. 2, neni 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, rezulton se Bashkia Sarandë nuk ka përcjellë brenda afatit raportin mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve i cili duhet të dërgohej brenda 6 muajsh. Sa i takon nivelit të zbatimit të rekomandimeve rezultoi se:

Nga 41 masa organizative, janë pranuar 41 masa nga të cilat janë realizuar plotësisht 14 masa, janë realizuar pjesërisht 5 masa, në proces zbatimi 5 masa dhe nuk janë realizuar 17 masa.

Nga 3 masa për shpërblim dëmi janë pranuar 3 masa, të cilat nuk janë zbatuar.

Nga 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, është pranuar por nuk është zbatuar kjo masë.

Nga 23 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), janë pranuar 24 masa, janë në proces 3 masa dhe nuk janë zbatuar 21 masa.

Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Sarandë, konstatohet se nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore, pra rekomandimi është i pazbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 210-225 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Këshilli Bashkiak i Bashkisë Sarandë të analizojë në mënyrë të detajuar situatën lidhur me moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm, të identifikojë përgjegjësitë institucionale dhe individuale për

mospërbushjen e tyre, si dhe ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

Masa Organizative

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit.

1.3. Rekomandimi: Drejtori i Personelit dhe i Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit “Harta e proceseve të punës”.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë, Drejtori i Personelit dhe i Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

- Hartimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm.

- Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa si vijon:

- Hartimin dhe miratimin e një rregullore mbi përshkrimin e pozicioneve të punës në institucion, në bashkëpunim me nëpunësin civil, duke analizuar përshkrimet aktuale të pozicioneve të punës dhe për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil të jenë në përputhje me detyrat funksionale dhe kërkesat specifike të ligjit dhe VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionin e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

- Të planifikojë dhe të shpallë për tu plotësuar pozicionet e lira në shërbimin civil, në përputhje me strukturën e institucionit, duke u kujdesur që të realizojë procedurën në grup për kategorinë ekzistues.

- Të hartojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në fund të vitit 2022, në zbatim të afateve të përcaktuara në VKM nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin e pranimit në shërbimin civil”.

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Sarandë sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit dhe Drejtorinë e të ardhurave, të marrin masa për rakordimet vjetore të vlerës së debitorëve në fund të periudhës për të gjitha llojet e Taksave. Tarifave vendore, duke kryer kontabilizimin e tyre në pasqyrat financiare. Të kontabilizohet në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlera prej 74,782,000 lekë për taksën e ndikimit nga ndërtimet informale (ALUZNI) dhe detyrimet nga abonentët familjarë sipas aktmarrëveshjes me Nd. UK Saranda në shumën 259,314,461 lekë, si dhe të kontabilizohen vlera shpërbllim dëmi prej 10,317,550 lekë të rekomanduar dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 nga KLSH-ja, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 118, datë 22.7.2022.

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e procedurave të prokurimit të mos lidh kontrata shërbimi/ zbatimi në subjektet që janë debitorë ndaj Bashkisë Sarandë për detyrimet debitorë të ardhura nga auditimet e KLSH-së apo institucionet të tjera. Në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomikë të marrin të gjitha masat administrative e ligjore

në të gjitha shkallët për vjeljen e detyrimeve në shumën 163,812,712 lekë, sipas listës analitike që disponon Sektori i Financës në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (Njësia e Prokurimit), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën. Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

19.2. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Sarandë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kritereve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

19.3. Rekomandimi: Gjithashtu për 5 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përlllogaritet penaliteti përkatës dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Sarandë sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

21.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

22.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

23.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

24.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi

25.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

26.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe (KTP).

27.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Sarandë të të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane, të merren masa për të miratuar leje ndërtimin e shtesave të merret konfirmim nga inxhinieri i licencuar me anë të akt-ekspertizës së shtesa e ndërtuar mbi objektin ekzistues nuk ndikon në qëndrueshmërinë dhe aftësinë mbajtëse të strukturës

28.1. Rekomandim: Nga ana e IMT bashkia Sarandë të merren masa për të vendosur gjoba për kundërvajtjet e konstatuara sipas legjislacionit në fuqi konkretisht ligji 107/2014 neni 52 pika e.) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

29.1. Rekomandim: Nga ana e IMT bashkia Sarandë të merren masa për gjobat e vendosura të shoqërohen më relacion përkatës dhe shpjegues se çfarë lloj shkelje është konstatuar e shoqëruar me imazhe dhe sipërfaqe ekzakte.

30.1. Rekomandim: Nga ana e IMT bashkia Sarandë të merren që kundërvajtjet e konstatuara të dalin me vendime sipas legjislacionit në fuqi ligji 9780 “Për inspektimin e ndërtimit” neni “Neni 13 Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet Brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit, inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës/qarkut/kombëtar nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.

31.1. Rekomandim: Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren masa që kundërvajtjet e konstatuara dhe vendimet e mbajtura të ekzekutohen sipas legjislacionit në fuqi, Neni 13 “Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet” e Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, që shprehet: Vendimet e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të Bashkisë/Komunës/Qarkut/kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë, sipas llojit të shkeljes. Përgjatimisht, vendimet për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm kanë afat deri në 30 ditë për zbatimin e tyre.

B. Masa shpërblim dëmi

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 190,000 lekë pa TVSh nga OE “J. K.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 20.12.2020, me objekt “Rikualifikim dhe shtrim të rretit rrugor Ksamil”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 52,000 pa TVSh nga OE “N.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11 prot., datë 14.11.2022, me objekt: “Riveshje Rr. “Musa Demi”, Shiku & Trotuari Rr. “Lefter Talo” dhe rikualifikim i rrugës “Janaq Kumi”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 78,900 lekë pa TVSh nga OE “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, rruga “Apostol Çuni” mbi “Adem Shemen”, mbi Komisariat dhe rikualifikim i rrugëve në Berdenesh, Çuk, Manastir”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera

c. Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të ngrejë një grup pune për të evidentuar numrin

e parkimeve të rezervuara nga subjekte private që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë si dhe të shikohet mënyra e taksimit e të gjitha parkimeve të rezervuara.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 380,000 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë nga parkimet e rezervuara.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për dy Subjektet “P.” ShPK dhe “I.-B.” ShPK, të cilët nuk kanë kontratë me Bashkinë Sarandë dhe kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosorë pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet. Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë “P.” sh.pk dhe “I.-B.” ShPK pa kontratë qiraje deri më 31.12.2022, të kërkohet detyrimi në vlerën 13,932,000 lekë, nga e cila: për shoqërinë “P.” ShPK në vlerën 5,778,000 lekë dhe shoqërinë “I.-B.” ShPK në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe Drejtoria e Shërbimeve duhet të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të kryer verifikime në terren për të gjitha kontratat e lidhura me subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit, nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara.

3.2. Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik Financiar, të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore prej 6,106,500 lekë, nga subjektet e individ private.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 13,433 mijë lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimi tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj.) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 321,676 mijë lekë.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 3,195,540 lekë, nga kontratat e qirave. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe

Kontrollit të Territorit Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 85,315 mijë lekë, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Sarandë të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 21,120,000 lekë.

9.1. Rekomandimi: DAV Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt (Nius) sekondarë dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore. Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pa maturuar në vlerën 1,900,000 lekë ndaj 20 subjekteve.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Administratorin e Njesisë Administrative Ksamil, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të patakshme me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë "Familje", ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2022, rezultojnë 4,280,400 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 87,396 mijë lekë.

12.2. Rekomandimi: Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimin të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Sarandë.

13.2. Rekomandimi: Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimin të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Sarandë.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 25,675 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe

Kryeinspektorin e IMTV të ndjekin me përpikmëri të gjitha rrugët administrative dhe ligjore kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për arkëtimin e vlerës 22,515,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

15.2. Rekomandimi: Gjithashtu, IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin e subjekteve dhe arkëtimin e vlerës 2,887,109 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, respektivisht:

- vlera 2,771,395 lekë nga investitorit Xh. M..

- vlera 115,624 lekë nga investitori Z. F..

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

1.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (Njësia e Prokurimit), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën. Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

E. Masa disiplinore

KLSh mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germat b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Sarandë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSh-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit të përzgjedhura, rezultuan mangësi në të gjitha rastet sa i përket dokumentimit dhe respektimit në mënyrë kronologjike të hapave të ndjekur për realizimin e procedurës, pasi në asnjë rast dokumentacioni i mbajtur nuk protokollohet. Urdhrat, procesverbalet, kontratat, etj., përmbajnë formalisht numra apo data protokollit, pasi konstatohet se brenda një muaji disa dokumente njëherësh përmbajnë të njëjtin numër, pra nuk respektohet disiplina protokollare e regjistrimit me numër rendor. Po kështu, konstatohet se në asnjë rast projektet e punimeve të hartuara nga projektuesit nuk janë marrë në dorëzim nga sektori i urbanistikës, siç përcaktohet në kontratën mes palëve. Për pasojë nuk krijohet bindja e arsyeshme se në cilin moment janë kryer veprimet procedurale dhe a janë respektuar afatet nga njëri hap në tjetrin. Po në këtë kontekst, është konstatuar se në procedurën e

prokurimit me objekt pastrimi i qytetit, urdhri i prokurimit nr. 3, datë 14.02.2023 nga titullari, ka dalë pa u përgatitur dokumentacioni nga njësia e prokurimit mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit, dokumentacion që faktikisht është mbajtur më datë 26.04.2023. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18; Pikën 6.3 të kontratave të shërbimit me projektuesit, ku përcaktohet se projekti do merret në dorëzim nga përfaqësues të Urbanistikës, si dhe pikën 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në faqet 93-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Njësitë e prokurimit të marrin masa për të dokumentuar dhe protokolluar hap pas hapi çdo dokument që hartohet në funksion të zhvillimit të procedurës së prokurimit, si dhe mos të iniciojnë hartimin e dokumenteve të tenderit në rastet kur projekti, fondi limit dhe specifikimet teknike të hartuara nga projektuesi, nuk janë marrë në dorëzim nga sektorët e ngarkuar për këtë qëllim.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit, u konstatuan mangësi në të gjitha rastet sa i takon hartimit të kriterëve të kualifikimit dhe konkretisht:

- aplikimi në mënyrë të gabuar i masës së vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme, në të gjitha rastet;

- mos argumentimi apo analizimi i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuar, në të gjitha rastet;

- aplikimi i kriterëve të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës, të cilët kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve në 8 raste dhe konkretisht: kufizime në vitin e prodhimit të automjeteve/makinerive të punës; kërkesa në 1 rast për arkitektë dhe në 1 rast për inxhinier restaurator me pretendimin se një pjesë e punimeve do të kryhen në zona arkeologjike, ndërkohë që nuk ka asnjë zë punimesh, projekt apo specifikim që lidhet me këtë kategori apo me veprimtari që duhet të mbahen në vëmendje dhe të kihet kujdes gjatë punimeve në zonën arkeologjike; kërkesa për ekspert zjarrfikës për shërbimin “azhornim hartash”; disponimi i punonjësve hidroteknik apo hidraulik në raste kur nuk ka punime të tilla; disponimi i autoboteve për pastrimin e ujërave të zeza ndërkohë që nuk ka zëra të tillë punimesh; disponimi i punonjësve shtrues pllakash kur nuk ka punime të tilla; disponimi i një fabrike pllakash ndërkohë që në preventiv nuk ka punime shtrimi pllakash apo trotuaresh;

-mos përfshirja në çdo rast e të gjithë setit të dokumenteve që lidhen me garantimin e punimeve të ngjashme, apo mos përfshirja e mjeshtërive specifike në çdo rast, pavarësisht se sipas zërave të punimeve nevojiten të tillë dhe konkretisht, sa i takon objekteve të prokurimit “rikonstruksione apo rehabilitime rrugësh”, lidhur me garantimin e punimeve të ngjashme të realizuara me sukses nga operatorët pjesëmarrës, konstatohet se në disa raste kërkohet të dorëzohet i gjithë seti i dokumenteve për këtë qëllim (formulari i vlerësimit nga AK, kontrata, marrja në dorëzim, kolaudimi, fatura, etj.) dhe në disa raste kërkohet vetëm një pjesë e tyre. Po kështu, sa i takon po kësaj natyre punimesh, konstatohet se pavarësisht se në preventive ka patur punime që lidhen me kanalizime, apo trajtimin e ujërave të bardha, nuk është kërkuar për secilin rast disponimi i specialistëve hidroteknik apo hidraulik, por vetëm për një pjesë të këtyre rasteve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2 dhe 77 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 2, 39, 41, 43 dhe 55. (Më hollësisht trajtuar në faqet 93-152 të Raportit

Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në Bashkinë Sarandë të marrë masa që, gjatë përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në procedurat e prokurimit, të sigurojë që këto kriterë të mos kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në mënyrë të pajustificuar. Kërkesat duhet të jenë të argumentuara qartë, në përputhje me objektin konkret të prokurimit, si dhe të mbështetura në analizën e zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga ekspertë të fushës përkatëse, rast pas rasti, me qëllim garantimin e konkurrencë, transparencë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, sa i takon përmbushjes së kriterëve, rezultoi se në 8 raste KVO ka shpallur fitues operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve të kualifikimit, si gjatë vlerësimit të vetë deklarimeve, ashtu edhe gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga fituesit. Mangësitë kryesore konstatohen në disponimin e licencave përkatëse të kërkuara, mangësi në përmbushjen e specifikimeve sa i takon makinerive dhe funksioneve të tyre apo të dokumentacionit teknik të tyre, mangësi në dokumentacionin faktues për realizimin me sukses të punimeve të ngjashme, mos disponimi i të gjithë numrit të nevojshëm të punonjësve sipas specialiteteve të kërkuara, apo mos paraqitja e dokumentacionit verifikues për aftësitë profesionale të tyre. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 93-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Nga Komisionet e vlerësimit të ofertave të merren masa për vlerësimin e çdo dokumentacioni të paraqitur nga ofertuesit duke shqyrtuar secilin prej tyre, si dhe të mos vijohet me shpalljen e tyre fitues në rastet kur evidentohen mangësi të cilat nuk përbëjnë devijime të vogla.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik u konstatua se në 3 raste me objekt rikonstruksione apo rehabilitime rrugësh, dokumentacioni i përgatitur nga projektuesi i kontraktuar për këtë qëllim, është jo i plotë dhe i qartë dhe për këtë fakt nuk patur një reagim as nga njësia e prokurimit e cila ka vijuar me përgatitjen e kriterëve dhe dokumenteve standardeve. Më konkretisht rezulton se për objektin “*Rikualifikim dhe ri veshje e Onhezmi dhe Adem Sheme*”, kategoria C e punimeve në preventiv që lidhet me punimet në tubacionet e shkarkimit të ujërave të bardha përbëhet ndër të tjera nga zëri puseta shiu me kapak zagarë hekuri 20 copë, të cilat nuk identifikohen në projekt. Po kështu, as në dokumentin e specifikimeve teknike të hartuar nga projektuesi, nuk ka asnjë të dhënë apo specifikim për asnjë prej zërave që përmban kategoria C e punimeve që lidhen me shkarkimin e ujërave të bardha. I gjithë dokumentacioni mbi specifikimet teknike përmban vetëm të dhëna lidhur me 3 kategoritë e tjera të punimeve.

Për objektin “*Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në lagjen 3 dhe Lugu i Dardhës*”, projektuesi ka dorëzuar një preventiv me zëra punimesh dhe pa çmime dhe vlera, si dhe një preventiv me zëra punimesh, çmime dhe vlera nga ku ka dalë edhe fondi limit. Mes këtyre dokumenteve ka diferenca sa i takon numrit të objekteve, pasi në preventivin pa çmime dhe vlera janë pasqyruar punime në rrugën 13 Bilbilenjt, në rrugët e brendshme të Lugut të Dardhës, si dhe sistemim i hapësirës pas shtëpisë së oficerëve, ndërkohë që në preventivin e rregullt i cili përmban çmimet dhe vlera, janë parashikuar punime vetëm në rrugën 13 Bilbilenjt dhe në rrugët e brendshme të Lugut të Dardhës. Po kështu, vihet re se për rrugën 13 Bilbilenjtë, nuk korrespondojnë sasishtë e zërave mes dy preventivave. Lidhur me objektin e tretë, atë të hapësirës pas shtëpisë së oficerëve, konstatohet se

nuk është pjesë e projektit të hartuar nga projektuesi, pasi nuk ka asnjë të dhënë apo paraqitje grafike lidhur me këtë hapësirë dhe as është pjesë e specifikimeve teknike, siç është vepruar për projektimin e dy rrugëve të tjera.

Për objektin “Rikonstruksioni i rrugës 47”, nga njësia e prokurimit është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar një arkeolog për veprimtarinë vëzhgim arkeologjik pasi rruga ku do të kryhen punimet ndodhet në zonën A të Arkeologjisë. Nga auditimi rezulton se kjo rrugë nuk ndodhet në zonë arkeologjike A. Nga përfaqësuesit e Bashkisë u deklarua se pavarësisht se objekti i prokurimit është rikonstruksioni i rrugës 47, në këtë objekt prokurimi është futur edhe rikonstruksioni i një sheshi që ndodhet në zonën Arkeologjike A. Për sa më lart është e pa qartë se ku është mbështetur njësia e prokurimit për vendosjen e këtij kriteri pasi rikonstruksion sheshi nuk shprehet as në objektin e prokurimit dhe as nuk ka të dhëna, sipërfaqe, zëra punimesh dhe as specifikime teknike në dokumentacionin e dorëzuar nga projektuesi. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 93-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21.1 Rekomandimi: Njësia e prokurimit të marrë masa për mos vijimin e asnjë procedure prokurimi për të cilën nuk ka marrë në dorëzim informacionin e nevojshëm, të qartë dhe të mjaftueshëm nga specialistët e fushës të cilët janë përgjegjës për hartimin e preventivave, zërave të punimeve dhe projekteve, si dhe të garantojë transparencë në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit, duke argumentuar teknikisht me cilat specifikime apo zëra punimesh lidhen ato.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të llojit “Blerje me vlerë të vogël” rezultoi se në 9 raste, vihet re copëzim i fondit limit për realizimin e blerjeve me të njëjtën natyrë dhe thuajse zëra të njëjtë shpenzimesh, me pasojë shmangien e procedurave të rregullta të prokurimit me tenderim në sistemin elektronik dhe konkretisht për dy raste blerje uniformash me vlerë totale fondi limit 1,541,667 lekë dhe 7 raste për rehabilitime apo rikonstruksione me natyrë të njëjtë zërash punime, me vlerë totale të fondit limit 6,140,483 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 93-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

22.1 Rekomandimi: Njësitë e prokurimit të marrin masa për shmangien e copëzimit të fondeve dhe grupimin e sa më shumë blerjeve me natyra të njëjta apo zëra të njëjta shpenzimesh, në një procedurë të vetme, nisur nga fakti se nevojat për shpenzime të njëjste publike janë planifikuar dhe miratuar që në hartimin e buxhetit vjetor.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i kontratave për dhënie me qira të pasurive të Bashkisë Sarandë gjatë vitit 2023, konkretisht për ambientet e lokaleve “R.” dhe “S.”, u konstatua se në zhvillimin e procedurave të konkurrimit janë aplikuar, përveç tre kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor, edhe tre kriterë shtesë të propozuara nga anëtarët e Komisionit për çështjet juridike. Ndër to, dy kriterë “Banorë në Bashkinë e Sarandës” dhe “Posedim mbi 10 vjet i objektit” përbëjnë kriterë diskriminuesë dhe cenojnë konkurrencën për subjektet pjesëmarrëse. Nga auditimi rezultoi se këto 2 ambiente janë poseduar më parë prej shumë vitesh nga i njëjti individ (Lokal R. dhënë me qira që nga viti 1993 dhe lokal S. që nga viti 2009), pra asnjë person tjetër nuk mund të plotësojë kriterin e posedimit të ambienteve për një periudhë mbi 10 vite, duke eliminuar automatikisht konkurrueshmërinë. Krahas sa më lart, rezultoi se asnjë prej ambienteve

të dhëna me qera, nuk janë në pronësi të Bashkisë Sarandë, pasi për këtë Bashki nuk ka dalë ende as VKM-ja për transferimin përfundimtar në pronësi të aseteve, duke qenë se Bashkia Sarandë nuk ka përfunduar identifikimin e gjendjes, vlerësimin dhe inventarizimin e aseteve të saj. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Kreu II, pika 4 e VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar dhe VKM nr. 411, datë 09.06.2005 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të pa luajtshme shtetërore në Bashkinë Sarandë, Qarku Vlorë”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandimi: Këshilli Bashkiak të analizojë dhe të marrë masa për vlerësimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mangësitë e konstatuara për dhënien me qira të ambienteve të lokal R. dhe S. dhe në përfundim të vlefshmërisë së dy kontratave të lidhura, të vlerësojë me kujdes kriterin “për pjesëmarrjen që lidhet me posedime të mëparshme të ambienteve”, pasi ky kriter kufizon konkurrencën.

Menjëherë dhe me përfundimin e afatit të kontratave

23.2 Rekomandimi: Bashkia Sarandë nëpërmjet njësisë përgjegjëse për asetet, të marrë masa për përshpejtimin e procedurave për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve të saj, me fokus fillimisht ato asete për të cilat ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me të tretë.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit në Bashkinë Sarandë, u konstatua se në të gjitha rastet e verifikuara, konkretisht në trembëdhjetë raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, përfshirë edhe atë të kërkuar me legjislacionin përkatës, rezultoi i paplotë. Për më tepër, janë evidentuar vonesa të konsiderueshme në shqyrtimin e aplikimeve, përtej afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar
Leje ndërtimi			
1	Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	H. Ç. dhe M.M.	24.02.2023
2	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E. Group”	30.03.2023
3	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	“S. R. E. Group”	04.04.2023
4	Strukturë banimi 7 kate (1 kat parkim i hapur + 6 kate banim) dhe shërbime me 4 kate parkim nën tokë	“M. I.”	12.04.2023
5	Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë	“O. & A.”	28.04.2023
6	Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	L. Gj.	10.05.2023
7	Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	E. O.	17.05.2023
8	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S.-A.”	17.05.2023
9	Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.”	13.06.2023
10	Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
11	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
12	Objekt banimi 2 kat dhe 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë	E. D.	29.09.2023
Certifikata përdorimi			
13	Godinë banimi dhe shërbimesh	L. P.	21.03.2023

Për rastet e sipërcituar, problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me: **i)** Shqyrtimin e aplikimeve me afate të tejkzgjatura në katër raste (për rastet 1, 3, 6, 12); **ii)** Mangësi në vërtetimet e regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore në dymbëdhjetë raste (për rastet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12); **iii)** Mangësi në projektin arkitektonik, siç janë mungesa e planit të piketimit, planit të mbulimit, dimensionimit të fasadave teknike, detajet e elementeve konstruktive të strukturës, prerjet teknike, projekti dhe detajet e pishinave, etj., në dymbëdhjetë raste (për rastet

1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12); **iv**) Mangësi në projektin konstruktiv në gjashtë raste (për rastet 1, 3, 4, 5, 9, 12); **v**) Mangësi në projektin hidrosanitar, siç janë mungesa e planimetrive dhe detajeve të lidhjes me rrjetin K.U.Z., plani i rrjetit për largimin e ujrave të shiut, planimetri dhe detaje të lidhjes me rrjetin K.U.B., etj., në gjashtë raste (për rastet 1, 2, 3, 4, 5, 12); **vi**) Mangësi në projektin elektrik, siç janë mungesa e detajeve të montimit të sistemit rrufe-prites, detajet e instalimeve elektrike, mangësi në të dhënat e kuadrit elektrik, etj., në njëmbëdhjetë raste (për rastet 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12); **vii**) Mangësi në dokumentacionin e vlerësimit të riskut sizmik, siç janë mungesa e studimi sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik në dymbëdhjetë raste (për rastet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12); **viii**) Mangësi në preventivin e punimeve, ku nuk janë përfshirë zërat e punimeve të pishinave në tetë raste (për rastet 2, 3, 5, 6, 8, 9, 10, 11); **ix**) Mangësi në licencat profesionale të hartuesve të projekteve ndërtimore në tetë raste (për rastet 2, 3, 4, 7, 9, 10, 11, 12); **x**) Mangësi në deklaratat e përgjegjësive profesionale të hartuesve të projekteve ndërtimore në tre raste (për rastet 2, 7, 10); **xi**) Mangësi në policat e sigurimit të përgjegjësive profesionale të hartuesve të projekteve ndërtimore në shtatë raste (për rastet 2, 5, 6, 7, 10, 11, 12); **xii**) Mungesën e projekteve që përbëjnë projektin ndërtimor në gjashtë raste (për rastet 2, 4, 6, 7, 8, 9); **xiii**) Mungesën e oponentëve teknikë në dy raste (për rastet 4, 5); **xiv**) Mangësi në plotësinë e dokumentave të pronësisë dhe rifreskimit të tyre në nëntë raste (për rastet 1, 2, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12); **xv**) Mungesën e marrëveshjes midis pronarëve të pronave me zhvilluesin në tre raste (për rastet 1, 10, 11); **xvi**) Mungesën e projektit arkitektonik në formatin DWG në dymbëdhjetë raste (për rastet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12).

Në lidhje me auditimin e çertifikatave të përdorimit, për rastin nr. 13, referuar tabelës së mësipërme, është konstatuar se: **i**) Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 509 ditësh pune; **ii**) Mungon licenca e kolaudatorit; **iii**) Mungon kontrata me mbikëqyrësin e punimeve; **iv**) Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane; **v**) Mungon situacioni përfundimtar i kryerjes së punimeve; **vi**) Mungon projekti 'as-built'; **vii**) Mungon çertifikata përfundimtare e auditimit të eficiencës së energjisë; **viii**) Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, neni 44, pika 2; Ligjit nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë", i ndryshuar, pika 5, nënpika b); Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë", i ndryshuar, neni 54; VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b), ç), dh), e), ë), g); pika 1/1, nënpika i), ii), iii), iv); neni 20; neni 21; neni 26, pika 5; neni 27/2, pika 1, nënpika c), d), e), ë), g), gj), l); neni 34, pika 6; VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi", shtojca 2. (Më hollësisht trajtuar në faqe 152-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për të analizuar dhe adresuar situatat problematike që lidhen me shqyrtimin e aplikimeve me afate të tejzgjatura, si dhe miratimin e aplikimeve që paraqiten me mungesa të theksuara në dokumentacion, duke evidentuar personave përgjegjës, si dhe të merren masa konkrete, në përputhje me kompetencat ligjore, për të siguruar shqyrtimin e aplikimeve brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me dokumentet e planifikimit në fuqi.

Brenda datës 31.10.2025

24.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe çertifikata përdorimi, të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet* me: praninë, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha projekteve ndërtimore, dokumentacionit të

nevojshëm dhe të kërkuar në dispozitat ligjore. Në rast plotësimi ose mos plotësimi të këtyre kushteve, DPZHT dhe Bashkia Sarandë të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në njëmbëdhjetë raste, objektet e miratuara nuk respektojnë kondicionet urbane, siç janë distancat urbane (nga objektet kufitare – 5 raste; nga kufiri i pronës – 3 raste; nga trupi i rrugës – 3 raste); lartësia maksimale e lejuar e katit përdhe (1 rast); lartësia maksimale e lejuar e objektit (1 rast); numri minimal i lejuar i vend parkimeve (5 raste); intensiteti maksimal i lejuar (9 raste); koeficienti i lejuar i shfrytëzimit të territorit (2 raste); objekti i miratuar del jashtë kufirit të pronësisë (1 rast); aksesimi për në pronë kryhet mbi një pronë mbi të cilën nuk ka asnjë informacion (1 rast). Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar
1	Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	H. Ç. dhe M.M.	24.02.2023
2	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E. Group”	30.03.2023
3	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	“S. R. E.Group”	04.04.2023
4	Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë	“O. & A.”	28.04.2023
5	Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	L. Gj.	10.05.2023
6	Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	E. O.	17.05.2023
7	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.”	17.05.2023
8	Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.”	13.06.2023
9	Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
10	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
11	Objekt banimi 2 kat dhe 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë	E. D.	29.09.2023

Për rastet e sipërcituar, problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me: **i)** Mosrespektimin e lartësive maksimale të lejuara, siç janë lartësia e katit përdhe me përdorim shërbim dhe lartësia maksimale e lejuar (*rasti 1, 11*); **ii)** Mosrespektimin e numrit minimal të vendparkimeve (*rasti 1, 6, 7, 8, 9*); **iii)** Objekti i miratuar del jashtë kufirit të pronësisë në katet nëntokësore, për një sipërfaqe rreth rreth 10.7 m² (*rasti 1*), ndërsa në një rast tjetër (*rasti 5*) aksesimi për në pronë kryhet mbi një pasuri për të cilën nuk ka asnjë informacion mbi poseduesin ose dakordësi për dhënien e të drejtës së kalimit; **iv)** Mosrespektimin e Intensitetit maksimal të lejuar (*rasti 2, 3, 4, 6, 7, 9, 10, 11*), duke lejuar ndërtimin e një sipërfaqeje totale prej 2816.5 m²; **v)** Mosrespektimin e distancave urbane nga kufiri i pronës, nga trupi i rrugës, nga objektet kufitare (*rasti 3, 4, 5, 7, 9, 10, 11*), duke miratuar distanca si: 0.13 metra, kur do të duhej të ishte 7 metra nga kufiri i pronës; 2.2 metra, kur do të duhej të ishte 13 metra nga objektet kufitare; 1 metër, kur do të duhej të ishte 3 metra nga trupi i rrugës; **vi)** Mosrespektimin e Koeficientit të Shfrytëzimit të Territorit (*rasti 4, 5, 10*), duke miratuar një KSHT = 51.3%, kur KSHT_{lejuar} = 50%, si dhe duke miratuar një KSHT = 41.3%, kur KSHT_{lejuar} = 40%.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 1, pika d); VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 14, pika 2; neni 34, pika 2; neni 35, pika 1; neni 36, pika 3, nënpika b); neni 37, pika 1, nënpika c); pika 2; pika 3, nënpika b), c); Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Sarandë, neni 36, pika 1; neni 37, pika 1; neni 44.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 152-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Sarandë, në përputhje me kompetencat përkatëse, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të analizuar procedurat e

shqyrtimit dhe miratimit të aplikimeve të paraqitura përmes sistemit elektronik *e-lejet*, veçanërisht në rastet kur objektet nuk respektojnë kondicionet urbane të përcaktuara; për rishikimin e metodologjisë aktuale të llogaritjes dhe vlerësimit të këtyre kondicioneve; për evidentimin e rasteve konkrete të shkeljeve dhe personat përgjegjës, me qëllim garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit të Bashkisë Sarandë, në përputhje me dokumentet e planifikimit të territorit dhe dispozitat ligjor në fuqi.

Brenda datës 31.10.2025

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në të gjitha rastet, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit e Bashkisë Sarandë nuk ka kërkuar / respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, pika 6, DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Gjithashtu, në dispozitat nënligjore të sipërcituara, specifikohet gjithashtu se informacioni, që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën / hartat kadastrale për pronën / pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, rezulton se:

- Në të gjitha rastet, pra në dymbëdhjetë raste, leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat rregullatore të sipërcituara shprehet qartësisht se informacioni, që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën;

- Në dhjetë raste (*për rastet 1 – 4; 6 – 11, referuar tabelës së procedurave të audituara*) nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Rajonale të Ujësjellës – Kanalizime;

- Për lejen e ndërtimit ***“Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”***, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023, nuk është respektuar mendimi i Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, e cila nuk e ka miratuar aplikimin, si dhe është shprehur se aplikanti duhet të plotësojë dokumentacionin me: *“1.Projektin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH); 2.Lejen për ushtrimin e profesionit “Ekspert privat zjarrfikës” nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së”*. Edhe pse në këto kushte, ky aplikim është miratuar nga DPZHT, Bashkia Sarandë;

- Për lejen e ndërtimit ***“Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”***, me zhvillues L. Gj., miratuar në 10.05.2023, nuk është respektuar mendimi i AZHT, si dhe leja e ndërtimit është miratuar pa marrë miratim nga ky autoritet. AZHT, me anë të shkresës me nr. 358 prot; datë 19.01.2023, i është drejtuar aplikantit duke kërkuar, ndër të tjera, edhe përmirësimin e plotë të projektit arkitektonik në përputhje me tipologjinë e objektit. Asnjë ndryshim nuk është reflektuar në projektin arkitektonik / ndërtimor, përveç eliminimit të dritareve në faqet kallkan. Gjithashtu, nuk është respektuar mendimi i OSHEE, e cila është shprehur me anë të shkresës me nr. 14 prot; datë 10.01.2023, se zhvillimi i këtij objekti paraqet problem për rrjetin e shpërndarjes dhe linjave 20 KV, 10 KV, 6 KV, 0.4 KV, që administrohen prej OSSH. Edhe pse në këto kushte, Bashkia Sarandë ka vazhduar me miratimin e lejes së ndërtimit;

- Për lejen e ndërtimit ***“Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”***, me zhvillues E. O.,

miratuar në 17.05.2023, nuk është ri-kërkuar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, e cila në mendim-dhënien e saj është shprehur se “... është në proces shqyrtimi për Procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 152-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për të analizuar situatat në lidhje me mangësitë në kërkimin dhe respektimin e mendimit të autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, evidentimin e përgjegjësive, si dhe të përdoren të gjithë instrumentet ligjorë për të siguruar marrjen e mendimit nga këto autoritete, sipas tipologjisë së objektit në zhvillim, dhe respektimin e mendimit të shprehur prej tyre.

Brenda datës 31.10.2025

26.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për:

- Të kërkuar dhe respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, në varësi të tipologjisë së objektit dhe kushteve në të cilat zhvillohet. Për të gjitha rastet në të cilat këto autoritete kërkojnë ndryshimin e projektit ndërtimor ose plotësimin e dokumentacionit, miratimi i lejeve të ndërtimit të kryhet vetëm pasi është ri kërkuar mendimi i tyre dhe është marrë miratim pozitiv (ose në heshtje);

- Të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Ujësjiellës-Kanalizimeve. Informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

Menjëherë dhe në vijimësi

26.3 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për të përdorur çdo rrugë institucionale për të ri kërkuar mendimin e Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin për lejen e ndërtimit “*Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë*”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023; Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për lejen e ndërtimit “Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues L. Gj., miratuar në 10.05.2023; Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për lejen e ndërtimit “Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues E. O., miratuar në 17.05.2023; pasi të jenë plotësuar kërkesat e këtyre autoriteteve nga zhvilluesit dhe aplikantët respektivë.

Deri në datë 30.06.2025

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, u konstatua se:

Situata 1: Në të gjitha rastet e verifikuara, konkretisht në dymbëdhjetë raste, zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin “*Njoftim për fillimin e punimeve*”, i cili jepet pas marrjes së sigurisë se zhvilluesi ka plotësuar të gjithë dokumentacionin dhe kushtet e nevojshme për të filluar punimet. Gjithashtu, ky dokument shënon datën e saktë të fillimit të punimeve, referuar së cilës llogaritet respektimi ose jo i grafikut të punimeve dhe afatit të përfundimit të punimeve. Duke iu referuar pikës 8 të dokumentit të lejes së ndërtimit, si dhe nenit 40 të ligjit 107/2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, afati

për fillimin e punimeve është një vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit. Kjo problematikë është evidentuar në rastet e mëposhtme:

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar
1	Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	H. Ç. & M. M.	24.02.2023
2	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E. Group”	30.03.2023
3	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	“S. R. E. Group”	04.04.2023
4	Strukturë banimi 7 kate (1 kat parkim i hapur + 6 kate banim) dhe shërbime me 4 kate parkim nën tokë	“M. I.”	12.04.2023
5	Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë	“O. & A.”	28.04.2023
6	Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	L. Gj.	10.05.2023
7	Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	E. O.	17.05.2023
8	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.”	17.05.2023
9	Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.”	13.06.2023
10	Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
11	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
12	Objekt banimi 2 kat dhe 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nëntokë	E. Demi	29.09.2023

Për rastet 1 – 5, referuar tabelës së mësipërme, ndërtimi i objektit ka filluar në mungesë të dokumentit **“Njoftim për fillimin e punimeve”**.

Situata 2: Për certifikatën e përdorimit me objekt **“Godinë banimi dhe shërbimesh”**, me zhvillues z. L. P., miratuar në 21.03.2023, nga auditimi i ushtruar mbi projektin ndërtimor të objektit të ndërtuar, krahasuar kjo me fotot e objektit në të gjitha drejtimet janë konstatuar ndryshime, si janë: **i)** Çarje në pjesën e sipërme të muraturës së katit përdhe, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në projekt, por janë realizuar; **ii)** Ballkoni perimetral në katin e parë, i cili nuk ka qenë i parashikuara në projekt, por është realizuar; **iii)** Mbulesa me çati me tjegulla e ballkonit në katin e fundit, e cila nuk ka qenë e parashikuara në projekt, por është realizuar; **iv)** Nuk është realizuar ballkoni perimetral në katin e fundit, i cili ka qenë i parashikuar në projekt dhe nuk është realizuar.

Në praktikën e ngarkuar në sistemin *e-lejet* nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë miratimin e këtyre ndryshimeve, si do të ishte leja e ndërtimit për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, ose kopje e gjobës së vendosur nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me neni 42 të Ligjit 107/2014 **“Për planifikimin e zhvillimit të territorit”**, i ndryshuar, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 152-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Sarandë, sipas kompetencave të tij, të merren të gjitha masat për të analizuar situatat në lidhje me fillimin e punimeve pa u pajisur fillimisht me dokumentin e **“Njoftimit të Fillimit të Punimeve”**, evidentimin e personave përgjegjës, si dhe zbatimin ose aplikimin e të gjithë instrumenteve për të përfshirë në praktikën e punës, shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me dokumentin e **“Njoftimit të Fillimit të Punimeve”** vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Brenda datës 31.10.2025

27.2 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Sarandë, sipas kompetencave të tij, të merren të gjitha masat për të rritur bashkëpunimin midis Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Sarandë, për të kryer inspektime në terren përpara miratimit të certifikatave të përdorimit, me qëllim marrjen e një sigurie të lartë, se objektet e përfunduara nuk kanë devijuar nga projektet e miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dhjetë raste, dokumentet e emetuar nga Bashkia Sarandë nuk janë të saktë. Këto pasaktësi kanë të bëjnë me mungesën e përcaktimit të vlerës së TNI-së në dokumentin e vendimit të miratimit të lejes së ndërtimit, miratimin e një afati për përfundimin e punimeve të ndryshim nga ai i përlloritur nga inxhinieri konstruktor, mos pasqyrimin e saktë të ndryshimeve që aplikanti duhet të kryejë në projektin ndërtimor etj. Më konkretisht, këto problematika janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar
1	Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	H. Ç. dhe M.M.	24.02.2023
2	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E. Group”	30.03.2023
3	Strukturë banimi 7 kate (1 kat parkim i hapur + 6 kate banim) dhe shërbime me 4 kate parkim nën tokë	“M. I.”	12.04.2023
4	Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë	“O. & A.”	28.04.2023
5	Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	L. Gj.	10.05.2023
6	Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	E. O.	17.05.2023
7	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.”	17.05.2023
8	Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.”	13.06.2023
9	Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
10	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023

Për rastet e sipërcituar, problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me: **i)** Emetimin e dokumentit të vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit dhe dokumentit të vlerësimit pozitiv të praktikës pa përcaktuar vlerën e TNI-së (*rasti 1, 3, 5, 7, 8, 9, 10*); **ii)** Përcaktimin e një afati për përfundimin e punimeve të ndryshëm nga ai i përlloritur nga inxhinieri konstruktor (*rasti 1, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10*); **iii)** Njoftimin e aplikantit dhe zhvilluesit për detyrimin e reflektimit të ndryshimeve në projekt, pa specifikuar se çfarë ndryshimesh duhet të kryhen, pa dhënë arsyet ligjore përkatëse (*rasti 1, 2, 4, 5*); **iv)** Miratimin e lejes së ndërtimit në mungesë të lejes së zhvillimit (*rasti 4*); **v)** Miratimin e lejeve të zhvillimit kur objekt nuk plotëson kriteret e përcaktuara për objektet të cilat zhvillohen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit (*rasti 5*); **vi)** Miratimin e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi kur informacioni në dokumentacionin e ngarkuar në sistem nuk është i saktë (objekti zhvillohet në njësi strukturore të ndryshme nga ajo e cituar nga zhvilluesi / aplikanti). Zhvilluesit i është miratuar padrejtësisht aplikimi, duke shfrytëzuar kondicionet urbane të një njësie strukturore tjetër, të cilat mundësojnë ndërtimin e një sipërfaqeje me të madhe se nj. str. në të cilën faktikisht zhvillohet objekti (*rasti 6*); **vii)** Miratimin e lejes së ndërtimit në favor të një subjekti tjetër, i ndryshëm nga ai që ka bërë aplikimin (*rasti 6*).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 36, pika 1, pika 2; VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 9, pika 1; neni 13, pika 1, 2, 3, 4; neni 20, pika 2, nënpika b); neni 21, pika 3; neni 23, pika 1; Vendimin nr. 41, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, pika 3, nënpika b), c); pika 4;

(Më hollësisht trajtuar në faqe 152-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

28.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Sarandë, sipas kompetencave të tij, të merren të gjitha masat për të analizuar situata e mëposhtme, si dhe evidentimin e përgjegjësive për personat që kanë shqyrtuar dhe miratuar lejet e ndërtimit:

- “Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues z. E. O., miratuar në datë 17.05.2023, për marrjen në konsideratë nga ana e DPZHT të një informacionin të pasaktë, më konkretisht, mos kryerjen e verifikimit se në cilën njësi strukturore zhvillohet objekti; për miratimin e lejes së ndërtimit në favor të shoqërisë në të cilën zhvilluesi (person fizik) i cituar në dokumentacionin, ka aksione, dhe jo në favor të vet zhvilluesit (person fizik);

- “**Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë**”, me zhvillues “O. & A.”, miratuar në datë 28.04.2023, për miratimin e lejes së ndërtimit, në mungesë të lejes së zhvillimit, kur për njësinë strukturore ku zhvillohet objekti nuk ka një Plan të Detajuar Vendor të miratuar;

- “**Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë**”, me zhvillues z. L. Gj., miratuar në datë 10.05.2023, për mos-marrjen e mendimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, si objekt që zhvillohet në Zonat me Përparësi Zhvillimit e Turizmit.

Brenda datës 31.10.2025

28.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për të përfshirë në dokumentet e emetuar prej saj, të dhëna si vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë, argumentimin ligjor dhe shpjegime të tjera në lidhje me ndryshimet / plotësimet e kërkuara nga DPZHT ose autoritete të tjera, si dhe përcaktimin e saktë të afatit të përfundimit të punimeve, referuar atij të përcaktuar nga inxhinieri konstruktor.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Sarandë, u konstatua se në gjashtë raste, objektet e miratuara nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” pasi subjektet private që kanë aplikuar për leje zhvillimi dhe ndërtimi për objekte me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m² nuk kanë kontribuar në fondin publik për strehim social, siç kërkohet nga ky ligj. Këto problematika janë evidentuar në rastet e mëposhtme:

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar
1	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E. Group”	30.03.2023
2	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me zhvillues “Saranda Real Estate Group	“S. R.E. Group”	04.04.2023
3	Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë	“O. & A.”	28.04.2023
4	Objekt banimi dhe shërbime 7 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. -A”	13.06.2023
5	Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
6	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023

Për rastet 1, 2, 4, 5, 6, nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Për rastin 3, është konstatuar se sipërfaqja e dakordësuar për të kaluar në favor të fondit publik të banesave sociale është 84.75 m². Nga llogaritja e kryer nga grupi i auditimit është konstatuar se sipërfaqja e saktë do të duhej të ishte 109.29 m² (e llogaritur sipas formulës 3642 m² me funksion banim * 3%). Diferenca midis sipërfaqes së dakordësuar dhe asaj të llogaritur nga grupi i auditimit është 24.54 m².

Diferenca midis sipërfaqes totale që subjektet private, për të cilat janë miratuar leje ndërtimi me sipërfaqe me të madhe se 2,000 m² banim, do të duhet të kalonin në favor të fondit publik për strehim social, të llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Sarandë është 377 m².

(Më hollësisht trajtuar në faqe 152-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë Juridike, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për të njoftuar zhvilluesit të cilët kanë përfutur lejet e ndërtimit të cituara më sipër, në lidhje me detyrimin që kanë ndaj fondit publik për strehim social. Bashkia Sarandë të ndjekë të gjitha procedurat ligjore deri në refuzimin e aplikimeve për

pajisje me çertifikatë përdorimi, në rastet kur zhvilluesit nuk shprehin dakordësi për hartimin dhe nënshkrimin e akt-marrëveshjeve për kontributin në fondin publik të strehimit social, si dhe për përcaktimin dhe kalimin e sipërfaqeve përkatëse në favor të bashkisë.

Brenda datës 30.06.2025

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste, një prej ortakëve të shoqërisë në favor të së cilës është miratuar leja e ndërtimit, rezultoi të jetë punonjës në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Lejet e ndërtimit janë miratuar në favor të shoqërisë “E. G” ShPK, me NIPT M.....A. Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentin e ekstraktit historik të regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit, është konstatuar se z. H. K. është aksioner në këtë shoqëri i 25% të aksioneve, vërtetuar kjo dhe nga kontrata e themelimit të kësaj shoqërie, në datën 26.10.2021. Gjithashtu, z. K. është edhe punonjës (në cilësinë e nëpunësit) në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), Bashkia Sarandë. Z. K. ka qenë pjesë e grupit të punës që ka kontrolluar dokumentacionin e lejeve të miratuara, të listuara më poshtë. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Për lejet e miratuara si vijon:

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar
1	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E. Group”	30.03.2023
2	Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	E. Obzova	17.05.2023
3	Objekt banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023
4	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group”	15.06.2023

(Më hollësisht trajtuar në faqe 152-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

30.1 Rekomandimi: Drejtoria Juridike e Bashkisë Sarandë, në përputhje me kompetencat e saj, të marrë të gjitha masat e nevojshme për analizimin e situatës së konstatuar lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi nga një punonjës i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), i cili rezultoi të jetë aksioner në subjektin përfitues të lejeve përkatëse. evidentimin e personave përgjegjës dhe nxjerrjen e përgjegjësive.

Brenda datës 31.10.2025

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Sarandë u konstatua se për periudhën e vitit 2023, struktura organizative e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është e miratuar me Urdhër nr. 36, datë 06.02.2023 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë në përbërje të së cilës janë 12 punonjës. Nga 12 punonjësit vetëm 2 (dy) prej tyre plotësojnë kriteret ligjore të nenit 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Ndërsa 10 dhjetë punonjësit e tjerë nuk janë të arsimuar në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit, ku gjithashtu vlen të theksohet se 5 pesë prej tyre nuk kanë arsim të lartë, por kanë arsim të mesëm.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Dt. e fillimit	Data e largimit
1	A. M.	Kryeinspektor	Akademia Ushtarake	25.11.2022	29.06.2023
2	N. H.	Kryeinspektor	Akademia Ushtarake	29.06.2023	Në vazhdim
3	P. I.	Specialist Jurist	Drejhtësi	19.06.2023	Në vazhdim
4	A. H.	Inspektor	Biokimi	21.07.2023	Në vazhdim
5	V. Q.	Inspektor	I mesëm	01.01.2023	Në vazhdim
6	R. M.	Inspektor	I mesëm	07.08.2023	06.02.2024
7	H. K.	Spec. ndërtimi	Inxhinieri Ndërtimi	26.06.2023	Në vazhdim
8	V. Xh.	Inspektor	Akademia e Rendit	01.01.2023	24.07.2023

9	B.K.	Inspektor	I mesëm	10.01.2023	07.07.2023
10	E. Z.	Inspektor	I mesëm	10.01.2023	31.07.2023
11	S. A.	Inspektor	Gjuhë e huaj	10.01.2023	29.03.2023
12	K. R.	Inspektor	I mesëm	01.01.2023	10.01.2023

(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

31.1 Rekomandimi: Këshilli Bashkiak i Bashkisë Sarandë ta analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe Bashkia Sarandë të marrë masat për plotësimin e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor me inspektor sipas parashikimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në Bashkinë Sarandë nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për hartimin dhe zbatimin e planeve të punës mujore, tremujore dhe/ose vjetore, në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit...”, konkretisht nën-pika b. ii. Megjithëse këto plane duhen hartuar nga Kryeinspektori i IMTV-së dhe t’u përcillen strukturave të varësisë për zbatim, nuk u dokumentua ekzistenca apo zbatim i tyre për periudhën nën auditim.

Gjithashtu, në kundërshtim me kërkesat e nenit 5, pika f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, IMTV nuk ka realizuar raportimin periodik çdo tre muaj pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), për masat e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara, si pezullime punimesh, gjoba, urdhra për prishje objektësh të paligjshme, kallëzime penale apo kërkesa për heqje licencash.

Në dispozicion u vendos vetëm një raportim për periudhën 29.06.2023 – 30.10.2023, i cili nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjithë periudhën objekt auditimi dhe nuk përmban informacion të plotë për të gjitha masat e ndërmarra.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

32.1 Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor i Bashkisë Sarandë, të marrë të gjitha masat për të hartuar në mënyrë periodike plane mujore / tremujore / vjeçare të punës, si dhe të hartojë / raportojë / dërgojë çdo tre muaj, raportin e aktivitetit pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes, si dhe dosjeve individuale të procedurave, është konstatuar se jo në të gjitha rastet inspektorët kanë respektuar procedurat e parashikuara në mbajtjen e procesverbaleve të konstatimeve, si dhe dokumentimin e plotë dhe të saktë të kundërvajtjes:

Situata 1: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se në 40 raste (nga 126 procedura që ka mbajtur IMTV) kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me fotografi ose video dhe nuk është bërë pjesë e dosjes individuale për secilën praktikë, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a).

Situata 2: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se për 113 raste për të cilat kryeinspektori i IMTV ka nxjerrë vendimin e prishjes, në 75 raste vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar. Për 38 rastet në të cilat ky vendim është ekzekutuar, në shtatë raste ky proces nuk është dokumentuar me evidenca fotografike, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pika a).

Situata 3: Nga auditimi i procedurave të mbajtura nga IMTV, ku janë evidentuar problematika lidhur me llogaritjen e saktë të vlerës së masës administrative dënim me gjobë, në shumë raste, llogaritja e saktë e kësaj vlere nga grupi i auditimit nuk ka qenë e mundur, për shkak se mungojnë detaje në lidhje me materialet e përdorura, përmasat, volumetritë, etj. Kjo problematikë është konstatuar: në 71 raste, ku vlera e masës administrative dënim me gjobë është vendosur e pabazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore, pasi në të gjitha rastet e konstatuara vlera e gjobës është 500,000 lekë; në 10 raste, ku vlera e gjobës do të duhej të ishte llogaritur si shumatore e zërave të punimeve; në 6 raste, ku konstatimet e kryera nga inspektorët e IMTV, janë klasifikuar si punime për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi, ndërkohë që janë punime për të cilat duhet pajisja me deklaratë paraprake punimesh (2 raste) dhe leje ndërtimi (4 raste). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 61 të Rregullores së Funksionimit të Bashkisë Sarandë, pika f).

Situata 4: Nga auditimi i vendimeve të nxjerra nga kryeinspektori, për dënim me gjobë, në së paku dy raste, nga ana e kryeinspektorit të IMTV, vlera e masës administrative dënim me gjobë nuk është llogaritur e saktë. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nën-pika e.V), kur objekti pa lejet përkatëse ndërtohet për qëllime fitimi në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, vlerës së gjobës i shtohet dhe penalteti prej 5,000,000 lekë. Nga ana e inspektorëve, në përshkrimin e kundërvajtjes, nuk është cituar nëse këto objekte janë ndërtuar për qëllime fitimi ose për qëllime strehimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 61 të Rregullores së Funksionimit të Bashkisë Sarandë, pika f).

(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

33.1 Rekomandimi: Kryeinspektori, në bashkëpunim me inspektorët e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të Bashkisë Sarandë, të marrin të gjitha masat, për të përfshirë në rregulloren e brendshme:

- Dokumentimin e kundërvajtjeve me evidenca fotografike / videografike;
- Dokumentimin e procesit të prishjes së objektit të kundërligjshëm me evidenca fotografike / videografike;
- Përshkrimin e saktë të kundërvajtjes së konstatuar, duke cituar ndër të tjera, materialet e ndërtimit të përdorura, përmasat, volumetritë, si dhe çdo informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm për përcaktimin e saktë të vendimeve vijuese të kryeinspektorit;
- Përcaktimin e qëllimit të objektit të ndërtuar pa leje, nëse ky objekt është ndërtuar për qëllime strehimi, fitimi, ose ndonjë funksion tjetër, për të gjitha rastet që konstatohen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit ose zonat e mbrojtura.

Brenda datës 31.10.2025

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimeve të nxjerra nga kryeinspektori, u konstatua se: *Situata 1:* Nga auditimi i vendimeve për pezullimin e punimeve, u konstatua se, nga ana e kryeinspektorit janë nxjerrë në total tre vendime për pezullimin e punimeve. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se në katër raste nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve (kur ky vendim do të duhej të ishte nxjerrë). Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Datë		
1	000099	20.07.23	K. M.	Shkela e deklaratës paraprake
2	000018	07.03.23	A.	Shkelje deklarate paraprake

3	000022	16.03.23	M. I.	Rritje e sip. ndërtimore duke shkelur lejen e ndërtimit
4	000131	13.12.23	A. L.	Shkelja e afateve të mbarimit të punimeve

Situata 2: Nga auditimi i vendimeve për dënim me masë administrative gjobë, u konstatua se nga ana e kryeinspektorëve të IKMT, Bashkia Sarandë janë nxjerrë në total 125 vendime për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, me vlerë totale 141,760,550 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se:

- Në 71 raste, vlera e masës administrative dënim me gjobë ka qenë në vlerën 500,000 lekë. Kjo vlerë fikse nuk është e parashikuar në asnjë nga pikat dhe nën-pikat e nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar. Procedurat e cituara kanë të bëjmë me punime të kryera pa leje ndërtimi, për të cilat, vlera e gjobës llogaritet sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014, i ndryshuar, pika 1, e);

- Për rastet kur vlera e masës administrative është llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nën-pika e), janë konstatuar problematikat e mëposhtme:

Nr.	Nr. serie	Data	Konstatimi	Kundërvajtësi
1	000091	03.07.2023	Ndërtim tende me strukturë të lehtë metalike me 72 m ²	V. V.
2	000108	12.09.2023	Nd. str. metal mbuluar me panele “sanduiç” 15m*4m	E. Sh.
3	000076	07.06.2023	Ndërtim platforme betoni	B. Gj.
4	000112	20.10.2023	Mbyllja e verandës me material tulle dhe alfa bllok 19m ²	S. A.
5	000113	23.10.2023	Ndërtim strukture me dru, mbuluar me llamarinë, 39m ²	F. S.
6	000117	30.10.2023	Ndërtim strukture metalike, 225m ²	S. Xh.
7	000122	20.11.2023	Mbyllja e ballkonin të banesës, 9 m ²	P. B.
8	000139	20.12.2023	Nd. mbulese me panele sanduiç, riparim muri në pronë	A. I.
9	000085	03.07.2023	Ndërtim strukture me konstruksion metalik 4.7m x 5m	E. D.
10	000115	30.10.2023	Ndërtim muri me blloqe betoni	V. A.

Është konstatuar se vlera e gjobës është llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nën-pika e). Gjithsesi, në këto raste nuk janë respektuar plotësisht këto dispozita, pasi vlera 35,000 lekë/m², e përdorur për llogaritjen e gjobave, nuk gjen zbatim në këtë rast, sepse asnjë prej këtyre kundërvajtjeve nuk janë objekte. Në rastet e sipërcituara, vlera e gjobës do të duhej të ishte llogaritur si shumatorja e punimeve të kryera pa leje;

Në së paku dy raste, nga ana e kryeinspektorit të IMTV, vlera e masës administrative dënim me gjobë nuk është llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nën-pika e.V), pasi, kur objekti pa lejet përkatëse ndërtohet për qëllime fitimi në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, vlerës së gjobës i shtohet dhe penalteti prej 5,000,000 lekë. Rastet në të cilat nuk janë zbatuar këto dispozita janë si më poshtë:

Nr.	Nr. serie	Data	Konstatimi	Kundërvajtësi
1	000104	24.08.23	Ndërtim beach bari me strukturë druri	O. S.
2	000107	30.08.23	Nd, str. beach bari me str. druri, mbuluar me sanduiç	R. Z.

- Në së paku 6 raste, konstatimet e kryera nga inspektorët e IMTV, janë klasifikuar si punime për të cilat nuk është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi. Faktikisht, janë punime për të cilat duhet pajisja me deklaratë paraprake punimesh (rastet 1, 3) dhe leje ndërtimi (rastet 2, 4, 5, 6), referuar përcaktimeve të nenit 7 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 3, nën-pika ii) dhe nenit 11, pika 1, nën-pika a). Gjjobat janë përlllogaritur sipas përcaktimeve të nenit 52 ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 1, nën-pika d), ndërkohë që do të duhej

të llogariteshin sipas përcaktimeve të pikës 1, nënpika e).

Nr.	Nr. serie	Data	Konstatimi	Gjoha	Kundërvajtësi
1	000102	18.08.23	Nd. str. me konst. druri dhe vetratë xhami	50,000 lekë	V. P.
2	000135	25.12.23	Ndërtim platforme betoni	100,000 lekë	E. O.
3	000123	21.11.23	Nd. str. metalike, mbuluar me material sanduic	50,000 lekë	A. V.
4	000125	24.11.23	Nd. verande betoni mbi strukturë metalike 30m ²	50,000 lekë	M. D.
5	000132	15.12.23	Ndërtim mur betoni 21 ml	100,000 lekë	V. V.
6	000103	21.08.23	Nd. muri tulle me llac mbi nje shtrese betoni	50,000 lekë	T. C.

Situata 3: Nga ana e kryeinspektorëve të IKMT, Bashkia Sarandë janë nxjerrë në total 124 vendime për prishjen e objekteve të kundërligjshëm. Referuar informacionit të marrë nga IMTV, si dhe auditimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua se në njëmbëdhjetë raste, ekzekutimi i vendimit të prishjes nuk mund të kryhet, për arsytet e sqaruara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Arsyeja e mos-ekzekutimit të vendimit të prishjes
	Nr. serie	Datë		
1	000197	30.12.22	J. M.	Masë sigurie, datë 16.01.2023
2	000069	29.05.23	V.L.	Rrëzuar të dy vendimet e IMT nga gjykata
3	000100	03.08.23	E. D.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata, vendimi nr. 184/2023
4	000058	18.05.23	A. I.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
5	000075	06.06.23	R.P.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata, masë sigurie
6	000039	05.05.23	K. D.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
7	000055	18.05.23	G. P.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
8	000031	18.04.23	A. S.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
9	000018	07.03.23	A.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
10	000010	22.02.23	G. B.	Rrëzuar vendimet e IMT nga gjykata
11	000068	29.05.23	F. O.	Rrëzuar vendimi i prishjes nga gjykata, ulur masa e gjobës në 50.000 lekë

Nga 113 kundërvajtje të konstatuara, për të cilat IMTV, Bashkia Sarandë ka nxjerrë vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, ky vendim është ekzekutuar vetëm në 37 raste (28 prej këtyre rasteve janë faktuar me foto); në një rast objekti është kthyer në gjendjen e mëparshme nga kundërvajtësi; në 75 raste nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, pika d), si dhe në kundërshtim me neni 52 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 6.

Situata 4: Pas mbajtjes së procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, brenda një afati 10-ditor, kryeinspektori i IMTV-së, duhet të nxjerrë vendimet sipas rastit në lidhje me shkeljen e konstatuar, si: vendim për pezullimin e punimeve, prishjen e objektit të kundërligjshëm, vendim për dënimin me masë administrative gjobë ose kallëzim penal për kundërvajtësin. Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se në tre raste, nga ana e kryeinspektorit, nuk është respektuar afati dhjetë ditor për nxjerrjen e vendimeve vijuese sipas rastit, në funksion të kundërvajtjes së evidentuar në procesverbalin e konstatimit. Më konkretisht, këto raste janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PVKK		Vendim prishje		Vendim për gjobë		Kundërvajtësi
	Nr. serie	Data	Nr. serie	Data	Nr. serie	Data	
1	000015	06.03.2023	000116	17.03.2023	000094	17.03.2023	Pa ID
2	000076	07.06.2023	000117	16.06.2023	000113	18.09.2023	B. Gj.

3	000016	06.03.2023	000117	17.03.2023	000065	17.03.2023	Pa ID
---	--------	------------	--------	------------	--------	------------	-------

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Situata 5: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me përcjelljen e indicies së veprës penale te organet ligj zbatuese, për të gjithë kundërvajtësit e konstatuar që kanë kryer ndërtime në kundërshtim me nenin 199/a të Kodit Penal, është konstatuar se, nga 85 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Sarandë, të cilat përbëjnë veprë penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal dhe IMTV do të duhej të ishte drejtuar organeve ligj-zbatuese për dërgimin pranë tyre të indicies për veprë penale, kjo procedurë është kryer në 50 raste, ndërsa në 35 raste IMTV nuk e ka nisur procedurën e kallëzimit penal. Nga ana e kryeinspektorit, z. A. M., nuk është respektuar i njëjti standard në lidhje me përgatitjen e kallëzimeve penale, pasi për procedurat e mbajtura gjatë periudhës që ka qenë kryeinspektor, është konstatuar se për procedurat:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Kundërvajtja
	Nr. serie	Datë		
1	000073	05.06.2023	G. S.	Ndërtimi I një muri me beton
2	000037	27.04.2023	A. T.	Ndërtim muri me gur dhe llac

është përgatitur kallëzim penal, ndërsa për të gjitha procedurat e tjera nuk është përgatitur, edhe pse kanë të bëjnë me shkelje të ngjashme ose më të rënda si: “Platformë betoni 9.3 m * 8m; Mur rrethues me gur dhe llac; Çati mbi soletë ekzistuese me dru; Ndërtim objekti me mur guri dhe llac; Ndërtim i një muri me gjatësi 27 ml, lartësi 1m -1.6m; Ndërtim i një garazhi mbi objekt ekzistues me mur guri dhe llac, 8 m²”, etj.

- Nga ana e kryeinspektorit, z. N. H., nuk është respektuar i njëjti standard në lidhje me përgatitjen e kallëzimeve penale, pasi për procedurat e mbajtura gjatë periudhës që ka qenë kryeinspektor, është konstatuar se për procedurat:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Kundërvajtja
	Nr. serie	Datë		
1	000103	21.08.2023	T. C.	Ndërtim muri tulle me llac mbi nje shtrese beton
2	000105	28.08.2023	A.M.	Ndërtim muri me gure dhe llac
3	000106	28.08.2023	A. K.	Ndërtim muri me guri dhe llac, porte metalike
4	000102	18.08.2023	V. P.	Ndërtim strukture me konstruksion druri dhe vetrate xhami ne ballkonin ne pronës te vet

nuk është përgatitur kallëzim penal, ndërsa për kundërvajtje të tjera të ngjashme kryeinspektori ka përcjellë në institucionet ligj-zbatuese indicien e veprës penale. Rastet e ngjashme, për të cilat nuk është përgatitur kallëzim penal janë si më poshtë:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Kundërvajtja
	Nr. serie	Datë		
1	000110	03.10.2023	A. B.	Ndërtim mur mbajtës
2	000121	18.11.2023	F. M.	Ndërtim muri me gurë pa llav
3	000122	20.11.2023	P. B.	Mbyllja e ballkonin te banesës, sip 9 m ²
4	000132	15.12.2023	V. V.	Ndërtim mur betoni 21 ml
5	000134	23.12.2023	T. B.	Nderti muri guri dhe llaci

(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

34.1 Rekomandim: Nga ana e Këshillit Bashkiak, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për të analizuar situatat në lidhje me:

- Mos marrjen e vendimit për pezullimin e punimeve, evidentimin e personave përgjegjës, si dhe marrjen e masave, brenda kompetencave ligjore, për të amenduar rregulloren e brendshme të funksionimit dhe organizimit, me qëllim përfshirjen në detyrat e IMTV-së, kryerjen e inspektimeve pas nxjerrjes së vendimit të pezullimit, me qëllim marrjen e informacionit nëse subjektet e pezulluar kanë plotësuar kushtet për të cilat është nxjerrë vendimi i pezullimit;

- Përlllogaritjet e gabuara të vlerave të masave administrative (dënim me gjobë) të konstatuar nga grupi i auditimit, evidentimin e personave përgjegjës, si dhe marrjen e masave, brenda kompetencave ligjore, për të siguruar llogaritjen e saktë të gjobave, brenda afateve të parashikuara, duke marrë gjithmonë në konsideratë faktorë të tjerë si, tipologjia e kundërvajtjes (banesë ose tipologji tjetër), pozicionin ku ndodhet (nëse ndodhet në zonë me përparësi zhvillimit të turizmit ose zonë të mbrojtur), qëllimin e objektit të kundërligjshëm (për qëllime fitimi ose jo), si dhe kategorizimin e saktë të kundërvajtjes (punime që duhet të pajisen me leje ndërtimi ose jo).

Brenda datës 31.10.2025

34.2 Rekomandim: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të merren të gjitha masat për të:

- Ri-kryer inspektive në objektet (e konstatuar nga grupi i auditimit) për të cilët është nxjerrë vendimi i prishjes, por që nuk është ekzekutuar. Nëse këto objekte janë akoma në gjendjen e konstatuar nga inspektorët e IMTV-së, të merren të gjitha masat për të ekzekutuar vendimet e prishjeve (kryerjen e prishjeve me mjetet e IMTV / Bashkisë Sarandë ose duke kërkuar asistencën e IKMT);

- Të përcjellë pranë organeve ligj zbatuese të gjitha rastet, që në zbatim të ligjit, përbëjnë veprë penale, si dhe trajtimin e tyre me të njëjtin standard.

Brenda datës 30.06.2025

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, si dhe bashkëpunimit midis këtyre dy strukturave të mbrojtjes dhe planifikimit të territorit, janë konstatuar disa parregullsi gjatë auditimit në terren të objekteve të pajisur me leje ndërtimi, por ende në zhvillim, të evidentuara më poshtë:

a. Për leje ndërtimi për objektin **“Godinë banimi + shërbime 1, 4, 5 kate, me 2 kate bodrum, (parkim) nën tokë”**, me zhvillues z. A. B., me nr. 3763 prot.;

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se kemi të bëjmë me devijime të dukshme të projektit, pasi në katin përdhe është shfrytëzuar pothuajse e gjithë sipërfaqja e truallit dhe katet e sipërme që ngrihen mbi katin përdhe ndryshojnë me projektin e miratuar;

b. Për leje ndërtimi për objektin **“Godinë banimi dhe shërbime me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me zhvillues z. H. C. dhe z. M. M., me nr. 3093 prot.;

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se nuk është respektuar zbatimi i këtij projekti, pasi nuk është ndërtuar kati nëntokë (parkimi), por objekti fillon të zhvillohet direkt mbi kuotën e sistemit. Konsolat e dala të objektit ndryshojnë me projektin e miratuar, si dhe fasada mbrapa e objektit vihet re se ndryshon nga ajo e prerjes teknike;

c. Për leje ndërtimi për objektin **“Objekt 3 kate dhe 1 kat podrum me funksion banimi”**, me zhvillues z. A.B.:

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se kati nëntokësor është ndërtuar i gjithi mbi tokë. Në lejen e ndërtimit të miratuar nga DPZHT, Bashkia Sarandë, objekti që do të ndërtohet ka faqe kallkan ngjitur me objektin ekzistues, ndërkohë që (në gjendjen faktike), objekti në zhvillim është ndërtuar i unifikuar me objektin ekzistues, pra janë trajtuar si një objekt i vetëm, dhe jo si dy objekte të ndarë me faqe kallkan. Hyrja për në parkim, referuar projektit të miratuar, është në anën e majtë të objektit dhe me një çarje, ndërsa në gjendjen faktike hyrja për në parkim është pozicionuar në anën e djathtë dhe ka

dy çarje. Për sa i përket lartësisë totale të objektit, referuar projektit të miratuar, objektit të propozuar dhe objekti ekzistues kanë diferencë një kat, ndërsa referuar gjendjes faktike të konstatuar në terren, të dy objektet (objekti në zhvillim dhe objekti ekzistues) kanë katër kate mbi tokë;

d. Për leje ndërtimi për objektin **“Objekt banimi 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nën tokë”**, me zhvillues shoqëria “A.” ShPK:

- Nga verifikimi i projektit ndërtimor dhe krahasimi i tij me situatën faktike në terren është konstatuar se nuk është respektuar projekti ndërtimor, pasi objekti është i gjithi mbi tokë, pa kat nëntokë, dhe lartësia e katit të parë teknik është më e madhe se katet e tjera.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, i ndryshuar, pika a). *(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

35.1 Rekomandim: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), Bashkia Sarandë të merren masa për të kryer inspektime në objektet e mëposhtme:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Miratuar në:
1	Godinë banimi + shërbime 1, 4, 5 kate, me 2 kate bodrum, (parkim) nën tokë	Al. B.	19.06.2023
2	Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	H. C. & M. M.	24.02.2023
3	Objekt 3 kate dhe 1 kat podrum me funksion banimi	A. B.	22/02/2023
4	Objekt banimi 4 kat mbi tokë dhe 1 kat parkim nën tokë	“A.”	12/06/2023

Në rast se nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) vërtetohen konstatimet e grupit të auditimit, të merren masat e parashikuara në dispozitat ligjore, si nxjerrja e vendimit të dënimit me masë administrative gjobë, prishja e objektit ose pjesëve që kanë dalë nga leja e miratuar e ndërtimit, deri në kthimin në gjendjen fillestare ose të miratuar.

Menjëherë

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në bazë të data bazës elektronike që disponon IMTV Bashkia Sarandë u konstatuan pasaktësi në 42 raste praktike. Konkretisht, vendimet për gjobë janë mbajtur për subjekte ende të pa identifikuar, pa ofruar një arsyetim të qartë për llogaritjen e gjobës dhe pa specifikuar bazën ligjore (neni, pika dhe referencat përkatëse të ligjit). Gjithashtu, nuk është bërë kallëzimi penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë për subjektet që kanë kryer punime pa leje ndërtimi. Veprime në kundërshtim me nenin 5 *“Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore”* të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*; nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”* i ndryshuar; nenin 199/a të Kodit Penal. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

36.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të Bashkia Sarandë të analizojnë, të nxjerrin përgjegjësitë dhe të marrin masa, duke bashkëpunuar me Njësitë Bashkiake dhe Komisaratin e Policisë për identifikimin e ndërtuesve të pa ligjshëm për 42 praktikat me Vendime Gjore për vitin 2023, dhe ndjekjen e procedurave ligjore të përcaktuara për rastet e shkeljeve të konstatuara.

Deri në 30.07.2025

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: Në procesverbalin e konstatimit të shkeljes nuk ka një arsyetim për llogaritjen dhe bazën ligjore të gjobës së vendosur (neni, germa,

specifikimet e ligjit) si dhe nga Kryeinspektori i IVMT-së nuk ka vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit në dosjet e subjekteve: K. M.; V. M., Th. B.; G. S.; J. B.; G. M.; M. I., veprime në kundërshtim me nenin 30, të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

37.1 Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Sarandë të marrë masa, në referimin e bazës ligjore për llogaritjen e masës së gjobës si dhe të vijojë procedurat për arkëtimin e shumave të detyrimit sipas dosjeve të subjekteve: K. M.; V. M., Th. B.; G. S.; J. B.; G. M.; M. I..

Deri në 30.07.2025

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoratet e terrenit, Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka vijuar procedura për arkëtim e shumave të detyrimit sipas dosjeve të subjekteve: E. H. O. (për 100,000 lekë); F. Q. Ç. (për 1,925,000 lekë); F. T. K. (për 630,000 lekë); E. D. (për 2,940,000 lekë); A.F. B. (për 10,780,000 lekë); V. V. (për 2,520,000 lekë); B. H. B.(për 2,520,000 lekë); B. Gj. (për 34,125,000 lekë). Veprime në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative“ i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

38.1 Rekomandimi: IVMT Bashkia Sarandë të marrë masa, të vijojë procedura për arkëtim e shumave të detyrimit sipas dosjeve të subjekteve: E. H. O. (për 100,000 lekë); F. Q. Ç. (për 1,925,000 lekë); F. T. K. (për 630,000 lekë); E. D. (për 2,940,000 lekë); A. F. B. (për 10,780,000 lekë); V. V. (për 2,520,000 lekë); B. H. B. (për 2,520,000 lekë); B. Gj. (për 34,125,000 lekë).

Deri në 30.07.2025

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: Nga Kryeinspektori i IVMT-së i Bashkisë Sarandë është nxjerrë “Urdhri i Ekzekutimit“ për prishjen e objektit të kundërligjshëm, por nuk ka vijuar ndërhyrjen për “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, sipas dosjeve të subjekteve: F. Q. Ç.; S. Xh.; E. D.; K. M.; A. F. B.; V. V.; B. H. B.; V. M., Th. B.; B. Gj.; G. S.; J. B.; G. M.; Veprime në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

39.1 Rekomandimi: IVMT Bashkia Sarandë të marrë masa, për zbatimin e Urdhrit të Ekzekutimit sipas Vendimeve për prishjen e objekteve të kundërligjshëm, sipas dosjeve të subjekteve: F. Q. Ç.; S. Xh.; E. D.; K. M.; A. F. B.; V. V.; B. H. B.; V. M., Th. B.; B. Gj.; G. S.; J. B.; G. M.;

Deri në 30.07.2025

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: IVMT-ja e Bashkisë Sarandë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Sarandë me kallëzim penal për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në ngarkim të shtetasve S. Xh., E. D.; K. M.; B. Gj.; J. B.; G. M.; M. I.; veprime në kundërshtim me nenin 199/a të Kodit Penal. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

40.1 Rekomandimi: IVMT Bashkia Sarandë të marrë masa, të kryej kallëzim penal për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi në ngarkim të shtetasve S. Xh., E. D.; K. M.; B. Gj.; J. B.; G. M.; M. I.

Deri në 30.07.2025

41. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, të mbajtura nga Inspektoret e terrenit, nga Kryeinspektori i IVMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobë“, veprime në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 183-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

41.1 Rekomandimi: Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit Bashkia Sarandë të vijoj procedurën për nxjerrjen e Vendimit për “Dënim me Gjobë“, për 3 subjekte që janë me procesverbal konstatimi për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtim konkretisht nr. 000015, datë 06.03.2023 (pa identifikuar); 000076, datë 07.06.2023 (B. Gj.) dhe 000016, datë 06.03.2023 (pa identifikuar), të mbajtura nga Inspektoret e terreni.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja “b” dhe “c” -Të drejtat e KLSH-së, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Sarandë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **9,928,993 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Rikualifikim i rrugëve të brendshme me beton, Metoq, Berdenesh, Çukë, Manastir*”, Bashkia Sarandë, me vlerë të kontratës 7,774,464 lekë me TVSH, realizuar nga BOE “T.” ShPK & “C.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,257,520 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5 prot., datë 1.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe BOE T.” ShPK & “C.” ShPK; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7; si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,257,520 lekë pa TVSh** nga BOE “T.” ShPK & “C.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5 prot., datë 1.04.2023, me objekt: “*Rikualifikim i rrugëve të brendshme me beton, Metoq, Berdenesh, Çukë, Manastir*”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt:

“Ndërhyrje në Infrastrukturën e brendshme Ksamil”, Bashkia Sarandë 2023, me vlerë të kontratës 57,219,548 lekë me TVSh, realizuar nga OE “J. K.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **106,594 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7 prot., datë 20.04.2023të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe “J. K.” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **106,594 lekë pa TVSh** nga OE, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7 prot., datë 20.04.2023, me objekt: “Ndërhyrje në Infrastrukturën e brendshme Ksamil”, Bashkia Sarandë 2023, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikualifikim rrugë të brendëshme në Sarandë”. Bashkia Sarandë 2023, me vlerë të kontratës 29,141,277 lekë me TVSH, realizuar nga OE “E.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **178,730 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve (marrëveshje kuadër) nr. 20 prot., datë 20.04.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe OE “A.” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **178,730 lekë pa TVSh** nga OE “A.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën (marrëveshje kuadër) nr. 20 prot., datë 20.04.2023 me objekt: “Rikualifikim rrugë të brendshme në Sarandë”, Bashkia Sarandë 2023, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikualifikim rrugë të brendshme me asfalt në Gjashtë, Sarandë”, Bashkia Sarandë, me vlerë të kontratës 8,721,907 lekë me TVSh, realizuar nga OE “S.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **180,056 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6 prot., datë 18.04.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe OE “S.” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **180,056 lekë pa TVSh** nga OE “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6 prot., datë 18.04.2023, me objekt: “Rikualifikim rrugë të brendshme me asfalt në Gjashtë, Sarandë”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *Rikualifikim dhe ri veshje e rrugëve "Onhezmi" dhe rrugës "Adem Sheme", Bashkia Sarandë.*, me vlerë të kontratës 37,784,758 lekë me TVSh, realizuar nga OE "Sh." ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **163,350 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6 prot., datë 27.03.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe OE "Sh." ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **163,350 lekë pa TVSh** nga OE "Sh." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6 prot., datë 27.03.2023, me objekt: *Rikualifikim dhe ri veshje e rrugëve "Onhezmi" dhe rrugës "Adem Sheme", Bashkia Sarandë.*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Rikonstrukcion shkolla 9-vjeçare Adem Sheme, Sarandë."*, Bashkia Sarandë, me vlerë të kontratës 70,902,705 lekë me TVSh, realizuar nga OE "V. K." ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **4,608,563.36 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 13 prot., datë 22.12.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe OE "V. K." ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,608,563.36 lekë pa TVSh** nga OE "V. K." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 13 prot., datë 22.12.2022, me objekt: *"Rikonstrukcion shkolla 9-vjeçare Adem Sheme, Sarandë"*, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës faza II (loti përfundimtar)"*, Bashkia Sarandë., me vlerë të kontratës 378,836,979 lekë me TVSh, realizuar nga BOE "E. K." & "Sh." ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,871,980 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 10 prot., datë 22.10.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe BOE "E.K." & "Sh." ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 93-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,871,980 lekë pa TVSh** nga BOE "E. K." & "Sh." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në me nr. 10 prot., datë 22.10.2021, "*Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe Lugu i Dardhës faza II (loti*

përfundimtar)”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit me objekt pastrimi i qytetit, rezultoi se krahas procesverbaleve tepër formale të mbajtura pa asnjë tregues sasior apo cilësor konstatohet se ka mangësi të theksuara në dokumentimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe konkretisht:

Nuk është e dokumentuar shërbimi i larjes dhe dezinfektimit të kontejnerëve. Referuar pikës 24.6 të Kontratës, operatori duhet të kryejë këtë shërbim mesatarisht për 7 kontejnerë/ditë, duke bërë zëvendësimin e tyre për periudhën e kryerjes së shërbimit të larjes. Po kështu, referuar pikës 24.9 të Kontratës, *të gjitha lëndët dezinfektuese dhe aromatike dhe uji i përdorur për larjen e kontejnerëve, pra përbërja dhe leja e përdorimit duhet të jenë të miratuara fillimisht nga organet shtetërore shëndetësore dhe më pas edhe nga autoriteti kontraktor. Mos miratimi i lëndëve kimike të përdorura e bën të pa vlefshëm këtë shërbim dhe nuk mund të kryhet pagesa.* Nga auditimi nuk rezultoi të jetë marrë asnjë masë për verifikimin e zbatimit të këtij detyrimi nga operatori ekonomik pasi nuk evidentohet asnjë dokument miratues mbi produktet kimike të pastrimit as nga organet shëndetësore dhe as nga vetë autoriteti kontraktor. Pavarësisht kësaj, janë vijuar pagesat për larje e dezinfektim të cilat për periudhën objekt auditimi (korrik-dhjetor 2023) me pasojë dëm ekonomik në vlerën 481,712 lekë;

Po kështu, nga auditimi rezultoi se kontrata e shërbimit është nënshkruar mes palëve më datë 03.07.2023, ndërkohë që rezultoi se për muajin korrik operatori ka faturuar shërbime edhe para kësaj date, që më 01.07.2023, kur kontrata nuk ka qenë në fuqi, në një vlerë prej 1,080,488.2 lekë pa TVSh, me pasojë dëm ekonomik. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë në bashkëpunim me sektorin juridik dhe mbikëqyrësin e kontratës së shërbimit të pastrimit të qytetit, të marrin masa për njoftimin e operatorit ekonomik për kthimin e vlerës së përfituar në mënyrë të padrejtë dhe të pa dokumentuar prej 1,562,200 lekë, ose zbritjen e kësaj vlere nga situacionet e ardhshme të faturuara.

Brenda shtator 2025

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre në territorin e Bashkisë Sarandë, u konstatua se paraqiten me mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto subjekte dhe në evidentimin e mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se për vitin 2023, të **16 subjektet** të cilët operojnë në fushën e tregtimit të karburantit, Bashkia Sarandë nuk i ka pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, duke sjellë të ardhura të munguara për

Buxhetin e Bashkisë në shumën **24,640,000 lekë**, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave të autorizimeve / licencave.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35, VKM-në nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4, VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, i ndryshuar me VKM 344, datë 19.04.2017.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore në Bashkinë Sarandë, të marrë masa për identifikimin, regjistrimin, e përditësimin e subjektet që operojnë në fushën e karburanteve, si dhe arkëtimin e detyrimeve nga 16 subjektet, sipas *aneksit bashkëlidhur.*, në shumën 24,640,000 lekë në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i subjekteve të cilat kanë kryer punime ndërtimi për kontrata për investime publike u konstatua se gjatë vitit 2023, janë lidhur 20 kontrata për investime publike, për të cilat nuk janë tarifuar për shërbimet dhe për pastrimin.

Nga auditimi i të dhënave u konstatua se, për 20 kontratat e investimeve publike të lidhura me Bashkinë Sarandë dhe Operatorët Ekonomikë, nuk është proceduar me tarifimin mbi shërbimet e pastrimit sipas parashikimeve paketës fiskale. Detyrimi prej **2,090,000 lekë** përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën “b” të nënpikës 1.3 të pikës 1 në nenin 9, shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 35, shkronjën “f” të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikën 10 të nenit 3 dhe pikën 2 të nenit 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe pika B.1.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave nga taksat dhe tarifate vendore në bashkëpunim me Drejtorinë juridike në Bashkinë Sarandë, të marrin masa për krijimin e një regjistri, ku të përfshihen të gjitha subjektet që kryejnë punime ndërtimi për investime publike në territorin e Bashkisë.

2.2 Rekomandim: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa për arkëtimin në buxhetin e Bashkisë, nëpërmjet të gjitha rrugëve ligjore të shumës 2,090,000 lekë, për 11 subjekte, sipas *aneksit bashkëlidhur.*

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të plazhit në Bashkinë Sarandë, u konstatua se për vitin 2023 janë lidhur **93 kontrata me afat 1 vjeçar**, me sipërfaqe të kontraktuar me Bashkinë Sarandë prej 41,964 m², në vlerën prej 37,767,600 lekë. Gjithashtu përgjatë vitit 2023, kanë qenë aktive edhe 47 kontrata në shumën 25,138,800 lekë të lidhura nga vitet e mëparshme, konkretisht me afat 3 vjeçar (6 kontrata me sipërfaqe prej 5,112 m² në shumën 4,600,800 lekë), me afat 4 vjeçar (1 kontratë me sipërfaqe prej 315 m², në shumën 283,500 lekë) dhe me afat 5 vjeçar (40

kontrata me sipërfaqe prej 22,505 m², në shumën 20,254,500 lekë).

Gjatë vitit 2023, Bashkia Sarandë ka ushtruar kontroll në terren për verifikimin e subjekteve që kanë kontrata të lidhura me Bashkinë për shfrytëzimin e sipërfaqeve të plazhit. Nga auditimi i raporteve të kontrollit u konstatua se Bashkia Sarandë nuk ka vepruar me penalizimin e 82 subjekte (64 kontrata me afat 1 vjeçar dhe 18 kontrata me afat më shumë se 1 vit) të cilat kanë shfrytëzuar sipërfaqe më tepër prej 27,066 m², nga ato të lejuara/kontraktuara, duke mos i penalizuar rast pas rasti në shumën 24,359,400 lekë.

-Nga auditimi u konstatua se nga ana e Drejtorisë së Shërbimit në Bashkinë Sarandë nuk është vepruar me penalizimin e këtyre subjekteve, duke vendosur gjoba dhe penalitete shoqëruar me ndërprerjen e kontratës për shkak të shkeljeve të sipërfaqeve të lejuara, si dhe të arkëtohej shuma e tarifave sipas kontratave për këto sipërfaqe të shfrytëzuara në tejkalim të atyre të lejuara.

Nga auditimi i dokumentacionit mbështetës të kontratave të lidhura gjatë vitit 2023, konstatohen mangësi në lidhje me mos paraqitjen në dosjet e tyre të pagesës së taksave dhe detyrimeve fiskale në Bashkinë Sarandë, mungesa e planvendosjes për mundësimin e sipërfaqes dhe distancat e lejuara, mangësi edhe në procesverbalin e dorëzimit të sipërfaqes së kontraktuar.

Gjithashtu për vitin 2023 u konstatua se në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publik, si dhe mungonin procesverbalet e monitorimit të kontratave për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1172, datë 24.12.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.171, datë 27.3.2019, për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë Juridike, të marrë masa konkrete për pezullimin e 82 kontratave për subjektet, të cilat kanë shfrytëzuar hapësirat e plazhit gjatë vitit 2023 në tejkalim të sipërfaqeve të lejuara, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni në të ardhmen.

Menjëherë

3.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Bashkinë Sarandë, të merren masa konkrete për plotësimin e dokumentacioneve mbështetëse për kontratat e plazhit duke i shoqëruar me planvendosjen për mundësimin e sipërfaqes dhe distancave të lejuara, si dhe të bëhen pjesë të dosjes edhe aktet e kontrollit të verifikimit në terren, me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të kriterëve ligjore si dhe raportit sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe sipërfaqe në përdorim publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.3 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria Juridike, të marrin masa për arkëtimin nëpërmjet të gjitha rrugëve ligjore për detyrimet e konstatuara nga tejkalimi i shfrytëzimit të sipërfaqeve të lejuara, për 82 subjekte në shumën 24,359,400 lekë, sipas aneksit bashkëlidhur, si e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i kontratave për dhënien me qera të aseteve që Bashkia Sarandë ka lidhur gjatë vitit 2023, rezultoi se për 2 rastet e audituara, atë të dhënies me qera të ambienteve të lokal R. dhe S., grupi i punës për hartimin e dokumenteve të konkurrimit ka përcaktuar si vlerë dysheme të qirasë mujore, vlerën për pasuri që jepen me qera jashtë qytetit, pra

100 lekë/m², ndërkohë që të dy ambientet e lokaleve ndodhen brenda qytetit dhe konkretisht në zonën qendrore të qytetit të Sarandës, duke bërë që për bashkinë të rezultojnë të ardhura të munguara në vlerën totale prej 423,000 lekë (293,400 lekë nga lokal Riviera dhe 129,600 lekë nga lokal Sos). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Kapitulli III, pika a. (*Më hollësisht trajtuar në faqet 23-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë, nëpërmjet njësisë përgjegjëse për çështjet ligjore, të marrë masa për rishikimin e 2 kontratave lokal R. dhe lokal S., duke aplikuar çmimin që i takon zonës së qytetit prej 200 lekë/m², si dhe të kërkojë arkëtimin e diferencës së krijuar gjatë vitit 2023 nga aplikimi i çmimit për zonën jashtë qytetit dhe konkretisht 293,400 lekë nga lokal R. dhe 129,600 lekë nga lokal S..

Brenda shtator 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tetë raste, taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur e saktë, pasi çmimi mesatar referues i shitblerjes në qytetin e Sarandës është 56.000 lekë/m². Bashkia Sarandë aplikon dy lloje të ndryshme përqindjesh, 4% dhe 6%, sipas hartës së zonave fiskale. Kjo problematikë është evidentuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për **“Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me zhvillues z. H. Ç. dhe z. M. M., miratuar në 24.02.2023, me problematika si më poshtë vijon: Vlera e TNI-së e llogaritur nga grupi i auditimit është **8,201,760 lekë**. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **7,241,136 lekë**. Diferenca prej **960,624 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

2. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë”**, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 30.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

Vlera e TNI-së e llogaritur nga grupi i auditimit është **13,101,312 lekë**. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **8,157,632 lekë**. Diferenca prej **4,943,680 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë. Gjithashtu, kësaj vlere do të duhej t’i ishte shtuar gjashtë për qind e vlerës së preventivuar të ndërtimit të pishinës, vlerë e cila nuk është pjesë e preventivit të punimeve, dhe për këtë arsye nuk mund të llogaritet nga grupi i auditimit.

3. Leje ndërtimi për **“Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me zhvillues “S. R. E. G” ShPK, miratuar në 04.04.2023, me problematika si më poshtë vijon: Kjo taksë është llogaritur e saktë vetëm për objektin, por kësaj vlere do të duhej t’i ishte shtuar gjashtë për qind e vlerës së preventivuar të ndërtimit të pishinës, vlerë e cila nuk është pjesë e preventivit të punimeve, dhe për këtë arsye nuk mund të llogaritet nga grupi i auditimit. Pishina është pjesë e investimit, si e tillë, referuar përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për **“Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”**, i ndryshuar, pika 1, do të duhej të ishte bërë pjesë e vlerës totale të TNI-së.

4. Leje ndërtimi për **“Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nëntokë”**, me zhvillues “O. & A.” ShPK, miratuar në 28.04.2023, me problematika si më poshtë vijon: Vlera e TNI-së e llogaritur nga grupi i auditimit është **16,348,939 lekë**. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **15,118,656 lekë**. Diferenca prej **1,230,283 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

5. Leje ndërtimi për **“Godinë shërbimesh dhe hotelerie 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë”**,

me zhvillues L. Gj., miratuar në 10.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:
Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 54,008,307 lekë. Sipas VKB-së me nr. 160, datë 01.12.2022, për “*Miratimin e paketës fiskale të vitit 2023*”, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet në funksion të turizmit është **3%** mbi vlerën e punimeve (preventivi i punimeve). Referuar këtyre të dhënave, më poshtë po bëjmë llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt:

54,008,307 lekë * 3% = 1,620,249 lekë
--

Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **1,478,657 lekë**. Diferenca prej **141,592 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

6. Leje ndërtimi për “*Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë*”, me zhvillues E. O., miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

Vlera e TNI-së e llogaritur nga grupi i auditimit është **4,457,824 lekë**. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **3,604,160 lekë**. Diferenca prej **853,664 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

7. Leje ndërtimi për “*Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë*”, me zhvillues “S.-A.” ShPK, miratuar në 17.05.2023, me problematika si më poshtë vijon:

Vlera e TNI-së e llogaritur nga grupi i auditimit është **3,002,720 lekë**. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **2,810,528 lekë**. Diferenca prej **192,192 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë. Gjithashtu, kësaj vlere do të duhej t’i ishte shtuar gjashtë për qind e vlerës së preventivuar të ndërtimit të pishinës, vlerë e cila nuk është pjesë e preventivit të punimeve, dhe për këtë arsye nuk mund të llogaritet nga grupi i auditimit.

8. Leje ndërtimi për “*Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë*”, me zhvillues “E. G” ShPK, miratuar në 15.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

Vlera e TNI-së e llogaritur nga grupi i auditimit është **6,162,240 lekë**. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Sarandë është **6,025,600 lekë**. Diferenca prej **136,640 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë. Gjithashtu, kësaj vlere do të duhej t’i ishte shtuar gjashtë për qind e vlerës së preventivuar të ndërtimit të pishinës, vlerë e cila nuk është pjesë e preventivit të punimeve, dhe për këtë arsye nuk mund të llogaritet nga grupi i auditimit.

Minimalisht, diferenca midis taksës së ndikimit në infrastrukturë të llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Sarandë, për rastet e audituara, është **8,458,675 lekë**. Veprime në kundërshtim me nenit 46 të ligjit 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, si rrjedhojë, nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “*Sistemin e taksave dhe tarifave vendore*”. (Më hollësisht trajtuar në faqe 152-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, të merren të gjitha masat për:

- Të llogaritur në mënyrë të saktë vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke marrë në konsideratë sipërfaqet e sakta të objektit në zhvillim, sipas funksioneve, dhe koeficienteve të parashikuar në dispozitat ligjore;

-Të bërë të mundur arkëtimin e vlerave të llogaritura gabim nga Bashkia Sarandë, nga zhvilluesit:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Diferenca e TNI-së
1	Godinë banimi dhe shërbimi me 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	z. H. Ç. dhe z. M.M.	960,624 lekë
2	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë (1 kat parkim i hapur + 5 kate banim) dhe parkim nëntokë	“E. Group” ShPK	4,943,680 lekë
3	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	“S. R. E. Group” ShPK	1,230,283 lekë

4	Strukturë banimi me 2 – 6 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nën tokë	L. Gj.	141,592 lekë
5	Godinë banimi 6 kate dhe 1 kat parkim nëntokë	z. E. O.	853,664 lekë
6	Objekt banimi dhe shërbime 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S. –A.” ShPK	192,192 lekë
7	Objekt banimi 6 kate dhe pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“E. Group” ShPK	136,640 lekë
TOTALI			8,458,675 lekë

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua se në gjashtë raste janë skualifikuar operatorë ekonomikë për mangësi të cilat ishin të ngjashme me ato të operatorëve të tjerë që janë shpallur fitues.

Këto mangësi lidhen kryesisht me vetëdeklarimet e operatorëve dhe, në dy raste, me mungesën e verifikimit të angazhimit të të njëjtave makineri në kontrata të tjera ekzistues, duke rezultuar në kualifikimin e operatorëve me ofertë më të lartë, me pasojë efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë në vlerën 13,754,234 lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe parimet e 3E.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 93-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: KVO të marrë masa për garantimin e përdorimit me efektivitet të fondeve në dispozicion, duke vlerësuar me kujdes dhe paanshmëri mangësitë që çojnë në skualifikimin e operatorëve ekonomik, sidomos në rastet kur kjo vendimmarrje shoqërohet me pasoja financiare.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Pastrimi i qytetit” u konstatua se në përlllogaritjen e fondit limit janë përfshirë në mënyrë jo të drejtë zërat “kosto administrative 5%” dhe “amortizim i kontejnerëve”, të cilat kanë rritur në mënyrë joreale fondin limit në vlerën prej 8,388,166 lekë me pasojë efekt financiar negativ për buxhetin.

Më konkretisht, rezultoi se zëri “kosto administrative” është aplikuar në mënyrë të dubluar, pasi në preventivat përkatës janë përfshirë njëherë elementët që përmban kosto administrative dhe aplikimi për herë të dytë i masës prej 5% vlerës së preventivit, e dublon këtë kosto.

Ndërkohë sa i takon amortizimit të kontejnerëve, ato janë në pronësi të Bashkisë Sarandë dhe çdo kosto apo shpenzim për ta, zhvlerësohet në regjistrat e aseteve dhe llogaritë përkatëse kontabël të Bashkisë dhe nuk mund të konsiderohen si shpenzim që i kompensohet operatorit ekonomik. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, pika III/30, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe pikës 1.6 të VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 93-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Njësitë e prokurimit, gjatë përlllogaritjes së fondit limit, të marrin masa të analizojnë me kujdes elementët që përfshijnë në çmimin/njësi të shërbimeve që prokurojnë, pasi modelet e përlllogaritjes së kostove për menaxhimin e integruar të mbetjeve përmbajnë edhe zëra shpenzimesh për rastet kur Njësia vendore e kryen vetë shërbimin e pastrimit dhe jo çdo zë i këtij

modeli duhet të aplikohet gjatë rasteve kur Njësia vendore e prokuron shërbimin.

Në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

E1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore - “Vërejtje”, si më poshtë:

- 1. Z. T. H.**, në cilësinë e ish - nëpunësit të Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara, për 3 raste;
- 2. Z. N. H.**, në cilësinë e Kryeinspektorit për periudhën 29.06.2023-31.12.2023, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- 3. Z. P. I.**, në cilësinë e juristit dhe ish-kryeinspektorit të komanduar pranë IMT, për mos-ekzekutimin e vendimit të prishjes në një rast;
- 4. Z. K. R.**, në cilësinë e inspektorit në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit
- 5. Z. V. Q.**, në cilësinë e inspektorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- 6. Z. S. A.**, në cilësinë e inspektorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- 7. Z. A. H.**, në cilësinë e inspektorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- 8. Z. B. K.**, në cilësinë e inspektorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- 9. Z. R. M.**, në cilësinë e inspektorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- 10. Z. E. L.**, në cilësinë e specialistit të Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit publik, veçanërisht në administrimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët fitues;
- 11. Z. R. S.**, në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur;
- 12. Z. M. Zh.**, në cilësinë e Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur;

13. Zj.B. D. në cilësinë e Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit, si dhe në cilësinë e anëtares së Komisionit për përgatitjen e dokumentacionit për dhënien me qira të aseteve;

14. Z. A. B., në cilësinë e Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur;

15. Z. R. H., në cilësinë e Njesisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur

E2. Për punonjësit e larguar

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre:

1. Z. R. P.

2. Z. P. Zh.

3. Z. H. K.

4. Z. A. M.

5. Z. E. Z.

6. Z. A. B.

7. Z. J. M.

8. Z. K. A.

9. Z. V. Xh.

10. Z. R. Ç.

E.3. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Sarandë, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

